



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHE 12 TETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. I 12. OKTOBRA 2012. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Votimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011,
5. Interpelanca me ministrin Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së, lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komunikimet elektronike,
11. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011,
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
13. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe
14. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Alma Lama, lidhur me shpenzimin e fondeve publike nga Qeveria e Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje Godišnjeg izveštaja performanse sa revizijskim finansijskim pregledima Kancelarije generalnog revizora za 2011. godinu,
5. Interpelancija sa ministrom Enver Hoxhaj, po zahtevu PG LDK, u vezi sa stanjem spoljne politike Kosova,
6. Prvo razmatranje Nacrt zakona o platama javnih funkcionera,
7. Prvo razmatranje Nacrt zakona o proširenim nadležnostima za zaplenivanje imovine stečene krivičnim delom,
8. Prvo razmatranje Nacrt zakona o pravosudnom ispitu,
9. Prvo razmatranje Nacrt zakona o penzijskim šemama finansiranih od države,
10. Drugo razmatranje Nacrt zakona o elektronskim komunikacijama,
11. Razmatranje Izveštaja revizije godišnjih finansijskih pregleda Univerziteta Prištine za 2011.godinu,
12. Razmatranje Predlog-odluke Vlade Republike Kosova o imenovanju članova Nezavisnog borda za ponovno razmatranje žalbi,
13. Razmatranje Statuta Univerziteta Prištine i
14. Parlamentarna debata po zahtevu poslanice Alma Lama u vezi potrošnje javnih fondova od strane Vlade Kosova.

Seancën e drejtoi kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar 5 minuta, kurse në emër të deputetëve 3 minuta.

Sipas radhës, fjalën e ka kërkuar deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!
Tema për të cilën dua të flas sot ka të bëjë me studimin e fizibilitetit për Kosovën nga Komisioni Evropian.

Por, para se të filloj të flas për këtë, dua të përshëndes suksesin që arriti Shqipëria që ta marrë statusin e vendit kandidat. Mendoj që është një arritje e mirë me rastin e 100-vjetorit të Shqipërisë, sepse ka pasur një lloj padrejtësie në këtë proces, kështu që mirë që gjërat u vunë në vend.

Sa i përket Kosovës, do të doja gjithashtu ta përshëndetja një lajm të mirë, por unë nuk po shoh. Fatkeqësisht, në studimin e fizibilitetit për këdo që e ka lexuar, Kosova nuk konsiderohet shtet në këtë, por na vjen me një emër tjetër, dhe emri i cili i është vënë tani është - entitet.

Fatkeqësisht, pas marrëveshjeve që janë arritur në Bruksel, Kosova e ka fituar edhe fusnotën këtë vit. Në këtë raport, Kosova na erdhi me emrin “entitet me fusnotë”. Prandaj, ky dimension politik, sikur edhe dimension tjetër, që është më shumë teknik, nuk na jep mundësi shumë të gëzohemi dhe të jemi me entuziazëm, ashtu sikur u mundua të ishte dje Qeveria e Kosovës.

Dimensioni tjetër, i cili e karakterizon këtë studim, ka të bëjë me theksin që vihet pas skanimit të gjendjes.

Në një raport mjaft të shkurtër prej 15 faqesh e kam bërë një analizë shumë të thjeshtë dhe teknike. Fjala “korrupsion” përmendet plot 15 herë; fjalët “krim” dhe “krim i organizuar” përmenden plotë 12 herë. Përmenden për ta përshkruar gjendjen, por edhe për të kërkuar nga institucionet e Kosovës që t’i adresojë këto probleme.

Sundimi i ligjit vazhdon të mbetet çështja kryesore që e ngarkon jo vetëm Qeverinë, por edhe gjyqësinë. Janë disa masa që Qeveria e Kosovës duhet t'i ndërmarrë, por mbi të gjitha duhet të ketë vullnet politik për t'i adresuar këto çështje.

Një dimension tjetër i këtij studimi është edhe skanimi i gjendjes në veri. Natyrisht që nuk mund të fajësohet tërësisht Qeveria e Kosovës në lidhje me situatën atje, por nuk mund të jetë as tërësisht e pafajshme. Dhe, studimi i fizibilitetit kërkon drejtpërdrejt, ose institucionet evropiane kërkojnë drejtpërdrejt angazhimin e institucioneve të Kosovës për ta adresuar, për ta pasur alternativën e tyre, dhe kjo shprehimisht thuhet në raport, që Kosova duhet të ketë strategji. Deri tani nuk kemi parë strategji, edhe pse është promovuar me...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Pasi nuk është paraqitur askush, shkojmë sipas radhës. Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuara deputete dhe të nderuar deputetë,

Dua ta bëj një konstatim për hir të elektoratit. Edhe atëherë kur mund të mos pajtohem me një çështje në diskutim, vota ime do të jetë gjithnjë ashtu si vendoset në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Por, në këtë foltore nuk do të mungojë edhe mendimi im i lirë.

Nga zhvillimet e fundit në Kuvend është manifestuar një kakofoni në qëndrimet e Grupit Parlamentar të PDK-së dhe duke u përsëritur kjo, herë-herë krijohet përshtypja për nervozitet edhe në politikat e qeverisjes.

Disa nga këto aspekte vijnë edhe nga fakti se ekziston një demokraci e paprecedent në pragmatizmin tonë politik për shprehjen e mendimit dhe manifestimit, qëndrimeve opONENTE brenda Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kjo është vlera e kësaj shkëlqyese, që e karakterizon vazhdimisht dhe duhet të shërbejë për të tjerët si shkollë e demokracisë.

Por, edhe këto mendime duhet ta kenë një koncept për perspektivë dhe këto qëndrime duhet ta kenë një radius për inspirim.

Nëse njëri që sapo ka hyrë brenda ia tregon derën një themeluesi të subjektit, nuk kemi të bëjmë me shprehje të mendimit të lirë.

Gjithashtu, edhe përgjigjja e themeluesit të atakuar, kur vjen rrufeshëm, me qëllim për ta goditur në aspekte të integritetit dhe jo në mendimin plotësisht pa kompetencë, nuk është e qëlluar, madje e dëmshme si qëndrim dhe si leksion. Kur kapitulli i derës përsëritet dhe

bëhet fabul e bezdisshme, atëherë cenon individin dhe zvetënon institucioni dhe zhubravit e dëmton imazhin tonë.

Këto zhvillime duhet ta kenë fundin. Thërret zëri i arsyes. Është fat i mirë që kryeministri, si udhëheqës edhe i PDK-së, është treguar vizionar në sintetizimin e veprimeve utilitare dhe në konceptet strategjike.

Në përkushtimin e tij të koncentruar në të shumtën e kohës me pozitën e Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe me vizionin e Kosovës shtet të pavarur dhe funksional, nuk ka vërejtur koncepte skajshmërisht të ngushta rajonale të bashkëpunëtorëve në organizimin e institucioneve, duke e hendikepuar konceptin e tij evropian.

Pa u fokusuar te akëcili, kanë instaluar origjina të lagjes së tyre në pozita të larta politike administrative, duke e harruar një numër të madh të komunave, të cilat janë bastione të PDK-së, kanë edhe kuadro të përgatitura dhe shumë të devotshme.

Me evitimin e këtij lëshimi, inkorporimi i LBD-së, kontraktimi i ri me deputetë të pavarur dhe shkarkimi nga Ekzekutivi i atyre që kërkohet nga zërat e arsyes dhe nga miqtë tanë, ky koalicion i tashëm do të bëhej edhe më funksional dhe koncepti vizionar i kryeministrit për Kosovën evropiane do të rrezatojë edhe më shumë, pa e përjashtuar mundësinë për ta rritur numrin e partnerëve në koalicion. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Imri Ahmeti.

IMRI AHMETI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Pas fjalës së kryetarit të Kuvendit, zotit Krasniqi, në seancën e kaluar, për legjitimitetin e kontestuar të deputetëve, sikur ka vërshuar padrejtësisht nga të gjitha anët një vlerësim dhe etiketim i përgjithshëm, edhe gjeneral, se të gjithë deputetët e këtij parlamenti janë hajna, se të gjithë deputetët e këtij parlamenti janë milionerë, me paratë e abuzuara e të tjera.

Nëse kryeparlamentari në diskutimin e tij ka hedhur dyshimin e legjitimitetit të këtij Kuvendi për shkak të shumë parregullsive në zgjedhjet e fundit, për të cilat pajtohemi, kjo nuk i jep të drejtë askujt, as medieve, as shoqërisë civile dhe askujt tjetër, madje-madje as vetë kryeparlamentarit t'i emërojë të gjithë deputetët pa legjitimitet, t'i emërojë të gjithë deputetët hajna, t'i emërojë të gjithë deputetët që janë pasuruar me miliona të vjedhur.

Këto kualifikime publike dhe të përgjithësuara pothuajse nga të gjithë dhe për të gjithë janë absurde. Kuvendi nuk bën të ndodhet në këtë frymë, sepse ka detyrime dhe përgjegjësi kushtetuese që ta luftojë krimin, veçanërisht në radhët e veta.

Kualifikimet e tilla, nga kushdo qofshin ato, janë fyerje për të gjithë deputetët për personalitetin e tyre, përbuzje dhe degradim për institucionin e Kuvendit, si organi më i lartë i vendit.

Të nderuar deputetë,

Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë ta dinë se cilët deputetë janë hajna, cilët deputetë janë milionerë që e kanë keqpërdorur paratë publike. Madje-madje, nëse ka të tillë, siç shkruan shtypi këtyre ditëve, edhe cilët deputetë janë vrasës. Por, kjo mund të bëhet vetëm nëse zbulohen këto raste dhe ndahet drejtësia nga autoritetet përkatëse, e jo nëpërmjet deklarimeve publike dhe mediale se të gjithë janë njësoj.

Besoj se shumica e deputetëve nuk janë hajna. Besoj se shumica e deputetëve nuk janë pasuruar me keqpërdorimin e parasë publike, por jetojnë e punojnë me nder dhe janë përfaqësues legjitimë të qytetarëve të Kosovës, të cilët e kanë fituar këtë përfaqësim nga mbështetja e qytetarëve në sajë të kontributit politik dhe të vlerave të tyre personale.

Është mungesë e guximit të plotë e autoriteteve përkatëse publike për ta konkretizuar dhe adresuar fajësinë në të gjitha nivelet për atë se kush manipuloi me zgjedhjet, kush i vodhi votat dhe kush është duke e vjedhur dhe plaçkitur pasurinë shtetërore.

Në vend të akuzave të përgjithshme, si Kuvend kemi detyrim ligjor të kërkojmë llogaridhënie nga organet kompetente për zbatimin e ligjit që ato organe të jenë më efikase dhe më të përgjegjshme për luftimin e kriminalitetit të të gjitha llojeve dhe në të gjitha nivelet. Prandaj, është në shërbim të këtij Kuvendi, në shërbim të demokracisë dhe të qytetarëve tanë që organet e drejtësisë sa më parë ta thonë fjalën e vet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Në emër të grupit. Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë sot i kam dy çështje për t'i shtruar.

E para ka të bëjë me protestën e studentëve, e organizuar më 1 tetor të këtij viti. Para 15 vjetësh, më 1 tetor 1997, studentët e Universitetit të Prishtinës të dëbuar dhunshëm nga objektet e tyre universitare nga regjimi i dhunshëm serbë, veç tjerash, kërkuan çlirimin dhe lirinë e popullit tonë. Ata, ndërkaq, u sakrifikuan për shtetin që do të lindë e që për shumëkënd do të dukej vetëm si një ëndërr, për shtetin që natyrisht do ta kishte edhe qeverinë, e cila do ta udhëhiqte vendin e lirë.

Por, a mund t'i ketë shkuar dikujt ndërmend se Qeveria jonë pikërisht në 15-vjetorin e protestave masive studentore që e bënë historinë të ndërhyjë me forcë ndaj studentëve, djemve e vajzave tona.

Si rezultat i kësaj proteste, e drejtë e tyre e garantuar me ligj, ku pakënaqësia e tyre u shpreh pra nëpërmjet kësaj proteste, pati edhe studentë të lënduar, disa tjerë të ndaluar në Polici. Pse duhej të ndodhte një gjë e tillë? Kujt iu desh kjo?

Në vend të ndonjë ceremonie zyrtare, të organizuar nga Ministria e Arsimit, përkatësisht Qeveria, për shënimin e këtij përvjetori jubilar, u zgjodh e kundërta. Ato skena në asnjë rrethanë nuk do të duhej të ndodhnin, aq më tepër në shënimin e këtij jubileu.

Pamjet televizive para Rektoratit të Universitetit të Prishtinës më 1 tetor nuk dhanë imazh të mirë të qytetarët e Kosovës. Ndërkaq, ndërhyrja e Policisë së Kosovës, pavarësisht se kush i ftoi, thënë realisht nuk i bëri nder 1 tetorit të kësaj date historike në 15-vjetorin e saj, kur para së gjithash do të duhej përkujtuar e nderuar sakrifica studentore nëpër dekada e dekada me radhë.

Në vend të saj, fatkeqësisht, Qeveria e zgjodhi atë që në asnjë mënyrë nuk është dashur të ndodhë. Ndërhyrja e Policisë vërtet ishte e papranueshme.

Ndërkaq, çështja tjetër që dua të ngre ka të bëjë me regjistrimin e popullsisë.

13 vjet pas përfundimit të luftës dhe 4 vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova ende nuk di në të vërtetë se cili është numri i saktë i popullsisë së saj.

Sipas rezultateve preliminare të procesit të regjistrimit, një milion e 739 mijë e 825 është numri i banorëve që jetojnë në territorin e Kosovës, duke i përjashtuar komunat në pjesën veriore të Kosovës.

Rezultatet preliminare të regjistrimit të banorëve që jetojnë në territorin e Kosovës nuk e përmbajnë në vete shifrën përafërsisht 700 mijë qytetarë të Kosovës, që u larguan në 2-3 dekadat e fundit nga vendi. Ata u përjashtuan nga e drejta për të qenë banorë të atdheut të tyre. Pse? Gjithmonë sipas rezultateve zyrtare, shifra prej 700 mijë kosovarëve, që konsiderohen që jetojnë në diasporë pas viteve '90-ta, nuk përmban numrin e ish-banorëve të Kosovës, të cilën ende konsiderohen si diasporë kosovare, që jetojnë kryesisht në Turqi dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Numri i kësaj diaspore është shumëfish më i madh.

Procesi i regjistrimit të popullsisë, i ekonomive familjare dhe i banesave kishte filluar më 1 prill të vitit të kaluar, e në disa komuna zgjati më shumë se 15 ditë. Ky ishte regjistrim i parë i popullsisë, që bëhet pas 30 vjetësh në Kosovë, duke qenë se regjistrimi i fundit në të cilin kishin marrë pjesë të gjitha etnitë, ishte mbajtur në vitin 1981.

Sipas të dhënave të Entit Statistikave të Kosovës, në regjistrimin e popullsisë, në vitin 1981, Kosova e kishte një popullsi prej 1 milion e 584 mijë e 440 banorëve. Në anën tjetër, sipas vlerësimeve në vitin 1981, Kosova e kishte një popullsi prej 1 milion e 584 mijë, në anën tjetër, sipas vlerësimit të vitit 1991, në regjistrimin e bojkotuar atëbotë nga shqiptarët, Kosova i kishte 1 milion e 956 mijë e 196 banorë.

Prandaj, si është e mundur që pas plot 30 vjetësh Kosova të ketë rritje prej vetëm 200 mijë banorësh. Absurd! Kujt i konvenon kjo?

Për herë të parë, pas 30 vjetësh Kosova pati mundësi ta regjistrojë numrin e saktë të popullsisë së saj. Për fat të keq, dështuam të gjithë. Natyrisht, me fajin e Qeverisë së vendit. Shtrohet pyetja: Pse u manipulua ky proces jashtëzakonisht i rëndësishëm për Kosovën? Si është e mundur që, për shembull, në komunën e Gjakovës, numri i votuesve të jetë më i madh se numri i banorëve?! Nuk ka asnjë kuptim që për shkak të këtij keqveprimi shumë keq të organizuar dhe për më tepër shumë keq të mbikëqyrur, Kosova të dal me numër më të vogël banorësh, sesa i ka në të vërtetë.

Ndoshta një përfundim i tillë, i cili tash së shpejti do të publikohet edhe zyrtarisht, i konvenon pushtetit aktual, mirëpo jam e sigurt që publikimi i tillë i këtyre shifrave më së paku u konvenon qytetarëve të Kosovës, sidomos atyre që Qeveria i ka vendosur në gjumin e numrave, për të mos thënë inekzistues.

Është absurde të mbrohen numrat që nuk janë logjik...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e mora fjalën që të bëjë një kërkesë në emër të Grupit të Deputetëve të Rinj të Kuvendit të Kosovës, e cila vjen si rezultat i takimit që kemi pasur me të rinj nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci.

Ne e dimë se Ministria e Arsimit e ka bërë një marrëveshje me kryetarët e komunave të Preshevës dhe Bujanocit për regjistrimin e studentëve në këto komuna në UP në bazë të një kuote, brenda së cilës konkurrojnë aplikuesit që vijnë nga këto dy komuna, e në këtë rast duke iu bërë padrejtësi nxënësve që vijnë nga Medvegja, të cilët nuk kanë pasur mundësi aplikimi për shkak të mosmarrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe kësaj komune. Ne kemi marrë rekomandim nga ky takim që të propozojmë në Kuvend dhe Ministria nëpërmjet Kuvendit ta marrë porosinë dhe ta ketë konsideratë këtë propozim, propozimin e këtyre të rinjve që të hiqet kuota për këto komuna dhe t'u lejohet aplikimi të gjithë nxënësve nga të tri komunat, në bazë të meritës, arritjes në tekstin pranues të regjistrohen në fakultet, ose jo.

Konsiderojmë që ky propozim është me vend dhe presim që Ministria e Arsimit t'i ndërmarrë hapat e duhur në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

KRYETARI: Në emër të grupit?

REXHEP SELIMI: Jo.

Më 5 maj 2011, deputetët e Kosovës debatuan dhe e votuan një mocion të dalë nga interpelanca, që kishte kërkuar Lëvizja “Vetëvendosje”, dhe ky mocion i kishte 3 pika.

1. Të ndërpriten bisedimet me Serbinë,
2. Qeveria të ndërmarrë hapa konkretë për ta shtrirë autoritetin e shtetit të Kosovës në gjithë territorin e saj, veçanërisht në veri, dhe
3. Qeveria e Kosovës ta informojë rregullisht, çdo 3 muaj, Kuvendin e Kosovës për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Kosovës.

Nga ky mocion u votuan pika e dytë dhe e tretë e këtij mocioni dhe ky votim i shndërroi këto pika në vendime të Kuvendit. Pra, pika e tretë e obligon Qeverinë ta informojë Kuvendin çdo tre muaj për hapat e ndërmarrë.

Jo vetëm që nuk raportoi dhe nuk e informoi asnjëherë Kuvendin për hapat e saj konkretë, por me këtë Qeveria e Kosovës manifestoi edhe një herë se nuk e njeh këtë Kuvend dhe nuk i përfill vendimet e tij. Në të njëjtën kohë, Qeveria nuk e njeh këtë Kuvend dhe po vazhdon t’i shkelë vendimet e këtij Kuvendi dhe njëkohësisht po vazhdon ta shkelë edhe Kushtetutën që e ka aprovuar vetë.

Përderisa mocioni kishte të bënte drejtpërdrejt me problemet që ka Kosova me Serbinë dhe ndërhyrjes së kësaj të fundit në territorin e Republikës së Kosovës, Qeveria në vend që t’i zbatojë vendimet e Kuvendit, ajo pikërisht po e bën të kundërtën, po i shkel vendimet e Kuvendit dhe po i zbaton me zell marrëveshjet me Serbinë.

De fakto dhe de juro, Kosova po merr obligime ndaj marrëveshjeve me Serbinë si rezultat i bisedimeve me të, duke mos i respektuar njëkohësisht edhe obligimet që dalin nga Kuvendi i Kosovës.

Sa për ilustrim, më lejoni të jua rikujtoj vetëm një nga zbatimet e marrëveshjeve - zbatimi për marrëveshjen me targat, kur Qeveria e Kosovës pranoi të hiqet shkronja “R” nga targat e Kosovës në raport me Serbinë dhe këtë “R”, pra “Republikën”, asnjëherë nuk e shtriu në territorin e saj, përkatësisht në veri.

Pra, kërkojmë edhe një herë nga Qeveria që t’i zbatojë vendimet e Kuvendit, e jo t’i shkelë ato. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Fadil Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: I nderuari kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Dua të ngre një çështje rreth vendosjes së arkave fiskale nga bizneset në vendin tonë.

Çështja e vendosjes së arkave fiskale nga bizneset në Kosovë dhe dhënia e kuponëve fiskalë konsumatorëve është në fazën që mbetet për të dëshiruar.

Në një shtet ligjor dhe demokratik, patriotizëm në kuptimin e mirë të fjalës është edhe kur kërkohet kuponi fiskal për çdo artikull që blihet, sepse është në funksion të forcimit të ekonomisë së shtetit dhe të rritjes së mundësisë së investimeve.

Në shoqëritë e zhvilluara me fanatizëm u kushtohet kujdes këtyre çështjeve, si nga institucionet, ashtu edhe nga qytetarët. Këtë logjikë duhet ta instalojmë sa më shpejt që të jetë e mundur edhe në vendin tonë.

Në një seancë më herët, ministri i Financave i pati dhënë disa shifra inkurajuese, por Administrata Tatimore e Kosovës duhet të bëjë hapa të shpejtë deri në realizimin e plotë të këtij projekti.

Nuk është i mjaftueshëm marketingu televiziv për kërkimin e kuponëve fiskalë, duhet të vazhdojnë të gjitha format e promovimit.

Si rezultat i së kaluarës së hidhur, që e kemi kaluar si vend, qytetarët ende ngurojnë të jenë bashkëpunues me organet përgjegjëse. Duhet sensibilizimi dhe vetëdijesimi i të gjithë qytetarëve se bashkëpunimi me shtetin është interes i përgjithshëm publik.

Kështu si është tani, sa i përket çështjes së arkave fiskale, e kemi një situatë kaotike me tri kategori. Njëra, që është më e veçanta, ajo që i ka vendosur arkat fiskale dhe i përdor plotësisht kuponët fiskalë. Nëse vazhdon të diskriminohet kjo kategori nga konkurrenca jo e barabartë në treg, nuk mund të presim rezultate të kënaqshme.

Kategori tjetër është ajo që i ka të vendosura arkat fiskale e nuk i përdor kuponët fiskalë, por vetëm në rastet kur i kërkohen. Kjo është mjaft problematike.

Dhe, e treta, ajo që nuk i ka të vendosura arkat fiskale. Për këtë s'kam koment fare.

Unë dua ta përmend vetëm një fushë të biznesit. Të gjithë jemi dëshmitarë se pothuajse në gjitha pompat e derivateve, në gjithë territorin e vendit, bëhen keqpërdorime. Ato kanë arka fiskale, por nuk ua ofrojnë qytetarëve kuponët fiskalë, vetëm në rast se ata janë të vendosur ta marrin.

Këtë vendosmëri nuk jam fort i bindur që e kemi madje as ne deputetët kur jemi me vetura tona. Nuk duhet të qëndrojmë indiferentë në këto situata.

Mosvëmendja e qytetarëve për rëndësinë e kuponit fiskal, apo loja e pronarëve me kohën e konsumatorit sa ai duhet të presë nëse dëshiron ta marrë kuponin fiskal duhet të ndalet sa më shpejt dhe në formë ligjore.

Për funksionimin e arkave fiskale, përgjegjës do të jetë, si shitësi që nuk e ka lëshuar kuponin fiskal, ashtu edhe blerësi që nuk e ka marrë atë. Konsumatori nuk duhet në asnjë mënyrë t'i bashkëngjitet shitësit në evazionin fiskal që e shkakton.

Çështja e kuponëve fiskalë, të nderuar kolegë deputetë, është vetëm një segment prej shumë të tjerëve, që ka nevojë për një ndërhyrje shumë më efikase të organeve përgjegjëse në funksion të forcimit të shtetit ligjor. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: I nderuari kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Në tetor të vitit 2008 hyri në fuqi Ligji për pensionet e pjesëtarëve të TMK-së dhe i njëjti filloi të aplikohet në shkurt të vitit 2009, si parakusht për ta krijuar FSK-në.

TMK-ja numëronte pak mbi 3 000 pjesëtarë, por gjysma e tyre nuk i arriti standardet dhe kushtet për pranim në FSK. Gjysma e mbetur jashtë uniformës u trajtua me Ligjin në fjalë, i cili ndër të tjera garantonte pensione për grupmoshën mbi 45 vjet.

Krahas ligjit për pjesëtarët e demobilizuar, nga fondet dhe programet e ndryshme u siguruan pagat për një vit shtesë dhe kredi të pakthyeshme prej 2 500 euro për çdo individ.

Me ta kuptuar situatën jo aq të favorshme, pjesëtarët e TMK-së organizuan protesta para Ministrisë së FSK-së, e cila ishte në krijim e sipër.

Një delegacion i tyre u pranua në bisedime nga Shtabi i Përgjithshëm, autoritetet e Ministrisë dhe të Qeverisë, me ç'rast ata i shprehën pakënaqësitë dhe kërkesat.

Të demobilizuarit u garantuan se do të gëzojnë përkujdesjen e vazhdueshme institucionale, me të cilën do ta kenë mundësinë e punësimit në institucionet qendrore, lokale, agjencitë e ndryshme, shërbimet, ndërmarrjet publike e të tjera.

Për këtë arsye u themelua edhe Zyra për Çështje të Trashëgimisë së TMK-së, e cila do të përkujdesej për nevojat esenciale të ish-pjesëtarëve të TMK-së.

Sot, pas 4 vjetësh, rreth 650 ish-pjesëtarë të TMK-së janë pa asnjë përkujdesje dhe trajtim institucional, që do të thotë se janë pa punë, pa të ardhura financiare dhe me shpresa të zbehta për të ardhmen e tyre.

Të njëjtit që për 10 vjet ishin në uniformë në shërbim të shoqërisë, shumica prej tyre edhe pjesëmarrës të UÇK-së, u gjendën në rrugë, ku e kishin humbur hapin për risocializim nga jeta ushtarake në atë civile.

Për ta ishte shumë vonë për shkollim e rikualifikim, por shumë herët për ta gëzuar pensionin sipas ligjit. Shumica e kësaj kategorie e kanë kualifikimin dhe përvojën në fushën e sigurisë, emergjencave, për menaxhim të situatave, komunikim, AIT-i, deminim e tjera.

Sensibilizimi i dobët i shoqërisë, nepotizmi, moskujdesi deri në përbuzje në institucionet qendrore dhe ato lokale ndaj nevojave elementare të ish-pjesëtarëve të TMK-së i detyron të njëjtit t'i shprehin pakënaqësitë e tyre si përkujtues për autoritetet e Qeverisë se çështja e këtyre pjesëtarëve ka nevojë për trajtim të vazhdueshëm.

Kërkoj nga organet e Qeverisë së Kosovës që në agjendën e saj ta trajtojë këtë situatë, duke siguruar fonde, programe dhe vende pune për të gjithë ish-pjesëtarët e TMK-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Flas në emër të grupit.

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Ditëve të fundit kanë dalë disa deklarata nga këshilltari i Presidentes, zoti Ramush Tahiri, i cili i zbuloi disa fakte shumë interesante për punën e saj gjatë kohës së fundit. Ai tha që Presidentja është takuar me pjesëtarët e strukturave paralele serbe, ka mbajtur pra takime të fshehta nga opinioni, sepse këtë nuk e kemi ditur deri në momentin kur ai foli, dhe po ashtu tha që, si këshilltar, ky i konsideron këto struktura të jenë legjitime, pra në njëfarë mënyre tha që këto struktura janë të pranueshme për Presidencën dhe prandaj Presidentja është takuar dhe do të bisedojë me to.

Të gjithë ne pajtohemi, ose të paktën deklarativisht në sferën publike, që strukturat e Serbisë në Kosovë janë kriminale dhe janë të paligjshme, e rrjedhimisht janë edhe antikushtetuese. Si të tilla, ato, natyrisht, do të duhej të ndiqeshin penalisht. Me to duhet të merren institucionet e sigurisë dhe ato të drejtësisë. Pra, me krimin e organizuar nuk mund të ketë kurrfarë kompromisi.

Në Republikën e Kosovës është i paligjshëm dhe jolegjitim çdo post publik antikushtetues. Liderët e komunave serbe në veri të Kosovës janë zgjedhur në zgjedhjet e Serbisë, të mbajtura në Kosovë padrejtësisht dhe kundër ligjeve tona, madje-madje edhe në kundërshtim me një rezolutë që e ka nxjerrë ky Kuvend për t'i kundërshtuar ato zgjedhje.

Dhe, rrjedhimisht, tash Presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga, sipas këshilltarit të saj, zotit Ramush Tahirit, i paska takuar këto struktura, duke i konsideruar ato legjitime. Pra, i paska takuar strukturat paralele të Serbisë, të cilat i konsideron legjitime vetëm pushteti në Beograd.

Unë e kam një pyetje për Presidenten: A mund të na tregojë ajo, kush ka qenë në këto takime prej këtyre strukturave paralele? Pra, a e di ajo me kë është takuar? Për shkak se ne e dimë që këto struktura paralele kanë qenë të përfshira në krimet prej më të ndryshmeve kundër qytetarëve të Kosovës. Janë të përfshira në vrasjen e shqiptarëve nëpërmjet sulmeve terroriste; janë të përfshira në vrasjen e policit të Kosovës Enver Zymberi; janë të përfshira në uzurpimin e pronës publike; janë të përfshira në uzurpimin e pronës private të shqiptarëve atje. E, për të gjitha këto krime, a e di Presidentja, a e ka takuar ndonjë pjesëtar, i cili drejtpërdrejt i ka kryer këto krime, për shkak se po thotë se është takuar me mbështetësit e tyre politikë.

Ne konsiderojmë që ky veprim i Presidentes së Republikës së Kosovës është i papranueshëm dhe në kundërshtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në kundërshtim të plotë me postin e saj si presidente. Rrjedhimisht, kjo është arsye e mjaftueshme që kjo presidente të thirret para përgjegjësisë dhe kjo presidente të japë dorëheqje nëse këto takime janë të vërteta, siç ka thënë këshilltari i saj, Ramush Tahiri.

Dhe, e kam një pyetje tjerë edhe për Qeverinë. A e keni ditur ju që Presidentja po takohet me strukturat paralele edhe çka keni ndërmarrë? Pra, nëse e keni ditur dhe i keni miratuar me heshtje këto takime, atëherë a i konsideroni edhe ju këto struktura legjitime dhe a është ky një përdorim i postit të Presidentes për t'ua hapur juve rrugën në mënyrë që t'i vazhdoni tash takimet me strukturat paralele, duke thënë ja që Presidentja po i konsideron legjitime, rrjedhimisht do t'i konsiderojmë edhe ne të tilla.

Dhe, për fund, e kam edhe një pyetje për njërin prej deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për zotin Elmi Reçica, meqenëse qenka këtu. Duke pasur parasysh që të gjithë e dinë që Ramush Tahiri është mik juaj i ngushtë, a e keni ditur edhe ju që këto takime kanë ndodhur dhe çfarë keni ndërmarr ju, nëse e keni ditur? Faleminderit!

KRYETARI: Jemi në pikën e rendit të ditës deklarime jashtë rendit të ditës, e jo në pikën e pyetjeve parlamentare. Fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj ta shtroj një çështje që po ashtu u shtrua nga një koleg deputet dhe dua ta shtroj në dimensionin që i takon. Dje, Komisioni Evropian e ka publikuar një dokument të rëndësishëm, e ka publiku studimin e fizibilitetit për Kosovën. Deri më tash konsiderohet që është konfirmimi më serioz që i ka ardhur vendit tonë lidhur me procesin e integritimeve evropiane. Deri më sot konsiderohet që është dokumenti që e inkurajon më së shumti, jo vetëm Qeverinë e Kosovës, Parlamentin, institucionet lokale, shoqërinë civile dhe gjithë shoqërinë kosovare për të punuar edhe më shumë në përmbushjen e kriterëve për integrim në BE.

Dje, zoti Fyle, me prezantimin në pjesën për Kosovën, tha që Kosova po ecën me hapa të mëdhenj drejt BE-së dhe sa po të përmbushen kriteret e BE-së do të ndërmerren hapa konkretë në procesin e ardhshëm për pranimin ose për kyçjen e Kosovës në stabilizim-asociim, në këtë proces që ka herë është kërkuar nga Kosova.

Po ashtu, u përmend se Kosova duhet të vazhdojë t'i përmbushë edhe kriteret që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit, me administratën publike, me pakicat, me tregtinë, me gjyqësinë, me të drejtat e njeriut, me reformat elektorale e tjera. Dëshiroj të them që kjo nuk është dekurajuese, përkundrazi do të konsiderohet fat që Kosovës i janë dhënë këto kriterë, duke u barazuar me të gjitha shtetet tjera, të cilat i kanë përmbushur ato. Pra, tani më duhet, për mendimin tim, që edhe Kuvendi i Kosovës ta rishikojë strategjinë e vet për procesin e integritimeve evropiane në përputhje me këtë dokument dhe po ashtu duhet të shikohet i gjithë procesi; duhet të inkurajohen gjithë faktorët në Kosovë; të gjithë ata që kanë detyra për të bërë për sa i përket këtij procesi; t'i harmonizojnë ato dhe t'i bashkërendisin bashkë me Qeverinë e Kosovës në rrugën, e cila është më e rëndësishmja deri tash drejt integritimeve evropiane.

Më lejoni të ju them po ashtu se dje, edhe shteteve tjera rreth nesh, u është atribuuar një sukses. Suksesi më i madh konsiderohet, edhe pse me kushtëzime, statusi kandidat për Shqipërinë. Ne duhet ta vazhdojmë bashkëpunimin me këto shtete, duke pasur parasysh që e kemi marrë një ndihmë të madhe, veçanërisht nga Shqipëria, sa i përket përvojës së saj në këtë rrugë të gjatë dhe të mundimshme. Kosova po ashtu duhet të vazhdojë në përmbushjen e kriterëve të saj në këtë proces.

Unë kërkoj që në vend të debatit, i cili shpeshherë po bëhet sensacional për çështje të ndryshme, t'i kthehemi debatit për kriterë të rëndësishme bashkë me Qeverinë dhe institucionet tjera, që kanë përgjegjësi në këtë aspekt, debatit se si të përmbushen këto kriterë në mënyrën sa më të mirë dhe më të shpejtë dhe Kosova sa më shpejt të hyjë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Me kaq përfundon pika e parë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë mbledhje janë parashtruar 8 pyetje parlamentare. Mirëpo, ministri i Financave, Bedri Hamza, e ka njoftuar Kuvendin se nga data 9-17 tetor 2012 është në vizitë zyrtare jashtë vendit, prandaj pyetjet e deputetes Hykmete Bajrami parashtruar atij janë shtyrë për mbledhjen e radhës.

Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Enver Hoxhaj. Deputet, e ke fjalën. A është këtu deputeti? Nuk është. Deputetja Alma Lama, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputete e ke fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Siç është bërë zakon, sa vjen koha e pyetjeve parlamentare, kryeministri frikësohet dhe e lëshon seancën. Por, unë pyetjen do ta bëj, gjithsesi. Pyetja ime lidhet me vizitën e tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mbledhjen e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara dhe në lidhje me ushtrinë e zyrtarëve që ai e ka marrë me vete në këtë asamble. Desha t'i

di rezultatet e kësaj vizite, e cila, në bazë të asaj që është publikuar dhe mund të analizohet, ka kushtuar më shumë se 200 mijë euro. Pra, cilat janë rezultatet, sepse ne e pamë kryeministrin në marginat e takimeve, i cili suksesin më të madh e pati me takimin me zonjën Eshton, të cilën mund ta takonte, për shembull, edhe në Bruksel. Nuk kishte nevojë për të fluturuar deri atje. Kjo ishte pyetja ime lidhur me kryeministrin për dështimin e vizitës atje.

KRYETARI: Dhe, pyetja e dytë? Se dy pyetje i ke.

ALMA LAMA: Edhe pyetja e dytë është e njëjtë. Lidhet pikërisht me justifikimin për numrin e madh të zyrtarëve, të cilët i ka marrë me vete. Dakord, prania e Kryeministrit, e Presidentes dhe ministrit të Jashtëm është e justifikueshme atje. Por, të marrësh kaq shumë ministra të tjerë dhe zyrtarë dhe t'i paguash me buxhetin e shtetit edhe për aktivitetet, të cilët nuk janë fare zyrtare, mendoj se kjo është tërësisht e papranueshme. Nuk e kuptoj se çfarë kanë bërë ata ministra atje dhe cili është rezultati i atyre takimeve. Vetëm nëse i kanë mbajtur valixhet e ministrave, sepse kanë marrë shumë këshilltarë e fotografë e tjerë, e si duket ky mentaliteti ballkanik - që dikush duhet t'u shërbejë - se ministrat janë shumë të mëdhenj, është shumë i pranishëm këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet Afrim Kasolli, qëndro në sallë! Pyetje për ministrin Enver Hoxhaj.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Më fal se isha pak i zënë.

Çështja: Shumë qytetarë të Kosovës, të cilët aktualisht jetojnë e veprojnë në Republikën e Kroacisë, pasi ta plotësojnë afatin ligjor për përfitimin e nënshtetësisë së Kroacisë ndeshen me vështirësi paradoksale, administrative dhe juridike. Me këtë rast, autoritetet kroate, edhe pse e kanë njohur shtetin e Kosovës dhe dokumentet e lëshuara nga Republika e Kosovës, kërkojnë nga këta qytetarë që për ta fituar këtë të drejtë duhet ta dorëzojnë shpërnguljen e lëshuar nga Republika e Serbisë. Kjo kërkesë po u krijon këtyre qytetarëve shumë vështirësi në veprimtarinë e tyre në këtë shtet, si dhe po e mban në një gjendje ambivalente statusin juridik dhe ligjor. Pyetja për ministrin është: Çfarë ka bërë Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës në tejkalimin e kësaj gjendjeje dhe në zgjidhjen e këtij problemi? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryetar,

Shumë të respektuar deputetë,

I nderuari deputet,

Më lejoni që për temën që ju e shtruat ta jap një përgjigje sa më të shkurtër. Gjatë vitit të kaluar dhe gjatë këtij viti, unë katër herë e kam shtruar këtë çështje në takim me ministrat e Punëve të Jashtme të Kroacisë. Së fundi, më 5 tetor 2012, kur ministrja kroate ishte në vizitë në Kosovë kam biseduar për temën e tillë dhe jam më se i sigurt që në një hapësirë kohore të përshtatshme, autoritetet kroate nuk do të kërkojnë më nga qytetarët e Kosovës që realisht të heqin dorë nga shtetësia serbe, meqë një kërkesë e tillë është e paligjshme, është e padrejtë dhe të njëjtën kohë e shkel dinjitetin e qytetarëve të Kosovës.

Unë do të jua ofroj edhe një material të detajuar për të gjitha komunikimet që i kemi pasur deri më tash dhe jam më se i sigurt që deri në janarin e vitit 2013, nga autoritetet kroate do të kem një përgjigje të plotë dhe të saktë.

Po ashtu, dua të ju them që nuk është Kroacia vendi i vetëm, sepse një situatë të tillë e kemi edhe me Slloveninë dhe në këtë çështje e kemi trajtuar edhe me autoritetet sllovene, ndërsa në Kuvendin e Kosovës ka qenë një pyetje edhe nga një deputete tjetër sa i takon 'Republikës së Bajernit', meqë edhe kjo pjesë e Gjermanisë shpeshherë i ka vështirësuar procedurat e dhënies së shtetësisë me argumentet e njëjta. Edhe tek autoritet gjermane ne kemi bërë disa shkresa, disa takime dhe besoj që do të merrni edhe ju, por edhe deputetët të tjerë përgjigje të plota, sa i takon një shqetësimi të tillë.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

Më shumë se një formë komenti. Për shtetet tjera unë nuk e kam ditur për shkak se qytetarët e Kosovës që jetojnë në Republikën e Kroacisë janë adresuar tek unë për këtë problem, meqë nuk kanë gjetur adresë tjetër institucionale, veçanërisht në kohën e fundit kur Ambasada e Kosovës në Kroaci është duke u treguar shumë indolente në trajtimin e këtij problemi. Për këtë arsye e kam shtruar këtë problem.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Dua vetëm të ju informoj, i nderuar zoti deputet, që vitin e kaluar, kur unë kam qenë në vizitën e parë bilaterale dhe zyrtare në Kroaci, jam takuar me qytetarët e Kosovës që jetojnë në Kroaci dhe temë kryesore ka qenë çështja e shtetësisë kroate dhe procedurat e komplikuara.

Unë ju premtoj që ne si Ministri e Punëve të Jashtme do ta kryejmë punën tonë. Ndërsa komentin që e pate sa i përket ambasadës, do ta marrë me seriozitetin më të madh. Mirëpo, qëllimi i informimit tim ishte që në të gjitha nivelet me presidentin Josipović, me kryeministrin, me ministrin e Punëve të Jashtme, me kryetarin e Kuvendit të Kroacisë, e kemi shtruar disa herë një kërkesë të tillë dhe e kemi një person përgjegjës, i cili merret me këtë çështje, edhe sa i takon Kroacisë, edhe Sllovenisë, mirëpo edhe sa i takon Bajernit.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, pyetja është një çështje që mua më shqetëson dhe nuk ia kam bërë pyetjen ministrit, pse ai është përgjegjës pikërisht për këtë, por nga aspekti profesional kam menduar që mund ta japë një përgjigje dhe së bashku të kontribuojmë, nëse normalisht shumica mendon që kjo çështje mund të rregullohet.

Për shkak të situatës politike dhe të ndryshimeve të shumta që ka pësuar Kosova që nga paslufta, ky Kuvend, në këtë legjislaturë, duke përfshirë edhe legjislaturat e tjera ka bërë plotësim-ndryshime të ligjeve, duke e sjellë për secilin rast edhe një ligj të ri, që e plotëson dhe e ndryshon një ligj tjetër ekzistues. Ky proces i plotësim-ndryshimit të ligjeve ka bërë që pothuaj secili ligj të jetë i fragmentuar në disa dokumente, gjë që, mendoj unë, nuk është fare praktike dhe nuk shkon aspak në favor të zbatimit të ligjeve. Është mirë që të kemi ligje të mira dhe të ju përshtatemi rrethanave, por ne të gjithë e kemi obligim që ta bëjmë më të lehtë punën për ata që duan t'i zbatojnë ligjet. Pyetja është: A ka mundësi që të gjitha ligjet, që si pjesë të tyre i kanë edhe një apo dy ligje që i plotëson dhe i ndryshon ato, të harmonizohen në një dokument të vetëm, e jo ta kemi ligjin të ndarë në disa pjesë. Nëse po, kush duhet ta bëjë këtë: A jeni ju të gatshëm si Ministri e Drejtësisë ta inicioni një proces të tillë, meqenëse po thuaj të gjitha ligjet për plotësim-ndryshim sponsorizohen nga Qeveria, apo këtë duhet ta bëjë Parlamenti? Unë e kam shtruar këtë edhe në Komision dhe kam dëshiruar që kjo çështje të shkojë në Kryesi, por nuk e kam pasur përkrahjen e Komisionit, kështu që jam detyruar ta bëj në formë të pyetjeve parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Administrata ka pasur mundësi të japë përgjigje, por megjithatë urdhëro zëvendëskryeministër Kuçi.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë, anëtarë të Qeverisë,

E nderuara deputete Bajrami,

Ju falënderoj për pyetjen! Unë mendoj që është njëra prej sfidave, me të cilën ballafaqohen njerëzit që i implementojnë ligjet në Kosovë. Dhe, duhet të them shumë sinqerisht, edhe njëra prej pyetjeve më sfiduese në kuptimin më pozitiv të mundur dhe po ashtu është njëra prej çështjeve që krijon huti, qoftë te implementuesit e ligjeve, por edhe te qytetarët, ngase e kemi një lëmi të caktuar, që ligji është amendamentuar disa herë, e më pastaj kemi nënligje të shpërndara dhe shpeshherë vendimmarrësi në implementimin e ligjeve apo ata që njoftohen për ligjet nuk mund ta gjejnë në kohën apo në vendin e duhur, e kjo nganjëherë krijon pamundësi që ligji të zbatohet si duhet, apo në mënyrë adekuate.

Mu për këtë, Ministria e Drejtësisë ka propozuar që në strategjinë legjislative të këtij viti të jetë Projektligji për aktet normative dhe po ashtu Ministria e Drejtësisë dhe unë personalisht e kam marrë një vendim, duke e angazhuar Departamentin për Çështje Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë që të bëjë përgatitjen e unifikuar të ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, të plotësuara apo të ndryshuara, me ligje për plotësimin dhe ndryshimin e ligjeve bazike.

Po ashtu, e kam angazhuar Ministrinë e Drejtësisë që gjatë përgatitjes së teksteve të unifikuara me ligje të konsultohet me të gjitha institucionet e përfshira në rastin e hartimit dhe miratimit të legjislacionit në Republikën e Kosovës, në veçanti me njësitë përkatëse të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me Zyrën e Presidentit, me Zyrën e Kryeministrit dhe me njësitë tjera përkatëse të institucioneve që propozojnë ligje.

Gjithashtu kërkoj që të gjitha tekstet e ligjeve të unifikuara të dërgohen dhe të publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe njësia përkatëse, apo Departamenti për Çështje Ligjore, dhe Ministria e Drejtësisë është e gatshme t'i kryejë punët organizative, teknike, profesionale, po ashtu logjistike e financiare për këtë.

Unë dua të besoj që ky mandat do t'i jepet me ligj Ministrisë së Drejtësisë, por ndërkohë jemi duke punuar teknikisht në harmonizimin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Praktikë e parlamenteve tjera është - autorizohet Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta bëjë spastrimin e ligjeve. A ke pyetje shtesë deputete? Jo. Faleminderit!

Deputetja Kymete Bajraktari, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministri nuk është këtu: A do ta bësh pyetjen?

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pse ministri nuk është këtu, unë do ta bëj pyetjen.

Njëra prej çështjeve të cilën e kam shtruar në seancën e 14 qershorit është edhe ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Kështu që për të pasur rezultate të mira në ngritjen e cilësisë në mësimdhënie nevojitet shëndeti i mirë i mësimdhënësit.

Mesatarja e pikëve të provimit në fund të klasës V, të klasës IX dhe provimit të maturës është alarmante, me 51%, 55% dhe 47%.

Në Raportin e Progresit, nga Ministria e Arsimit kërkohet vëmendje dhe hulumtim i menjëhershëm, pasi ky tregues fundamental e pasqyron cilësinë e dobët në arsim.

Pyetja është: A keni statistika për numrin e punëtorëve, të cilët janë duke punuar në mësimdhënie e nuk janë në gjendje të mirë shëndetësore, por për arsye të rënda ekonomike janë të detyruar të punojnë?

KRYETARI: Faleminderit deputete! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Ministri nuk është këtu. Deputet, mund ta bësh pyetjen.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kjo është hera e dytë që po e shtroj këtë pyetje, por kjo pyetje faktikisht është duke u sjellë vërdallë tash e tri javë, e ministri Beqaj vazhdimisht nuk është këtu. Nuk e di, po më duket se po i marrin shumë kohë këta këshilltarët e transaksionit dhe kompanitë e interesuara për privatizimin e pronës publike, meqë në njëfarë mënyre po punon vetëm për ta, e nuk di a po i japin edhe rrogë ata, e jemi duke e paguar edhe ne.

Po pyetje ime ka të bëjë, siç e kam shtruar edhe në seancën e kaluar, me shpenzimet e Kosovës sa i përket mungesës së kodit telefonik. Më saktësisht, kërkesa për ministrin ka qenë të na tregojë saktë se sa para e ka paguar Kosova përdorimin e kodit të Monakos 377 prej se është themeluar telefonia mobile Vala 900.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministren Mimoza Kusari-Lila. Ministria nuk është këtu. Nuk do ta bësh pyetjen?

E përfunduar pikën e dytë të rendit të ditës. Për pikën e tretë na duhet kuorumi. I kemi 67 deputetë.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve plenare, të mbajtura më 13 dhe 17 shtator 2012

A ka vërejtje në këto procesverbale? Konstatohet se Kuvendi i miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 13 dhe 17 shtator 2012.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Votimi i Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen plenare më 17 shtator 2012, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar në votim. Andaj, kërkohet deklarimi me votim për miratimin e Raportit vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Kuorumi është i plotë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi i miratoi Raportin vjetor të performansës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

Pika e pestë e rendit të ditës:

5. Interpelanca me ministrin Enver Hoxhaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike, në bazë të nenit 44 të Rregullores së Kuvendit, e ka parashtruar kërkesën për ta ftuar në interpelancë ministrin Enver Hoxhaj lidhur me gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës.

Ju njoftoj që në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në tri orë. Parashtruesi i interpelancës e mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në përfundim të debatit deri në 5 minuta, neni 44, pika 7 e Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44, pika 8 të Rregullores së Kuvendit, ministri Enver Hoxhaj e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e shtruar në interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash.

Në kohën e ndarë për diskutime sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve pa grup parlamentar, e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Ismet Beqiri, në cilësinë e parashtruesit, që ta arsyetojë ftesën për interpelancë.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetari!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Në bazë të nenit 65, pika 9 e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve tjera që nuk dëshiroj t'i lexoj, sepse e keni materialin, grupi ynë parlamentar e ka kërkuar këtë interpelancë me ministrin Hoxhaj për ta informuar Kuvendin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës për gjendjen në politikën e jashtme të Kosovës.

Politika e jashtme e Republikës së Kosovës ka degraduar në shkallën më të ulët të mundshme.

Procesi i njohjes ndërkombëtare të Kosovës ka stagnuar me vetëm 5, nëse i shtohet edhe një shtet që ende tash, dashtë Zoti të jetë e vërtetë që na ka njohur, me 6 njohje për këtë vit.

Ky proces e ka humbur përfundimisht seriozitetin gjatë këtij mandati qeverisës dhe është karakterizuar me skandale të shumta e luftë për merita e rivalitete të theksuara. Pas debatit dhe debaklit ndërmjet anëtarëve të Qeverisë së Kosovës, kryeministrit, zëvendëskryeministrit të parë përgjegjës për lobim dhe ministrit të Punëve të Jashtme në lidhje me njohjen apo mosnjohjen e Kosovës nga Mali, kërkohet seriozitet dhe qartësim sa më i shpejtë i situatës së krijuar, e cila shkon në dëm të interesit jetik të qytetarit të Republikës së Kosovës.

LDK-ja kërkon përgjegjësi për situatën e krijuar dhe kërkon të sqarohet nëse ka pasur njohje formale nga Mali; nëse njohja është tërhequr si rezultat i pamaturisë së aktorëve të politikës së jashtme të Kosovës, apo ka pasur falsifikim të dokumenteve.

Lidhja Demokratike e Kosovës kërkon përgjigje të prerë nga Qeveria nëse Nigeria dhe Uganda e kanë njohur Kosova. Për të dyja këto raste, LDK-ja qysh në vitin e kaluar kishte kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme që ta largojë nga lista e njohjeve Nigerinë dhe e ka ripërsëritur kërkesën disa herë sivjet për Nigerinë dhe Ugandën, në mënyrë që të mos dëmtohen raportet bilaterale dhe mundësia që ato shtete ta konfirmojnë njohjen në të ardhmen. Prandaj, Qeveria e Kosovës sa më shpejt duhet ta sqarojë edhe çështjen e njohjes nga këto dy shtete, njohje këto që disa herë janë demantuar nga sekretarja e shtetit Klinton, Baranesha Eshton, Ambasada e SHBA-ve në Kosovë dhe zyrtarë të lartë të shteteve të QUINT-it.

Politika e jashtme e Kosovës është tepër reaktive dhe e çakorduar, e si rezultat edhe procesi i anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare po ashtu ka stagnuar në tërësi.

Qeveria nuk e ka përmbushur premtimin për anëtarësimin në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Qeveria ka deklaruar disa herë që si kompromis i marrëveshjes për përfaqësim rajonal të fusnotës, anëtarësimi në BERZH është çështje e kryer, duke e paralajmëruar këtë anëtarësim gjatë muajve mars-prill 2012. Po ashtu, nuk ka pasur përpjekje serioze dhe lobim për anëtarësim në Këshillin e Evropës, ku Kosova tashmë është njohur nga më shumë se 2/3 e shteteve anëtare.

Qeveria po ashtu nuk e ka përmbushur premtimin për shtrirje të mëtutjeshme të rrjetit diplomatik nëpërmjet hapjeve të ambasadave të reja, ose misionëve tjera diplomatike dhe konsullore, premtime këto të bëra që në vitin 2011.

Ministria e Punëve të Jashtme, që nga viti 2010 nuk ka arritur ta hapë as edhe një ambasadë ose konsullatë të vetme. Numri mbetet i njëjtë, 20 ambasada, 13 konsullata, që kur LDK-ja ka udhëhequr me këtë ministri.

Procesi i emërimit të ambasadorëve të rinj është përcjellë me shkelje të mëdha ligjore, me anashkalim total të procedurave të parapara me ligj e me Kushtetutë dhe shkelje të praktikave diplomatike.

Në këtë proces ka dominuar vetëm nepotizmi dhe politizimi i skajshëm, përderisa ka pasur emërime në postet diplomatike më të ulëta se ambasadorë edhe pa konkurse fare, si dhe ngritje në poste dhe grada diplomatike pa i përfillur procedurat ligjore.

Përfaqësimi rajonal po ashtu ka degraduar. Me gjithë kompromisin që është bërë për një përfaqësim rajonal me fusnotë, kemi një përkeqësim edhe më të madh të situatës lidhur me përfaqësimin rajonal të Kosovës.

Kosova nuk është anëtarësuar, as nuk merr pjesë në asnjë nismë të rëndësishme politike rajonale. Në vend të kësaj, ky kompromis është zëvendësuar me pjesëmarrjen e zyrtarëve të Kosovës në disa tryeza të rrumbullakëta, kryesisht të karakterit teknik.

Është premtuar për më shumë se 100 anëtarësime pas fusnotës, por tani Ministria e Punëve të Jashtme mburret me pjesëmarrjen në vetëm 7 organizma, që kryesisht janë task-forca, tryezat e rrumbullakëta e grupe punuese.

Imazhi i Kosovës mbetet më i përkeqësuar në rajon. Kjo pasqyrohet me investime të huaja direkte, inekzistente dhe paraqitja e Kosovës si shtet me rrezikshmëri të lartë dhe nivel jashtëzakonisht të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ministria e Punëve të Jashtme nuk ka bërë asgjë për ta përmirësuar këtë imazh. Përkundrazi, joserioziteti i politikës së jashtme të Kosovës në fakt e ka dëmtuar këtë imazh edhe më shumë.

Për të mos ju marrë kohë, para se ta lexoj tekstin e mocionit që ne propozojmë që të votohet, janë disa raste të shkeljeve që bëhen, siç janë rasti i drejtorit të Departamentit për Çështje Konsullore, i Departamentit për Buxhet dhe Financa, rasti i udhëheqjes të

Divizionit të Personelit. Të gjithë këta zyrtarë janë ulur në poste, përkatësisht në pozitën e tyre pa u përfillur asnjë procedurë dhe me vendim, sigurisht, të atyre që mund ta marrin këtë vendim.

Po ashtu, këto tri raste kanë paraqitur ankesë në KPMK dhe kanë fituar atje, por ministria nuk e zbaton vendimin, që njerëzit të cilëve padrejtësisht u janë mohuar, përkatësisht u janë zbritur pozitat, t'i kthejnë vendet e tyre të mëparshme. Pse nuk zbatohen këto vendime? Të mos më keqkuptoj askush, por nuk mund ta bëjmë asnjë ministri dhe asnjë vend pune vetëm për një komune, ose për një lagje. Ju i keni 8 zyrtarë, kërkoj falje që e them këtë, vetëm nga Suhareka, të pranuar shumë prej tyre pa procedura, ose me procedura joligjore. E them këtë, nuk kemi asgjë kundër, por nuk është korrekte, nuk është e drejtë. Nëse veç në Suharekë janë këta njerëz të kualifikuar, është në rregull, por së paku të përfillet procedura, e procedura nuk është përfillur.

Po ashtu kemi punësim nëpër pozita të larta pa përfillje të procedurave, siç është motra e ministrit të Kulturës, miku i Ibrahim Gashit, ish-zëvendësministrit, tanimë rektor. Pse gradohen zyrtarët që ende nuk e kanë bërë asnjë vit përvojë pune në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe dërgohen në misione diplomatike, kurse ata që janë nga themeli i MPJ-së degradohen? Me çfarë procedure janë emëruar pozitat, për shembull në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Çeki, pozita "këshilltar" ka aplikuar në vitin 2009 për staf diplomatik; Ambasada në Arabi Saudite, rasti i zëvendës/konsullit - pa kurrfarë procedure; sekretari i parë transferohet nga ministria pa i plotësuar kushtet ligjore; në Zvicër, emërimi i zëvendës/konsullit ose konsullës pa kurrfarë procedure. Në rastin e konkursit për staf diplomatik dhe atë konsullor, që është shpallur në vitin 2011, deri ku ka shkuar procesi, pse nuk dalin rezultatet dhe a janë shkelur procedurat ligjore? Ne themi - po.

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës propozon që këtë mocion, përkatësisht këto rekomandime, në përputhje me nenin 44, paragrafi 4, pika d e Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe i ftojme deputetët që ta votojnë mocionin në vijim.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon përgjegjësi nga Qeveria e Kosovës për skandalin rreth njohjes-mosnjohjes nga Republika e Malit;
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon të njoftohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, brenda afatit prej 2 javësh, lidhur me njohjet nga Nigeria dhe Uganda, duke paraqitur dëshmi të qarta që vërtetojnë njohjen nga këto dy shtete;
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që urgjentisht t'i sqarojë kompetencat e anëtarëve të Qeverisë, duke i përshkruar saktë obligimet dhe detyrat e punës të të gjithë përfaqësuesve të Kabinetit qeveritar që merren me politikë të jashtme, në mënyrë që të evitohen skandalet si rezultat i luftës për merita rreth njohjeve;

4. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që të merren hapa të menjëhershëm për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në veçanti në BERZH dhe në Këshillin e Evropës, dhe të raportojë në Kuvend në baza të rregullta mujore lidhur me avancimin e procesit të anëtarësimit.

5. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që të ndalojë politizimin e Shërbimit Diplomatik të Kosovës dhe të veprojë në përputhje me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutën, me rastin e emërimeve apo ngritjes në detyrë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë shpresoj dhe besoj se në fund këto rekomandime dhe këtë mocion do t'i miratojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Shumë të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Më lejoni të them që politika e jashtme është interes nacional, është mishërim i politikës së brendshme dhe reflektim i unitetit politik.

Në politikën e jashtme të gjithë duhet të ndajmë përgjegjësinë e përfaqësimit të interesit shtetëror, unë si ministër, ju si deputetë dhe ne si qytetarë.

Pikënisja e historisë së re të politikës së jashtme të Kosovës filloi pikërisht këtu para pesë vjetësh kur ne së bashku e shpallëm Kosovën, shtet të pavarur dhe sovran. Prandaj, jam shumë i nderuar që sot mund të flas për zhvillimin e politikës së jashtme, sidomos në këtë një vit e gjysmë të mandatit tim. Dua ta falënderoj Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe shefin e Grupit Parlamentar, zotin Ismet Beqiri, për iniciimin e kësaj interpelance.

Të nderuar deputetë,

Kosova është shtet i pavarur dhe procesi i njohjeve është i pakthyeshëm dhe i pandalshëm. Njohja zyrtare e Republikës së Kosovës ka një gjeografi globale, nga Kanada në Japoni dhe nga vendet nordike në vendet afrikane, prandaj askush nuk mund ta ndalë rrjedhën e historisë së njohjes së plotë të Republikës së Kosovës. Kosova e pavarur është pjesë e peizazhit të shteteve sovranë demokratike të Ballkanit Perëndimor dhe të Evropës. Ajo e përfaqëson një realitet politik e juridik dhe një fakt gjeopolitik në Evropë dhe në botë.

Më lejoni të them, që në fillim se fuqizimi i pozitës ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, është një prioritet i lartë shtetëror. Qëllimi ynë është kompletimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, me synim për integrimin e plotë në sistemin ndërkombëtar. Në këtë drejtim, në vitin 2011, ne kemi hartuar një dokument strategjik, siç ishte Strategjia për arritjen e njohjes së plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Kjo strategji ka mundësuar një koordinim shumë të mirë ndërmjet presidentes Jahjaga, të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, kryeministrit Thaçi, zëvendëskryeministrit Pacolli, Ministrisë së Punëve të Jashtme, si dhe të aktorëve të tjerë institucionalë publikë, të shoqërisë civile dhe të botës akademike.

Për herë të parë, këtyre institucioneve, ky dokument u ka shërbyer si një orientim strategjik dhe analitik në procesin e njohjeve. Për herë të parë lobimin, krahas qendrave multilaterale, e kemi vendosur edhe në rrafshin bilateral, shtet me shtet.

Gjatë tërë kësaj kohe, unë kam pasur një plan konkret të punës dhe të matshëm, një agjendë javore, mujore dhe vjetore, të shoqëruar me një qasje të mirë strategjike dhe me analiza të detajuara për secilin shtet. Në këtë drejtim, fokusi ka qenë në tri grupe të shteteve si shtetet që janë afër njohjes së Kosovës, së dyti shtetet që kanë qëndrim pozitiv ndaj Kosovës dhe shtetet që kanë qëndrim neutral ndaj pavarësisë së Kosovës.

Duke u bazuar në këtë strategji, unë kam vizituar 42 shtete që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës. Kam qenë disa herë në Amerikën Latine, në Amerikën Qendrore, në Azi, Oqeani, Lindje të Mesme dhe në Afrikë. Kam takuar mbi 120 përfaqësues të këtyre shteteve, presidentë, kryeministra, ministra të punëve të jashtme. Rezultatet janë sot të matshme. Brenda këtyre 17 muajve, Republika e Kosovës është njohur nga 17 shtete sovrane, anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Për çdo muaj, kemi arritur të sjellim një njohje, në një periudhë të vështirë ku sigurimi i njohjes është i kushtëzuar nga rrethana të veçanta gjeopolitike.

Në këtë qasje strategjike, jemi përkrahur nga aleatët e fuqishëm, siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe shtetet e tjera. Ne jemi shumë falënderues ndaj këtyre shteteve, ndaj miqve ndërkombëtarë për mbështetjen që i kanë dhënë procesit të përmbylljes së njohjes së plotë të Kosovës.

Një qasje të veçantë e kemi aplikuar edhe ndaj pesë shteteve të Bashkimit Evropian, që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Pa dyshim që mosnjohja e Republikës së Kosovës nga këto pesë vende paraqet një sfidë, mirëpo mosnjohja ka të bëjë me situata të politikës së brendshme të secili shtet veç e veç dhe assesit të politikës së jashtme. Këto pesë vende nuk paraqesin ndonjë bllok kundër pavarësisë së Kosovës, nuk e bllokojnë procesin e integritetit evropian.

Ne kemi krijuar marrëdhënie shumë të mira institucionale me këto shtete. Unë kam pasur takime bilaterale me të gjithë ministrat e punëve të jashtme të tyre. Pas insistimeve tona të vazhdueshme, disa nga këto shtete e kanë pranuar pasaportën e Republikës së Kosovës, të tjerat e kanë dhënë votën për anëtarësimin e Kosovës në organizatat rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,
Të nderuar zonja e zotërinj,

Më lejoni të jap një shpjegim të shkurtër rreth dilemës që ngritët se a është i paktë numri i njohjeve që e kanë njohur Republikën e Kosovës dhe a është Ministria e Punëve të Jashtme në nivel të detyrës së saj? Por, mbi të gjitha, më lejoni t'i përmend disa faktorë determinues që e kanë vështirësuar këtë proces dhe këto fakte konkrete besoj që japin një shpjegim të drejtë dhe racional sa i takon një procesi të tillë.

Së pari, apo argumenti i parë, procesi i njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës është i kushtëzuar nga rrethana të veçanta politike dhe ligjore ndërkombëtare në të cilat është pavarësuar Kosova.

Së dyti, në bazë të praktikës ndërkombëtare, legjitimitimi i shteteve të reja pas vitit 1945, është realizuar nëpërmjet anëtarësimit në OKB. Kjo në thelb ka nënkuptuar njohjen kolektive të shteteve të reja duke i bërë praktikisht të panevojshme njohjet nga shtetet veç e veç.

Së treti, në rastin e Kosovës, mungesa e konsensusit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për mbështetjen e Propozimit Gjithëpërfshirës të të dërguarit të posaçëm të OKB-ës për statusin e Kosovës, presidentin Marti Ahtisari, e ka detyruar Kosovën që të ndjekë rrugën e njohjeve individuale.

Së katërti, mungesa e unitetit brenda Bashkimit Evropian, për shkak të mosnjohjes së deritanishme nga pesë shtetet anëtare, ka ndikuar jo vetëm në relacionet ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, por kjo situatë ka ndikuar negativisht edhe në pjesë të tjera të botës.

Së pesti, kundërshtimi i pavarësisë së Kosovës nga shtetet me ndikim në rajone të caktuara të botës, si dhe problemet e brendshme në disa shtete, kanë qenë një rrethanë shtesë që e kanë bërë të vështirë këtë proces.

Përkundër kësaj, Kosova është njohur deri më tani nga pothuajse gjysma e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara, që përfshijnë shtete më demokratike dhe më të zhvilluara në botë.

Procesi i njohjes është i pandalshëm dhe ju do të shihni se njohje të reja do të ketë së shpejti. Ne jemi të sigurt që numri i njohjeve në muajt e fundit do të rritet dhe do të ketë lajme pozitive.

Për të gjitha këto njohje që kanë ndodhur dhe do të ndodhin, meritore janë, pa dyshim, qytetarët e Kosovës dhe institucionet e saj.

Unë jam i obliguar ta kryej detyrën si ministër i Punëve të Jashtme.

Të nderuar deputetë,

Duke i aplikuar të gjitha format e ndikimit tek shtetet, ne kemi arritur ta dinamizojmë trendin e njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

Sa i takon çështjes së Malit, që u përmend edhe nga zoti Beqiri dhe që është ngritur në këtë interpelancë, mendoj se ka ndodhur një keqkuptim në komunikimet tona ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit. Unë, për këtë keqkuptim, ndjej keqardhje edhe para qytetarëve të Kosovës, por edhe para Malit, meqë Kosova synon të jetë vend serioz në komunikimet tona diplomatike.

Në të njëjtën kohë, përpjekja ime si ministër i Punëve të Jashtme, është që në çdo formë, me çdo kusht, ta ruajmë kredibilitetin e Republikës së Kosovës, si një anëtar i përgjegjshëm i bashkësisë ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Njohjet janë të rëndësishme dhe do të mbesin prioritet i politikës së jashtme derisa Kosova do të bëhet anëtare e plotë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Mirëpo, politika e jashtme, nuk guxon të reduktohet vetëm në njohje, prandaj ndër objektivat madhore tona kanë qenë dhe mbeten si:

- Kultivimi i marrëdhënieve speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës;
- Ndërtimi i një partneriteti strategjik me Bashkimin Evropian dhe NATO-n;
- Përfshirja e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave;
- Anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare;
- Bashkëpunimi rajonal në rrafshin bilateral multilateral;
- Promovimi i interesave ekonomike të Kosovës në botë;
- Promovimi i një imazhi real dhe modern të Republikës së Kosovës, si dhe
- Vazhdimi i ndërtimit dhe i funksionalizmit të një Shërbimi Diplomatik dhe efikas të Republikës së Kosovës.

Jetësimi i këtyre objektivave është prioritet po aq i rëndësishëm sa edhe shtimi i njohjeve, sepse njohjet janë kuptimplota me anëtarësimin e plotë të Kosovës në institucionet euroatlantike, sepse njohjet i shërbejnë forcimit të pozitës ndërkombëtare të Kosovës, mbi të gjitha atëherë kur ne marrim pjesë aktivisht në mekanizmat rajonal dhe ndërkombëtarë. Njohjet nuk janë veç qëllim, por janë një bazë e fuqishme që në ndërmjet të Republikës së Kosovës dhe shteteve tjera të ketë bashkëpunim të ngushtë diplomatik dhe shkëmbim në të gjitha fushat e jetës.

Për një vit e gjysmë, unë kam zhvilluar mbi 150 takime bilaterale. Në këtë kohë ne e kemi dyfishuar numrin e shteteve me të cilat kemi lidhur marrëdhënie diplomatike. Tani jemi në proces të nënshkruajmë marrëdhënie diplomatike edhe me të gjitha shtetet e mbetura.

Gjatë kësaj kohe, ne kemi nënshkruar 105 marrëveshje bilaterale ndërmjet Kosovës dhe shteteve të tjera. Janë nënshkruar 10 marrëveshje multilaterale dhe 9 marrëveshje ndërkombëtare.

Për inicimin, harmonizimin dhe shkrimin e tyre, është bërë një punë e palodhshme. Aktualisht kemi iniciuar edhe 72 marrëveshje dypalëshe në fushën e sigurisë dhe të bashkëpunimit policor, në fushën e mbrojtjes dhe të promovimit të investimeve, në

fushën e eliminimit të tatimeve të dyfishta të transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave, bashkëpunimin doganor në fushën e ripranimit dhe të bashkëpunimit kulturor.

Ne kemi intensifikuar korrespondenca diplomatike me të gjitha shtetet e botës, duke i njoftuar ato me zhvillimet në Kosovë, për procesin e shtet-ndërtimit, rreth perspektivës tonë evropiane, me agjendën politike pas largimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare.

Për çdo zhvillim të rëndësishëm në Kosovë, ne kemi hartuar dokumente të veçanta politike, ku kemi qartësuar pozicionin e Republikës së Kosovës karshi zhvillimeve dhe situatave brenda Kosovës, apo në rajon. Kjo flet jo vetëm për veprim në fushën e politikës së jashtme, por edhe për formësim të mendimit të politikës së jashtme. Vetëm këtë vit ne kemi dërguar mbi 900 dokumente, letra informuese dhe kërkesa tek homologët e mi në gjithë botën. Vizitat e shpeshta, takimet e shumta, letrat e panumërta janë në funksion të përfaqësimit dhe të mbrojtjes së interesit të shtetasve të Republikës së Kosovës. Nëpërmjet organizimit të shumë konferencave ndërkombëtare në Prishtinë, ne e kemi vendosur Kosovën në qendër të vëmendjes së diplomacisë botërore për tema dhe procese të rëndësishme ndërkombëtare, diplomacia publike ka qenë dhe mbetet prioritet yni.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Pas largimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare, agjenda e vetme mbetet integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në strukturat euroatlantike. Integrimin në Bashkimin Evropian gjithmonë e kam parë si një instrument për të modernizuar shoqërinë tonë dhe për të implementuar reformat e duhura, në mënyrë që Kosova të jetë konkurrenente me shtetet tjera në Bashkimin Evropian.

Gjatë kësaj periudhe, unë kam vizituar zyrtarisht dhe me karakter bilateral të gjitha kryeqytetet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Kam zhvilluar 34 vizita vetëm brenda Bashkimit Evropian. Kam qëndruar tri herë në Berlin, tri herë në Paris, tri herë në Londër dhe tri herë në Romë për të shtyrë agjendën bilaterale të Kosovës me këto shtete dhe atë të integritimeve evropiane.

Në këto takime, unë kam ngritur tema të ndryshme, duke filluar nga situata në veri të vendit, marrja e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, fillimin e studimit të fizibilitetit e deri te çështje të tjera të ndryshme.

Sot dua t'ju uroj për përfundimin e studimit të fizibilitetit drejt Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe të Republikës së Kosovës. Kjo do të jetë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUSI: Regjia, t'i llogariten minutat e Grupit Parlamentar.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Unë, zoti kryesues të falënderoj dhe po ashtu e falënderoj edhe Grupin Parlamentar për mundësinë e dhënë që ta përfundoj fjalimin.

Dita e djeshme shënon pa dyshim etapën e Kosovës evropiane dhe për këtë meritore janë qytetarët e Kosovës dhe të gjitha institucionet tona.

Të nderuar deputetë,

Anëtarësimi në organizatat ekonomike, financiare, kulturore, sportive janë përcaktues që Kosova të integrohet në sistemin ndërkombëtar. Prandaj, ne kemi bërë një punë jashtëzakonisht të madhe në sigurimin e mbështetjes së shteteve për të qenë anëtare e plotë në shumë organizata rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare. Menjëherë pas arritjes së marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për përfaqësimin rajonal, më 24 shkurt 2012, Ministria e ka bërë një agjendë të detajuar të kërkesave për anëtarësim.

Ne kemi aplikuar deri më tash në 28 organizata rajonale. Nga 8 organizata kemi marrë përgjigje pozitive për anëtarësim. Me dy organizata jemi në përgjigje preliminare dhe me katër organizata jemi në pritje të përgjigjes deri në fund të vitit, për shkak të asaj që shumica e vendimeve të këtyre organizatave merren në fund të vitit.

Ne kemi shkuar edhe më tutje, kemi aplikuar edhe me tetë organizata tjera që nuk janë fare në listën e rekomanduar nga zyra e baroneshës Eshton.

Me pjesëmarrjen e Republikës së Kosovës në mbi 80 takime rajonale dhe evropiane, ne e kemi fuqizuar pozitën ndërkombëtare dhe shtetësinë tonë.

Objektiv tjetër strategjik i Republikës së Kosovës mbetet anëtarësimi i Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në Këshillin e Evropës, në Kartën e Adriatikut dhe në shumë organizata dhe nisje rajonale e euroatlantike.

Këto çështje i kam ngritur në të gjitha takimet bilaterale, si në rajon, ashtu edhe në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Ne kemi siguruar përkrahjen edhe të gjitha shteteve që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës për t'u bërë anëtare e plotë e këtyre organizatave. Anëtarësimi në këto organizata do të jetë një fitore shumë e madhe e diplomacisë së Kosovës por mbi të gjitha edhe një përfitim i drejtpërdrejt për zhvillimin ekonomik.

Të nderuar deputetë,

Pavarësia e Kosovës ka prodhuar paqe, siguri dhe stabilitet në rajon. Brenda katër vjetëve të pavarësisë, Kosova është shndërruar në model për ndërtimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Kjo qasje dëshmon përkushtimin e pathyeshëm të popullit të Kosovës për t'iu bashkuar vlerave evropiane.

Gjatë kësaj periudhe, kemi zhvilluar një bashkëpunim intensiv rajonal. Në këtë drejtim është intensifikuar niveli i bashkëpunimit me vendet e rajonit, si Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia, Kroacia, Sllovenia, Bullgaria dhe Turqia. Me Greqinë kemi bashkëpunim

institucional në baza të rregullta. Me Bosnjë-Hercegovinën kemi zhvilluar takime në nivele të ndryshme. Por, bashkëpunimi ynë me Republikën e Shqipërisë, pa dyshim se zë një vend të veçantë në kuadër të bashkëpunimit euroatlantik.

Rol të rëndësishëm në punën tonë, ka edhe diplomacia ekonomike. Si hap të parë kemi hartuar strategjinë për diplomaci ekonomike në bashkëpunim të ngushtë me USAID-in. Në bashkëpunim me ministritë e linjave, ne kemi organizuar konferenca dhe forume ekonomike që deri më tash janë mbajtur në Itali, Gjermani, Hungari, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqi, Francë, Bullgari dhe shtete tjera. Përmes konferencave ekonomike janë promovuar interesat ekonomike të vendit dhe janë ftuar investitorët e huaj për të investuar në Kosovë.

Ne kemi nënshkruar shumë marrëveshje në fushën e ekonomisë dhe të tregtisë me vende të fuqishme ekonomike të botës, që do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës.

Ne jemi angazhuar edhe në krijimin e shërbimeve të mira për qytetarët tanë që jetojnë jashtë vendit dhe në mbrojtjen e interesave të tyre. Kemi vazhduar në ofrimin e shërbimeve konsullore në 13 misione konsullore dhe në ambasada të Republikës së Kosovës. Që nga lëshimi i pasaportës së parë biometrike të Republikës së Kosovës, në qershor të vitit të kaluar, nëpërmjet misioneve konsullore janë pajisur 65 000 qytetarë me dokumente personale dhe zyrtare në misionet tona diplomatike.

Të nderuar deputetë,

Sa i përket emërimit të ambasadorëve, më lejoni të ju njoftoj se ambasadorët e emëruar janë njerëz profesionistë, kompetentë dhe assesi partiakë. Në mandatin tim asnjë zyrtar i Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk është larguar, asnjë ambasador nuk është shkarkuar, përkundrazi, ne kemi graduar stafin e brendshëm, i kemi avancuar dhe trajnuar. Në përputhje me kornizën ligjore, lëvizjet e ambasadorëve nga një mision në tjetrin, i shërbejnë thellësisht fuqizimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të Shërbimit të Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Kur unë e kam marrë Ministrinë e Punëve të Jashtme, kishte disa ambasada të cilat ishin të paplotësuara me vendin e ambasadorëve. Prandaj, plotësimi i këtyre vendeve si dhe procesi i rotacionit kanë ndodhur duke respektuar plotësisht ligjet në fuqi, konventat ndërkombëtare dhe qëllimi ka qenë e mbetet fuqizimi dhe zgjerimi i rrjetit diplomatik. Ambasada jonë në Australi do të hapet brenda një periudhe shumë të shkurtër, do të jetë e gatshme me 1 dhjetor, për deri sa konsullata jonë në Stamboll e re është funksionale dhe konsullata në Strasburg dhe në Gjenevë, do të jenë po ashtu funksionale deri më 1 dhjetor të këtij viti.

Më lejoni të përfundoj duke thënë se jam i vetëdijshëm se ne mund dhe duhet të bëjmë edhe më shumë, mund të kemi edhe rezultate më të mira, por mund të ketë pasur edhe gjatë kësaj kohe edhe lëshime të caktuara. Po një gjë mund t'ju garantoj që unë si ministër i Punëve të Jashtme do të punoj 15 orë në ditë, në mënyrë që Republika e Kosovës të përfaqësohet në mënyrë dinjitoze në botë. Në funksion të realizimit të këtyre

prioriteteve të politikës së jashtme ne shprehim vullnetin e plotë për të luajtur një rol shumë më të rëndësishëm dhe për të pasur një bashkëpunim shumë më të ngushtë me Kuvendin e Kosovës dhe me të gjithë deputetët e nderuar, sikurse me të gjithë aktorët relevantë publikë, shtetërorë, të shoqërisë civile dhe të medieve në Republikën e Kosovës. Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,

I nderuar ministër Hoxhaj,

Të nderuar deputetë,

Ishte kënaqësi që ne të dëgjojmë ministrin Hoxhaj, që foli për të gjitha arritjet që kanë të bëjnë prej kohës kur ai e ka marrë mandatin si ministër i Punëve të Jashtme, një punë dhe raportim, me të vërtetë që duhet çmuar dhe vlerësuar. Po ashtu e konsiderojmë si të dobishëm një debat i cili është një moment i mirë për ta shtyrë përpara gjithë procesin e njohjeve të Kosovës dhe një proces që ka të bëjë me mandatin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Është mjaft e qartë nga ajo që e tha, që raportoi ministri Hoxhaj, por edhe nga ato që ne i shohim çdo ditë se Ministria e Jashtme e ka dinamizuar politikën e jashtme dhe i ka thelluar marrëdhëniet me shumicën e shteteve, e ka forcuar pozitën ndërkombëtare të Kosovës, në përgjithësi dhe Republika e Kosovës sot gëzon një pozitë më të mirë në raport me shtetet tjera dhe e ka vendin e saj si anëtare e çmuar në bashkësinë ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Jashtme nga viti 2011 e ka aplikuar një qasje më të re, më moderne dhe më dinamike në raport në diplomacinë e Kosovës. Ministria e Punëve të Jashtme ka hartuar një varg dokumentesh si strategji dhe dokumente tjera, të cilat kanë kontribuar në mënyrë përmbytëse në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon Kosova.

Në fushën e njohjeve, Ministria e Punëve të Jashtme e ka bërë një depërtim të jashtëzakonshëm, mund të thuhet, dhe nëpërmjet ministrit, stafit diplomatik dhe gjithë kapaciteteve që i ka kjo ministri kanë pasur një qasje pragmatike të fokusuar ku kanë arritur po ashtu edhe të dyfishojnë numrin e njohjeve në vit.

Nëpërmjet një strategjie të menduar mirë, Ministria e Jashtme e ka angazhuar spektrin publik të Kosovës e po ashtu ndërkombëtar në procesin e rritjes së numrit të njohjeve ndërkombëtare për Kosovën.

Rol të madh në rritjen e këtij numri luan përmirësimi i dukshëm i imazhit të Kosovës në botë. Qeveria e Kosovës me paraqitje të saj në konferenca, samite, forume ndërkombëtare, nëpërmjet vizitave bilaterale që ka arritur duke e prezantuar Kosovën në mënyrë reale, tani më Kosova trajtohet si të gjitha vendet tjera të botës. Në anën tjetër, marrëdhëniet e Kosovës me shtetet tona mike janë thelluar edhe më shumë dhe janë më

shumë përmbajtjesore. Janë më shumë se 74 marrëveshje, protokolle e memorandumet e bashkëpunimit, të nënshkruara brenda kësaj periudhe, më shumë se 150 takime bilaterale të mbajtura dhe më shumë se 70 vizita të bëra.

Këta janë vetëm disa nga numrat që pasqyrojnë qartë raportet me fuqitë më të mëdha botërore.

Qeveria e Kosovës në dy vjetët e fundit e ka intensifikuar dukshëm raportin me të gjitha vendet e rajonit, me fokus të veçantë me Shqipërinë. Ministria e Punëve të Jashtme ka avancuar raportet me Shqipërinë deri në nivel të përfaqësimit të përbashkët konsullor në vendet tona, por jo vetëm me Shqipërinë, por Ministria ka thelluar edhe bashkëpunimin me tërë rajonin duke bërë të gjitha vendet e rajonit që të ngrenë zërin për çështjet që janë me rëndësi për Kosovën.

Kosova, në vitin 2011, ka filluar të marrë qëndrime të qarta për të gjitha problemet e mëdha në botë, ka reaguar për të gjitha ato që mund të konsiderohen si shkelje e të drejtave të njeriut dhe për çështje apo probleme tjera në botë. Qeveria e Kosovës e ka ngritur zërin pra dhe ka reaguar për dhunën në Egjipt, Libi e Siri, duke u rreshtuar kështu përkrah demokracive të mëdha botërore.

Ministria e Punëve të Jashtme, përpos se e ka bërë një punë të shkëlqyeshme në prezantimin e Kosovës jashtë, ka bërë edhe një punë të madhe në raport me diasporën, siç u përmend edhe në vetë fjalën e ministrit, përpos se janë ngritur problemet e diasporës edhe me ministrat e vendit përkatës gjatë takimeve bilaterale. Ministria e Punëve të Jashtme shihet qartë se ka ofruar edhe shërbime konsullore në gjitha qendrat e mëdha, ku kemi një koncentrim më të madh të diasporës sonë e kjo dëshmohet po ashtu edhe me faktin se në këtë periudhë janë lëshuar mbi 65 000 dokumente të ndryshme nga konsullatat e Republikës së Kosovës nëpër vende të ndryshme.

Ajo që u theksua edhe nga vetë ministri e që konsiderohet ndoshta risia më e madhe e mandatit të tij, e që duhet të konsiderohet edhe një risi që është sjell edhe në diplomaci edhe për vendet e rajonit, që janë rreth nesh, është ajo që për herë të parë në diplomacinë tonë janë përdorur në mënyrë aktive diplomacia ekonomike, publike dhe kulturore.

Ministria e Punëve të Jashtme e ka hartuar një strategji për diplomacinë ekonomike e cila i ka shërbyer Ministrisë së Jashtme dhe institucioneve tjera të Kosovës dhe të gjitha përfaqësive diplomatike të Kosovës si udhërrëfyes.

Si rrjedhojë e kësaj strategjie janë organizuar një numër i madh i konferencave për investitorë, forumeve të biznesit dhe konferencave tjera me karakter ekonomik. Duhet theksuar që në këto konferenca nuk kanë qenë të pranishëm vetëm përfaqësues politikë ose diplomatikë të vendit tonë, po edhe përfaqësues të asociacioneve të ndryshme të biznesit, të organizatave të tjera që kanë dhe merren me çështje të ekonomisë dhe zhvillimit ekonomik.

Në anën tjetër, përpos diplomacisë publike dhe kulturore, Ministria e Jashtme e ka prezantuar Kosovën në shumë forume dhe shtete, gjë që ka përmirësuar dukshëm imazhin

e Kosovës dhe e ka thyer shumë paragjykime për vendin tonë, të cilat paragjykime kanë qenë të krijuara për vite të tëra.

E gjithë kjo punë që u përmend, nuk do të ishte e mundshme pa përkushtimin e plotë të gjithë Qeverisë, pa ministrin Hoxhaj, pa stafin e tij profesional e diplomatik dhe gjithashtu nuk do të ishte e mundur edhe pa forcimin e një rrjeti diplomatik të Kosovës, gjë që Ministria e Jashtme e ka bërë me sukses.

Ministria e Punëve të Jashtme e ka iniciuar edhe nënshkrimin e marrëveshjeve për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me më shumë 35 shtete, për derisa ka përfunduar vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me 11 shtete.

Nga kjo shihet se kemi një dyfishim të numrit të këtyre marrëveshjeve në krahasim me vitin 2010.

Si rrjedhojë e tërë këtij dinamizmi, Ministria e Jashtme ka bërë edhe akreditimin dytësor të shumë ambasadorëve tanë dhe sot shumë prej tyre mbulojnë më shumë se një shtet nga qendrat ku ata veprojnë.

Krejt në fund, dëshiroj të inkurajoj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, ministrin Hoxhaj, për angazhimet e tij jo vetëm në çështjet që kanë të bëjnë me njohjen e shtetit tonë në botë, me rritjen e numrit të njohjeve, por në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë edhe me prezantimin e Kosovës dhe interesave të vendit tonë në organizata të ndryshme rajonale dhe ndërkombëtare, t'i bëjë të gjitha reformat e nevojshme në Ministri, t'i ngrejë kapacitetet, t'i shfrytëzojë edhe ato kapacitete mbështetëse që janë rreth nesh dhe që na afrohen nga miqtë dhe institucionet e ndryshme ndërkombëtare, duke pasur parasysh gjithnjë ato që quhen veprime prioritare në raport me procesin e integritetit tonë në BE. Faleminderit dhe suksese për ministrin dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Hyseni e ka fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër Hoxhaj,

Unë do të përqendrohem në disa aspekte më thelbësore, do të thosha të asaj që e bën një politikë të jashtme të një vendi, në aspektin më thelbësor të asaj që përbën orientime strategjike të diplomacisë së një vendi, aspekte më thelbësore të asaj që e bën një Ministri të Punëve të Jashtme koordinatorë kyçe të veprimit në rrafshin ndërkombëtar, të asaj që Ministrinë e Jashtme e bën koordinatorë kyçe dhe këshilltare të çdo aktiviteti të Republikës së Kosovës në marrëdhëniet ndërkombëtare, qoftë bilaterale, qoftë multilaterale.

Edhe nga të gjitha këto, sot dëgjuam asgjë, dëgjuam gjithçka tjetër, po asgjë nga këto.

Dëgjuam si lobohet për njohje të reja për Kosovën dhe lobimi është vetëm një dimension i cili s'do të jetë dimension fare nesër kur Kosova do të jetë shtet i pranuar në OKB, ndërkaq politika e jashtme e një vendi është shumë më shumë se kaq.

I nderuar ministër Hoxhaj, të jeni i sigurt se unë, më mirë se kushdo tjetër, jam i vetëdijshëm sa i ndërlikuar është procesi i njohjeve ndërkombëtare për Kosovën, sa delikat është ky proces, sa i ndjeshëm, sa i lëndueshëm. Dhe duke qenë deri në atë masë i lëndueshëm, ju me kolegët tuaj në Qeverinë e Republikës së Kosovës, e keni lënduar keq, e keni diskredituar, e keni komprometuar keq. Madje-madje duke u përpjekur të instalohen edhe metoda korruptive në një proces, i cili duhet të ruhet aq i pastër dhe aq i pakompromentuar, sepse vetëm si i tillë në plan afatgjatë Republikës së Kosovës do t'i sjellë dobi.

Është vështirë të arrihen njohje të reja, po vështirësia e këtij procesi nuk guxon të na zmbarsë nga domosdoja e ruajtjes së këtij procesi, si një proces i pastër, si një proces i cili nuk lejon ndërhyrje të agjendave personale, si një proces i cili nuk lejon ndërhyrje të agjendave biznesore, të tregtimeve të ndryshme, që janë të turpshme.

U tha këtu që Kosova ka pasur shumë strategji, ka ndërtuar shumë strategji, ka elaboruar shumë strategji, ka bërë shumë veprime në këtë dhe atë, pajtohem dhe shumë mirë, mirëpo efekti i të gjitha këtyre matet në rezultate konkrete dhe rezultatet konkrete flasin për dështim, pothuaj total në të gjitha ato përpjekje.

Çka po ndodhë me konsolidimin e mëtejme të Shërbimit të Jashtëm të Kosovës, që është një mekanizëm thelbësor veprues në politikën e jashtme? Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministri Hoxhaj e kanë për obligim të ndërtojnë një plan të qartë veprimi në marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës me botën. Po është Shërbimi Diplomatik dhe Konsullor ai mekanizmi veprues që e çon më tej këtë plan veprimi.

A po përpunohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme informacionet që ambasadat e Republikës së Kosovës i kthejnë? Unë ju them që jo, të nderuar deputetë. Nuk përpunohen. Madje në muaj të tërë, ndonjë informacion shumë urgjent i ndonjë ambasadori tonë në botë, nuk lexohet fare.

A po çohet më tej ndërtimi i strukturës së jashtme të Shërbimit të Jashtëm të Kosovës? Kemi një degradim të skajshëm. Me një nxitim qesharak për të zëvendësuar ambasadorë të dëshmuar të Republikës së Kosovës, me një nxitim të pakuptueshëm që të ngopen apetitet, qoftë edhe militante partiake, por gjithnjë në kurriz të një shërbimi kualitativ diplomatik.

Nuk dëgjuam asgjë nga ministri Hoxhaj rreth orientimeve strategjike të politikës së jashtme të Kosovës.

Çfarë po bën diplomacia e Kosovës që ta parandalojë një skenar jo shumë të këndshëm për Kosovën, që bota të mësohet me Kosovën, me fusnotë? Ka rrezik që një gjysmë identitet që po i servohet Kosovës, një status midis një shteti të njohur ndërkombëtarisht

dhe një territori, që Kosovën do ta hendikepojë keq në ecjen e saj të mëtejme drejt konsolidimit të plotë ndërkombëtar të shtetësisë. Unë pyes: Çfarë bën diplomacia e Kosovës në këtë rrafsh?

A është në dijeni ministri Hoxhaj se cili nga ministrat e Republikës së Kosovës, javën e ardhshme, ka aktivitet të jashtëm dhe ku?

Të nderuar deputetë, unë ju siguroj që ministri Hoxhaj nuk e di. Nuk ka detaje dhe informacion, sepse këto veprime të ministrave tjera nuk koordinohen me Ministrinë e Jashtme. E unë ju them që në çdo qeveri normale në botë, Ministria e Jashtme dhe ministri janë koordinatori kryesor i çdolloj aktiviteti në politikën e jashtme, madje edhe i agjendës në politikën e jashtme të presidentit.

Dhe unë këtu pyes, po ashtu, a njoftohet me kohë ministri Hoxhaj për agjendën e Presidencës së Kosovës, a njoftohet me kohë për agjendën e kryetarit të Kuvendit dhe a njoftohet me kohë për agjendën e secilit ministër në Qeverinë e Republikës së Kosovës, për aktivitet ndërkombëtar?

Kam shumë frikë se jo. Dhe kjo, sërish është e pafalshme, e papranueshme dhe kjo e bën thelbin e asaj që Lidhja Demokratike e Kosovës, po vazhdon ta quajë çakordim total i aktivitetit në marrëdhëniet ndërkombëtare.

U tha këtu që pesë vende të Bashkimit Evropian, që nuk e njohin Kosovën, nuk e pengojnë anëtarësimin, integrimin e Kosovës në BE. Keni kujdes, si e lexoni Raportin e Progresit! Unë ju ftoj për kujdes të shtuar si e lexoni çdo konkluzion të Komisionit Evropian, që ka të bëjë me Kosovën. Unë ju ftoj të keni kujdes dhe ta keni parasysh ‘aster*x’, atë yllin që është vendosur te Kosova dhe fusnota poshtë.

Të nderuar deputetë,

Këtij Kuvendi dhe këtij populli, kur është bërë ajo marrëveshje qesharake për fusnotën, i është thënë që kjo fusnotë do të aplikohet vetëm në aktivitetet rajonale të Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës ka ftuar për kujdes, mos do të marrë dimension më të gjerë kjo punë. Dhe lexojeni me kujdes raportin e djeshëm dhe do të konfirmohet kjo drojë, e cila ishte e ligjshme dhe legjitime e Lidhjes Demokratike të Kosovës, atëherë.

Është shumë mirë që bëhet një hap para në atë që quhet Marrëveshje Stabilizim-Asociimit. Mirëpo, nuk mendoj që ka vend për entuziazëm të tepruar, sepse, sërish po ju ftoj ta lexoni me kujdes çdo pasus në këtë raport dhe në tri-katër faqet e para çdo kund thuhet që kjo nuk paragjykon vendimet e ardhshme të Këshillit, kjo nuk paragjykon statusin e Kosovës. Kjo madje nuk e paragjykon edhe mundësinë e tërheqjes së ndonjë njohje edhe nga vendet që e kanë njohur Kosovën. Dhe kjo, për herë të parë përdoret në gjuhën e Komisionit.

Ne e mirëpresim absolutisht dhe Lidhja Demokratike e Kosovës do të punojë me ngulm që agjenda evropiane e Kosovës të shkojë përpara. Dhe nuk e kemi asnjë dilemë në këtë.

Kosova është Evropë dhe është Evropë plotësisht. Dhe, unë besoj e kërkoj që edhe në Bruksel, jo vetëm nga 22, por nga 27 vende, të kuptohet që Kosova është në zemër të Evropës. Nuk është në Afrikë, nuk është në Azi, nuk është Tajvan, s'është Sahara Perëndimore, nuk është Palestinë, nuk është Makao.

Dhe pyetja është, çfarë bën Ministria dhe politika e jashtme e Kosovës, diplomacia e Kosovës që këto t'i theksojë qartë dhe mirë. Kosova nuk guxon të hendikepojë vetveten përjetësisht, me mosveprimin në momentet kyçe, momentet akute të shtet ndërtimit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkoj ndjesë që e zgjata, desha vetëm t'i hedh disa ide për trajtim dhe t'i shpreh para jush disa shqetësime që unë dhe grupi im parlamentar, Lidhja Demokratike e Kosovës, i shohin si tejet brengosëse dhe tejet shqetësuese. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Tek sa e dëgjonim ministrin Hoxhaj, duke na u adresuar sot këtu në këtë interpelancë, krijohej përshtypja që ai po flet në një forum ndërkombëtar e jo në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Dihet që shkruesi dhe folësi e prodhojnë dëgjuesin. Çdokush që shkruan dhe flet e ka në mendjen e vet një dëgjues që do t'i lexojë ose do t'i dëgjojë ato të cilët prodhohen para tij. Dhe nga adresimi që e bëri ministri Hoxhaj, është e qartë që dëgjuesi i tij nuk jemi ne. Pra, ky fliste si në një forum ndërkombëtar dhe jo si në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku duhet të japë përgjegjësi dhe llogari për çështjet që janë ngritur këtu dhe në përgjithësi për politikën e jashtme të Republikës së Kosovës.

Pra, nga pikëpamja e ministrit Hoxhaj, ne nuk ishim sot këtu. Kjo sallë ishte e zbrazët dhe në këtë sallë ishte i mbushur vetëm ballkoni. Pra, vetëm atje lart ku ndodhën ndërkombëtarët, vetëm aty kishte dëgjues për fjalimin e ministrit Hoxhaj. Prandaj, ky nuk ishte ministër në Kuvend, por ishte ministër për ballkonin e Kuvendit dhe mbase edhe ministër i ballkonit.

Kush e di, ndoshta kjo kompensohet duke u folur ndërkombëtarëve si vendës. Pra, teksa neve na flet, thuaja se jemi ndërkombëtarë dhe me fjalorë diplomatik, mbase pikërisht ndërkombëtarëve ky u flet hapur, u jep llogari dhe aty është politik.

Edhe pak bëhen gjashtë muaj që ministri Hoxhaj nuk ka qenë në Komisionin për Punë të Jashtme të Republikës së Kosovës. Herën e fundit ishte më 27 prill të vitit 2012, e herën e fundit, më 4 shtator të këtij viti në mënyrë unanime, Komisioni për Punë të Jashtme i dërgoi një letër ministrit Hoxhaj që të vijë e të raportojë në Komision për çështjen e politikës së jashtme, e cila ishte edhe e çakorduar, por në të njëjtën kohë, edhe pa vizion.

Deri më 3 tetor, ne nuk kemi marrë përgjigje nga ministri Hoxhaj. Pra, nuk është se ne s'morëm përgjigje negative, meqenëse ne s'morëm përgjigje fare. Dhe më 3 tetor përgjigjet asistentja e tij, e cila përgjigjet duke thënë që s'mund të përgjigjet tash për tash, meqenëse nuk e di se kur do të vijë ministri Hoxhaj.

Kjo ndodhi pas një deklarimi timin publik, për një radiostacion të Kosovës, më 2 tetor, vetëm atëherë u përgjigj asistentja e ministrit Hoxhaj.

Me 8 shtator, ia kemi bërë ministrit një kërkesë për një sqarim lidhur me një kandidat për Shërbimin e Jashtëm dhe përgjigjen e kam marr vetëm sot. Kjo është në vazhden e sjelljes së njëjtë ku ministri Hoxhaj sa herë që ka kontakt të drejtpërdrejtë me neve të Komisionit për Punë të Jashtme, vjen me një paketë libra, revista dhe dokumentacion tjetër, që ne nuk kemi kohë ta lexojmë në mbledhjen e Komisionit, por ai e dyfishon nëpërmjet fjalimit të tij përmbledhës aty.

Ndërkaq, ky ministër, në raport me Komisionin tonë bëhet aktiv vetëm kur vjen puna te kandidatët për ambasadorë, ku u ndahen poste njerëzve, të cilët kur vijnë në Komisionin tonë për t'u dëgjuar, për t'u intervistuar, flasin se si e duan shumë vendin ku do të shkojnë.

Pra, në përgjithësi, s'po them për secilin prej tyre, por në përgjithësi këta kandidatë për ambasadorë, kur na kanë ardhur neve në Komision, në vend se të shprehin atdhedashuri për Kosovën dhe njohuri për vendin ku do të shkojnë, këta normalisht që kanë njohuri për vendin ku janë dhe shprehin dashuri për vendin ku do të shkojnë. Në vend se të jenë kandidatë të devotshëm për ambasadorë, ata janë tashmë turistë të kënaqur.

Përveç shkeljeve të ndryshme ligjore që i kemi diskutuar në Komisionin tonë, e të cilat i përmendi edhe ish- ministri, kemi edhe dobësi të llojit të kandidatit për ambasador, zotit Ahmet Shala, i cili siç dihet, bashkë me të ndjerin Dino Asanaj, paraqet vendësit kryesorë të procesit kryesor në Kosovën e pasluftës që është privatizimi neoliberal.

Dihej që Dino Asanaj përjetoi vdekje të dhunshme, vdekje makabër, ndërkaq personin tjetër të privatizimit, zotin Ahmet Shala, po fërfëllojnë në Japoni si ambasador, pas dështimit që ai të bëhet ambasador në Belgjikë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pra, në njërën anë e kemi Dino Asanaj, që është nën dhe, në anën tjetër, e kemi zotin Ahmet Shala që po e çojnë në dheun e largët të Japonisë. Vetëm në Zelandë të Re, do të mund të ishte më larg se kaq.

Unë nuk do të zgjatem më shumë për këto çështjet e Komisionit, llogaridhënies, përgjegjësisë, ndonëse kemi një mal me fakte për mungesën e këtyre, por do të them disa çështje konceptuale sa i përket politikës së jashtme që janë shumë problematike për Kosovën, për shkak të kësaj Qeverie dhe Ministrisë së saj përkatëse. Besoj që kemi një përqendrim të tepërt tek multilateralja dhe një deficit të bilaterales. Multilateralja është ajo ku mundësohet anëtarësimi që e relativizon sovranitetin, bilateralja është ajo ku kemi partneritet që e forcon subjektivitetin.

Pikërisht, mendësia multilaterale na e ka sjellë fusnotën. Ideja për t'u integruar, të jemi në forumet ndërkombëtare, për t'u bërë anëtar. Mirëpo, aty relativizohet subjektiviteti ynë, sepse organizmat multilateralë, janë organizma që udhëhiqen prej konsensusit, i cili më tutje realizohet nëpërmjet emëruesit më të vogël të përbashkët.

Multilateralja është interesi i fuqive të mëdha, i shteteve të vogla si puna jonë, interesi parësor është bilaterali. Pra, ne duhet ta kultivojmë mendësinë bilaterale. Kjo nuk do të thotë ta lëmë multilateralen, por jo të përqendrohemi tek multilateralja qind për qind, ndërkaq ta neglizhojmë dhe përçmojmë marrëdhënien bilaterale. Tek bilateralja, partneriteti pra e konfirmon subjektivitetin e palëve. Te marrëdhënia bilaterale ne nuk jemi më anëtarë, por bëhemi palë. Dhe, kjo është shumë e rëndësishme, për dinjitetin e këtij vendi, për perspektivën e tij zhvillimor në çdo aspekt.

Me shtetet e vogla dhe të mesme ne mund të zhvillojmë bashkëpunim sistematik në ekonomi, në arsim, në kulturë e kështu me radhë. Sepse, shtetet e vogla dhe të mesme na kuptojnë më mirë, na kuptojnë më shumë. Ndërkaq, kur vjen puna te superfuqitë, tek fuqitë e mëdha, me të cilat po ashtu duhet të përpiqemi të kultivojmë marrëdhënie të mira, aty përvoja historike e ka dëshmuar që ato janë më të dobishme nëse e merr një ndihmë të madhe një herë. Pra, bashkëpunimi sistematik është më shumë i mundshëm dhe i leverdishëm me ata me të cilët je i krahasueshëm. Ndërkaq, me ata me të cilët je i pakrahasueshëm, është më mirë ta marrësh një ndihmë të madhe një herë, ta zëmë vendosim FSK-në ta shpallim dhe bëjmë ushtri, nga një superfuqi mund të marrim gjithë armatimin e nevojshëm për më shumë se një dekadë nga një superfuqi. Ndihma e madhe një herë prej një superfuqie, është leverdia kryesore prej superfuqive.

Ndërkaq, meqenëse jemi shtet i dobët dhe i vogël, me shtetet e vogla dhe mesatare, do të mund të bënim bashkëpunim sistematik.

Në mbledhjen e 27 prillit, që e kemi pasur me ministrin Hoxhaj, ai është përgjigjur siç duhet në dy pyetje shumë të rëndësishme, që i kam parashtruar unë. Pyetja e parë ka qenë, a e njeh Republika e Kosovës Republikën e Serbisë? Ministri Hoxhaj u përgjigj siç duhet dhe siç është e drejtë dhe e dobishme: Jo, tha!

Pra, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës nuk e njeh Republikën e Serbisë dhe kjo është shumë mirë, mirëpo Qeveria e Republikës së Kosovës nuk është në përputhje me qëndrimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës.

Në çdo aspekt të jetës politike, ekonomike e institucionale, kemi pafund fakte që Qeveria e Republikës së Kosovës e pranon, e njeh, e toleron Republikën e Serbisë. Kjo do të thotë që kjo Qeveri, në fakt nuk qeveris. Por, kjo jo domosdoshmërisht është fakt i keq, duke pasur parasysh se çfarë Qeverie kemi.

Problemi është që qëndrimi i drejtë i ministrit Hoxhaj nuk arrin të mishërohet e konkretizohet askund dhe kësaj iu vu vula me mocionin kundër reciprocitetit me Serbinë, që u votua nga deputetët e pozitës, të ndërsyer prej Qeverisë aktuale.

Dhe këtu, një sqarim, reciprociteti që e kemi kërkuar ne, nuk është reciprocitet banal gjeometrik. Nuk mund të bëhet tash Serbia në jug të Kosovës. Nuk është reciprocitet i pasqyrës, por është reciprocitet strategjik. Serbia nuk na njeh, që të mos na njohë, ne s'duhet ta njohim, që të na njohë. Pra, reciprociteti që patëm kërkuar asokohe ka qenë strategjik dhe tendenca ka qenë që të banalizohet ai duke iu ndërruar karakterin dhe duke u trivializuar.

Më tutje, ministri Hoxhaj është përgjigjur siç duhet edhe në një pyetje tjetër, po aq të rëndësishme. Pyetja ime ka qenë: A është tregtia e jashtme pjesë e politikës së jashtme? Ky është qëndrim kapital. Ministri Hoxhaj, sërish është përgjigjur drejt, ka thënë: Po! Mirëpo, kjo do të thotë që zëvendëskryeministrja Kusari duhet, sa i përket tregtisë së jashtme, t'i nënshtrohet ministrit Hoxhaj. Dhe kjo do të thotë që mbase më mirë ministri Hoxhaj të jetë zëvendëskryeministër, sesa zëvendëskryeministrja aktuale. Dhe kjo s'ka të bëjë me emra të veçantë, kjo ka të bëjë me botëkuptimin politik me konceptin e qeverisjes.

Tregtia e jashtme, edhe unë mendoj që duhet të jetë pjesë e politikës së jashtme. Dhe në këtë aspekt, është i domosdoshëm dallimi i shteteve mike dhe i atyre jo mike. Jo se ne e bëjmë këtë dallim, por këtë dallim tashmë e kanë bërë vetë shtetet që nuk na kanë njohur kundrejt atyre që na kanë njohur. E këtu nuk bëjnë përjashtim as marrëdhëniet pra tregtare, përkundrazi, ato duhet të jenë pjesë integrale e politikës së jashtme, siç nuk janë aktualisht dhe në kundërshtim me qëndrimin e ministrit Hoxhaj.

Pra, shtetet, të cilat nuk na njohin, nuk na trajtojnë sikurse shtetet të cilat na njohin. Dhe, nëse ne këto shtete i trajtojmë njësoj, ne bëjmë padrejtësi ndaj shteteve që na kanë njohur duke i ulur në nivelin e atyre që nuk na kanë njohur.

Dhe, së fundi, politika e jashtme e Kosovës në rajon duhet të përqendrohet në marrëdhëniet me shqiptarët të cilët jetojnë nëpër vendet që na rrethojnë, pra politika e jashtme të përpilohet varësisht nga pozita dhe gjendja e shqiptarëve në ato vende.

Nëse dëshironi ta merrni vesh të vërtetën e Maqedonisë, të vërtetën e Malit të Zi, të vërtetën e Serbisë, pyetni shqiptarët që jetojnë atje, të shtypur politikisht e të shfrytëzuar ekonomikisht. Shqiptarët atje, janë e vërteta e këtyre vendeve.

Një aspekt i veçantë i kësaj politike pra duhet të jetë kontakti i rregullt, i shpeshtë dhe i drejtpërdrejt me shqiptarët jashtë kufijve të Kosovës dhe Shqipërisë për t'i shikuar mundësitë dhe nevojat e angazhimit institucional të vendit tonë, për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve nëpër këto vende ku ata janë autoktonë. Ta kemi parasysh që këta shqiptarë nuk janë pakicë. Kufiri i dhunshëm i ka bërë nominalisht pakicë, ndërkohë që politikisht, historikisht, pra përmbajtësisht ata nuk janë pakicë. Janë popullsi autoktone.

Dhe hapi i parë në këtë aspekt, do të duhej të ishte që me rastin e vizitave në vendet si Mali i Zi dhe Maqedonia, duhet së pari qeveritarët e Kosovës t'i takojnë shqiptarët atje.

Vetëm një shembull po e marr. Kur shkon ndonjë zyrtar i Republikës së Kroacisë në Mal të Zi, kurrë nuk shkon në Podgoricë pa u ndalë në Herceg-Novi ose në Kotorr.

E qeveritarët e Kosovës, e besa edhe të Shqipërisë, drejt në Podgoricë, pa u ndalur as në Ulqin, as në Anë të Malit, as në Tivar, as në Plavë e Guci, as në Malësi të Tuzit.

Pra, ne marrëdhëniet me këto shtete fqinje, duhet t'i ndërtojmë varësisht prej pozitës së shqiptarëve atje, sepse pozita e shqiptarëve është e vërteta e atyre vendeve.

Ndërkaq, në të njëjtën kohë, në Luginë të Preshevës, pra në Kosovë Lindore, nuk do të duhej që të dërgohet ministri i Diasporës, sepse ata s'janë mërgimtarë në tokë të huaj. Mendoj që është bërë një gabim i madh që është dërguar ministri i Diasporës para shumë muajsh. Kjo nuk do të duhej të përsëritet, gjithmonë duke pasur parasysh që edhe pavarësia e Shqipërisë, edhe pavarësia e Kosovës, janë bërë në emër të kombit e për hir të kombit dhe shqiptarëve që mbesin jashtë Kosovës dhe Shqipërisë ne, si institucione, si politikanë, si deputetë, si qytetarë u kemi shumë borxh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, fjalën e ka zoti Shala.

BLERIM SHALA: I nderuar kryesues,

Deputetë,

Kabinet qeveritar,

Diplomacia e Kosovës, që prej thyerjes së madhe të viteve 1989-'90, në Evropë dhe në Ballkan, ka pasur një rol shumë të veçantë në zhvillimet historike dhe politike të Kosovës, të cilat janë shfaqur me mundësinë që Kosova të mëvetësohet si shtet i pavarur.

Diplomacia e Kosovës vazhdon të ketë një detyrë shumë të veçantë, e cila dallon atë prej diplomacive të shteteve të sapokrijuara pas përbërjes së ish- Jugosllavisë, sepse edhe pas shpalljes së pavarësisë edhe pas njohjeve që iu bënë shtetit të Kosovës prej shumë shteteve në Evropë dhe në të gjitha kontinentet tjera, caku kryesor i konsolidimit ndërkombëtar të Kosovës nuk është arritur, ai i inkuadrimit të Kosovës në OKB.

Politika e jashtme e Kosovës i ka prioritetet e qarta, i ka objektivat afatshkurtra dhe afatgjata të definuara saktë, i ka krijuar mekanizmat e saj nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, Zyrës së Presidencës dhe Zyrës së kryeministrit, megjithatë po qe se synojmë të bëjmë një vlerësim të qëndrueshëm të punës, që është bërë në këtë fushë shumë të veçantë të stabilizimit të pozicionit ndërkombëtar të Kosovës, nuk është vështirë që të spikaten të metat, që kanë përcjellë në vazhdimësi diplomacinë kosovare.

1. Janë artikuluar fillimisht pritje aspak realiste, që çështja e njohjes së shtetit të Kosovës dhe inkuadrimit të Kosovës në OKB, është çështje muajsh, më së largu pak vitesh. Në këtë mënyrë janë krijuar pritje të mëdha te qytetarët e Kosovës, të cilat janë pasuar me zhgënjim dhe me dëshpërim.

2. Janë dhënë premtime, aspak të sakta, për heqjen e vizave për udhëtime në shtete të BE-së, gjë që po ashtu e ka shtuar mosdurimin te qytetarët e Kosovës.
3. Janë bërë paralajmërime të paqëndrueshme edhe për perspektivën euro-atlantike të Kosovës dhe kjo ka gjithnjë pasojë në perceptimin e kësaj detyre kapitale nga qytetarët e Kosovës.
4. Janë rrezikuar raportet e Kosovës me FMN-në, për shkak të agjendave të brendshme zgjedhore dhe po ashtu, nuk kemi arritur që partneritetin e kamotshëm me Bankën Botërore, ta kthejmë në sukses, sa i përket fuqizimit të sektorit energjetik dhe atij të bujqësisë, që janë parë gjithmonë prej Bankës Botërore si dy prioritetet kyçe të Kosovës, sa i përket zhvillimit ekonomik.
5. Improvizimet e shumta, mungesa e koordinimit ndërmjet autoriteteve kryesore të politikës së jashtme të Kosovës, madje gafet dhe skandalet e ndryshme diplomatike, kanë bërë që të dobësohet gjasa që të marrim njohje të reja. Këto improvizime kanë sjellë storie të çuditshme në mediet tona edhe në trajtë të kërkimit të njohjes nga shtetet, të cilat nuk kanë adresë të qartë të qeverisjes - rasti i Malit.
6. Nuk ka pasur konsistencë, sa i përket prioriteteve dhe synimeve kyçe në politikën tonë të jashtme dhe po ashtu, nuk janë dhënë sa dhe si duhet sqarimet qytetarëve të Kosovës, se cilat janë rrugët e anëtarësimit në OKB. Më konkretisht, dihet që rritja e numrit të njohjeve nga shtetet anëtare të OKB-së ka më shumë rëndësi psikologjike sesa politike dhe diplomatike, sepse anëtarësimi në OKB njeh procedurat e qarta, të cilat akoma nuk janë hapur në rastin e Kosovës, për shkaqe të njohura për të gjithë ne.
7. Nuk janë ngritur me kohë shqetësimet tona në Bruksel, në Bashkimin Evropian, sa i përket raporteve të Kosovës me Bashkimin Evropian, apo këtë e kemi bërë vetëm kur kemi kuptuar se do të përballemi me telashe të shumta në relacionet tona me BE-në, për shkak të refuzimit të pesë shteteve anëtare të BE-së për ta njohur Kosovën.
8. Nuk i është dhënë deri vonë rëndësia e duhur raportit të ndërlidhur dhe të ndërvarur midis stabilizimit të brendshëm të Kosovës, integritetit të veriut të Kosovës në rendin kushtetues të Kosovës dhe konsolidimit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës.
9. Nuk janë shfrytëzuar në masë të duhur mundësitë për nisma rajonale, të cilat do ta shquanin Kosovën si një shtet që synon të ketë fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet e rajonit dhe të jetë shtet, që kontribuon në paqen dhe stabilitetin e rajonit.
10. Nuk është bërë shumë punë në imazhin ndërkombëtar të Kosovës dhe po ashtu, nuk është shfrytëzuar sa dhe si duhet mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, në rastin e pavarësimit të Kosovës.

Të gjitha këto të meta, së bashku kanë bërë që politika e jashtme e Kosovës të jetë realisht, akoma larg përmbushjes së synimeve kryesore të saja. Askush në mesin tonë, në Kuvendin e Kosovës nuk mund ta dijë se kur Kosova do të jetë anëtare e OKB-së.

Anëtarësimi në paktin NATO dhe në Bashkimin Evropian është pak a shumë i përlogaritshëm, por saktësia në këtë aspekt është goxha dëshpëruese për qytetarët e Kosovës.

Diplomacia kosovare, për shkak të mospërbushjes së synimit kryesor të konsolidimit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, gjë që është interes nacional, do të duhej të ishte detyrë që bashkon Qeverinë dhe opozitën, të gjitha partitë që bëjnë Kuvendin e Kosovës, shoqërinë kosovare në përgjithësi.

Në anën tjetër, po kuptohet gjithnjë e më shumë, që stabilizimi i brendshëm i Kosovës, integrimi i veriut, fuqizimi i sundimit të ligjit në gjithë Kosovën dhe normalizimi i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, do të krijojnë rrethanat e domosdoshme, që të ndodhë ai kërcimi kualitativ në fushën e njohjeve të Kosovës, i cili pastaj do ta shkurtonte ndjeshëm rrugën tonë kah OKB-ja dhe do të krijonte rrethana më të favorshme për raportet e Kosovës me Bashkimin Evropian. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, kush e ka fjalën?
Fjalën e ka Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

I nderuar kryeministër,

Të respektuar kolegë deputetë,

Sot po diskutohet për politikën e jashtme të shtetit të Kosovës, e cila është konsoliduar me vite, që nga fillimvitet e '90-ta e deri më sot.

Për të gjithë ne, tanimë është bërë e ditur dhe është kristalizuar e vërteta se vendi ynë, kur është në pyetje politika e jashtme, është i drejtuar kah integrimet veriatlantike. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, përveç që kemi konsoliduar politikën e jashtme, kemi vënë themelet dhe jemi në përfundim të ndërtimit edhe të diplomacisë së vendit tonë, si mekanizëm që zbaton politikën e jashtme.

Sot, vendi ynë është i pranishëm në të gjitha iniciativat ndërkombëtare, rajonale dhe shumë të tjera përtej kufijve të rajonit tonë. Përveç kësaj, për të njëjtin qëllim edhe Prishtina është shndërruar në qendër që pret shumë personalitete ndërkombëtare, bëhen takime të karakterit bilateral e multilateral, organizohen forume të rëndësishme. Të gjitha këto bëhen në sajë të një angazhimi permanent të institucioneve të shtetit tonë në përgjithësi dhe drejtuesve të dikastereve të ndryshëm të ekzekutivit, në veçanti.

Pa mohuar angazhimet e mëparshme, këtë herë na duhet të theksojmë se kur bëhet fjalë për politikën e jashtme dhe diplomacinë e shtetit të Kosovës, merita të jashtëzakonshme kanë: zëvendëskryeministri, zoti Behgjet Pacolli, ministri për Punë të Jashtme, zoti Enver Hoxhaj. Ata me angazhimin e tyre kanë bërë një punë të jashtëzakonshme për shtimin e numrit të njohjeve dhe përmirësimin e imazhit të vendit tonë në botë.

Sot, jemi të pranishëm gjithkund, gjë e cila na ka munguar në të kaluarën e afërt. Zëri i Kosovës tani, sa vjen e po dëgjohej gjithnjë e më shpesh dhe gjithnjë e më fuqishëm edhe në kontinentin e Azisë, Afrikës, Amerikës Jugore dhe pothuajse në çdo cep të globit. Ky zë, jo vetëm që po dëgjohej, por edhe respektohet. Diplomacia e Kosovës sot është më aktive se kurrë. Ajo ka arritur, që të kthejë në anën tonë shtetet, si Gana dhe Gaboni, që kanë pasur raporte shumë të ngushta dhe historike me Serbinë.

Të nderuar kolegë deputetë, vendi ynë kurrë nuk ka qenë më aktiv në të gjitha drejtimet e politikës së jashtme. Sot jemi aktiv në shumë fusha të diplomacisë, si në diplomacinë ekonomike, kulturore, publike dhe digjitale. Ne si deputetë, kur realizojmë vizita jashtë vendit, shohim dhe mund të dëshmojmë, se rrjeti ynë diplomatik është në funksion të përgjegjësive që ka marrë dhe i përgjegjshëm për detyrat që i ka. Ata tanimë kanë fituar përvojë, që të ndihmohen delegacionet e Kosovës në realizimin e sa më shumë takimeve në institucione të ndryshme.

Më lejoni që në fund, të falënderoj aktorët kryesor të politikës së jashtme, presidenten e vendit, zonjën Jahjaga, kryeministrin Thaçi, zëvendëskryeministrin Pacolli dhe ministrin Hoxhaj, për punën e jashtëzakonshme, që e bëjnë në interes të vendit, pa harruar edhe deputetët, që janë shumë aktivë në çështjen e politikës së jashtme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS-ja, zoti Miletic.

PETAR MILETIĆ: Gospodine potpredsjedniče Skupštine,
Predsjedniče Vlade,
Članovi Vlade, ministre Hodžaj,
Poštovane kolegice i kolege poslanici,
Za razgovor o radu Ministarstva Inostranih Poslova moramo sagledati sve činjenice, koje utiču na njegovu efikasnost.

Ovo Ministarstvo najmlađe je na Kosovu i nastaje kao rezultat primene Ahtisarijevog plana. Za postojanje respektabilne diplomatije, ipak potreban je duži vremenski period. Školovanje kadrova, stalno usavršavanje i razvoj međunarodnih odnosa, može dati vidljive rezultate samo u dužem periodu.

Dakle, bez kontinuiteta u radu i bez dovoljno stručnog i osposobljenog kadra, Ministarstvo Spoljnih Poslova, suočava se ponekad i sa nerealnim očekivanjima, očekivanjima koja previđaju da Kosovo ima komplikovan status u međunarodnim odnosima. Očekivanjima, koja ne uzimaju u obzir da najveće svetske sile stavljaju Kosovo u fokus svojih diplomatskih aktivnosti a da su pri tom njihove pozicije i interesi potpuno suprotstavljeni. Bez namere da osporim primedbe opozicije na rad Ministarstva Spoljnih Poslova, ipak postavlja se pitanje, čime meriti rad Ministarstva Spoljnih Poslova?

Mislim da na normiranje rezultata rada u diplomatiji, svakako nije način. To eventualno može da bude samo jedan pokazatelj, koji može koliko da pomogne, toliko i da odmogne pravoj analizi. Smatram da je jedini pravi način, pošteno i argumentovano utvrđivanje

činjenica da li je i koliko Ministarstvo Spoljnih Poslova na čelu sa ministrom Hodžajem, doprinelo diplomatskom položaju Kosova?

Ono što treba pohvaliti je činjenica da ministar svojiim radom i nastupima nije od svojih sagovornika pravio neprijatelje Kosova, već naprotiv stvarao je odnose prijateljstva i podrške. U situaciji u kojoj se kosovsko društvo nalazi u odnosima u regionu, koje može poremetiti čak i trivijalna stvar ili izjava, nije bilo neodmerenih reči iz Ministarstva Spoljnih Poslova, makar ne na nivou pravila. Čak i kada su regionalne politike različite i naizgled nepomirljive, prvi zadatak diplomata je da se stvori atmosfera da su dogovori mogući. Ovu neophodnu atmosferu, koja mora zavladatai regionom, atmosferu da odgovorni ljudi mogu da razgovaraju iako se ne slažu, da mogu sve pa i najteže probleme rešavati pregovorima, Ministarstvu Spoljnih Poslova nije narušavalo.

Diplomatski kontakti koje moja stranka i ja lično imamo potvrđuju da je prilikom razgovora ministra Hodže i stranih diplomata, jedna od prioriternih tema bila položaj srpske zajednice i da u tim kontaktima ministar ima realan i konstruktivan pristup. Želim da ga sa ovog mesta u tome ohrabrim i podržim. Proklamovanu politiku Ministarstva Spoljnih Poslova, da Kosovo pored dobrih odnosa, na najvišim nivoima vlasti, moraju postojati snažni odnosi između građana, društava i svih institucija u regionu. Takvu politiku SLS najsnažnije podržava. To je uostalom i konkretizacija naše politike o potrebi saradnje među običnim ljudima na terenu, kojima politika treba da otkloni sve političke i birokratske barijere za saradnju, a ne da te barijere pod izgovorom većeg cilja proizvodi.

Ne želim da sve moje diskusije u ovom domu budu isključivo shvaćene kao odbrana interesa moje zajednice. Misija nas poslanika manjinskih zajednica nije samo da branimo naše zajednice. Smatram jednostavno, da je naša odgovornost sveopšti razvoj Kosova, a da od toga zajednice mogu imati smo korist.

U tom smislu, dok razgovaramo o radu diplomatije na Kosovu, želim da istaknem da je neophodno veće angažovanje na privlačenju stranih investicija. To je jedini put oporavka Kosova i razvoj svih njenih građana. U tom, po razvoj Kosova, najvažnijem zadatku, Ministarstvo Spoljnih Poslova mora biti skretničar interesa velikih svetskih kompanija, da se zainteresuju za Kosovo.

Institucije Kosova moraju omogućiti da logika biznisa, koja dovodi strane ulagače prevlada sve potencijalne probleme i izazove. Zato od Ministarstva Spoljnih Poslova tražimo veći nivo angažovanja na dovođenju stranih investicija, promovisanju Kosova kao dobrog mesta za ulaganje, a od svih vršioca vlasti, i od svih učesnika u političkom životu Kosova, poboljšanje poslovne klime i ostvarivanje boljih privrednih pretpostavki za ulaganje.

Takođe, principijelno pozivamo ministra da u svom radu i kadriranju vodi računa o zastupljenosti etničkih i polnih grupa na Kosovu.

Poslanička Grupa Samostalne Liberalne Stranke, podržaće rad Ministarstva Spoljnih Poslova i očekuje da naše iznete sugestije budu shvaćene kao izraz potrebe da Kosovo bude dobro mesto za život svih ljudi i svih zajednica.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Interpelanca e sotme për punën dhe të arriturat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është ndoshta një prej momenteve shumë të rëndësishme të punës së kësaj legjislature dhe sonës si deputetë.

Ky diskutim dhe vënia në peshojë e punës së këtij dikasteri, ndër më të rëndësishmit në Qeverinë e Kosovës, po ndodhë në një moment kur Ministria e Punëve të Jashtme është gjendur në një situatë midis përfaljeve të shumta të medieve dhe jashtë tyre, për zgjidhje kompetencash apo edhe demante të njohjes së Republikës së Kosovës në rrafshin ndërkombëtar.

Kolegë deputetë, nga radhët e LDK-së folën për punësime me theks nga Theranda, nga vjen ministri Hoxhaj, por po jua kujtoj se kur është formuar Ministria e Punëve të Jashtme, është udhëhequr nga ju zoti Hyseni, prandaj 80% e stafit të saj janë anëtarë të LDK-së. Megjithatë, ky nuk është fokusim i diskutimit tim të sotëm, por janë të arriturat dhe puna që është bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës në Politikën e Jashtme.

Andaj, më lejoni që ato t'i numëroj në fjalën time, në vijim. Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, angazhohet për mbrojtjen e interesave shtetërore, në arenën ndërkombëtare, promovimin e interesave politike dhe ekonomike të Kosovës, si dhe mbrojtjen dhe përfaqësimin e të drejtave dhe interesave të shtetasve të saj.

Njëra ndër sukseset më të rëndësishme të Republikës së Kosovës e në veçanti të Ministrisë së Punëve të Jashtme, padyshim është arritja që të nënshkruhen 103 marrëveshje ndërkombëtare, përkatësisht traktate të lidhura ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të huaja ose organizatave ndërkombëtare. Marrë parasysh praktikën ndërkombëtare dhe proceset e zhvilluara, nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve në këtë nivel, në këtë interval kohor, është një rezultat që duhet përshëndetur dhe vlerësuar lart. Dhe, këtu padyshim meritat më të mëdha i shkojnë Qeverisë Thaçi dhe ministrit Hoxhaj, që me përkushtimin e tij dhe punën e palodhshme kanë bërë, që qytetarët të ndjehen të relaksuar sa i përket politikës së jashtme.

Si rezultat i nënshkrimit të marrëveshjeve dypalëshe ndërshtetërore është thelluar bashkëpunimi ndërshtetëror me shtete të ndryshme dhe është themeluar baza kontraktuale në shumë fusha të rëndësishme të veçantë, si bashkëpunimi ekonomik, mbrojtja dhe promovimi reciprok i investimeve, bashkëpunimi doganor, fusha e sigurisë dhe e policisë, riatdhesimi, transporti rrugor, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, bashkëpunimi

zhvillimor, asistencë teknike e tjera. Kompetencat e Ministrisë së Punëve të Jashtme shtrihen edhe në procesin e hyrjes në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare, ku të gjitha aktet ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me hyrjen në fuqi, vlefshmërinë, raportimin për zbatim, pastaj ruajtjen, administrimin dhe publikimin e informacioneve, për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, bëhen nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës.

Të nderuar kolegë deputetë, qytetarë të nderuar të Kosovës, ky përshkrim lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare ka për qëllim informimin e drejtë të opinionit, se për çfarë pune të rëndësishme bëhet fjalë, si dhe për të dëshmuar se në të gjitha këto marrëveshje është drejtpërdrejt e përfshirë Ministria e Punëve të Jashtme. Kjo është tregues shumë i qartë, se çfarë bëhet në këtë ministri. Vetëm gjatë kësaj periudhe, Ministria e Punëve të Jashtme, në bazë të fushëveprimtarisë së vet e ka koordinuar procesin e nënshkrimit të 54 marrëveshjeve ndërkombëtare dypalëshe, ratifikimit të 47 marrëveshjeve dypalëshe dhe njoftimit për hyrje në fuqi të tyre, të shteteve palë. Kjo shifër del të jetë më tepër se gjysma e marrëveshjeve në total.

Gjatë kësaj kohe, në emër të Qeverisë së Kosovës, janë nënshkruar 10 marrëveshje ndërkombëtare. Gjithashtu, nga periudha 2011 deri më tani janë nënshkruar 5 protokolle të bashkëpunimit me ministrinë e punëve të jashtme të Kroacisë, Bullgarisë, Sllovenisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Janë nënshkruar 5 memorandume mirëkuptimi me Këshillin Britanik në Kosovë, marrëveshje bashkëpunimi për programin Fulbright, me Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, marrëveshje bashkëpunimi me Akademinë Diplomatike të Republikës së Kroacisë, Republikës së Turqisë dhe Arabisë Saudite. Janë nënshkruar 35 letra autorizime për ministrat dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, në emër të Qeverisë, si dhe shtatë letër pëlqime për nënshkrim të marrëveshjeve ndërinstitucionale për ministrinë dhe agjencitë shtetërore.

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë u dërguan letra në drejtim të gjitha qeverive të botës, për njohjen e saj. Njohjet e para filluan menjëherë pas disa orësh dhe ato ishin masive, ndërsa njohjet e mëvonshme ishin kryesisht rezultat i lobimit dhe udhëheqjes së mirë të politikës së jashtme të Qeverisë Thaçi dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të kësaj Qeverie.

Për të folur për sukseset e kësaj Ministrie do të duhej ndoshta edhe më shumë kohë, por për shkak të kohës së kufizuar, do të ndalem këtu. Megjithatë, mendoj se këto shifra, fakte të prekshme, janë një tregues dhe barometër i pakontestueshëm për sukseset e këtij dikasteri të Qeverisë Thaçi. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti nënkryetar i Kuvendit,
Zoti kryeministër,
Ministër i Jashtëm,
Zoti zëvendëskryeministër dhe dy ministra tjerë, e Integritetit dhe i “Autostradave”,
Kolegë të nderuar,

Pajtohem me fjalinë e parë të raportit të ministrit të Jashtëm, që thotë politika e jashtme është interes nacional dhe duhet të jetë konsensuale dhe jam pajtuar dhe në bisedimet në Komision me këtë konstatim të tij. Bile, e kam trimëruar aq sa kam mundur në turbullirat që i kanë ndodhur atij rreth kryerjes së funksionit të tij si ministër resori dhe përdëgjimeve të detyrimeve që kanë marrë në ministri dhe përtej saj, për politikën e jashtme.

Çështja është, sa mënyra e veprimit lejon funksionalisht që kjo politikë e jashtme, që është interes nacional i Kosovës, në këtë periudhë dhe në të gjitha periudhat, mund të bëhet konsensuale me veprimet konkrete të Ministrisë dhe të politikës së jashtme.

Unë këtu dëgjova diskutime deputetësh të cilët janë më shumë raportues të Ministrisë me shifra, se sa vetë ministri. Ministri preferon të flasë në koordinata më të gjëra, ndërsa rolin e raportuesit po e marrin deputetët, pak e çuditshme, sepse edhe nuk janë në atë Komision, i cili e ka pak a shumë detyrë kuvendore, që të merret më shumë me këto punë, po kjo është çështje tjetër.

Në rast se thashë, dom që të kemi politikë të jashtme konsensuale dhe është interes i vendit, atëherë duhet të sillemi në të gjitha nivelet, në nivelin e ndërtimit të asaj Ministrie, në nivelin e rrjetit diplomatik dhe në nivelin e konsultimit institucional, që këto politika të jenë konsensuale.

Unë mund t'ju them që në të tri nivelet kjo nuk ka ndodhur. Dhe, është keq, sepse edhe këtu u tha, u përmendën problemet e filiacionit politik, bile njëri e dha edhe një përqindje, 80% këtu para meje, që janë të LDK-së. Nuk e di sa janë, sepse filiacionet është problem të dihen në atë mënyrë, sepse ndërgjegjja politike e njerëzve është e lirë dhe njerëzit mund të kenë simpati këso e aso edhe kur bëjnë funksione nacionale. Më në fund edhe ministri i Jashtëm, është një pozicion politik, po e synon një interes nacional.

Çështja është që kjo Ministri që është e re dhe mezi është formuar dhe është penguar gjatë e gjatë deri sa është formuar. Bile ka pasur rezistenca për dhjetë vjet që të mos ketë as Komision Parlamentar për Punë të Jashtme dhe këtë e dëshmoj, sepse e kam udhëhequr për tri legjislatura, atëherë duhet të provohet që të ndërtohet mbi kritere dijeje, mbi kritere njohjeje a të problemeve të vendit, të aspiratave të tij dhe të raporteve me të tjerët, që janë raporte shumë delikate edhe dje edhe sot.

Krejt ai kapacitet që kemi ne në punët e jashtme, edhe në diplomaci, po të dëndësohej i krejt Kosovës, është pak problematik, a e mbërrin kapacitetin e vërtetë për të pritshmet? Kjo ndodhë më keq, nëse atëherë bëhen preferencat politike momentale në hyrjen në këtë shërbim. Unë po them, që kësaj mund t'i iket nëse zbatohen ligjet, të mirë e të këqij, me mungesa e pa mungesa, ato çfarë i kemi tash. Ka pasur prova të vërteta që këto ligje nuk janë zbatuar edhe në këtë mandat. Dhe, ministri e di, sepse kemi komunikim edhe përmes Komisionit, po edhe komunikim përtej kësaj, të një kolegjaliteti, ta quajmë ne hajde, kolegjaliteti përtej përfaqësimit dhe unë nuk e di sa janë këto detyrime të tij politike, sa janë zgjidhje të tij. Mua më duket që ekziston një pështjellim i fuqishëm edhe i kompetencave edhe inkompetencave rreth politikës së jashtme, kështu që detyrimet e tij

mbasandaj bëhen të pakalueshme, sepse ai e tha vetë, ne shkruajmë shumë letra. Është e vërtetë që këta shkruajnë letra, po ajo është punë e tyre të shkruajnë letra edhe të lexojnë dhe të analizojnë letra, veçse letrat për emërime që kanë ardhur, për shembull në Komision, janë hiç profesionale. Bile, nganjëherë ka gabime që mua më vjen keq edhe t'i përmend, po duhet për t'u përmendur. Ty të vjen rekomandimi për njeriun, i arsyetuar krejt për një vend tjetër dhe rekomandohet në vendin tjetër. Ajo është një, unë do të thosha, një pakujdesi, sepse ai farë propozimi ka kaluar nëpër faza të ndryshme dhe nuk e kanë pasur korrektësinë, që variantin e fundit ta lexojnë. Ose, vjen njeriu me letër, kërkohet të bëhet ambasador dhe vjen njeriu na thotë në Komision, më falni por unë s'jam ambasador, unë dua konsull të bëhem edhe s'kam punë me ju dhe faktikisht s'ka punë me Komision.

Unë kisha thënë që këto janë jo korrektësi në punë, pikërisht në shkrimin e letrave dhe në leximin e letrave. Mos të flasim tutje për afate paraligjore të ndërrimeve. Le të bëhen ndërrime, zonja dhe zotërinj, si në çdo Ministri edhe në të Jashtmen, por keni kujdes se ato vlera e kapacitete që i ke, ai që i gjuan, ai e pëson vetë. Ku ta marrim kualitetin për t'i ruajtur, le ta kenë ata filiacionin çfarë të donë, se kurrkush s'mund të bëhet sot në Kosovë përfaqësues diplomatik, që ka le dje, po e ka një biografi e një kulturë e një mënyrë të veprimit e një back ground e tjera, e tjera.

Kjo puna që ministri na tha, që ka shkuar në të gjitha qendrat e Bashkimit Evropian, ndoshta mendon në pesëshen, sepse në vendet që s'e kanë njohur Kosovën, është i vështirë kontaktimi. Unë e di dhe ia di si vështirësi, po edhe s'të pranojnë në cilësinë çfarë e do ti dhe është problem, domethënë nuk është çështje e thjeshtë ajo punë. Unë nuk po i numëroj vendet, por dihet ato cilat janë.

Nuk jam këtu as për të bërë kritika, që thonë rrënuese, shfarosëse, po nuk jam as njeri që krijoi "llakerovka"- forma të lavdërimeve, të cilat edhe në literaturë janë qesharake. Pse po e them këtë? Ministri e tha këtu, unë punoj 15 orë, më duket, nëse e ke thënë orën... po dua të jem i saktë, se më duket e the 15, se ke mund të thuash edhe 16, a sa të duash, a 24, a si të duash. Kjo është interesant. Pse më duket interesant?

(Ndërhyrje)

Jo, ky tha punoj për punën që e ka, nuk po hy andej, ai del e arsyeton vetë, problemi është që një vartës i këtij ministri, kur e merr rrugën të shëtisë nëpër Evropë dhe i takon ambasadorët, fjalja e parë është- thotë që mos bëni zhurmë se ministri ynë punon 15 orë. Domethënë, problemi është i asaj që unë e quaj edhe si formë e diskursit të "llakerovkës". Gjë nuk i vlen, as këtij ministri, as Kuvendit, as Ministrisë së Jashtme, as Qeverisë së Kosovës, që të krijojnë vartës, të cilët e kryejnë rolin e vet duke i bërë elozhe një ministri. Se, vartësi është vartës, le t'i realizojë detyrat edhe detyrimet që i ka, nuk ka nevojë, unë besoj që ministri Hoxhaj është asi niveli se kënaqet një vartës i tij, që s'është profesionist, se të jetë profesionist dhe të jetë diplomat është shumë më i mençur, gjen argumente tjera ta lavdërojë ministrin për të mos ua qitur mentë njerëzve, duke i bindur se punon nga 15 orë ose 17, po e zëmë. Hajde, 16 po them. Kjo duket pak si humor dhe është mirë që duket, sepse kjo po më shtyn që të përmend diçka, sepse prej trashëgimisë mësohet

shumë. Ne kemi pasur, ne tash po them shqiptarët, një njeri, një shkrimtar brilant, i shkëlqyeshëm dhe atdhetar i shkëlqyeshëm, Faik Konica.

Në anën tjetër, më hyn në punë direkt, sepse është ndër ambasadorët më të shkëlqyer të shqiptarëve, për shumë vite, po edhe karshi të tjerëve. Bile, ka që i kanë thënë është “enciklopedia që ecën” dhe nëse doni të flisni mirë për shqiptarët jashtë, zotni Konica veç thuaj që je shqiptar dhe sillu qysh je, është mjaft.

Dhe, është e vërtetë që ka qenë kështu. Problemi është tjetërkund. Vetë ky Konica, duke qenë shkrimtar brilant dhe duke pasur një empiri me përvojë jetësore, me përfaqësimin e shqiptarëve, që është krejt atipike, e ka shkruar një tekst për këtë temë, që quhet: “Një ambasadë e Zulluve në Paris”, që është tekst, unë do të thosha shkollor për këto raporte të përfaqësuesve të shqiptarëve jashtë.

Çka ndodhë këtu? Këtu janë edhe ata që bëjnë “llakerovkë”, për punë të Qeverisë dhe të Ministrisë dhe ata që pretendojnë që problemi është brenda gjithmonë dhe nëse brenda rregullohesh, përfaqësimi jashtë është në rregull. Pak a shumë, siç i bie popullorçe te ne: “qysh të përcjellin te shpija, aq ata japin edhe notën në pazar”, se kjo është një urti popullore, po i bie pak a shumë njësoj.

Zullutë, që është normalisht figurë te Konica, po dihet që ka të bëjë me Shqipërinë, ata, një ambasador i tyre do të bëjë festë edhe kryetari i Zulluve brenda, që është Denizullu-Serpe, bëjnë festë nacionale për sukseset e mëdha që i ka arritur në Paris. Ata, në të vërtetë, kolegët e tyre tërë kohën janë tallur, ky s’ka qenë në gjendje të shohë që është tallje, se ka njerëz që kur të thonë je analfabet, të thotë: “Ti je më i miri i dynjasë”, dhe ti nëse s’e di që është tallje, e merr.

Në tubimin popullor, Denizullu, në Zullulland, i thërret të gjithë dhe thotë: “Po i festojmë sukseset tona”. Është një atje i shkretë, po them i shkretë në kuptimin e fatit të tij, po jo i dijes, plugu, se edhe emrat kanë kuptim, që është punëtor i madh dhe thotë: “Shikoni, ata janë tallur me ne, t’i grahim, t’i kryejmë punët tona brenda”, se aty thotë na respektojnë, përderisa s’i kryejmë punët tona ata do të qeshin me ne”.

Dhe, çka është përfundimi? Turma e linçon plugun, që lufton për interesa të tyre, sepse Denizullu-Serpe ka thënë që ky është sukses. Zullutë e Konicës e kanë Zot besimi borigën, dru. Nuk jemi në atë situatë dhe unë mendoj që, po kthehem prapë te konsensusi, konsensus, konsensus për kualitet, konsensus për përgjegjësi, kurrkush në këtë vend ideal s’ka për t’u bërë, por gjithkush do të mbetet i përmendur nëse punon me optimumin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Zoti kryesues,
Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Një kritikë për politikën e jashtme të Republikës së Kosovës është se kjo politikë është shumë e sheshtë dhe shumë e padiferencuar, kurse politika e jashtme duhet të jetë më e valëzuar dhe më e diferencuar se kaq.

Kosova nuk mund të ketë politika të njëjta, për shembull, si me shtetet të cilat na kanë ndihmuar për shtetësinë tonë dhe na kanë njohur si shtet, si dhe atyre që nuk na kanë njohur si shtet dhe bile, na luftojnë që ne të mos njihemi prej të tjerëve. Kosova në këtë aspekt, duhet t'i ketë të paktën katër nivele të ndryshme të politikës së jashtme.

Së pari, politikë e jashtme e veçantë me Republikën e Shqipërisë. Kjo politikë duhet të jetë politikë e integritit.

Së dyti, politikë e jashtme me shtetet që tradicionalisht na kanë ndihmuar dhe na kanë njohur, siç janë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Britania e Madhe, Turqia, si dhe shumë shtete të tjera perëndimore.

Politika me to duhet të jetë kërkesa e ndihmës, në aspektin e zhvillimit ekonomik, si dhe për konsolidimin e sovranitetit të Kosovës, sidomos në aspektin e sigurisë si dhe në aspektin ushtarak.

Së dyti, politika e jashtme me ato shtete që nuk na kanë njohur, por që nuk na luftojnë në mënyrë të hapur, mirëpo e bëjnë këtë gjë, siç tha edhe ministri vetë, për çështjet e tyre të brendshme, ato nuk na njohin për shkak se i kanë problemet e tyre, siç janë: Spanja, Sllovakia, e kështu me radhë.

Me këto shtete politika e jashtme duhet të jetë më aktive, që t'i bindim ato dhe t'i sigurojmë se krijimi i marrëdhënieve të plota diplomatike me Kosovën, nuk ua kërcënon atyre aspak sovranitetin dhe integritetin e tyre territorial. Dhe, këtyre shteteve, të gjithave, duhet t'iu shpjegohet rasti i Turqisë, e cila siç dihet ka probleme atje të brendshme me kurdët, mirëpo kjo as nuk e ka penguar Turqinë që ta njohë Kosovën, por në anën tjetër njohja e Kosovës as nuk ka kontribuar që kurdët ta ndryshojnë strategjinë e tyre, kundër Turqisë, ta zëmë.

Pra, paska edhe shtete, të cilat e paskan njohur Kosovën, po paskan problemet e tyre të brendshme dhe problemet e tyre të brendshme nuk kanë ndikuar që ato të mos e njohin Kosovën.

Si dhe në fund, do të kemi politika të veçanta me shtetet, të cilat jo vetëm që nuk na njohin, po na luftojnë në mënyrë të hapur me të gjitha mjetet, pa kursyer kurrgjë dhe kudo që atyre u jepet mundësia, siç janë Serbia dhe Rusia.

Me këto shtete duhet politikë e fuqishme e jashtme dhe e brendshme, e cila gjithkund dhe kudo i sfidon potencialet e tyre destabilizuese dhe minuese në raport me Kosovën. Kosova duhet të jetë më aktive në argumentimin e Kosovës si rast i okupimit klasik dhe i çlirimit të drejtë, si rast i gjenocidit, si rast i domosdoshmërisë së dekolonizimit, si dhe ta demaskojë vazhdimisht politikën obstruktive dhe hegjemoniste serbe dhe ruse në Kosovë,

si dhe ta bindë më shumë komunitetin ndërkombëtar dhe evropian se përparimi i interesave ruse, sidomos në veri të Kosovës, përbën një potencial të madh destabilizues, jo veç për Ballkanin, po për krejt Bashkimin Evropian, si dhe e minon arkitekturën e sigurisë evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Selmani, kryetare e Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Përshëndetje për kryeministrin dhe ministrat e Kabinetit qeveritar.

Duke marrë parasysh interpelancën, e cila është ftuar sot për ministrin Enver Hoxhaj, mund të themi se mund të debatojmë, po jo të ftohet në interpelancë, për arsye se çështja e lobimit është çështje e cila është përgjegjësi e të gjithëve, ndoshta edhe e Qeverisë edhe e Kuvendit edhe e artistëve. Duke marrë parasysh se Kosova është shtet i pavarur dhe në shtetin e pavarur, të gjitha njohjet, që kanë ardhur pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kanë ardhur si rezultat i inercionit të pavarësisë dhe njohjeve nga vendet mike dhe ndikimit të tyre në vendet tjera.

Në rast se e pamë prezantimin e ministrit, çfarë strategjie përdorë Qeveria për çështjen e lobimit në koordinim me presidenten, kryeministrin, zëvendëskryeministrin e parë, kryetarin e Kuvendit dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, mund të themi se duhet të gjithë të jemi së bashku, se Kosova ka mjaftë armiq të tjerë dhe nevoja e përbashkët e të gjithëve është, që Kosova të ketë numër të njohjeve më të mëdha se sa deri më tani.

Nuk mund të themi se është përgjegjësi vetëm e një personi, apo një ministri, apo një zyrtari tjetër të Qeverisë për keqkuptimet, që mund t'i shprehin njerëzit që kanë qenë në pozicionet e mëparshme, duke marrë parasysh se të gjithë i kemi borxh Kosovës edhe me dashje edhe pa dashje, në rast se duam të akuzojmë dikë, pikë së pari duhet të aludojmë se Kosova është më e madhe se kryeministri Thaçi, më e madhe se ministri Enver Hoxhaj dhe më e madhe se zëvendëskryeministri i parë, Behgjet Pacolli. Dhe, kërkoj mirëkuptim nga të gjithë, se të gjithë i kemi borxh shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Kryeministër, ministra, deputetë,

Unë për politikën e jashtme do të flas nga aspekti i ekonomisë. Kalimi nga ekonomia e planifikuar në atë të tregut, në të gjitha vendet në tranzicion është shoqëruar me ndryshime dramatike. Sikur të gjitha vendet edhe Kosova ka nevojë shumë të madhe për kapitalin e huaj, sepse nevojat për investime janë shumë herë më të mëdha, se sa kapacitetet ekzistuese.

Evidencat anë e kënd botës tregojnë, se investimet e huaja direkte janë shumë të nevojshme në këtë fazë të zhvillimit të shtetit. Jo të gjitha vendet janë në gjendje t'i tërheqin investimet e huaja direkte dhe jo shumë investitorë janë në gjendje t'i rrezikojnë resurset e tyre, pa studiuar mirë kushtet dhe situatën faktike në vendin ku investohen.

Fatkeqësisht, Kosova me këtë imazh të dëmtuar ka treguar se nuk është aspak atraktive për investime të huaja direkte. Dhe, këtë e tregojnë të gjitha të dhënat. Në vitin 2007, shuma totale e investimeve të huaja direkte, ka qenë 440 milionë, mandej kemi pasur rënie drastike, në vitin 2008, 2009 dhe në vitin 2011 shuma e investimeve të huaja kap shumën prej 440 milionëve, çka do të thotë është ende më e ulët se në vitin 2007 dhe në raportin e gjashtëmujorit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës, ka indikacione se investimet e huaja kanë pësuar ende rënie. Dikush mund të argumentojë se kjo është për shkak të krizës financiare, që u paraqit në vitin 2008, por Qeveria gjatë gjithë kohës është lavdëruar se Kosova ka qenë e paprekshme nga kjo krizë dhe nëse ky fakt qëndron, atëherë Kosova do të duhej të ishte më atraktive për investime të huaja direkte, në krahasim me vendet e rajonit. Por, në fakt është e kundërta, sepse të gjitha vendet e rajonit kanë më shumë investime, kanë absorbuar më shumë investime të huaja direkte, se sa vendi ynë.

Në këtë kontekst, tërheqja e investimeve të huaja direkte mbetet sfida kryesore e kësaj Qeverie dhe qeverive të ardhshme për vitet në vijim. Evidencat tregojnë se rritja e investimeve të huaja zvogëlon papunësinë, nxit rritjen ekonomike dhe mundëson transferin e teknologjisë. Duke marrë parasysh të gjitha këto, rëndësinë vitale të investimeve, përpjekjet e Qeverisë për të tërhequr investime të huaja, kanë qenë të vogla dhe nuk kanë dhënë asnjë rezultat. Përkundrazi, imazhi i dëmtuar i shtetit të Kosovës, për shkak të mungesës së rendit dhe ligjit, korrupsionit, krimit të organizuar, mosmarrëveshjeve në mes të dikastereve të Qeverisë, që merren me punë të jashtme e që nuk janë pak, i kanë dërguar sinjale botës, se Kosova nuk është vend ku duhet të investohet.

U përmend këtu se anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe institucione financiare është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe këtu ka ngecje. Kosova edhe sot e kësaj dite nuk është anëtare e Bankës Ekonomike për Rindërtim dhe Zhvillim. Sikur të ishte, Qeveria do të ishte në gjendje që të marrë kredi të buta nga kjo bankë për projekte zhvillimore dhe financimin e autostradave dhe jo të shesë asete publike, të cilat janë profitabile për të blerë asfalt.

Anëtarësimi në Bankën Ekonomike për Rindërtim dhe Zhvillim momentalisht nuk po bëhet, sepse po mungon një votë. Andaj, unë inkurajoj ministrin që në ditët kur punon 15 orë t'i ndajë disa minuta për të lobuar për anëtarësimin e Kosovës në Bankën Ekonomike për Rindërtim dhe Zhvillim dhe çështje të tjera që kanë ndikim pozitiv në ekonomi.

Ne i bëjmë thirrje Qeverisë që të luftojë krimin dhe korrupsionin, t'i koordinojë aktivitetet e veta dhe të mos bëjë gara se kush ka sjellë njohje dhe kush ka paguar për ato njohje. Kosovës nuk i duhen njohjet e blera. Bota duhet të bindet se Kosova është shtet, shtet ku luftohet krimi dhe korrupsioni, ku institucionet janë në shërbim të qytetarëve dhe të bizneseve, se Kosova është vend ku mund të investohet dhe Kosova ka Qeveri e institucione, që u dalin në mbrojtje bizneseve, qoftë atyre vendore ose ndërkombëtare.

Ne i bëjmë thirrje Qeverisë dhe të gjitha institucioneve, që të punojnë për përmirësimin e imazhit të dëmtuar të shtetit të ri, se kjo është përgjegjësi e madhe, që e kemi të gjithë ne përpara qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Vehapi e ka fjalën.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryeministër, ministra, i nderuar ministër Hoxhaj,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në fillim t'ua përkujtoj diçka që të gjithë e dimë, se për vlerësimin e rezultateve të ndonjë pune, qoftë edhe të thjeshtë, jo shkencore, metoda e krahasimit është shumë e rëndësishme, për të ardhur deri te përfundimet. Këtë e them, për faktin se gjendja ka ndryshuar shumë për të mirë në mandatin e ministrit Hoxhaj, krahasuar me mandatin e kaluar, për

shumë shembuj. Ministri Hoxhaj me marrjen e postit si ministër i Punëve të Jashtme, paraqiti për herë të parë një qasje moderne dhe të re në politikën e jashtme, një qasje e strukturuar dhe e menduar mirë. Këtë e bëri në çdo sferë të politikës së jashtme, duke përfshirë edhe lobimin për njohjen e plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.

Për herë të parë qasja ndaj shteteve që nuk e kanë njohur ende Republikën e Kosovës, është e koordinuar mirë, e fokusuar dhe e prioritetizuar. Ministria e Punëve të Jashtme ka hartuar një strategji të thuktë për njohjen e plotë ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, me analiza të veçanta se si duhet t'i qasemi secilit shtet veç e veç. Është hera e parë, që shteteve të ndryshme, që nuk e kanë njohur ende Kosovën, nuk i është qasur me një shabllon, ashtu siç ka ndodhur viteve paraprake, por me një përkushtim janë gjetur pikat që bashkojnë Kosovën dhe shtetin përkatës.

Ministri Hoxhaj ka mbledhur rreth tij të gjithë aktorët vendës e ndërkombëtarë, qeveritarë e joqeveritarë, dhe personalitete të shumta me ndikim, që të punojnë së bashku, që të avancojnë pozitën ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Në këtë formë, Kosova është prezantuar në vendet që ende nuk e kanë njohur, jo vetëm përmes politikanëve dhe zyrtarëve qeveritarë, por edhe përmes shoqërisë civile, gazetarëve dhe personaliteteve të tjera.

Kjo është një frymë e re në diplomacinë kosovare, që nuk është parë më herët dhe që ka pasur një efekt të madh pozitiv. Pra, ministri Hoxhaj e ka fuqizuar lobimin dhe këtë në bashkëpunim me qendrat e mëdha, siç janë: Uashingtoni, Londra, Berlini dhe Parisi. Kështu, në koordinim të plotë dhe me përkrahjen e këtyre qendrave, ministri ka bërë më shumë se 30 vizita në shtetet që ende nuk e kanë njohur Kosovën dhe ka takuar mbi 80 presidentë, kryeministra e ministra të punëve të jashtme nga vende anë e kënd botës, nga Fixhi e Timori Lindor deri në Dominika e Barbados.

Përmes strategjisë, koordinimit dhe punës së madhe të ministrit: Uashingtoni, Londra, Berlini, Parisi, por edhe shtetet tjera mike të Kosovës, kanë intensifikuar përpjekjet e tyre për t'i bindur shtetet e ndryshme të botës që të marrin hapin e njohjes së Kosovës si shtet.

Të nderuar deputetë, e gjithë kjo punë e madhe dhe të gjitha sukseset e arritura nga Ministria e Punëve të Jashtme, mund të shihen mjaftë qartë edhe me numra. Kosova në vitin 2009 ka marrë 11 njohje, në vitin 2010 ka marrë 8 njohje, ndërsa në vitin 2011, numri i njohjeve arrin në 13, përderisa në vitin 2012, vetëm deri tani kur po flasim, Kosovën e kanë njohur 7 shtete, ndërsa pritet që në javët në vijim Kosovës t'i vijnë edhe disa njohje, për të cilat Ministria e Punëve të Jashtme veç i ka marrë konfirmimet jozyrtare.

Këtu shihet qartë një dyfishim i numrit të njohjeve në këtë mandat qeverisës. Kjo ka ndodhur përkundër faktit, që puna në fushën e lobimit për njohjen e plotë ndërkombëtare të Kosovës, çdo vit bëhet më e vështirë, për shkak se të gjitha vendet, që nuk e kanë njohur ende Kosovën, janë shtete që nuk e kanë prioritet kryesor çështjen e njohjes së Kosovës. Përkundër kësaj, ministri ka arritur që njohjen e Kosovës ta fusë edhe në agjendën e vendeve më të largëta.

Ministria e Punëve të Jashtme këto dy vjet, përpos që ka dyfishuar numrin e njohjeve, ka arritur që të zbusë qëndrimin e shumë shteteve që nuk e kanë njohur ende Kosovën si shtet. Shumë prej këtyre shteteve, duke përfshirë këtu Sllovakinë, Bosnjën dhe të tjera, kanë ndërmarrë hapin e njohjes së pasaportave të Republikës së Kosovës. Ky, përpos që është një hap shumë i madh drejt vendosjes së marrëdhënieve të plota diplomatike me këto vende, paraqet një lehtësim të madh për biznesmenët, akademikët, studentët dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, këto dy vjet, Ministria e Punëve të Jashtme i ka dhënë një vëmendje të veçanta edhe pesëshes nga Evropa, e cila ende nuk e ka njohur Kosovën si shtet. Ministria e Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me partnerët e saj ka përpiluar analiza, të cilat japin një pasqyrë të arsyeve dhe problemeve, që këto vende kanë për të njohur Kosovën.

Këto analiza të përpiluara nga opinionbërës eminentë nga vendet përkatëse i shërbejnë Ministrisë së Punëve të Jashtme për të pasur një qasje më të fokusuar ndaj këtyre vendeve, e cila ka rezultuar edhe me përkrahjen e këtyre vendeve për proceset e integritimeve evropiane të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë, për të mos e zgjatur shumë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe ministri Hoxhaj, këto dy vjetët e fundit me punën dhe përkushtimin e madh e kanë prezantuar Kosovën në mënyrë brilante në arenën ndërkombëtare, duke e përmirësuar imazhin e Kosovës dhe duke e prezantuar Kosovën si partner të denjë dhe të barabartë të bashkësisë ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës, është duke udhëtuar pa plan e pa qëllim, apo më mirë të themi pa një të mirë për Republikën e Kosovës. Këto aktivitete e rrugëtime në qorrsoak janë turist-vizita dhe për kënaqjen e egoje të ministrit dhe të Kabinetit të tij.

Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës që nga koha e marrjes nga kjo Qeveri nuk është funksionalizuar kurrë, edhe pse kanë pasur kohë të mjaftueshme për të treguar se janë duke punuar. Kjo ministri ende nuk i ka emëruar kandidatët për ambasadorë në shumë vende që na kanë pranuar si shtet dhe ku do të duhej të ishin si lobues për shtete tjera, në rajonet ku emërohen.

Shumë ambasada mbesin pa ambasadorë për kohë të pacaktuar, kur pati dorëheqje, por edhe ato nuk di se sa janë reprezentative dhe a bëjnë më shumë dobi apo dëm, duke marrë parasysh disa përfaqësues të tillë.

Kjo, padyshim, paraqet jo stabilitet politik të institucioneve tona, për çka nuk doni të pranoni edhe pse edhe vetë po e dini se keni dështuar në shumë lëmenj në politikën e brendshme e të jashtme.

Në rend të parë, me lobimin e suksesshëm për të rritur numrin e njohjeve, aq shumë të proklamuar dhe të thëna me aq pompozitet nga partia në pushtet, se shumë shpejtë do të kalojmë numrin 100 të njohjeve. Kjo u premtua shumë moti, aq moti sa kemi harruar se kur na kanë njohur shtetet në kohën e fundit, me disa njohje të diskutuara, skajshmërisht të politizuara e shumë herë të debatueshme, me çka po humbet rejtingu brenda e në veçanti jashtë duke rrahur gjoks se cili e solli njohjen apo kush lloboi pas udhëtimeve të shumta, aq shumë të kushtueshme e shpeshherë konfuze për opinionin.

Të nderuar kolegë, Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës nuk ka bërë pothuajse asgjë për ngritjen e imazhit aq shumë të rrënuar të Kosovës jashtë. Pyesim ministrin, se a është bërë diçka dhe a mjaftojnë vetëm shëtitjet dhe daljet e kohëpaskohshme në media, me lajme spektakulare se na njohu ky shtet e pas disa ditësh, duke e mohuar veten apo kolegët e vet, se ka pasur lëshime e keqkuptime? Nuk e di se a i thonë kësaj diplomaci, e aq më tepër e jashtme?

Me qeverisje dhe angazhime të tilla të qeverisjes së tillë, Republika e Kosovës e ka shumë të largët integrimin evropian dhe pranimin në Kombet e Bashkuara. Kur këtyre fakteve i shtohet edhe niveli i lartë i korrupsionit, trafikimit dhe krimit të organizuar, atëherë kjo na tregon imazhin, që përçon kjo qeverisje.

Edhe Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës është pjesë e kësaj Qeverie, andaj nuk na zhgënjën më shumë. Sigurisht se Kosova meriton më shumë. Kosova do më shumë arritje, sigurisht, se Kosova nuk e do qeverisjen e tillë, që s'bën asgjë për të. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Deliu e ka fjalën.

BLERTA DELIU - KODRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Hoxha,
 Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
 Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,
 Unë edhe pse bëj pjesë në Komisionin për Integritet, mendoj që kemi të drejtë secili të ndajmë diçka për këtë interpelancë të ministrit Hoxhaj, për shkak se vetë aktiviteti i kësaj Ministrie nuk është i përcaktuar vetëm brenda një komisioni parlamentar. Për më tepër ky aktivitet është i lidhur me punë të shumta që po i bën Qeveria, duke u përpjekur të ndihmojë vendin apo shtetin në forma të ndryshme.

Se kam të drejtë në këtë që e thashë e vërteton më së miri fakti, që kryeministri i vendit zoti Hashim Thaçi, në 12 muajt e fundit është takuar me homologë dhe familje mbretërore: të Norvegjisë, të Austrisë, të Japonisë, Arabisë Saudite, të Suedisë, Hungarisë, Bullgarisë, Sllovenisë, Britanisë e shumë vendeve të tjera.

Kurse, presidentja e vendit, zonja Jahjaga është e vetmja kryetare, e cila është takuar tri herë me presidentin amerikan, Barak Obama, vetëm në 12 muajt e fundit. Ministri Hoxhaj është takuar me mbi 100 homologë, duke katërfishuar kështu numrin e marrëveshjeve diplomatike.

Me gjithë këtë angazhim, kjo Qeveri po tregon se është përcaktuar për shtet-formim dhe për respekt ndaj politikës së jashtme. Kjo Qeveri po dëshmon se është bartëse e marrëdhënieve të shenjta ndërmjet Kosovës dhe Amerikës, se është e përgjegjshme dhe po tregohet e përkushtuar drejt rrugës së saj euro-atlantike.

Partitë opozitare, të cilat sot po hedhin gurë e dru mbi dialogun, mbi kompromisin si vlerë, mbi diplomacinë, mbi lidhjet, mbi miqtë, mendoj se e kanë gabim dhe do të mbesin gjithmonë në margjinat e diplomacisë botërore.

Kur jemi tek intensifikimi i përpjekjeve të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në krye me ministrin Hoxhaj, unë do të përqendrohem tek përpjekja për diplomacinë publike dhe atë kulturore. Për këtë kam folur edhe në një seancë të kaluar, përmes së cilës dukshëm është arritur që të ndryshojë imazhi i Republikës së Kosovës në vende të ndryshme të botës.

Bota ka filluar ta identifikojë qytetarin e Kosovës me kulturën e tij, në pikturë, në art, në sport, në këngë, duke ndryshuar kështu rrënjësisht bindjen që mbizotëronte deri sot. E kam thënë edhe njëherë, po e përsëris prapë, se ndër mënyrat më të rëndësishme dhe efikase, përmes së cilës më së lehti mund të depërtohet tek qytetari i thjeshtë, janë aktivitetet kulturore sportive, konferencat e ndryshme, si dhe botimet e shumta që po bëhen.

Përmes ambasadave janë përkrahur këto aktivitete, përkundër faktit se qeveritë e kaluara nuk kanë pasur as idenë më të vogël, që përmes kësaj rruge shteti ynë mund të ndihmohet shumë. Këtu para vetes kam një mori të aktiviteteve, por meqë e kemi kohën e kufizuar, atëherë po përmend vetëm disa nga aktivitetet që janë zhvilluar dhe do t'i falënderoj me këtë rast të gjithë artistët, të gjithë sportistët, piktorët dhe këngëtarët, të cilët me

përkrahjen e ministrit të Jashtëm, kanë shtrirë aktivitetin e tyre në shtetin e Francës, në Bruksel, në Mbretëri të Bashkuar, në Austri, në Kroaci, në Zvicër e në shumë vende tjera.

Ju rikujtoj, të nderuar deputetë, se gjatë këtyre dy vjetëve të fundit qeveria britanike ka përkrahur me 300 mijë euro Ministrinë e Punëve të Jashtme, Qeveria norvegjeze me 200 mijë euro, Qeveria amerikane 150 000 euro, kurse ajo japoneze me 500 000 euro. Ndoshta kjo do të duket sikur ne po bartim shifra, siç u tha më herët që po themi shifra, por kjo vlen të përmendet për qytetarët, për shkak se këto ndihma janë dhënë edhe për shumë aktivitete kulturore dhe kanë qenë më se të domosdoshme dhe është mirë që qytetarët të jenë të informuar. Mbi 300 mysafirë, ministra, studiues, ekspertë, gazetarë, redaktorë, deputetë e kanë vizituar shtetin e Kosovës vetëm gjatë 2 vjetëve të fundit. Me këtë rast, unë dua ta përmend edhe Samitin Ndërkombëtar të Gruas, në të cilin kanë ardhur shumë gra të zonjat, në mesin e të cilave edhe gra shumë të rëndësishme që kanë kontribuar shumë për shtetin e Kosovës dhe ky ka qenë me të vërtetë një rast i mirë.

Dhe, fare në fund, besoj se është e udhës që ne si Kuvend i Kosovës të reflektojmë mirë mbi të gjitha këto fakte. Ka ende shumë për të bërë, më shumë lobim, më shumë miqësi, më shumë njohje, por me atë që ka trashëguar kjo ministri, unë mendoj që është bërë e pamundura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Sahatqija e ka fjalën. Tre minuta i keni.

TEUTA SAHATQIJA: Mendoj se për tre minuta nuk mund ta kryej, prandaj e dorëzoj me shkrim.

KRYESUESI: Atëherë, Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Për gjashtë minuta, a?

KRYESUESI: Gjashtë, partisë suaj.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Sot ishte një seancë e rëndësishme e diskutimit për politikën e jashtme të Kosovës dhe u panë shumë sfida dhe probleme që identifikohen në politikën e jashtme të Kosovës, duke filluar nga prezantimi i Kosovës, duke pasur parasysh diskutimet se çka mund të prezantojë dhe përfaqësojë ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës. A e përfaqëson ministri i Punëve të Jashtme kryetarin e Kuvendit, i cili thotë se Kuvendi i tij është me vota të vjedhura. A i përfaqëson ministri i Punëve të Jashtme mediat e vendit të tij, që thonë që ka deputetë që kanë vrarë njerëz të pafajshëm në Kosovë? A përfaqëson dhe çka përfaqëson ministri?

Po ashtu, ishte ana tjetër e medaljes, e cila thotë se në përfaqësimin e jashtëm të Kosovës ka probleme, ka probleme në luftën ndërmjet përfaqësuesve të ashtuquajtur, sepse tashmë po kemi problem kush është përfaqësuesi legjitim, a është zëvendëskryeministri Pacolli, apo ministri Hoxhaj. Ne e dimë se të dytë janë, por lufta me të cilën po përballen, po na del që pastaj duhet të kërkojmë falje edhe para Këshillit të Sigurimit se një vend nuk na paska njohur, por paskemi ra në lajthitje.

Dhe, i pamë disa elemente tjera që shpesh tingëllonin edhe qesharake, që ministri paska nënshkruar 30 marrëveshje, na tha një deputet; një deputet tjetër na tha që ministri ka vizituar 30 shtete që nuk e kanë njohur Kosovën, ndërsa ministri vetë tha që i ka vizituar 42; ministri na tha që punon 15 orë në ditë dhe fluturon shumë dhe për të punuar 15 orë e të fluturuar në të njëjtën kohë është problem, sepse thyhen ligjet e fizikës. Një trup në të njëjtën kohë nuk mund t'i zërë dy vende. Me siguri, ministri edhe punon, edhe fluturon, sepse ndoshta vlen ajo reklama që e shohim në televizionin tonë publik gjatë gjithë kohës “Red bull të bën me krah!”. Dhe, këto probleme po na bëhen probleme reale për Kosovën. Probleme të cilat është vështirë të menaxhohen dhe po vijmë në pikën ku ministri ka probleme edhe në aspektin e përfaqësimit të Kosovës dhe konkurrencë shumë të madhe nga ministrja e Integrimeve Evropiane. Sepse, edhe pse ministri është shumë i fuqishëm, punon 15 orë, fluturon shumë, ka probleme sepse Vlora është më e zonja në aspektin e përfaqësimeve dhe puthjeve, dhe e ka problem të ketë afërsi njerëzore ndoshta kaq të madhe me përfaqësuesit e tjerë të Kosovës.

Krejt çka po dua të them është që Kosova ka nevojë për përfaqësim të dinjitetshëm, ka nevojë për përfaqësim të interesave të qytetarëve të saj dhe ka nevojë që të përfaqësohet dhe të prezantohet dinjitetshëm. Mirëpo, ministri e ka problem këtë punë, sepse kur i merr listat për emërime në diplomacinë e Kosovës i shkon lista me militantë, që jam i bindur se as ai vetë nuk i ka në qejf, po i duhet ta kalojë. Dhe, kjo pastaj është një pengesë, të cilën duhet tejkaluar me aktivitetet e veta diplomatike, kushdo që është në politikën e jashtme, dhe këto probleme shkojnë edhe përsëriten, edhe rriten.

Efekti i multiplikatorit të problemit të transferuar nga Kosova në Perëndim është shumë i madh. Një problem i vogël në Kosovë, kur transferohet jashtë është shumë më i madh dhe nëse në aspektin e përfaqësimit diplomatik të Kosovës, në ambasadat e Kosovës dërgohen njerëz që nuk dinë gjuhë, nuk kanë as kulturë fillestare elementare, me siguri që ministri do ta ketë probleme kur vetë shkon në aeroport ata, kur e presin, e derisa të kthehet, kur kalon nga një shtet në një shtet tjetër, me problemet që këta ia shkaktojnë në vendin ku ai shkon.

Këto janë probleme, të cilat i ka diplomacia e Kosovës. Këto janë probleme me të cilat përballlet shteti i Kosovës dhe këto janë sfida me të cilat përballlet Kosova. Mendoj se çdo ministër do ta kishte shumë më të lehtë sikur ta kishte një Parlament legjitim, sikur kryetari i tij i Kuvendit të vendit të tij të mburrej me deputetët që i ka, e jo të turpërohet me votat e vjedhura. Sikur vendi i tij të kishte përfaqësim të dinjitetshëm dhe sikur vendi i tij të mos akuzohej nga mediet e huaja dhe të vendit të tij për afera të ndryshme, për afera që kanë të bëjnë me deputetë që vrasin, për aferat që kanë të bëjnë me ministra dhe përfaqësues të ndryshëm të shtetit që janë të përzier në tregti ilegale të ndryshme, bile edhe ndërkombëtare. Prandaj, mendoj se politika e jashtme është goxha komplekse. Është komplekse, sepse politika e jashtme, aq sa është e jashtme, është edhe politikë e brendshme. Kur të ketë një politikë të brendshme të dinjitetshme, jam i bindur se është shumë më lehtë të përfaqësohet Kosova dhe do të përfaqësohet më me dinjitet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit! I nderuar zoti kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht, të përshëndesim raportimin e ministrit Hoxhaj dhe angazhimin e Qeverisë në sjelljen e njohjeve të reja. Mirëpo, dëshirojmë të shprehim shqetësimin tonë të thellë në lidhje me gjuhën, të cilën hartuesit e këtij propozim-mocioni e kanë përdorur në gjithë propozimin për interpelancë. Ajo është mbushur me plot retorikë e pezëm dhe herë-herë reflekton edhe inate personale, që dikush mund të ketë ndaj dikujt.

Në tërë tekstin e propozim-mocionit ka përpjeke të njëpasnjëshme të manipulohet me të pavërteta, që krijojnë përshtypje të përpjekjes për ta degraduar punën dhe misionin e politikës së jashtme. Qëllimi i kundërshtimit tonë nuk është që t'i kundërvihemi me çdo kusht opozitës, por që të pengojmë depërtimin e frymës mohuese në analizën dhe vlerësimin e politikës së jashtme të shtetit tonë. Sot diplomacia e Kosovës varet nga angazhimi direkt dhe permanent në vendet me rrezeq permanente, në rrugët plot sfida e kërcënim mijëra kilometra larg. Ky është realiteti sot, e kolegët nga LDK-ja mund edhe të mos e dinë, sepse kur ikën gjendjen e lanë ndryshe. Sot jemi dëshmitarë se diplomacia e Kosovës e ka të imponuar që të punojë me secilin shtet veç e veç për ta pasur suksesin në përfitimin e njohjeve të reja. Po të mos ndodhë ky angazhim i madh i stërmundimshëm, atëherë rezultatet me të vërtetë do të ishin zero. Pasi jemi të vetëdijshëm për angazhimin e madh të serbëve dhe të rusëve, veçanërisht në vendet e Afrikës, me të cilat sidomos Serbia e ka pasur një traditë marrëdhëniesh të mira për të penguar njohjen e Kosovës.

Ata, siç ka deklaruar ish-ministri Jeremiq, janë të vendosur që të shpenzojnë gjithçka vetëm për t'i penguar njohjet. Diplomacia kosovare në këtë drejtim ka treguar suksese të jashtëzakonshme. Vetëm kujtojeni rastin e shtetit të Ganës. Ky shtet, që kishte raporte të fuqishme dhe historike me Serbinë, si rezultat i angazhimit të fuqishëm të diplomacisë kosovare e ndryshoi kahun dhe u rendit kah shtetet diplomatike që e njohin sovranitetin e Republikës së Kosovës. Madje ky shtet i ndërpreu të gjitha marrëdhëniet me shtetin e Serbisë. Jo më larg se para një muaji, ne e kishim në vizitë zyrtare në Kosovë ministrin e Punëve të Jashtme të Ganës. Ne duhet ta inkurajojmë Qeverinë e vendit që të angazhohet edhe më fuqishëm që Kosova të ketë sa më shumë njohje ndërkombëtare, në mënyrë që të integrohemi sa më shpejt në instancat demokratike ndërkombëtare.

Gjithashtu, sukses tjetër në rrafshin e njohjeve është edhe sensibilizimi i shteteve të kontinentit të Afrikës, të cilat deri në këtë mandat qeverisës s'kishin fare, apo kishin fare pak informacion për ekzistencën e Kosovës. Si rezultat i angazhimit të faktorëve relevantë të politikës sonë të jashtme, sot kemi arritur në atë nivel që gati gjysma e shteteve të Afrikës e kanë njohur Kosovën.

Kjo Qeveri ka bërë që zëri i Kosovës të dëgjohet në secilën pjesë të botës. Le të tregojë dikush nga këta që sot kritikojnë nëse kanë dhënë kontribut qoftë edhe vetëm për një njohje për Republikën e Kosovës. Madje, këtu s'ka çka të thotë as ish-ministri Hyseni, i ngarkuar ekskluzivisht për atë punë. Zëvendëskryeministri Pacolli, në një intervistë më

herët ka deklaruar se, “nëse dikujt ia merr mendja që mund të bëjë diçka për njohjet, atëherë unë ia ofroj në dispozicion avionin dhe gjithë shpenzimet përcjellëse, vetëm që të ketë sukses në këtë drejtim, vetëm le të lajmërohen, por pastaj duhet të mbajnë përgjegjësi në rast dështimi”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Buzhala e ka fjalën.

BERAT BUZHALA: I nderuari kryesues,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

U përmend politika e jashtme konsensuale, konkretisht u përmend nga deputeti Sabri Hamiti, i cili kërkoi që ta kemi një politikë të jashtme konsensuale. Edhe unë mendoj që do të ishte mirë, mirëpo unë e kam vetëm një pyetje: me kë? Logjikisht politikë e jashtme konsensuale do të duhej të zhvillohej me Komisionin për Politikë të Jashtme. E pyetja ime është edhe për zotin Hamiti, edhe për të gjithë anëtarët tjerë të këtij komisioni: A është e vërtetë që kryetari i Komisionit për Politikë të Jashtme, zoti Albin Kurti, nuk ka vizë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës? A është e vërtetë që ky komision, përveç vizitës në Shqipëri, nuk ka realizuar asnjë vizitë tjetër diku tjetër nëpër botë? Por, veç kur po shkruajnë gazetatat, mandej përgjigju!

A është e vërtetë që keni zhvilluar vizita tjetërkund, përveç Shqipërisë, e në Shqipëri te zoti Berisha pothuajse të gjithë banorët e Republikës së Kosovës kanë shkuar? Pra, ku është integriteti i Komisionit për Politikë të Jashtme? Pyetja tjetër: Liderët e opozitës nuk e kanë të ndaluar me ligj t’i vizitojnë shtetet tjera. Aq sa e di unë, lideri i opozitës Isa Mustafa tash së fundmi e ka realizuar një vizitë në Britani të Madhe, ku është takuar me një zyrtar, jo i nivelit të lartë dhe kjo është në mbamendjen time vizita e vetme që është realizuar jashtë shtetit. Dhe atje e dha premtimin, i cili më vonë u mohua për pjesëmarrje në dialog. Ndërsa, lideri i opozitës, lideri tjetër i opozitës, shoku Albin Kurti, e ka realizuar një vizitë tjetër në Gjermani, me zotin Llamshderf. Pra, ky ka qenë niveli i takimeve prej liderëve të opozitës. Çfarë politike konsensuale mund të zhvillohet këtu kur liderët e opozitës kanë probleme në katër vjetët e fundit me njeriun kryesor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në vendin tonë, Kristofer Dell, të cilin e kanë akuzuar, e kanë implikuar në lloj-lloj aferash. Kush është partneri ynë? A është Venezuela, a është Irani, a është Koreja e Veriut? Pra, zoti Enver Hoxhaj do ta bënte gabimin më të madh nëse do të provonte që me persona, të cilët sigurisht ia kanë uruar fitoren Çavezit në zgjedhjet e fundit, do të provonte ta bëjë një politikë të jashtme. Është e pakontestueshme që duhet bërë krahasime, pra krahasuar me kë zoti Enver Hoxhaj bën politikë të keqe, apo politikë të mirë? Krahasuar me kë, zoti Enver Hoxhaj ka dështuar? Unë e marr shembull ish-ministrin e Jashtëm, zotin Skënder Hyseni, i cili për 3 vjet e ka shpenzuar 40% buxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Në kohën kur vendimi i GJND-së ka qenë në favor të pavarësisë së Kosovës, ne e kemi shpenzuar buxhetin të shumtën për vende të shtrenjta në Uashington dhe për qëndrime pesëjavore të pajustificuara në takime me askënd.

Pra, rreziku më i madh i kësaj Qeverie është nëse provon të bëjë konsensus me këta liderë dhe me këtë politikë të jashtme që këtu na paraqitet si shpëtimtare. Politikën e jashtme bëjeni me ambasadorët e vendeve të QUINT-it, që janë avokatët kryesorë të pavarësisë së

Kosovës, e mandej dilni edhe në rajon. Shqipërinë nuk ua llogariti, se Sali Berisha i pret edhe turistët e Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, një minutë e keni.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po filloj prej këtij të fundit, se ky do ta bëjë veten interesant. Të mos bëhet avokat i zotit Dell, se askush nuk e ka akuzuar atë për biznes, e këtë po. Jo akuzuar, por është treguar se ky merret me biznese dhe me punë që s'i takojnë një njeriu deputet përfaqësues, por tjetër kush do të merret edhe me të.

Unë ju kisha lutur, zoti kryesues, e di që është Parlament dhe nuk është hera e parë. Mos e lejoni këtë provokator të bëjë provokime të tilla në seancë, sepse nuk është e vërtetë që liderit të opozitës zoti Mustafa ky po ia numëruaka, nuk e di nëse edhe ky në SHIK, vizitat që shkon jashtë. Është e turpshme zoti kryesues që ky të tregojë dhe po e ditka se sa vizita i ka bërë zoti Mustafa dhe, sipas tij...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Unë dua të ju them, nuk kam lejuar replikë as më parë, por në qoftë se doni, atëherë po ju lejoj. Ka kërkuar replikë edhe dikush tjetër. Atëherë, zoti Beqiri, edhe një minutë e ke si replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryesues, i gjithë qëllimi i interpelancës është...

KRYESUESI: Më fal, i ke dy minuta, se një minutë e ke të pashpenzuar të Arbenit.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Qëllimi i gjithë interpelancës është shumë qëllimimë dhe nuk duhet krijuar hapësirë njerëzve që këtë e shfrytëzojnë për marketing personal dhe individual, siç e bëri ky deputeti i famshëm i fundit.

Kryetarin, përkatësisht liderin e opozitës, unë nuk kam nevojë ta mbroj, e mbron puna e vet. Ai vetëm në Strasburg e në vizita të ndryshme në SHBA, nuk e kam ndërmend t'ia numëroj, veç dua të tregoj se ky po flet të pavërteta, po thotë rrena, gënjeshtër, e nuk është mirë të manipulohet me opinionin. Në fjalën e fundit që do ta kemi për interpelancën, i kam disa komente që do t'i them. Por, zoti kryesues, edhe një herë po e them - interpelanca nuk e ka pasur këtë temë, e nëse ky mendon se sa shpenzohet buxheti aq është efikas, nëse ky e llogarit që 40% është shpenzuar buxheti, e nga zoti Hyseni, a është dashur ta shpenzojë 130% për ndoshta joefikasitet? Kjo është çështje e tij. Por, edhe një herë po ju lus si kryesues, mos i lejoni të dalin nga tema edhe të fyejnë në këtë Parlament.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Buzhala.

BERAT BUZHALA: Zoti Beqiri, vetëm një fjali: Isa është kah i shtron më të mira rrasat se ti në sheshin "Nëna Terezë"!

KRYESUESI: Replikë, zonja Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Ju lutem, më lejoni të replikoj për një fjalë që u tha pak minuta më parë. Nuk e kam mendjen të diskutoj për politikën e jashtme, sepse ata që e bartin, si gjithë ne deputetët, e kryejnë detyrën, ose jo.

Fjalën e kam për kolegun tim, i cili pak më parë e ofendoi ministren Çitaku dhe kjo është e padrejtë. Kërkoj që ta tërheqë fjalën e vet, sepse me këtë na ofendoj të gjithëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Po më vjen keq nëse ka ndodhur ndonjë keqkuptim këtu. Por, unë nuk po e mbaj në mend që e ofendova dikë. Unë e theksova një fakt, bile edhe e lavdërova ministrin që është i mbifuqishëm, që arrin edhe të fluturojë, edhe të punojë në të njëjtën kohë. Dhe, e komplimentova edhe ministren që arrin të ketë edhe përqafime me zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian, që i kemi parë në televizor. Unë nuk thashë diçka çka nuk është parë në televizor, mirëpo thashë që ndoshta të nënkuptojë pak më shumë që do të kishte qenë më mirë të mbajë njëfarë distance protokollare.

Sa i përket ofendimit për gjininë, nuk besoj që dikush mund të pretendojë ta mbrojë gjininë kolektivisht. Këtu jemi të gjithë njerëz, që e kemi të drejtën e fjalës, të drejtën e mendimit dhe të drejtën e shprehjes, pa e ofenduar askënd dhe pa iu drejtuar askujt.

Ju nuk mund ta mbronj gjininë më shumë se ne të tjerët që e mbrojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Musliu. Zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Kërkoj nga deputeti Arben Gashi që ta tërheqë fjalën dhe të kërkojë falje publike për shprehjet e tij përdorur në emër ose edhe në adresë të Vlora Çitakut, ministres më të suksesshme, e cila po bën një punë shumë të madhe në integrimin e vendit, gjithashtu edhe në politikën e jashtme. E nëse jo, kërkoj nga të gjitha gratë që janë pjesë e Grupit të Deputeteve të Grave që ta lëshojnë seancën në mënyrë proteste. Faleminderit!

KRYESUESI: Ke të drejtë në replikë, zoti Gashi.

ARBEN GASHI: A mund ta di çka thashë që i paskam ofenduar gratë deputete, se nuk po e di?

KRYESUESI: Ju keni ndërmjet veti, nuk e di. Atëherë, fjalën e ka zoti Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit! I nderuari nënkryetar! Fillimisht do të doja të konstatoja që politikën e jashtme duhet cilësuar në kontestin real të shtet-krijimit të Kosovës dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, ju lutem, fjalën zotit Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar!

I nderuari kryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Meqenëse jemi në fund të debatit, do të doja të konstatoja që debatin për politikën e jashtme duhet vendosur në një kontekst real dhe politika e jashtme e reflekton përvojën që e kemi ne si shtet tani katër vjet dhe duhet shikuar krejtësisht realisht gjendjen në politikën e jashtme.

Padrejtësisht kështu debati për politikën e jashtme u kufizua në Ministrinë e Punëve të Jashtme, sepse politika e jashtme është një fushë e veprimit, ku pas Kushtetutës kanë kompetenca të gjitha institucionet kushtetuese të Kosovës, filluar nga: Presidentja e Republikës, Qeveria, Parlamenti. Ministria e Jashtme është vetëm një hallkë. Përgjithësisht, mund të konstatojmë se politika e jashtme është një storie e suksesit të shtetit të Kosovës, sepse ne kemi arritur si shtet i ri ta orientojmë dhe ta përcaktojmë drejt politikën e jashtme, qëllimet e shtetit të Kosovës në politikën e jashtme dhe duhet të jemi krenarë që një përcaktim i tillë po gëzon edhe njohje dhe mbështetje ndërkombëtare, sepse përcaktimi i vendit tonë për vlera strategjike të politikës së jashtme është një përcaktim më afatgjatë, permanent, i cili do të mundësojë që shteti ynë të ketë mbështetje çfarë kemi pas edhe me rastin e shpalljes së pavarësisë, por edhe mbështetjen që e kemi tani.

Ajo që duhet theksuar në mënyrë të veçantë është që politika e jashtme në këta katër vjet e gjysmë ka arritur ta konsolidojë shtetin e Kosovës, ka arritur ta sigurojë numrin e kënaqshëm të njohjeve. U tha shumë mirë në debat, nuk duhet të udhëhiqemi vetëm nga statistikatat dhe numrat matematikorë. Njohjet që kemi deri më tash janë njohje solide, sepse njohja jonë nuk ka shkuar përmes Kombeve të Bashkuara, nëpërmjet veprimeve të përbashkëta, por është një njohje specifike, që u bë në kushte specifike të krijimit të shtetit të Kosovës me një partneritet ndërkombëtar.

Absolutisht, numri nuk është brengë e Kosovës, edhe pse njohjet e kanë një efekt psikologjik. Me rëndësi është që ne i kemi ruajtur me politikën e jashtme partnerët tanë strategjikë, e kemi krijuar një partneritet të qëndrueshëm dhe raporte speciale me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe raporte jashtëzakonisht miqësore me Bashkimin Evropian, prandaj unë mendoj se këto janë vlera fundamentale të çdo qeverie, këto e tejkalojnë cilindo qeveri dhe këto janë orientime strategjike të vendit tonë. Do të flas vetëm për një segment të politikës së jashtme, i cili nuk u përmend në këtë seancë. Është segmenti i diplomacisë parlamentare. U fol për diplomacinë ekomomike, u fol për diplomacinë kulturore, por mendoj që edhe ne si Parlament mund të ndikojmë në politikën e jashtme. Segmenti i diplomacisë parlamentare është një shtyllë e fuqishme në të gjitha shtetet, dhe unë mendoj se ne duhet t'i aktivizojmë kapacitetet tona dhe nëpërmjet diplomacisë parlamentare të mundësojmë afirmimin e politikës së jashtme dhe në numrin e njohjeve.

E dini, të nderuar kolegë, që pothuajse jemi i vetmi Parlament që nuk i kemi formalizuar grupet e miqësisë me shumë shtete, e në vizitat e jashtme kur po dalim gjithmonë po premtojmë se do të fillojmë me grupet joformale të miqësisë. Është një mekanizëm jashtëzakonisht i fuqishëm që mund të ndikojë në afirmimin ndërkombëtar të shtetit tonë.

Do të jap dy-tri rekomandime për politikën e jashtme, jo për ministrin, sepse ministri është një aktor i politikës së jashtme. E dini se në bazë të Kushtetutës, Presidentja e Republikës e udhëheq politikën e jashtme.

E para është të vazhdojë me ndërtimin dhe forcimin e partneritetit me Bashkimin Evropian dhe të krijojë një strategji të veçantë për njohjen nga këto pesë shtete. Tani na duhet një strategji e veçantë dhe një mobilizim që të punohet për njohjen nga pesë shtetet e Bashkimit Evropian, sepse mosnjohja po e pengon aderimin në mekanizmat evropianë dhe mendoj se në këtë drejtim duhet të punohet.

E dyta, ministri e ka për detyrë ta konsolidojë plotësisht ministrinë, edhe pse janë arritur hapa shumë të rëndësishëm. Meqenëse është ministri me vetëm katër vjet e gjysmë përvojë, na duhet t'i forcojmë kapacitetet e Ministrisë së Jashtme, na duhet ta forcojmë edhe në aspekte kuadrore, në mënyrë që të vendoset një sistem i qëndrueshëm i politikës së jashtme, e unë mendoj se në këtë drejtim do të kemi rezultate efektive.

Dëshiroj ta përgëzoj ministrinë për modernizimin e komunikimit që ka bërë me ambasadat. Unë vetë kam qenë dëshmitar. Është një e arritur e madhe e shkëmbimit elektronik e të dhënave me të gjitha ambasadat dhe mendoj se informimi reciprok i ambasadave tona është një moment kyç i zhvillimit të aktivitetit të ambasadave, jo vetëm aktivitetit, pritjeve dhe përcjelljeve, por edhe aktivitetit diplomatik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar deputetë,

Sa i përket çështjes së punës së Ministrisë së Jashtme u fol shumë, ndoshta nuk mund të shtoj diçka. Unë fillimisht do ta kisha shfrytëzuar rastin që zotit Beqiri t'i them që vendi ynë ka vazhduar dhe vazhdon ende të rrezikohet nga shërbimet serbe dhe bashkëpunëtorët e tyre që mund të jenë edhe në këtë Parlament, në radhë të parë. Pastaj, po flasim për çështjet e tjera.

Të gjithë ne që i përfaqësojmë institucionet dhe gjithë shoqëria jonë do të dëshironim që të bëjmë më shumë që Republika e Kosovës të ishte atje ku ne synojmë, por mundësitë dhe dëshirat nuk janë e njëjta gjë. Për këtë duhet të pajtohemi të gjithë. Janë shumë faktorë që determinojnë politika përtej kufijve të shteteve të caktuara, por kjo nuk do të thotë që ne të ndalemi dhe të mos angazhohemi maksimalisht. Pas raportit të Dik Martit, vendi ynë u ballafaqua me një përkeqësim të imazhit, si rezultat...

KRYESUESI: Rregulloje mikrofonin!

FADIL DEMAKU: Sot, si rezultat i diplomacisë kosovare, vendi ynë nuk është i izoluar. Presidentja, kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme kanë realizuar shumë vizita, kemi marrë përgjigje të qartë për hapa konkretë për rrugën tonë në anëtarësimin drejt strukturave euroatlantike. Edhe pse, fatkeqësisht, edhe këtu tek ne kishte shumë që luteshin të ndodhte e kundërta.

Gjatë kësaj kohe, Kosova ka organizuar konferenca të nivelit ndërkombëtar për një imazh të një Kosove moderne dhe prosperuese. Ministria e Punëve të Jashtme e ka dinamizuar politikën e jashtme në çdo aspekt, vazhdimisht me kalimin e kohës i ka intensifikuar raportet me shtetet mike të Kosovës, e ka kthyer interesimin e vendeve të fuqishme të botës përsëri në çështjet që janë me rëndësi për Kosovën dhe qytetarët e saj, si dhe ka zhvilluar relacion edhe me vendet që ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës.

Bashkëpunimi, të cilin e gëzon Kosova sot me vendet më të fuqishme të botës është një bashkëpunim i të barabartëve dhe bashkëpunim përmbajtjesor me projekte konkrete. Ky transformim thelbësor i bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe vendeve mike të Kosovës vjen si rezultat i kontakteve të shtuara në nivel ministrash të Punëve të Jashtme, sidomos të vendeve më të fuqishme dhe me ndikim. Në anën tjetër, përpos një intensifikimi të shtuar të raportet me vendet mike të Kosovës, ministri Hoxhaj e ka bërë një depërtim në raportet me vendet, të cilat deri më tani nuk kishin ndonjë interesim të shtuar për Republikën e Kosovës, meqë nëpërmjet vizitave dhe takimeve të shtuara me ministrat e Punëve të Jashtme të atyre shteteve ka arritur të sigurojë përkrahje nga shtetet që e kanë njohur dhe që nuk e kanë njohur Kosovën në procese të ndryshme nëpër të cilat po kalon vendi ynë. Ministria e Jashtme ka sjellë një qasje të re të bashkëpunimit rajonal. Kjo ka ndikuar që të gjitha këto shtete të bëhen një zë i fuqishëm për Kosovën në të gjitha takimet e tyre bilaterale, por edhe në të gjitha takimet multilaterale dhe në forumet e ndryshme, ku ata marrin pjesë.

Si rezultat i tërë këtij intensifikimi të raporteve, Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Punëve të Jashtme, vetëm në këto dy vjetët e fundit e ka nënshkruar një numër të madh të marrëveshjeve bilaterale, multilaterale dhe memorandume bashkëpunimi. Kosova në këto dy vjetët e fundit e ka dyfishuar numrin e vendeve me të cilat ka vendosur marrëdhënie diplomatike. Përpos marrëveshjeve tashmë të nënshkruara për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, Ministria e Punëve të Jashtme është në procesin e përmbylljes së marrëveshjeve edhe me shumë shtete të tjera. Ministria e Punëve të Jashtme e ka vendosur Kosovën në hartë, jo vetëm nëpërmjet marrëdhënieve të shtuara bilaterale me shtetet, por edhe nëpërmjet qëndrimeve të qarta që Kosova ka marrë karshi temave të mëdha që janë të pranishme në arenën ndërkombëtare. Në këto dy vjetët e fundit, Kosova për herë të parë ka marrë qëndrim për çështje me karakter botëror, që e kanë bërë anëtare të përgjegjshme të bashkësisë ndërkombëtare. Këto që unë i përmenda sot janë vetëm një segment i vogël i punës së madhe që po bëhet nga Qeveria e Kosovës në politikën e jashtme. Pozita në të cilën Kosova gjendet sot ndërkombëtarisht vazhdimisht duhet të forcohet dhe ne kemi besim te ministri Hoxhaj dhe stafi i tij se do ta bëjnë më të mirën në këtë drejtim. Se po të ishin disa nga ata që e

kontestojnë punën e ministrit Hoxhaj sot në qeverisje, sinqerisht dyshoj se ne do t'i kishim humbur edhe shumë njohje që i kemi deri më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, për replikë apo jo? Mirë! Zoti Hamiti për replikë.

SABRI HAMITI: Ç'është e vërteta, zoti kryesues, meqë në mënyrë të drejtpërdrejtë më është përmendur edhe emri, por edhe është interpretuar pak diskutimi im, ma jep shansin as të mos e përmendi askënd, veçse të përforcoj edhe një herë. Politikë e jashtme e Kosovës e kërkon konsensusin dhe ky është detyrim kushtetues në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, sepse kjo veprimtari lidhet si detyrim me kryetarin e shtetit, ose tash kryetaren e shtetit, me kryeministrin, me ministrin e Jashtëm dhe me Parlamentin. Pra, edhe po të mos ishte kështu, situata që është në Kosovë, unë kërkoj dhe mendoj që është mirë të ketë konsensus me politikën e jashtme. Por, unë po nënvizoj prapë që është dhe detyrim kushtetues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Nuk besova që do ta marr fjalën fare dhe isha kah...

KRYESUESI: Dy minuta i ke...

HYDAJET HYSENI: E për dy minuta vetëm duhet t'i falënderoj ata që ma mundësuan që fjalën time, të cilën ç'është e vërteta nuk e kisha të shkruar, por e kam të konceptuar si zakonisht, të mos e mbaj fare. Vetëm të them se jam shumë i entuziazmuar me fjalimet e shkruara, me tonin që e dëgjova edhe andej, edhe kënde, kur flitet për një çështje siç është në mocion gjendja në politikën e jashtme, kurse në tekstin e propozuar pastaj si mocion pa e emërtuar çka, janë tri-katër çështje teknike etj.

Më duhen së paku pesë-gjashtë minuta për ta thënë mendimin tim për këtë, por meqë nuk m'u mundësua dhe e falënderoj shumë shefin e grupit parlamentar për këtë nderim që më bën, edhe pse jam nënkryetar i Komisionit të Jashtëm, megjithatë do ta shfrytëzoj rastin në ndonjë formë tjetër, në ndonjë rast tjetër. Suksese!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e ministrit Hoxhaj, nëse kanë përfunduar diskutimet. Zoti Hoxhaj e ka fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti kryesues,

I nderuar zoti kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Shumë të respektuar deputetë,

Më lejoni të them për fund që me shumë vëmendje e përcolla këtë interpelancë dhe me shumë vëmendje i dëgjova edhe shumë sugjerime, edhe shumë rekomandime, se si ta kemi një politikë të jashtme edhe më aktive, edhe më dinamike. Mendoj që ka pasur edhe

formulime, edhe sugjerime, të cilat nuk kanë të bëjnë me realitetin. Nuk e kam ndërmend që të merrem shumë me çështje të natyrës teknike.

Por, dua të ju them që çdo sugjerim-propozim që ka qenë vërtet i një natyre që neve na hyn në punë si Ministri e Punëve të Jashtme do të bëjë përpjekje maksimale që ta jetësoj si të tillë. Kuptohet që, në një fjalë të fundit, nuk është e mundur të merret qëndrim për të gjitha problemet, sugjerimet dhe propozimet që u dhanë këtu, por më lejoni të them që ne si Ministri e Punëve të Jashtme e kemi një qasje afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjate, si një orientim yni strategjik se si vërtet në baza ditore, javore, mujore dhe vjetore ta mbështetim dhe promovojmë interesin shtetëror të Republikës së Kosovës, e jo vetëm organizimi strukturor të ministrisë, mirëpo edhe organizimi përmbajtësor i kësaj ministrie dëshmojnë për atë që ne si Ministri e Punëve të Jashtme synojmë të jemi sa më efikas. Po ashtu, dua të ju them që ne kemi pasur një koordinim shumë të ngushtë me të gjithë aktorët relevantë në politikën e jashtme, qoftë me zonjën Presidente, me zotin Kryeministër, me zotin zëvendëskryeministër dhe me gjithë aktorët e tjerë relevantë në politikën e jashtme. Dhe, unë si ministër i Punëve të Jashtme, jo vetëm për situata shumë të rëndësishme që kanë ndodhur jashtë Kosovës, rreth Kosovës, por qoftë edhe për ndryshim të tonit, qoftë edhe për një ndryshim të një nuance, jo vetëm që i kam informuar aktorët përgjegjës dhe kemi pasur një qasje proaktive, mirëpo kemi ofruar edhe analiza shumë të detajuara dhe kemi ndërmarrë hapa konkretë se si ne të jemi sa më aktiv në situata të caktuara.

Dua po ashtu të ju them që nuk është e vërtetë që shumë ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës udhëtojnë jashtë vendit dhe ne si ministri nuk e koordinojmë një aktivitet. Ne i koordinojmë aktivitetet e tilla. Nuk është e vërtetë që nuk lexohen raportet që ofrohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Unë personalisht lexoj raporte dhe në bazë të këtyre raporteve ne reagojmë në relacionet tona bilaterale dhe multilaterale për situatat e caktuara. Po ashtu mund të ju them që mbrëmë, në orën 23:00 të natës, unë kam pasur komunikim me një zyrtar tonin që e kemi në Egjipt, se kryetari i Parlamentit të Egjiptit do të vijë dhe do ta vizitojë Kosovën. Do të thotë, dhe ajo çka është diplomaci parlamentare shpeshherë mbështetet dhe fasilitohet nga vetë Ministria e Punëve të Jashtme.

Kuptohet që pati shqetësime sa i përket asaj se sa në fjalimin tim, në raportimin tim, e unë kam pas për qëllim që të ju informoj në detaje, kam mund të marr qëndrim për çdo dilemë dhe për çdo zhvillim në politikën e jashtme. Një gjë e tillë ka qenë pothuajse e pamundur, mirëpo në të njëjtën kohë mund të ju them që nuk mund të flas specifikisht në emër të shteteve të tjera, meqë unë si ministër i Punëve të Jashtme e përfaqësoj Kosovën dhe nëse me një paragraf flas për pesë vende të Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur Kosovën dhe ju si deputetë e keni lirinë që të jeni më specifikë, mua nuk më lejohet që të them kjo ose ajo arsye e bën këtë shtet që ta ketë këtë apo atë qëndrim karshi Republikës së Kosovës.

Dua po ashtu të ju them që jam i gatshëm që me komisionin parlamentar, me të gjithë deputetët e komisionit parlamentar në çdo kohë, në çdo situatë, të vij dhe të ju informoj. Më me qejf i preferoj takimet pa media, jo pse kam dëshirë që mediet të mos jenë të

pranishme, por për çështje shumë sensitive të politikës së jashtme që juve u interesojnë, më ftoni, vij dhe ju raportoj, ju jap llogari të detajuar pa praninë e medieve, meqë nuk jam i interesuar ta lëndoј relacionin e Kosovës me një shtet për shkak se një mediumi të caktuar i duket më interesante ta bëjë një lajm nga një takim me Komisionin për Politikë të Jashtme. Po ashtu, jam i gatshëm të ju ofroj informata edhe me shkrim. Dua të ju them që për ne është kyç në vitin 2012 që edhe më shumë të kemi qasje bilaterale aktive dhe në atë moment kur ne e arrijmë një numër kritik të njohjeve, që do të duhej të jetë numër treshifror, ne përkundrazi të duhet mendojmë të kemi një qasje më aktive multilaterale, meqë integrimi i një shteti në sistemin ndërkombëtar është integrim mbi të gjitha multilateral, do të thotë anëtarësimi në organizata evropiane dhe botërore është jashtëzakonisht kyç.

Po ashtu, dua të ju informoj që njëri prej prioriteteve tona të rëndësishme është pozita e Kosovës në rajon, bashkëpunimi i ngushtë me të gjitha vendet fqinje të Kosovës, mirëpo në të njëjtën kohë edhe komunikimi ynë i rregullt dhe komunikimi im i rregullt me përfaqësuesit e shqiptarëve që jetojnë në vendet përreth, dhe unë jam i vetëdijshëm që politika e jashtme nuk duhet ta mbështesë, ta mbrojë dhe promovojë vetëm interesin e shtetit të Kosovës, por ka për obligim të angazhohet dhe ta përmirësojë edhe pozitën e shqiptarëve kudo që jetojnë në rajon dhe të çdo qytetari që ka relacion me Republikën e Kosovës. Dhe, mund të them që kontaktet e mia janë të rregullta. Kuptohet që unë nuk të bëj vizita bilaterale me kryetarët e partive politike në rajon, apo me përfaqësues politikë, se nuk është niveli dhe përshkrimi im i punës që bilateralisht ta vizitoj një parti politike në rajon.

Dua po ashtu të ju them se ne mendojmë shumë sa i përket relacionit tonë me Organizatën e Kombeve të Bashkuara, sa u përket situatave që mund të krijohen në favor të Kosovës. E kemi edhe një studim të veçantë për një temë dhe për një çështje të tillë, por kuptohet që këto janë vendime strategjike dhe vendimet e tilla duhet të koordinohen brendapërbrenda institucioneve tona dhe, mbi të gjitha, me shtetet relevante, por nuk është se mungon ideja, koncepti, përmbajtja se në çfarë forme t'i qasemi me institucionin më relevant të sistemit ndërkombëtar, sikur që është OKB-ja.

Me këtë nuk dua të them që do të ketë ndonjë hap të ri shpejt, por dua të them që e dimë saktësisht se çfarë do të duhej të ndodhë brenda një hapësire të caktuar kohore. U përmend disa herë politika e jashtme, si politikë e jashtme konsensuale dhe se duhet të kemi konsensus. Unë mendoj që kjo është një temë, e cila mbi të gjitha, në një të ardhme të afërt, do të na paraqitet në formë shumë konkrete. Unë mendoj që duhet të kemi konsensus të plotë se si ta forcojmë shtetësinë tonë të jashtme dhe duhet të kemi po ashtu konsensus në një proces të normalizimit të relacioneve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Ne si parti politike të gjithë ne ta mbështetim hyrjen e Kosovës në një proces dhe mendoj që ky Kuvend duhet të jetë shembull i arritjes të një konsensusi të tillë.

U përmend edhe anëtarësimi i Kosovës në Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim dhe në organizata tjera. Ajo çfarë mund të them është që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Qeveria e Kosovës janë duke e bërë punën e tyre dhe në një kohë të caktuar sa u

takon njohjeve dhe sa u takon anëtarësimeve, pa dyshim që do të kemi rezultate konkrete dhe këto rezultate janë pa dyshim meritë e qytetarëve të Kosovës. Në asnjë formë, në asnjë mënyrë nuk duhet t'i përshkruhen vetëm punës së një njeriu, apo të një institucioni.

Edhe një herë ju falënderoj shumë për të gjitha sugjerimet, propozimet dhe çdo gjë që keni thënë, e marr me seriozitetin më të madh. Jam i gatshëm në çdo situatë të jap llogari para këtij Kuvendi dhe para komisionit.

KRYESUESI: Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Sipas Rregullores, duhet t'ia jap fjalën për ta dhënë një sqarim shtesë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mendoj se sot ka qenë një seancë e veçantë për të diskutuar për diplomacinë kosovare, apo për politikën e jashtme të Kosovës, por mund të them më tepër për subjektivitetin ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Ndiej obligim që t'i them disa fjalë, pasi e udhëheq Qeverinë e Republikës së Kosovës në dy mandatet e diplomacisë kosovare.

Unë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë për kontributin e tyre, duke filluar nga ministri i mëhershëm, e deri te ministri aktual. Por, dua të theksoj se që në fillim të angazhimeve tona të përbashkëta për pavarësi dhe shtet sovran kemi qenë në një orientim të qartë të gjithë dhe unik me rrugëtimin tonë të koordinuar me partnerët dhe miqtë tanë ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, në veçanti.

Dua të theksoj se diplomaci ishte edhe vendimi për shpalljen e Kosovës së pavarur dhe koordinim i plotë. Në të njëjtën kohë jemi dëshmitarë, apo jam dëshmitar i mbështetjes së plotë, edhe pa Ministri të Jashtme, kur kanë ardhur njohjet masive për Republikën e Kosovës. Janë ato njohje prej më të fuqishmeve që i kanë ardhur Kosovës. Në anën tjetër, edhe njohjet që kanë ndodhur pastaj në fundin e vitit 2008, pastaj 2009. Suksesi ynë historik me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për të drejtën ndërkombëtare për bërjen e Kosovës të pavarur dhe sovranë është gjithashtu rezultat i këmbëngulësisë, por edhe i diplomacisë aktive dhe i drejtësisë, mbi të gjitha, dhe i respektimit të vullnetit të qytetarëve të Kosovës nga përfaqësuesit e zgjedhur të Kosovës për Kosovën sovranë bëri që ne të konsolidohemi dhe të forcohemi si shtet. Edhe njohjet tjera që kanë ardhur gjithashtu kanë qenë rezultat i punës së përbashkët. Unë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata që janë marrë me diplomaci, kompetentët për këtë çështje në të gjitha periudhat, pavarësisht nga pozicionet që kanë pasur. Por, mund të them që suksesi i arritur është madhor në krahasim me lëshimet apo ndonjë dobësi të paraqitur. Dhe, unë dua që t'i kemi më tepër se 100 njohje, por nuk po mund t'ia arrijmë.

Është e vërtetë - na kishim premtuar që do të kemi njohje të shpejta, por edhe është e vërtetë që pastaj ato njohje janë ngadalësuar. Pse janë ngadalësuar, është çështje për të cilën mund të diskutojmë gjerë e gjatë edhe në Parlament, edhe jashtë Parlamentit, edhe në takime të mbyllura, edhe në komisione të ndryshme. Ndërsa, sa u përket edhe pesë vendeve të Bashkimit Evropian, të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, mendoj që definitivisht kjo është e qartë, jo se këto vende nuk kanë problem me Kosovën

apo se janë kundër Kosovës, sepse të gjitha pa dallim e mbështetin perspektivën evropiane të Republikës së Kosovës, duke folur për Spanjën, për Greqinë, Sllovakinë, Rumaninë dhe Qipron. Dhe i falënderojmë, por është çështje e vendimeve të tyre të brendshme dhe ne nuk mund t'ua imponojmë, sikur që nuk kemi pasur mundësi t'ua imponojmë datat vendeve tjera që e kanë njohur. Por, i falënderojmë për raportet korrekte dhe të përgjegjshme të bashkëpunimit të nivelit të Kosovës me këto vende. Por, të mos harrojmë se shumica e këtyre vendeve e kanë njohur pasaportën e Republikës së Kosovës, kanë votuar për anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore, si dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ky është sukses i përbashkët, nuk është sukses individual i askujt. Jam dëshmitar i të gjitha këtyre proceseve dhe dua të theksoj se asnjë shtet për hatër të këtij apo atij individ nuk e njeh shtetin e Kosovës. Çdo shtet merr vendim duke e respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës dhe institucionet legjitime të Republikës së Kosovës. Prandaj, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ata që kanë qenë kontribuues, por në të njëjtën kohë së paku ata që pretendojnë të pengojnë, i ftoj të mos e bëjnë këtë, sepse ka pasur raste që është dëmtuar shteti i Kosovës nga pozicionimet politike ditore të skenës politike kosovare. Unë nuk dëshiroj të flas sot këtu me emra dhe subjekt, por i ftoj që të ndihmojnë dhe nëse dikush bën kilometrazh të tepërt, unë i ftoj që edhe ata ta bëjnë këtë, t'ia kushtojnë një kohë apo një udhëtim për të mirën e vendit dhe për të kërkuar njohje. Këto çështjet e brendshme, konceptet e ndryshme le të mbeten këtu, por në raport me botën, ju ftoj që ta kemi një politikë të jashtme konsensuale, e në të njëjtën kohë shtetformuese dhe afirmuese për shtetin tonë.

Gjithashtu, nuk pajtohem me askënd që çështjet apo deklaratimet e dëgjuara jashtë Kosovës të prezantohen edhe këtu. Unë po flas sa u përket kundërshtarëve të njohjeve të pavarësisë së Kosovës. Edhe në mandatin e kaluar gjithmonë kam qenë i hapur për bashkëpunim me opozitën sa i përket diplomacisë. Edhe sot, mendoj se të gjithë mund të kontribuojmë dhe secili mund ta mbështesë këtë proces të rëndësishëm. Lehtë është të mbahet një konferencë shtypi një herë në muaj, apo në dy muaj, apo një konferencë të caktuar një herë në tre muaj, por nuk do të jetë shumë lehtë, sepse tash e tutje duhet të punohet në mënyrë bilaterale në çdo shtet për njohje. Është e vërtetë që kemi shumë premtime për njohje, presim edhe në ditët dhe javët e ardhshme, por është e vërtetë se ka pasur edhe shumë premtime, të cilat po vonohen së realizuari. E këtë e dinë edhe partnerët tanë të mëhershëm të koalicionit dhe jemi duke u ballafaquar ne çdo ditë, kudo.

Shumë lehtë është të thuhet: “Kosova duhet të jetë anëtare e OKB-së”. Pajtohem plotësisht, po përpiqemi, por edhe ju i dini vështirësitë. Nuk janë vështirësi që kryeministri apo ministri i Jashtëm, apo Qeveria, apo një parti mund t'i tejkalojë në Këshillin e Sigurimit. Është një politikë apo diplomaci globale në të cilën duhet t'i adaptohemi dhe të punojmë maksimalisht. Tjetër, e gjithë diplomacia jonë është e koordinuar ngushtë me të gjithë miqtë dhe partnerët ndërkombëtarë, të cilët dëshiroj t'i falënderoj në të njëjtën kohë. Dhe, mendoj se kjo ka ndikuar edhe në fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës. Pastaj, te numri i njohjeve, merreni dhe shikojeni edhe numrin e njohjeve që kanë edhe Kroacia, edhe Bosnja, edhe Mali i Zi. Bile Mali i Zi diku pak mbi 70 njohje i ka. Pikërisht pse është anëtar i OKB-së,

por unë nuk po mund ta bind Rusinë. Nëse mundesh ta bindësh, urdhëro. Sot ta liroj vendin, vetëm binde. Nëse e ke atë fuqi, urdhëro! Ok, në rregull!

Je mësuar Alma me kamerë në krahë, kështu që... Nuk është ndonjë proces edhe aq i lehtë, siç mendon dikush, apo siç e sheh. Mendoj është shumë më i komplikuar dhe mendoj se duhet t'i ndihmojmë dhe ta kuptojmë njëri-tjetrin dhe të jemi të përgjegjshëm karshi angazhimeve që i kemi, sepse numrin e njohjeve mund ta rritim edhe më tepër dhe do ta rritim, por përsëri duhet të kalojë përmes Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Ne e kemi pasur shansin historik, meqë të gjithë kemi qenë në procesin e Vjenës në vitin 2007, por e dimë se si jemi ballafaquar me situatën e moskalimit të dokumentit të presidentit Ahtisari në Këshillin e Sigurimit, prandaj problemi qëndron nga aty për të vazhduar në raport me kundërshtarët e pavarësisë së Kosovës.

Në anën tjetër, për mua ishte shqetësuese sot kur dëgjoj opinione sa i përket studimit të fizibilitetit dhe raportit që dje e ka prezantuar Komisioni Evropian për Kosovën. Ky raport është historik për Republikën e Kosovës, është raporti më i avancuar për shtetin e Kosovës, sepse e vlerësojnë qartë se shteti i Kosovës është i konsoliduar në funksionimin demokratik të institucioneve, të rendit e ligjit dhe i ka ndërtuar të gjitha institucionet. I jep vlerësimet më të larta për Republikën e Kosovës dhe pikërisht nga këto vlerësime pasuan edhe reagimet agresive dhe shumë nervoze të Beogradit. Prandaj, unë dëshiroj të ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen, për punën e përbashkët pozitive-opozitive dhe uroj të gjithë qytetarët e Kosovës, por së paku ato që i dëgjuam dje nga qeveritarët e Beogradit të mos përkthehen në tjetër fjalor në Prishtinë, prej kujt do qoftë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi dy kërkesa shtesë, në drejtim të zotit Gashi. Zoti Gashi e ka kërkuar fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit! Unë veç desha ta bëj një sqarim lidhur me diskutimin tim të mëhershëm. Nuk ishte ideja as qëllimi i diskutimit tim që ta ofendoj askënd personalisht, as nuk është në kulturën time, e nëse në një formë në aspektin personal zonja Çitaku ndihet e ofenduar, më vjen shumë keq dhe i kërkoj falje. Mirëpo, çështja e diskutimit ishte diskutim politik dhe nuk besoj që ka pasur diçka personale. Faleminderit!

TEUTA SAHATQIJA: Në dy gjëra pajtohem me ministrin e Punëve të Jashtme, z. Enver Hoxhaj:

1.) Politika e jashtme paraqet interes shtetëror, dhe 2.) Nuk është vetëm Ministria e Punëve të Jashtme përgjegjëse për imazhin e Kosovës.

1. Pasi interesi shtetëror kërkon seriozitet, pune të përkushtuar dhe rezultate konkrete, kërkon përgjegjësi, si nga Qeveria dhe ministria përkatëse, por kërkon edhe nga Parlamenti një mbikëqyrje kompetente.

Pas arritjes së pavarësisë në vitin 2008, është pritur që Kosova ta fuqizojë sovranitetin dhe subjektivitetin e saj në arenën ndërkombëtare, të ketë më tepër njohje, kredibilitet dhe progres. Në fakt, ajo që pasoi pas arritjes së pavarësisë, në bashkëpunim me miqtë

tanë, ishte vala e parë e njohjeve pikërisht e indukuar nga aktiviteti i miqve tanë ndërkombëtarë.

Kryeministri atëbotë lavdërohej (me punën e atyre miqve) dhe premonte se do të kemi 100 njohje vetëm në muajt e parë, duke harruar se punën tonë duhet ta bëjmë ne vetë, e të mos mbështetemi vetëm në punën e të tjerëve, pasi interesi shtetëror e kërkon këtë nga një shtet sovran e i pavarur.

Njohjet: Me gjithë skandalet e shumta të njohjeve të kontestuara dhe skandalet tjera të numrit të njohjeve reale dhe fiktive që na treguan të papjekur para znj. Clinton dhe Eshton, përkundër garës se cili nga anëtarët e Qeverisë sollën më shumë njohje për Kosovën, zv.kryeministri apo ministri i Punëve të Jashtme dhe spektakleve të shumta mediale, Kosova arriti të fitojë vetëm 5 njohje në vitin 2012 dhe të jetë ende shume larg nga 100 njohjet e duhura për të trokitur në derën e OKB-së.

Të mos flasim për abuzim me diskrecionin diplomatik të shteteve me të cilat ishit në bisedime, me të cilat falë garës mes jush për merita e fuqizuat shtetin e Serbisë që t'i parandalojë këto njohje dhe t'i vërë në pozita të palakmueshme shtetet tjera.

Anëtarësimet: Ngjashëm është edhe me anëtarësimet në organizatat ndërkombëtare. Kosova sivjet nuk arriti të pranohet në asnjë prej organizatave, për dallim prej mandatit të kaluar, kur u bë anëtare e FMN-së, e BB-së dhe disa të tjera.

Përveç gabimeve amatoreske në aspektin e njohjeve, as puna brenda MPJ-së nuk është diçka me të cilën mund të krenohet Kosova, meqë njerëzit e rinj pranohen nëse i kanë librezat tuaja partiake dhe detyrat e rëndësishme caktohen me të njëjtin kriter, pasi njerëz të cilët nuk kanë njohje elementare të gjuhës së vendit ku shkojnë apo kualitete elementare njerëzore caktohen nëpër pozita diplomatike dhe konsullore.

Shteti i Malit, i Papua Guinea e Re, a janë shtete të cilat na kanë njohur, pasi herë i kemi pa ne ueb-faqe e në njoftime, e herë janë hequr. A e kanë njohur Kosovën Uganda dhe Nigeria, pasi këto njohje janë kontestuar nga znj Clinton dhe znj. Eshton?

Vetëm pas intervenimit të Grupit të Grave Deputete caktuat edhe gra ambasadore, gjë na gëzoi dhe publikisht ju kemi falënderuar në shumë raste. Por, caktimi i znj. V. Dobruna për ambasadore, duke mos e precizuar shtetin, tregon joseriozitet, pasi nuk ka shtet të përcaktuar (nuk mund të përcaktohet kontinenti si vend dekretimi), dhe pse në Amerikën Latine ne ende nuk kemi ambasada? Bile nuk i kemi as në shume shtete, të cilat e kanë njohur Kosovën para shumë kohësh.

2. Dhe, pohimi juaj i dytë se nuk është vetëm Ministria e Punëve të Jashtme përgjegjëse për imazhin e keq të Kosovës është pohim i drejtë.

Qeveria e cila nuk ka ende strategji të zhvillimit ekonomik, Qeveria e cila nuk mund ta shkëpusë Kosovën nga fundi i listave për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila nuk ishte në gjendje t'i demantojë akuzat e Dik Martit për trafikim

organesh dhe Qeveria, e cila na e dhuroi fusnotën dhe e cila është në gjendje të hyjë në bisedime me Serbinë pa asnjë përgatitje, pa vija të kuqe në temat, kjo Qeveri është gjithashtu përgjegjëse për imazhin e keq dhe humbjen e kredibilitetit të Kosovës. Pra, jo vetëm Ministria e Punëve të Jashtme.

(Diskutim i dorëzuar me shkrim)

KRYESUESI: Konstatohet se debati përfundon me zotën Beqiri, si propozues. Zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nga shumë folës u tha se qëllimi kryesor dhe i vetëm i interpelancës sonë ka qenë dhe mbetet ta bëjmë edhe më mirë dhe të bëhet edhe më e mirë politika jonë e jashtme dhe unë, zoti nënkryetar, mendoj që ka hapësirë t'i harmonizojmë rekomandimet me grupet tjera parlamentare. Edhe një herë po them - gjithmonë në frymën e asaj që përgjithësisht u zhvillua debati që të bëhet edhe më mirë në aspektin e krijimit të politikës sonë të jashtme, e mendoj që nëse na jepet pauza, ne mund ta harmonizojmë një tekst dhe pastaj të dalim me rekomandime dhe, fare në fund, pa dashur të polemizoj, më vjen keq që interpelanca ka dalë nganjëherë jashtë kontestit për çka është thirrur dhe pajtohem me zotën Demaku se në këtë vend sigurisht ka njerëz që nuk ia duan të mirën vendit tonë, punojnë edhe me shërbime të huaja. Do të vijë koha besoj dhe duhet nxjerrë të tillët, e sigurisht duhet të gjithë t'i luftojmë ata që nuk ia duan të mirën vendit në çfarëdo forme. Ne këtu nuk e kemi asnjë dilemë, me emër dhe mbiemër.

Prandaj, zoti nënkryetar, nëse ka mundësi, na jepni një pauzë të drekës dhe ne, me kolegët e grupeve, t'i harmonizojmë qëndrimet me shefat kolegë të tjerë. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Atëherë, në orën 16:15 minuta shihemi përsëri!

(Vazhdimin e seancës, pas pauzës së drekës, e drejton nënkryetari Xhavit Haliti)

KRYESUESI: Atëherë, të nderuara deputete dhe deputetë, po e vazhdojmë seancën.

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Vazhdojmë me seancën, fjalën e ka kryetari i Grupit të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pas debatit të bërë nga kolegët deputetë dhe të tjerët dhe ministri, u morëm vesh që të tri grupet, në të vërtetë të gjitha grupet parlamentare u dakorduan për tekstin, të cilin do të jua lexoj. E kam fjalën për grupet parlamentare: LDK, PDK, "Vetëvendosje", AAK, SLS, KKR, domethënë e kemi harmonizuar dhe unë do ta lexoj tekstin e rekomandimeve që jua propozojmë t'i votoni, kolegë të nderuar.

Në përputhje me nenin 44, paragrafi 4, pika d të Rregullores së Kuvendit, grupet parlamentare, që i përmenda, pas harmonizimit të tekstit të rekomandimeve, ia paraqesim Kuvendit krejt tekstin e mocionit për votim:

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon përgjegjësi dhe përgjegjshmëri nga Qeveria, veçmas për çështjen e njohjes, përkatësisht mosnjohjes nga tri shtete dhe për këtë ta informojë Kuvendin e Republikës së Kosovës deri në fund të këtij viti,
2. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që urgjentisht t'i sqarojë kompetencat e anëtarëve të Qeverisë, duke i përshkruar saktë obligimet dhe detyrat e punës të të gjithë përfaqësuesve të Kabinetit qeveritar që merren me politikë të jashtme,
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që të merren hapa të menjëhershëm për anëtarësim në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, në Këshillin e Evropës dhe të raportojnë në Kuvend në baza të rregullta tremujore lidhur me avancimin e procesit të anëtarësimit,
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria krijimin e partneritetit strategjik bilateral,
5. Kuvendi i Republikës së Kosovës e obligon Ministrinë e Punëve të Jashtme që t'i përgjigjet Komisionit për Politikë të Jashtme në baza të rregullta,
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria që të ndalojë politizimin e shërbimit diplomatik të Kosovës dhe të veprojë në përputhje me ligjet në fuqi dhe me Kushtetutën me rastin e emërimeve apo ngritjes në detyrë.

Të nderuar kolegë deputetë, edhe një herë po e përsëris, në bashkëpunim, në koordinim dhe në harmonizim me kolegët, përkatësisht me shefat e grupeve parlamentare ne ua propozojmë këto rekomandime dhe këtë tekst të mocionit që ta votoni. Faleminderit!

KRYETARI: A jeni dakord ju të tjerët? Të pranishëm janë 70 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 67 vota për, 1 kundër, Kuvendi i miratoi rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike.

Pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pagat e funksionarëve publikë

Fjalën e ka zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Anëtarë të Qeverisë, deputetë,

Më 4 tetor të këtij viti, Ministria e Administratës Publike nëpërmjet Zyrës së sekretarit e ka dërguar një shkresë te sekretari i Kuvendit dhe si sponsorues i ligjit pajtohet që të tërhiqet ky ligj dhe të harmonizohet paraprakisht, si dhe të lexohet në lexim të parë. Ju kërkoj mirëkuptim. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i komisionit, deputeti Idriz Vehapi.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryetar!

Si Komision Funkcional e përkrahim kërkesën e ministrisë për tërheqjen e projektligjit.

KRYETARI: Mirë! Projektligji për pagat e funksionarëve publikë i kthehet Qeverisë, me shumicën e votave të deklaruara të deputetëve.

Pika e shtatë e rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. E ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotën Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë, kryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Më lejoni që para jush ta prezantojë këtë projektligj, që është shumë me interes për qytetarët e Republikës së Kosovës, por njëkohësisht nëse më lejohet, zoti kryetar, do ta bëja një laborim pak më të gjatë se zakonisht lidhur me këtë projektligj.

Projektligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë, në koordinim dhe në bashkëpunim të plotë me përfaqësuesit e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në përfaqësuesit e Gjyqësorit, Prokurorisë, Policisë së Kosovës, Zyrës së Bashkimit Evropian, EULEX-it, Ambasadës Amerikane, Agjencisë Anti-Korrupsion dhe organizatave të shoqërisë civile deri në fazën finale.

Më lejoni të theksoj se për ta siguruar një harmonizim me legjislacionin e Bashkimit Evropian me këtë ligj është pranuar edhe ekspertiza e tre ekspertëve të Bashkimit Evropian, me të cilët është vërtetuar përputhshmëria e plotë e projektligjit me legjislacionin përkatës së BE-së për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, posaçërisht me vendimin kornizë të Këshillit të Ministrave të vitit 2005, i cili tanimë është përputhur me këtë ligj.

Ndër të tjera, jemi përkujdesur që ky projektligj të jetë në përputhje të plotë me atë që kemi paraparë edhe në Kodin e Procedurës Penale.

Zonja dhe zotërinj,

Të gjithë ne kemi qenë dëshmitarë të një debati të gjerë rreth procedurave të konfiskimit, rreth këtij ligji dhe rreth asaj se çka duhet të parashohë legjislacioni ynë në fushën e konfiskimit. Janë shprehur një numër i madh vërejtjesh, po ashtu edhe sugjerimesh, por

edhe aspirata shumë ambicioze, për çka dhe si duhet t'i përmbajë ky ligj. Unë, para së gjithash, dua të ju siguroj të gjithë ju se të gjitha këto propozime janë diskutuar gjerë e gjatë me grupet punuese. Janë diskutuar edhe nga ekspertët më të mirë të propozuar nga Komisioni Evropian që janë angazhuar për hartimin dhe draftimin e këtij projektligji dhe ndonëse shumica e këtyre rekomandimeve janë pranuar, megjithatë disa prej tyre nuk janë pranuar për arsye të gjendjes objektive në republikën tonë.

Ndonëse procedurat që ndërthuren këtu janë procedura që sjellin një reformë të thuktë në luftën tonë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, unë jam i gatshëm që ta mbrojmë përmbajtjen e këtij projektligji, duke marrë parasysh garancitë që dy herë radhazi kam marrë për secilën dispozitë se është në përputhje të plotë me kriteret e legjislacionit të BE-së. Unë tashmë kam adresuar disa herë shqetësimet kryesore të shumë palëve në këtë projektligj. Kërkesat tona kryesore, veçanërisht në konsultim me krerët e Gjyqësorit dhe Prokurorisë, kanë qenë: që të mund të ndahet barra e provës ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit, si dhe të mundësohet procedura e konfiskimit edhe për pronën e fituar para kryerjes së veprës penale për të cilën personi dënohet. Kur kemi filluar me draftimin e këtij projektligji, kemi hasur në shqetësime të shumta nga shumë bashkëpunëtorë të mi ndërkombëtarë dhe vendorë, të cilët kanë shprehur dyshimet për sigurinë juridike dhe për mundësinë e keqpërdorimit apo aplikimit të gabueshëm të procedurave të tilla, që do të mund ta rrezikonin edhe shkeljen e lirive dhe të të drejtave të qytetarëve tanë.

Këtu më specifikisht e kam fjalën për vërejtjet e shoqërisë civile, sesa për futjen e të ashtuquajturit “konfiskim civil” dhe ndonëse unë kam bindjen e plotë që Kosova në vitet në vijim, ndoshta për tri apo pesë vjetët e ardhshme, do të jetë e gatshme që ta fusë në legjislacion një çështje të tillë të konfiskimit. Nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar na është bërë me dije që Kosova nuk është ende e gatshme ta bëjë një gjë të tillë, një lloj të konfiskimit, i cili, edhe pse mund të ekzistojë, mund po ashtu të ketë një pasiguri të plotë dhe mundësi për shkelje të lirive dhe të drejtave të qytetarëve tanë. Për shembull, është shumë më lehtë në një vend të Bashkimit Evropian të dëshmohet prejardhja e pronës nëpërmjet dokumentacionit që daton nga madje shekuj më parë, që nuk është shkatërruar nga asnjë luftë, e sidomos është ndërlidhur me traditën e tyre të gjatë juridike dhe mundësitë ekonomike që ata i kanë sot.

Të gjitha këto e vlerësojnë dukshëm barrën e prokurorit për të dëshmuar prejardhjen jo legjitime të pasurisë, ashtu edhe barrën e qytetarit për të dëshmuar se pasuria e tij në fakt është e ligjshme. Por, në Kosovë nuk e kemi gjithmonë një mundësi të tillë, sikur në vendet e tjera. Prandaj, duke i pasur parasysh këto kufizime objektive që Kosova i ka sot, jemi munduar ta krijojmë një ligj që i përmbush kërkesat e BE-së, por njëkohësisht është përshtatur me ambientin e Kosovës. Dhe, për këtë, dispozitat që ne mund t'i quajmë të rregullta të konfiskimit i kemi përfshirë në draftin e ri të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa ky ligj përmban procedura të veçanta që i kemi quajtur “kompetenca të zgjeruara të konfiskimit”.

Për të hyrë në substancë të këtij ligji, draftin e ri të Kodit të Procedurës Penale, i cili përmban dispozitat për konfiskimin e dobisë pasurore me aktivitete kriminale, të cilat i

nënshtrohen konfiskimit të detyrueshëm, siç e parasheh edhe Kodi Penal. Nga vendimi kornizë i Bashkimit Evropian për këtë fushë, projektligji që Kosova po e përpilon sot dhe procedurat e saj gjithsesi duhet të përmbajnë këto standarde:

1. Ta lejojë gjykatën që të urdhërojë konfiskimin e pasurisë dhe dobisë pasurore nga vepra penale të fituara para dënimit të tij për vepër penale. E gjithë kjo procedurë tanimë është paraparë në Kodin e Procedurës Penale,
2. Në rastet kur i pandehuri është dënuar për vepër penale t'i lejohet gjykatës të urdhërojë konfiskimin e pasurisë së fituar me aktivitete të ngjashme me ato të cilat është dënuar dhe
3. Në rastet kur personi është dënuar dhe ka pronë për të cilën është joproportionale me të ardhurat e tij legjitime, gjykata mund të urdhërojë konfiskimin e këtyre pasurive nëse bindet se kjo pasuri është e fituar me aktivitet kriminal.

Zonja dhe zotërinj, të nderuar deputetë,

Të gjitha këto kushte tanimë i kemi në ligjin që po e prezantoj sot para jush. Ne gjithashtu e kemi marrë parasysh edhe draft-direktivën e BE-së të marsit të vitit 2012, e cila kërkon që shtetet anëtare mund ta konfiskojnë pasurinë edhe kur i pandehuri ka ikur nga shteti dhe është në arrati, por edhe ka vdekur. Dua të theksoj që kjo direktivë akoma nuk ka filluar të zbatohet as në vetë BE-në, por Kosova me një ligj të tillë po e hedh një hap përpara.

Dua të ndalem për pak minuta te barra e provës, që është bërë edhe debat i gjerë. Ndonëse në Projektkodin e procedurës penale të Republikës së Kosovës barra ngelet te prokuroi, për të dëshmuar se një vepër penale është kryer nga i pandehuri, pasi ai të dënohet për vepra penale të rënda, me këtë projektligj automatikisht barra bartet tek i pandehuri. Për të dëshmuar se pasuria e tij, e fituar para kryerjes së asaj veprë penale, është e fituar në mënyrë të ligjshme, nëse ai nuk di ta shpjegojë prejardhjen e pasurisë së tij, atij do t'i konfiskohet ajo. Kjo i kërkon prokurorit që të dëshmojë një rast, në shikim të parë “prima facia”, dhe kështu ta bartë barrën te i pandehuri që të dëshmojë se pronë e tij është legjitime. Megjithatë, kushtet e veçanta që Kosova i ka sot kërkojnë që të sigurohet që të drejtat dhe liritë e njeriut nuk shkelen gjatë bartjes së barrës të provës. Një i pandehur, i cili ka blerë pasuri dhe atë në mënyrë të ligjshme mund të mos jetë në gjendje që ta vërtetojë një gjë të tillë se si e ka fituar atë pasuri para vitit 1999.

Prandaj, ligji ynë duhet gjithsesi t'i përmbushë këto kushte që sot kërkohen edhe në vendet e BE-së. Dua të veçoj tri nene, të cilat sjellin risi kryesore në procedurën e konfiskimit.

Neni 6 i ligjit themelon një procedurë për Prokurorinë që ta konfiskojë pasurinë e pashpjegueshme, e them në thonjëza “pasi të jetë dënuar personi për një vepër penale”. Kjo procedurë mund të përdoret vetëm nëse i pandehuri është dënuar për kryerjen e veprave penale nga kapitulli XV, që janë krimet kundër të drejtës ndërkombëtare; kapitulli XXIII - veprat penale me narkotikë, kapitulli XXIV - krimi i organizuar, kapitulli XXV - krimet kundër ekonomisë dhe kapitulli XXXIV - veprat penale të korrupsionit.

Kufizimi i përdorimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm është bërë me qëllim të sigurisë juridike të qytetarëve tanë. Pra, nuk mund të dënohesh për shembull për një vrasje dhe të kërkohej të fillohet kundër tij konfiskimi i pronës apo edhe çështjet e tjera, të cilat nuk kanë reflektuar drejtpërdrejt në pasurinë e tij.

Brenda 30 ditësh nga data e dënimit për veprën penale, prokurori duhet gjithsesi të dëshmojë që personi i dënuar ka pasuri tjera, të cilat nuk janë fituar me kryerjen e veprës penale për të cilën është dënuar. Prokurori është i dënuar që të dëshmojë, ndër të tjera: a). Për pasurinë që është fituar pas 31 dhjetorit të vitit 1999, b). I pandehuri nuk ka të ardhura legjitime që do ta shpjegonin pasurinë e fituar, c). I pandehuri është përfshirë në sjelljen e ngjashme me ato për të cilat është shpallur fajtor dhe kjo sjellje do të mundësonte blerjen e atyre pasurive.

Në lidhje me barrën e provës të ndarë ndërmjet prokurorit dhe të pandehurit duhet të cek dy elemente kryesore: e para - i pandehuri i ka 30 ditë që të dëshmojë se e ka fituar këtë pasuri në mënyrë legjitime dhe nën dy - personi i dënuar mund ta paraqesë prova se shënimet e kadastrave ose dokumentet tjera për të cilat duhet të dëshmojë se pasuria e tij është e blerë me të ardhura të ligjshme nuk janë në dispozicion apo nuk janë të besueshme.

Neni tjetër, për të cilin dua të veçoj është neni 7 i ligjit, i cili themelon një procedurë për prokurorin që të konfiskojë dobitë pasurore për veprat penale nga i pandehuri, i cili tanimë ka vdekur. Ndonëse personi ka vdekur dhe procedura penale ndaj tij përfundon, me këtë ligj mundësohet që procedura të vazhdojë vetëm kundër pasurisë së tij. Ngjashëm me këtë, neni 8 i ligjit e themelon një procedurë, që prokurori të mund t'i konfiskojë dobitë pasurore për veprat penale në rastin kur i pandehuri e ka lëshuar vendin, apo është në arrati, në kushte të ngjashme me atë të nenit 7. E ne të gjithë e dimë që në Kosovë personat nuk mund të dënohen në mungesë, apo kur janë në arrati, por këtu është bërë një përjashtim, që pasuria e tij edhe në mungesë të tij apo në arrati të konfiskohet dhe të merret.

Dua të përmend këtu shkurtimisht disa veçori tjera të ligjit. Ligji e lejon prokurorin që të kërkojë konfiskimin e pasurisë, e cila është e transferuar në mënyrë të kundërligjshme nga i pandehuri te një person tjetër për ta mbrojtur atë.

Neni 9, e lejon prokurorin që të ngrijë pasurinë edhe në rastet kur hetimet janë pezulluar.

Neni 12 ndihmon që të krijohet një fond për kompensimin e viktimave me 10% të të ardhurave me të cilat janë konfiskuar. Kjo do të ndihmojë të realizohet një nevojë e gjatë për kompensimin e viktimave të krimit edhe në rastet kur i dënuari nuk ka mundësi ta bëjë kompensimin e tyre. Kjo do të ndihmojë që të sillet një drejtësi, një mbështetje dhe rehati më e madhe për viktimat e krimit.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të theksoj se asnjëra nga këto mundësi nuk kanë ekzistuar deri më sot në Republikën e Kosovës. Prandaj, deklaratat që ky ligj nuk sjell risi shpeshherë mund të shihen si jo shumë me vlerë.

Dua të ndalem pak te fuqia retroaktive e këtij ligji. Pasuria e fituar gjatë të njëjtës periudhë kohore, sa për atë që është dënuar dhe duhet të konfiskohet, me risitë e këtij ligji për shumë vepra penale, si ato që përmenda më lart, ky efekt zgjat shumë vite me parë. Është kufizuar deri më datën 31 dhjetor 1999 dhe përfshin konfiskimin e pasurisë së fituar edhe para periudhës së kryerjes së veprës penale për të cilën personi dënohet. Gjithashtu, mundëson procedurën për të pandehurin që të dëshmojë se dokumentet e tij, të cilat i mundësojnë dokumentimin legjitim të pronës së tij, mund edhe të mos ekzistojnë. Kjo ka qenë njëra nga shqetësimet kryesore të bashkëpunëtorëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe ky shqetësim, pra mënyra e vërtetimit të dokumenteve, të kadastrave dhe të tjera është adresuar në mënyrë adekuate dhe i gjithë ky lloj retroaktiviteti që e kemi dhënë në këtë ligj është aprovuar nga ekspertët gjermanë të kësaj fushe në praninë edhe të medieëve dhe të tjerave dhe është dhënë edhe me shkrim, duke garantuar që këto dispozita nuk janë në kundërshtim me dispozitat e BE-së.

Për ta ilustruar këtë që e thashë më lart, më lejoni ta jap një shembull praktik. Një person mund të dënohet për kryerjen e veprës penale që ka ndodhur para vitit 2005, por po ashtu në nenin 6 të këtij ligji prokurori mund të dëshmojë se pasuria e tij e fituar në mënyrë të pashpjegueshme që nga janari 2000 mund të jetë fituar me aktivitetet e ngjashme kriminale, prandaj edhe mund të konfiskohet.

Me atë që është paraparë në legjislacionin e Kosovës deri më sot, prokurori, jo vetëm që nuk është lejuar ta bëjë këtë, por deri më tani është dashur që ai vetë të dëshmojë para gjykatës që pasuria e këtij personi është fituar në mënyrë të kundërligjshme, pra të ndahet pjesa e barrës së provës. Në shembullin që e përmenda, prokurori mjafton të dëshmojë që ky person ka kryer njëherë vepër penale të korrupsionit apo të krimit të organizuar dhe të bëjë kërkesë para gjykatësit që të fillojë zbatimin e këtij ligji. Dhe, nga ai moment i takon të pandehurit që të dëshmojë gjithë pasurinë e tij që nga 1 janari i vitit 2000. Për ta siguruar këtë që nuk do të ketë shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut, i pandehuri mund ta fitojë të drejtën që të dëshmojë se e ka fituar pasurinë e tij në mënyrë të ligjshme, por gjithashtu ai mund të dëshmojë se i mungojnë të dhënat, dokumentet e duhura apo të besueshme, të cilat do të dëshmonin legjitimitetin e pronës së tij.

Ky argument gjithsesi mund të rrëzohet nga prokurori, ngase në shumicën e rasteve dërmuese ekzistojnë të dhëna, dokumente për rastin e tij pozitiv apo negativ. Si përfundim, më lejoni të përmend që unë jam i bindur shumë në evoluimin dhe ngritjen e kapaciteteve të Gjyqësorit dhe Prokurorisë në Republikën e Kosovës dhe ky ligj gjithashtu do të fillojë të ndryshohet dhe të përditësohet që nga momenti i adaptimit të tij.

Që të jem më i qartë, synojmë që pas disa vitesh ta zbatojmë edhe konfiskimin e pasurisë para marrjes së vendimit final të gjykatës, që ka filluar të zbatohet në disa vende evropiane, por që kanë traditë të shquar gjyqësore. Kosova nuk është cilësuar të jetë e

gatshme për një shkallë kaq të rreptë të konfiskimit. Sidomos pasi është dëshmuar si një procedurë e tillë, ka qenë krejtësisht e pasuksesshme dhe ka rezultuar në të drejtat dhe liritë e njeriut në rajon për shkak të situatës dhe traditës juridike që kemi. Dhe, unë e them, jo vetëm në kodin aktual, në kodin e vitit 2004, por edhe në atë të vitit 1977, apo prej kohës që ka pasur sistem juridik, nuk është lejuar që të fitohet pasuria në mënyrë të kundërligjshme dhe në cilindo rast gjykatat kanë pasur dhe kanë të drejtë të bëjnë veprime për konfiskimin e saj.

Kosova nuk mund ta përcjellë një shembull të dështimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, siç ka ndodhur në shumë vende të rajonit. Sipas thënies së famshme të Niçes: “Kushdo që i lufton të këqijtë duhet të kujdeset që në këtë proces të mos bëhet vetë i keq, ngase nëse fokusohesh shumë në errësirë, edhe errësira do të fokusohet në ty”. Dhe, prandaj unë dua ta përcjell këtë mesazh sot te ju, ndonëse të gjithë e duam dhe angazhohemi që ta çrrënjoshim krimin e organizuar dhe korrupsionin nga vendi ynë. Duhet të përkujdesemi që gjatë këtij rrugëtimi të mos i shkelim liritë dhe të drejtat e qytetarëve tanë. Të kemi kujdes që në emër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të mos i detyrojmë qytetarët tanë me obligime, të cilat nuk janë të gatshëm që ata t’i kryejnë, me të cilat shteti nuk mund të ofrojë përgjegjësitë e duhura dhe mbi të gjitha të mos kërkojmë më shumë përgjegjësi nga ata se sa mundësi që ofron vetë Republika e Kosovës. Dhe, pikërisht për këtë e kam fjalën kur them se duhet të ndërtojmë ligje që i bien tamam vendit tonë dhe mbi të gjitha në mënyrë graduale mundësojnë jetën e lirë të qytetarëve të republikës sonë.

Zonja dhe zotërinj,

Unë ju ftoj sot që në parim ta miratoni këtë projektligj, ftoj po ashtu Komisionin për Legjislacion që t’i bëjë përmirësimet e duhura në koordinim të plotë me secilin prej jush, po ashtu edhe me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë dhe t’i kemi gjithmonë parasysh mundësitë që i ka vendi ynë, dëshirat dhe deklaratimet politike që i kemi ne, por mbi të gjitha do të thosha vullnetin e qytetarëve tanë për siguri juridike.

Ajo me çka dua ta përfundoj fjalimin tim, unë jam shumë i interesuar që ligjet në vendin tonë ta godasin atë i cili nuk ka të drejtë, por ta mbrojnë qytetarin tonë i cili ka të drejtë dhe ligji do të miratohet duke marrë parasysh interesat e gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë besoj që me prezantimin dhe mundësinë që më ofruat pak më shumë sesa është dashur, ju falënderoj për këtë të gjithëve, ju zoti kryetar dhe të tjerët, do të kemi diskutime racionale dhe ajo çka mund të them duhet ta kemi një ligj që i bie tamam vendit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër! Fjalën tani e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion, deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka trajtuar këtë ligj dhe ka pasur debate të shumta, por mendimi i komisionit nuk ka qenë i unifikuar. Komisioni ka votuar dhe votat janë ndarë katër vota që ligji të procedojë më tutje dhe katër vota që ligji t’i kthehet Qeverisë. Dhe,

si rezultat i kësaj kemi arritur në një konkluzion të përgjithshëm që seanca duhet të marrë vendim se çka të bëhet me këtë ligj.

Mirëpo, para se të shkojmë atje unë po jap vlerësimet dhe debatet që janë zhvilluar në komision dhe arsyeshmërinë e asaj se çka është diskutuar. Problemi kryesor me ligjin, sipas diskutimit që kanë dalë nga komisioni, del te objekti i ligjit dhe fusha që ligji e rregullon. Po ashtu, problemi kryesor këtu është barra e provës. Është e vërtetë se parimisht, qysh nga e drejta romake deri më sot, barra e provës bie mbi akuzuesin.

Po ashtu, është e vërtetë se ligji nuk mund të ketë retroaktivitet. Asnjë ligj nuk mund të ketë pasojë prapa vepruese, në kuptimin që në fushën penale nuk mund, normalisht, të dënohesh për një vepër penale, e cila në kohën kur është kryer nuk ka qenë vepër penale. Po ashtu, konfiskimi dhe sekuestrimi janë dy tema tjera që janë diskutueshëm. Mirëpo, vetë qëllimi i këtij ligji është që t'i ndryshojë pikërisht këto fusha, që do të thotë se ky ligj e ka për qëllim që barrën e provës ta bartë nga akuzuesi te i akuzuari. Po ashtu, retroaktiviteti, që do të thotë që diçka, edhe nëse nuk ka bërë vepër penale në kohën kur është kryer, ndërsa sot mund të përbëjë vepër penale, mund të konsiderohet edhe në kohën e shkuar.

Dhe, konfiskimi i pasurisë e sekuestrimi edhe i përkohshëm janë dy çështje tjera, që janë debatuar dhe diskutuar. Këtu çështja është se a është e gatshme shoqëria jonë të kalojë në këtë stad dhe a është reale problematika që është diskutuar. Mendoj se problematika është shumë reale dhe mendoj se duhet patjetër ta kemi një ligj, i cili e trajton atë. Fatkeqësisht, ne duhet ta shkaktojmë këtë asimetri. Po them asimetri sepse e ndryshojmë barrën e provës. Kjo është ajo çka është diskutuar, ndërsa sa i përket ligjit unë mendoj se e kemi një ligj, të cilit duhet t'i japim disa përgjigje. Dhe, shumë prej nesh sot i kemi pyetjet: Pse nuk është bërë një ligj më i mirë? Pse nuk ka vullnet që pasuria e fituar nga aktivitetet joligjore të konfiskohet? Pse nuk ka angazhim për konfiskimin e pasurisë të fituar në mënyrë të paligjshme? Këto pyetje i shtrojmë gjithsecili prej nesh sot, besoj edhe ministri vetë. Unë mendoj gjithashtu se vendi ynë i varfër nuk mund t'ia lejojë vetes që ta ketë një shkallë kaq të lartë të krimit, nuk mund t'ia lejojë vetes që ta ketë një shkallë kaq të lartë të pasurisë të paligjshme dhe nuk mund ta ketë një shkallë kaq të madhe të njerëzve, që bëhen milionerë me aktivitete të paligjshme dhe që mburren me pasurinë e tyre publikisht.

Ne nuk mund të kemi transferim të vlerave si shoqëri, nuk mund të lejojmë që besimi ynë të tjetërsohet, nuk mund të lejojmë që vlerat dhe standardi ynë shoqëror të bëhet paraja. Sidomos, nuk mund të lejojmë që vlera jonë shoqërore të bëhet paraja e përfituar në mënyrë të paligjshme. Prandaj, ky ligj e ka për qëllim që t'i rikthejë edhe vlerat në besimin social dhe besimin institucional.

Ne sot kemi shumë sfida dhe dilema, po ashtu edhe kërkesa që na vijnë. Ju kanë ardhur të gjithë deputetëve besoj kërkesa që vijnë nga palë të ndryshme të interesuara, por si do t'i japim përgjigje ne, çfarë përgjigjesh do t'i japim, a do t'i japim përgjigje logjike, do t'i japim përgjigje emocionale, apo do t'i japim përgjigje të arsyeshmërisë së institucioneve

të shtetit të së drejtës. Dhe, mendoj se përgjigjja duhet të jetë e arsyeshmërisë të shtetit të së drejtës dhe mbi këtë bazë ne duhet të angazhohemi sot.

Sot, me këtë ligj ne përballemi me krimin e organizuar dhe paranë e fituar në mënyrë të paligjshme. Ne sfidohemi me një fuqi që është shumë më e madhe se ne, e cila po e dëmton shumë vendin, e cila po i tjetërson vlerat tona. Sfidë e cila duhet të sfidohet dhe të fitohet nga institucionet e Kosovës. Ne sot e sfidojmë këtë sfidë, ne sot duhet ta fitojmë këtë sfidë, sepse kjo është një luftë e të mirës kundër të keqes, është lufta kundër krimit, kundër abuzimit me shtetin, kundër korrupsionit, drogës, trafikimit dhe këtë sfidë duhet ta fitojmë së bashku. E them së bashku, duke pasur parasysh vullnetin për ta luftuar pasurinë e përfituar në mënyrë të paligjshme të të gjithë atyre që besojnë se në Kosovë duhet të sundojë shteti i së drejtës dhe që besojnë se në Kosovë mund të sundojë shteti i së drejtës.

Prandaj, unë mendoj se ne sot duhet të fokusohemi dhe të angazhohemi e t'i themi Qeverisë se e ka përkrahjen e Kuvendit, nëse vetë e ka vullnetin që ligjin ta marrë, ta ndryshojë, ta plotësojë, të marrë barrën e provës ta hedhë te i akuzuari, të mos ketë ndarje të barrës së provës, por barra e provës nga akuzuesi të kalojë te i akuzuari, retroaktiviteti po ashtu të shtrihet dhe konfiskimi dhe sekuestrimi i përkohshëm të jenë tema kryesore të këtij ligji.

Nëse Qeveria e ka vullnetin që t'i marrë dhe t'i adaptojë këto vërejtje, unë besoj se do të ketë përkrahjen e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe do ta ketë përkrahjen e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Prandaj, mendoj se ligjin duhet ta kthejmë në Qeveri dhe ta përmirësojmë atë, e pastaj të shkojmë e ta plotësojmë edhe një kriter, që është kriteri i Bashkimit evropian dhe që është një kriter i standardeve të një shoqërie demokratike, të cilën ne synojmë ta ndërtojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar.

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin dhe e vlerëson si një nga ligjet më të mira, i cili e plotëson bazën aktuale ligjore të Kodit të Procedurës Penale për luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Ne kemi vendosur ta miratojmë në parim, së paku për tri arsye.

E para: Projektligji i respekton parimet themelore të drejtësisë bashkëkohore.

E dyta: I respekton të gjitha parimet dhe standardet e Bashkimit Evropian me vetë faktin që në draftimin e tij kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, dhe

E treta: Mendojmë se projektligji u është adresuar kryesve të veprave penale dhe pasurisë së tyre. Dhe, me këtë projektligj ky qëllim arrihet. Pra, projektligji nuk ka pasur ambicie tjera më të mëdha dhe mendoj se mjaft është ambicie e madhe nëse e luftojmë pasurinë e

fituar nëpërmjet veprës penale dhe kjo na del mjaft, dhe mendojmë se ky projektligj do t'ua heqë justifikimin organeve të ndjekjes, do t'ua heqë justifikimin se nuk kemi bazë ligjore për ta luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin.

Nëse u referohemi kapitujve, të cilëve u referohet projektligji, atëherë fjala është për pasurinë e atyre që bëjnë kontrabandë me mallra; fjala është për pasurinë e atyre që bëjnë kontrabandë me njerëz, që bëjnë prostitucion, që japin dhe marrin ryshfet, pra edhe për korrupsion. Prandaj, ky projektligj i mbulon gati të gjitha fushat, në të cilat dikush, nëpërmjet veprës penale ka krijuar pasuri dhe ky ligj e krijon mundësinë që t'ua marrë pasurinë atyre, natyrisht pas një aktgjykimi dhe pas një shqiptimi të një dënimi.

Ambicie më të mëdha projektligji nuk ka pasur, prandaj mendojmë që këtë ambicie e arrijmë.

Është krijuar një përshtypje sikur ne nëpërmjet këtij projektligji po duam të mbulojmë diçka, të arsyetojmë diçka. Nëse dikush ka menduar që nëpërmjet këtij projektligji po përpiqemi t'i arsyetojmë zyrtarët, që janë pasuruar në këtë vend, zyrtarët në këtë vend mund të ndiqen ndryshe, ka baza ligjore nëpërmjet ligjeve që kemi aprovuar mu në këtë Parlament. Vetëm është çështje e organeve të ndjekjes dhe ç'është e vërteta, organeve të ndjekjes dhe të gjyqësisë nuk mund t'ua nxjerrim një ligj, nëpërmjet të cilit ata i bëjmë trima dhe i bëjmë të përkushtuar. Për t'i shtyrë organet e drejtësisë të punojnë, pasi ua krijuam dhe po ua krijojmë për çdo ditë bazën ligjore, na duhet llogaridhënia. Për llogaridhënien e ndjekjes së krimit të organizuar nuk do ta fajësoja shumë Qeverinë, sidomos në organet e drejtësisë, sa do t'i fajësoja Kuvendin dhe Presidencën, të cilat mund të kërkojnë llogaridhënie për çdo ditë prej Këshillit Prokurorial, sepse vetë i kemi zgjedhur, edhe prej Këshillit Gjyqësor, sepse Qeveria nëse përzihet në organet e drejtësisë për mungesë rezultatesh, atëherë kjo është ndërhyrje. Pra, është mirë të kthehem pak nga vetja edhe si deputetë të shohim se cila është përgjegjësia jonë.

Po kthehem te projektligji. Projektligji, për mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike i respekton parimet themelore të drejtësisë. Ne nuk mundemi "açik dynjasë", nuk ka rast në botë që projektligji kthehet në mënyrë retroaktive, e as nuk kam lexuar që ka projektligj, me të cilin kërkohet marrja e pasurive, që janë krijuar në mënyrë të paligjshme. Fundja, çka është e paligjshme? Është një parim, sipas të cilit thuhet se çdo gjë që është e paligjshme është krim. Prandaj, ne po flasim në këtë frymë. Çështje tjetër është e terminologjisë dhe e përdorimit të fjalorit politik, nëpërmjet të cilit po krijojmë përshtypje në opinion, sikur dikush diçka do të fshehë në këtë vend.

Unë, me kompetencë e them, edhe profesionale, edhe me sinqeritetin më të madh, se me këtë projektligj ne ia japim mundësinë prokurorit të mos na arsyetohet më, të mos thotë nuk kam bazë ligjore për ta ndjekur pasurinë e atyre, të cilët dënohen për vepra penale të krimit të organizuar dhe të korrupsionit, e qëllimi i këtij ligji është pikërisht luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Dhe, fundja, mendoj unë, te parimi i retroaktivitetit - barra e provës, e kemi bërë një tolerancë, e kemi kthyer barrën e provës në fazën e dytë të procedurës, gjë që është

përrjashtim nga parimet themelore të drejtësisë, por po përpiqemi të bëjmë diçka përtej praktikave të zakonshme të tjerëve. Por, sidoqoftë, këto kanë qenë edhe shqetësime të shoqërisë civile, që t'i inkorporojmë në projektligj dhe në këtë e kemi bërë. Tani, prej këtij momenti e kemi edhe afatin e mjaftueshëm për amendamentim. Mendoj se duhet ta amendantojmë për arsye teknike, jo shumë përmbajtjesore, sepse edhe kodi i procedurës është në shqyrtim e sipër dhe ka shumë nene që u referohen, që duhet ndryshuar, por sidoqoftë secili e ka mundësinë në periudhën e amendamentimit ta japë kontributin e vet.

Dhe, krejt në fund, unë ju ftoj të gjithëve që ta votoni këtë projektligj, me të cilin forcohet, po e përsëris, baza ligjore, por, me të cilin, natyrisht, prapë nuk mund t'i bëjmë trima dhe të përkushtuar ata që duhet ta ndjekin krimin, që ne po ua krijojmë bazën ligjore.

Të ju përkujtoj, edhe mbrëmë ishte kërkesë eksplicite e evropianëve, sidomos e raportit të studimit të fizibilitetit, që pikërisht ky ligj duhet të aprovohet në agjendë afatshkurtër, siç e thanë ata.

Prandaj, për arsye të caktuara politike e të krijimit të perceptioneve të ndryshme, ndoshta është mirë të hiqet dorë kësaj radhe prej politizimit edhe të këtij projektligji, në mënyrë që ta kemi sa më parë në leximin e dytë dhe që ta kemi sa më parë në fuqi, në mënyrë që janari i vitit 2013 ta gjejë Kosovën me Kodin e ri Penal në fuqi, me Kodin e Procedurës Penale në fuqi dhe në këtë rast me Ligjin për konfiskimin e pasurisë që fitohet nëpërmjet veprës penale.

Pra, ju inkurajojmë të gjithëve që ta votoni sot dhe të jeni pjesëmarrës aktivë në amendamentimin e projektligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDK-së, fjalën e ka deputeti Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë me vepër penale, lidhur me të cilin paraqet këto vërejtje dhe komente.

Vërejtja e parë ka të bëjë me emërtimin e këtij draftligji. Kështu, bazuar në emërtimin e propozuar, objekt i konfiskimit nuk do të jenë të gjitha pasuritë e krijuara në mënyrë të kundërligjshme, por vetëm pasuritë e krijuara me vepra penale, ekzistimi i të cilave duhet vërtetuar nga gjykata. Kështu e përcaktojnë dispozitat e këtij ligji, me gjithë faktin që dihet se pasuria përveç me vepër penale, mund të krijohet edhe me veprime tjera të paligjshme, e që në aspektin juridik nuk kualifikohen si vepra penale.

Përveç kësaj, emërtimi i këtillë i këtij drafti do të pamundësonte të konfiskoheshin shumë e shumë pasuri të kundërligjshme, të cilat janë realizuar nga persona të pandërgjegjshëm,

sidomos në periudhën e pasluftës, për shkak se gjykatat tona të stërngarkuara nuk po ia dalin t'i ndriçojnë dhe sqarojnë veprat penale të kryera kohëve të fundit, e lëre më t'i ndriçojnë veprat penale të kryera në dekadën e fundit në Kosovë.

Andaj, propozoj që emërtimi i këtij draftligji të formulohet kështu: Projektligji për kompetenca të zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së krijuar në mënyrë të kundërligjshme.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me veprimin, respektivisht mosveprimin retroaktiv të këtij ligji. Ç'është e vërteta, në nenin 6 pika 1.2, ligji përmban një formulim tejet të paqartë dhe jo mirë të ndërlidhur me paragrafin 1 të këtij neni, i cili e ka këtë tekst: "Pasuritë tjera janë marrë pas 31 dhjetorit 1999". Por, nga ky formulim nuk mund të konkludohet se ky ligj vepron në mënyrë retroaktive edhe kundër të gjithë personave, që janë pasuruar në mënyrë të kundërligjshme para hyrjes së këtij ligji në fuqi. Andaj, një ligj i kësaj natyre, pa fuqinë e veprimit retroaktiv ndaj të gjitha pasurive të kundërligjshme, në një vend siç është Kosova, ku pas luftës me qindra e qindra persona kanë krijuar pasuri marramendëse, rëndom në mënyrë të kundërligjshme, më shumë do t'i ngjasonte një ligji që i amnistion përfituesit e paligjshëm të pasurisë sesa që vërtet do të ndihmonte zbulimin dhe luftimin e kësaj dukurie të kundërligjshme.

Vërtet, është e pakuptimtë që shtetit dhe organeve të tij t'u mohohet e drejta për të konfiskuar pasuri të kundërligjshme, sepse sipas një parimi të njohur të drejtësisë, i cili daton që nga romakët e vjetër, pronari ka të drejtë ta kërkojë pronën e vet deri në pakufi. Prandaj, pikërisht shteti i Kosovës duhet të disponojë me ligjin, dispozitat e të cilit do t'u mundësonin organeve shtetërore për ta konfiskuar pasurinë nga personat që e kanë krijuar atë në mënyrë të kundërligjshme dhe ta rikthejë atë, në çdo kohë kur vërtetohet kundërligjshmëria, pa e marrë parasysh kohën e fitimit të pasurisë.

Po që se ky ligj aprovohet kështu siç është propozuar, atëherë në vend se ta ndihmonte luftën kundër kriminalitetit dhe konfiskimin e pasurisë së kundërligjshme, përkundrazi do të paraqiste një mbrojtje ligjore për personat, numri i të cilëve nuk është i vogël, që pas luftës e tutje në Kosovë kanë krijuar pasuri, madje edhe milionëshe, nëpërmjet veprimeve të ndryshme kundërligjore.

Vërejtja tjetër që mund t'i bëhet këtij ligji ka të bëjë me dispozitat e nenit 4 dhe nenit 6, sipas të cilave prokurori i Shtetit është i obliguar që të ofrojë prova për të vërtetuar se i pandehuri ka fituar pasuri të kundërligjshme, mirëpo pasi kemi të bëjmë me persona, për të cilët dyshohet se kanë krijuar pasuri me veprime të kundërligjshme, mirë është që barra e provave të bartet edhe mbi të dyshimtit, duke kërkuar prej tyre që të paraqesin prova me të cilat e vërtetojnë nëse pasuria është e ligjshme.

Vërejtja tjetër që mund t'i bëhet këtij drafti ka të bëjë me shprehjet dhe me terminologjinë e përdorur, e cila vende-vende nuk është profesionale dhe jo në pajtim me terminologjinë e Kodit të Procedurës Penale, i cili ka qenë edhe burim reference për këtë draft. Kështu, në nenin 7, paragrafi 8, pika 1,2,3, thuhet se gjykata nxjerr aktgjykim, në të

cilin e përcakton se i pandehuri ka kryer vepër penale. Duhet theksuar se me aktgjykim nuk përcaktohen çështjet, por ato vërtetohen.

Përdorimi joadekuat i shprehjes “përcakton” haset edhe në disa nene dhe paragrafë të këtij ligji. Po ashtu, edhe shprehja “për të treguar shkak të bazuar”, neni 6.1, pastaj “vërteton shkakun e bazuar”, neni 6.2, nuk janë shprehje adekuate dhe të njëjtat duhet zëvendësuar me fjalët “dyshimi i bazuar”.

Andaj, pasur parasysh të gjitha lëshimet e theksuara, disa prej të cilave janë përmbajtësore dhe tejet domethënëse për përmbushjen e qëllimit dhe fushëveprimin e këtij draftligji, Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon nga deputetët e këtij Kuvendi që të mos e votojnë këtë draftligj dhe të njëjtin t’ia kthejnë sponsorit për ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Ju faleminderit, kryetar!

Në kohën kur korrupsioni i ka lëshuar rrënjët nga niveli lokal e deri te ai qendror, nga Ministria e Drejtësisë na sillet një ligj, i cili nuk e lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin, por e amnistion atë.

Dhe, në vend që Ministria e Drejtësisë, pas gjithë atyre kritikave, që i janë bërë këtij projektligji, të njëjtin ta tërheqë, përballë qytetarëve të Kosovës thuhet retorika të mbrapshta politike, vetëm sa për t’u hedhur qytetarëve hi syve, kinse me këtë ligj do të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni.

Ne kemi thënë në vazhdimësi që ligjet që më së shumti i nevojiten Kosovës janë ligjet antimafia, ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme dhe ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve. Për këtë arsye, në programin tonë politik thuhet: Ne konsiderojmë që keqpërdorimet nuk vjetrohen kurrë. Të gjithë ata që kanë uzurpuar, vjedhur dhe keqmenaxhuar me pronën publike, duhet të përgjigjen para drejtësisë. Përveç kriminelit, duhet dënuar edhe krimin dhe produktin e krimit. Logjika e nxjerrjes së Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme është vendosja e veprave të kundërligjshme, të cilat nuk janë në Kodin Penal. Pra, mund ta quajmë si shtojcë të Kodit Penal, pasi në të janë të parapara veprat penale, që supozojmë se do të ndodhin.

Mirëpo, projektligji i sjellë nga Ministria e Drejtësisë, konkretisht nga Qeveria, është shumë i mangët për ta përmirësuar funksionimin më të mirë të sistemit të drejtësisë rreth konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme. Ky projektligj, i cili në brendinë e tij ka 15 nene, është dublifikim i neneve, të cilat janë të parapara në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale. Ndërsa, nenet tjera janë tejet teknike, të cilat do të mund të inkorporoheshin në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, kur e dimë faktin që këto të dyja kanë qenë në procedurë për plotësim-ndryshim.

Projektligji në fjalë nuk mundëson që të vihet në dyshim pasuria e të tjerëve, të cilët nuk kanë të ardhura të mëdha, ndërsa në anën tjetër kanë pasuri marramendëse. Konfiskimi i pasurisë në Kosovë do të duhej të bëhej sipas rrethanave dhe nevojave tona.

Më tej do të vazhdojë me analizën e neneve në këtë projektligj. Neni 2 u referohet veprave penale në Kodin Penal, pra nuk rregullon asgjë.

Neni 3 flet për përkufizimet. Pra, se çka do të thotë agjenci, ministri, konfiskim dhe nuk ka ndonjë term të panjohur tashmë. Pra, s'ka asgjë të re, përveç termit kompetenca të zgjeruara të konfiskimit, që thuhet që nënkupton masat për konfiskimin e pasurisë sipas procedurës së përcaktuar me këtë ligj. Mirëpo, nuk tregon se cilat qenkan ato masa. Pra, ky term nuk sanksionon asgjë dhe nuk shpjegon asgjë.

Paragrafi 1.5 i po këtij neni, pra i nenit 3, i referohet Kodit Penal, nenit 265, 267, kurse në kërkojmë zgjerim të kompetencave, e jo dublifikime dhe referime në Kodin Penal.

Gjithashtu, edhe paragrafi 1.6 i referohet Kodit Penal, pra nenit 97.2.

Neni 6, kushtet për konfiskimin e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal, flet pra për afatin kur prokurori i shtetit mund të paraqesë kërkesë tjetër te gjyqtari. Pra, edhe ky nen u referohet kapitujve të Kodit Penal, kapitullit 15, 23, 24, 25, 34, por nuk rregullon asgjë.

Në po këtë nen, në paragrafin 1.2 thuhet: "Pasuritë tjera janë marrë pas 31 dhjetorit '99". Përveç që ky ligj nuk rregullon asgjë, praktikisht e shton një problem të ri, e ai është kufizimi i hetimit të Prokurorisë. Në legjislacionin e Kosovës nuk ekziston aktualisht asnjë kufizim kohor në hetimet e prokurorit. Kurdo që ka ndonjë dyshim të bazuar, ndonjë provë, edhe sikur vepra penale të ketë ndodhur 30 apo 20 vjet më herët, ai është i obliguar t'i nisë hetimet dhe t'i shtyjë ato deri në periudhën kur ka mundësi hetimi dhe si e sheh të arsyeshme.

Miratimi i këtij ligji, kështu siç është, pengon hetimin e vërtetë profesional të çdo prokurori. Përfytyrojeni një situatë, sikur prokurori i çështjes ta posedonte dokumentacionin, i cili i përket 31 dhjetorit 1998. Sipas këtij ligji, ai dokumentacion nuk do të konsiderohej provë dhe nuk do të ishte i vlefshëm. Ju, zoti ministër, duhet ta dini që për vlerësimin e kësaj çështjeje janë prokurorët dhe gjykatësit dhe ata i vlerësojnë dokumentet valide ose jo, që mund të merren si prova në një hetim, apo në një gjykim. Ju nuk mund ta paragjykoni të gjithë arkivin e dokumentacionit të Kosovës deri në vitin 1999.

Burim prove, për shembull, janë dhe mund të përdoren shitblerja, "Buona fide", rastet pa dokumentacion, kur ekziston dëshmitari, të dhënat nga regjistri kadastral, të dhënat e gjendjes civile, si dhe një seri dokumentacioni tjetër, që tregojnë për veprimtaritë e personave në Kosovë edhe më herët se viti 1999.

Duhet të kemi parasysh se gjithçka e rregulluar nga sfera e së drejtës civile është në fuqi dhe merret parasysh. Kështu, në konsiderojmë se kufizimi kohor i hetimeve nuk ka bazë

të vlefshme logjike dhe juridike. Madje, ne konsiderojmë që me këtë kufizim kohor kufizohen hetimet e prokurorit, që në fakt fsheh në brendësi një moratorium për gjithçka që ka ndodhur më herët, e si pasojë pasuria e dikujt, e vënë në mënyrë të kundërligjshme para 1998, amnistohet dhe kryesi nuk penalizohet.

Neni 6 si tërësi i referohet nenit 160, pra vdekja e të pandehurit, konfiskimi i përkohshëm, urdhri ndalues dhe përveç që është si rrjedhojë e nenit 160 të Kodit Penal, e përbën një problem, pasi e kanë lënë në mundësinë e gjyqtarit nëse do t'i vazhdojë hetimet, apo jo. Ligji duhet të shprehet qartë, në mënyrë që gjykata ta ketë të qartë, a konfiskohet pasuria e paligjshme e trashëguar, apo jo. Për ne, po duhet konfiskuar. Nëse mbetet kështu, kjo është një mundësi tjetër për amnisti.

Paragrafi 4 i nenit 7 i referohet kapitullit XV të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu neni 7 paragrafi 5 i referohet kapitullit XIX të Kodit të Procedurës Penale. Përfundimisht edhe neni 7 do të mund të përfshihej në Kodin e Procedurës Penale, e jo të bëhet një ligj me këto referime.

Edhe neni 8 i referohet nenit 157 të Kodit të Procedurës Penale. Neni 9 i referohet nenit 157. Pra, të gjitha këto i referohen Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, mirëpo nuk rregullojnë asgjë.

Ne nuk mendojmë që me këtë lloj ligjesh ndërtohet shteti i së drejtës. Përkundrazi, është e papranueshme që abuzuesit me pasurinë e popullit, bandat e krimit apo politikanë hajdutë të vihen në themel të shtetit tonë. Dhe, të gjithë ata deputetë që votojnë për këtë projektligj do të dalin hapur në mbrojtje të krimit dhe korrupsionit dhe se ata ose janë blerë dhe nënshtruar nga krimi, ose janë vetë krimi.

Përfundimisht, ne i përkrahim kërkesat e përfaqësuesve të shoqërisë civile që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë në mënyrë që ta përpilojë një ligj, i cili seriozisht e lufton krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe për këto arsye ne do të votojmë kundër këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

E dimë që ky projektligj ka qenë një nevojë imediate dhe njëherësh kërkesë për kompletimin e kornizës ligjore për një parandalim dhe luftë të suksesshme të krimit të organizuar.

Duke pasur parasysh se ky ligj është vonuar dhe punuar gjatë nga Qeveria, i gjithë spektri ka pasur të pritura të mëdha, por fatkeqësisht në formën në të cilën është sjellë nuk i përmbush të priturat e qytetarëve të Kosovës, e në veçanti jo të atyre që janë të interesuar që krimi i organizuar të parandalohet dhe luftohet në mënyrën më të suksesshme.

Nëse me të vërtetë dëshirojmë që ligjet e Kosovës të jenë në harmoni me konventat ndërkombëtare për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, e në veçanti, në ato që flitet për sekuestrim dhe konfiskim të pasurisë së përfituar nga aktivitetet kriminale, ky ligj shpresoj se në komisionin përkatës duhet të ketë ndryshime thelbësore. Duke u bazuar edhe në konventat në të cilat po thirremi vazhdimisht. Po e përmendi Konventën Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, Kombet e Bashkuara 2000.

Konventën e vitit 1988 kundër trafikimit të paligjshëm të drogave, narkotikëve dhe substancave psikotropike, Konventa e Vjenës neni 5, paragrafi 4.

Po ashtu, Konventën e vitit 2000 kundër krimit të organizuar transnacional, Unto, Konventa e Palermos neni 12, paragrafi 7.

Dhe, duke u nisur nga këto konventa, mendoj se Qeveria duhet t'i ketë parasysh edhe vërejtjet të cilat vijnë më poshtë.

Vetëm emërtimi i këtij ligji nuk përkon me atë që Kosova është dashur dhe është pritur ta draftojë.

Fushëveprimi i këtij ligji duhet të përfshijë përveç personave fizikë edhe personat juridikë, sepse shumicën e rasteve i kemi persona juridikë të involvuar në krim të organizuar dhe në kontrabandim.

Nëse dëshirojmë të parandalojmë e jo vetëm të luftojmë krimin e organizuar në këtë ligj, duhet gjithsesi të adresohet çështja e masës parandaluese.

Procedura e caktimit dhe zbatimit të masave parandaluese sipas këtij ligji duhet të jetë autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekteve të këtij ligji. Pra, ky ligj gjithsesi duhet të saktësojë se hetimet e integruara, si ato kriminale edhe ato financiare lidhur me të dyshuarit për nenet: 15, 23, 24, 25 dhe 34 të Kodit Penal duhet të kryhen paralelisht e jo t'i lihet afat prokurorit të shtetit vetëm 30 ditë, pas aktgjykimit të formës së prerë që me një kërkesë të paraqitur Gjykatës t'i ofrojë prova dhe shkak të bazuar.

Personit fizik apo juridik do të duhej që t'i ofrohet një afat i arsyeshëm për të paraqitur prova që pasuria është blerë nga të ardhurat legjitime gjatë fazës së hetimeve e jo sipas nenit 6, paragrafi 2 i projektligjit që ne e kemi para vetes.

Me këtë rast barra e provës është me të dyshuarin dhe kjo ka qenë ideja dhe kërkesa e të gjitha palëve të interesuara që nga fillimi i draftimit të këtij projektligji.

Ky projektligj gjithsesi duhet të rregullojë më mirë edhe çështjen e sekuestrimit të pasurisë që është e predisponuar për konfiskim me qëllim të parandalimit të tjetërsimit dhe humbjes apo fshehjes së gjurmëve.

Për këtë arsye edhe çështja e blerësit 'bonafide' duhet të rishikohet me kujdes.

Çështja e pasurisë së fituar nga aktiviteti kriminal jashtë vendit apo pasuria e fituar nga aktiviteti kriminal në Kosovë, por e transferuar në një mënyrë apo tjetër jashtë Kosovës, duhet të adresohet në këtë ligj.

Dikush mund të thotë se kjo çështje rregullohet me ndihmë juridike ndërkombëtare, por kur flasim për konfiskim dhe këtë ligj specifik mendoj se kjo çështje duhet të adresohet këtu.

Gjithashtu duhet të rishikohet neni 6 pika 1.2 që thotë: "Pasuritë tjera janë marrë pas dhjetorit 1999". Besoj se sponsoruesi do ta qartësojë se nga doli kjo datë, pse jo nga qershori i vitit 99? Dhe mund të them nga krejt vërejtjet që u dhanë edhe nga parafolësit më mirë është që ky projektligj t'i kthehet Qeverisë dhe të draftohet ashtu si duhet në mënyrë që të kemi vërtet luftë kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe po ashtu të konfiskimit të pasurisë të paligjshme që ka ndodhur në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Krasniqi!

Shefja e Grupit Parlamentar.

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Duke marrë parasysh u dhanë shumë sugjerime nga të gjithë deputetët këtu dhe fatbardhësisht që ministri edhe në prezantimin e vet dhe në dëgjimin e të gjitha kërkesave të deputetëve, besoj që gjithë rekomandimet që u dhanë nga të gjitha grupet parlamentare, do të hyjnë në shqyrtim në projektligj për arsye që të nxjerrët një projektligj i cili lufton korrupsionin dhe u mundëson policisë, prokurorisë, gjykatës që në mënyrë më efikase të zbatojnë këtë ligj.

Në rast se hyjnë të gjitha rekomandimet të cilat u dhanë këtu atëherë mund të themi se kemi nxjerr një ligj me standarde të BE-së dhe në bazë të rekomandimeve dhe kërkesave të Komisionit Evropian.

Në parim mund të themi se duhet të përmirësohet projektligji në rast se hyjnë të gjitha rekomandimet, atëherë besoj që edhe ministri do të jetë i kënaqur me sugjerimet dhe do të nxjerrim ligjin çfarë i duhet Kosovës në këtë moment. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, nuk ka. "6+", nuk ka. Atëherë vazhdojmë me diskutimet e deputetëve të paraqitur. Fillojmë me deputeten Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar! Unë dëgjova në shpjegimin e ministrit në lidhje me këtë projektligj dhe që tani mund të ju them se nuk e di se sa i besueshëm është ministri duke pasur parasysh se ai pak më përpara dha dorëheqjen për arsye morale dhe u kthye pa krijuar këtë bazë morale në të njëjtin post.

Por, gjithsesi më vjen mirë që ministri kohët e fundit ka filluar të lexojë Niçen, mirëpo e keqja është që ministri vepron sipas leksioneve të Makia Velit.

Tani t'i kthehemi ligjit.

Lëvizja “Vetëvendosje” ka pritur me interes të veçantë hartimin e Ligjit për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Ne kemi vlerësuar se ky ligj është domosdoshëm për shkak të korrupsionit në shkallë të lartë dhe krimit të organizuar i cili gjithsesi ka çadrën e vet edhe tek politika. Po kështu kjo ka qenë një kërkesë disavjeçare edhe e Komisionit Evropian, i cili në raportet e progresit pasurinë e paligjshme e kritikon ashpër. Edhe në studimin e fizibilitetit të Komisionit Evropian që doli dje, miratimi i një ligji të tillë është një nga kërkesat kryesore.

Mirëpo, çfarë ka ndodhur, pas një zvarritje të gjatë nga Ministria e Drejtësisë, më në fund projektligji është hartuar, por kështu si është më shumë bënë dëm se sa i shërben luftës ndaj krimit dhe korrupsionit. Në fakt ky projektligj është dëshmi e gjallë se Qeveria do të bëjë gjithçka për ta penguar luftën ndaj krimit dhe korrupsionit.

Të thuash se përmbajtja e tij është e pakuptimtë është pak, nenet e këtij projektligji janë bërë thjeshtë të padëshirueshme për secilin gjykatës a prokuror që nesër do të duhet të mbështetet në të.

Pra zoti ministër, gjuhësisht është tërësisht i papranueshëm dhe i pakuptueshëm.

Unë personalisht e kam lexuar 4-5 herë dhe nuk e kuptoja dot për shkak se fjalitë nuk janë në gjuhën shqipe.

Janë tri probleme themelore për sa i përket përmbajtjes që ka ky ligj, pra dhe që nuk i adreson.

Së pari, projektligji i cili titullohet Projektligj për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale, kufizon maksimalisht hapësirën për hetime dhe konfiskim. Pra, ky projektligj mund të aplikohet vetëm tek ata persona të janë nënshtruar një procesi gjyqësorë dhe më pas janë shpallur fajtorë.

Ku mbetën kështu qindra shkeljet e tjera të ligjit që bëhen çdo ditë nëpër tenderë apo shitje pasurish apo vepra të tjera penale.

Ky projektligj ja pamundëson Prokurorisë të hapë hetime ex officio mbi bazën e dyshimit. Ta zëmë, mediet shkruajnë ose vetë Prokuroria ose prokurorët venë re një person të caktuar i cili, pasuria e tij është e dukshme, për shembull ndërton pallate tepër luksoze, mirëpo të ardhurat e tij nuk përlligjen. Këto mund të jenë para të ardhura nga krimi, mirëpo askush nuk është duke u dyshuar për një çështje të tillë. Si do të mbetet puna me këtë person? A duhet të hapet rasti ex officio, apo jo? Unë besoj që po.

Së dyti, ky projektligj e ngarkon Prokurorinë me zbardhjen e së vërtetës për sa i përket të mirave materiale që dikush dyshohet se i ka përfituar në mënyrë të paligjshme. E në fakt të gjitha vendet që kanë një ligj të tillë e ngarkojnë palën e hetuar.

Problemi më i madh është përcaktimi i afatit kohor për krimin. Në pjesën më të madhe nuk do të ketë veprim retroaktiv, ndërsa për disa vepra penale në një tekst të padeshfrueshëm është lënë fundi i vitit 1999.

Është një shprehje që thotë se krimi nuk plaket. Ky projektligj amnistion të gjithë ata që kanë keqpërdorur për shembull Fondin e 3-përqindëshit, apo fondin “Vendlindja Thërret” të mbledhura gjatë luftës me qëllimin për të ndihmuar në çlirimin e Kosovës. Pra, profiterët e djeshëm do t’ia dalin pa u hyrë gjë në këmbë dhe sot pasuria e tyre do të shpërlahet nëse nuk është shpërlarë, gjë që po ndodhë, besoj jemi gjithë dëshmitarë, ndërsa nesër ata do të konsiderohen të ligjshëm. Kjo në fakt është pikërisht filozofia e mafisë, ekonomia gri e cila është pranishme në Kosovë është rezultat i kësaj filozofie.

Më lejoni tani t’i lexoj vërejtjet që kanë ardhur nga disa organizata që e kanë kundërshtuar fuqishëm projektligjin dhe vërejtja tyre kryesore është që ndryshe nga që thotë ministri, ato nuk kanë qenë të pranishme, pra nuk kanë marrë pjesë në hartimin e projektligjit dhe mendimet e tyre nuk janë marrë parasysh. E kam fjalën për Asociacionin e Kriminalistëve të Kosovës, Organizata Çohu, Lëvizja Fol, Instituti GAF, Iniciativa Kosovare për Stabilitet, Iniciativa për Progres, Instituti Demokratik i Kosovës, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Rinjve të Njeriut, Qendra për Politika dhe Avokim.

Sipas një letre, të cilën na e kanë drejtuar, sot besoj të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës thuhet kështu: “Duke u nisur nga fakti se miratimi eventual i këtij ligji në formën që është në asnjë rast nuk garanton luftimin efikas të krimit të organizuar dhe korrupsionit, por vetëm është një kopje jo edhe aq e mirë e ligjeve penale ekzistuese, ne forumi i organizatave joqeveritare ju rekomandojmë që këtë draft të këtij projektligji t’ia ktheni Qeverisë për rihartim, sepse me miratimin eventual në parim të këtij projektligji nuk do të ishte shumë e mundur që të inkorporohen rekomandimet substanciale dhe të domosdoshme që t’ia ndryshonin përmbajtjen.

Ju njoftojmë, thotë se edhe në fazat fillestare të draftimit të këtij projektligji, kemi qenë pjesë e grupit punues fillestar, por asnjë nga rekomandimet tona nuk janë marrë parasysh nga sponsoruesi që është Ministria e Drejtësisë. Qëndrimet e Forumit janë si në vijim.

Së pari, duhet ndryshuar emri i draftligjit, i cili në të njëjtën kohë reflekton në fushëveprim dhe qëllimin e këtij draftligji. Forumi rekomandon që kualifikimi pasuritë e fituara me kryerjen e veprës penale të ndryshohet me pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme, pra edhe për rastet kur nuk ka të bëjë me vepër penale.

Së dyti, bëhet fjalë për barrën e provës për të vërtetuar ligjshmërinë e pasurisë së fituar që të bjerë mbi të dyshuarin, e jo sipas detyrës zyrtare.

Së treti ky draftligj do të duhej të zbatohet edhe për pasuritë e fituara në mënyrë të paligjshme të personave të dyshuar, të krijuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Sugjerohet gjithashtu krijimi i mekanizmave të veçanta brenda institucioneve ekzistuese: polici, prokurori, gjykata me qëllim të zbatimit më efikas të legjislacionit të kësaj fushe.

Ajo që dua t'i them propozuesit të këtij ligji është që një nga vërejtjet kryesore që vazhdimisht vjen nga Komisioni Evropian, është bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe në bazë të kësaj letre që ne na është drejtuar si deputetë shihet që mendimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile është injoruar plotësisht. Ndoshta ministri mund të na sqarojë këtë pse, mirëpo besoj që vërejtjet e tyre janë me vend dhe do të duhej të ishin marrë parasysh. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit! I nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të provoj të mos e zgjas për arsye se ministri shumë qartë dhe në mënyrë shumë precize e shpjegoi dhe e arsyetoi rëndësinë e këtij ligji. Mirëpo, konsideroj që ky ligj është dashur të miratohet qysh në legjislaturën e parë të këtij Kuvendi, sepse mund të merrni me mend se sa persona kanë përfituar pasurinë në mënyrë të paligjshme që nga viti 1999 e disa nga ata janë dënuar për vepra të caktuara penale, por pasurinë e tyre e fituan në mënyrë kundërligjore kanë mbetur në pronësitë e tyre dhe të trashëgimtarëve të tyre.

Te kjo situatë ka ardhur sigurisht për arsye, sepse prokurorët tanë nuk kanë pasur mundësi ligjore që t'ua konfiskojnë pasurinë e krijuar në mënyrë kundërligjore dhe ata tani pothuajse e kanë legalizuar atë pasuri të përfituar në mënyrë kundërligjore.

Është e qarë se qëllimi i këtij ligji dhe i hartuesit është për të krijuar një mekanizëm të saktë juridik për konfiskimin e pasurisë së fituar nga personat që kanë kryer vepër penale, kur procedurat penale nuk janë të mjaftueshme.

Të nderuar kolegë deputetë,

Prej legjislaturës së parë e deri më tani janë dënuar me dhjetëra persona për vepra të ndryshme penale si krim të organizuar, zhvatje, tregti me narkotikë, për fajde e të tjera, e të cilët janë pasuruar në mënyrë të paligjshme, por nuk ka pasur mekanizëm juridik përmes të cilëve atyre do t'u ishte konfiskuar pasuria e krijuar në mënyrë të paligjshme.

Andaj, shtyrja e miratimit të këtij ligji do të krijonte hapësirë për personat që kanë përfituar pasurinë në mënyrë të paligjshme e të cilët do të dënohen për vepër penale të mos u konfiskuar pasuria. Andaj, shtyrja do të thotë shtyrje me avazin që këta persona të vazhdojnë të përfitojnë në mënyrë kundërligjore.

Konsideroj se ky ligj mes dy leximeve do të plotësohet dhe do të amendamentohet, ndërsa konsideroj që ne duhet të japim mbështetjen për kalim në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Krasniqi.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Kur dëgjuam për përpilimin e këtij projektligji do të thotë për Projektligjin për trajtimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme sikur u ndez një dritë shprese që më në fund të bëhen hapat e parë në zbardhjen e kësaj dukurie që ka përfshirë shoqërinë tonë. Por, tani jemi të shqetësuar për sjelljen e këtij projektligji në këtë mënyrë dhe në këtë formë.

Ndoshta, zoti ministër do t'i kishte rënë më tamam po që se do të ishte Projektligji për konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme dhe jam i sigurt që do t'i kishte rënë shumë më tamam se sa ashtu siç e keni proceduar ju.

Ky projektligj nuk e lë mundësinë e verifikimit të pasurisë ekzistuese të grupeve të veçanta kriminale e në veçanti të personave publikë të cilën gjë e bëjnë të gjitha shoqëritë e civilizuar dhe demokratike në botë.

Me këtë projektligj amnistohet pasuria e paligjshme e gjithë personave që prej luftës e këndeje janë pasuruar me miliona nga hiq gjë. Pa marrë parasysh se çka vendos Parlamenti, ky projektligj nuk e arsyeton dedikimin e përpilimit të tij.

Me miratimin e këtij projektligji ne nuk e kryejmë detyrën tonë në këtë segment. Kjo problematikë është nju gur i sprovës në raport fillimisht me qytetarët e vendit dhe në raport me gjithë organizmat ndërkombëtarë që kanë vënë pikë të zezë trajtimin e korrupsionit dhe krime të organizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale që na është ofruar nga Ministria e Drejtësisë e të cilin po e diskutojmë sot, është i mbarsur me shumë kontradikta dhe paqartësi sa i përket çështjeve themelore që adreson.

Pajtohem me shumicën e parafolësve po ashtu edhe të aktorëve të tjerë të cilët janë marrë me këtë dukuri se vetë titulli i projektligjit mbetet problematik. Pra, në vend se të ishte emërtuar si Projektligji për konfiskimin e pasurisë në mënyrë të paligjshme na është ofruar një titull i çuditshëm si Projektligji për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale. Si do qoftë nëse ky projektligj kalon në këtë formë çfarë ne jemi duke e diskutuar, ka rrezik që të përmbysë logjikën në bazë juridike për ndërtimin e një shoqërie demokratike sipas premisave normative të shtetit të së drejtës.

Është më se e qartë se miratimi i këtij projektligji ishte pritur për një kohë të gjatë në këtë mënyrë shpresohet se më në fund, në sajë të forcës së ligjit do të krijoheshin rrethanat juridike për ndëshkimin e të gjitha atyre të cilët ndër vite në mënyrë të paligjshme akumuluan padrejtësisht kapital të pambuluar.

Mirëpo, shihet qartë se në vend të realizimit të këtyre synimeve, ky projektligj paradoksalisht nëse kalon në këtë mënyrë u ofron mbrojtje ligjore të gjithë atyre që veprimtarinë e tyre e ndërtuan në mënyrë të jashtëligjshme.

Pra, duke abrovuar efektin e retroaktivitetit mbi këtë kategori të shoqërisë Ministria e Drejtësisë na ofron një zgjidhje bizare, ku për herë të parë synohet që me anë të rregullave juridike të mbrohet dënuesi dhe të ndëshkohet viktimja. Në këtë kontekst kjo politikë promovon edhe një model tjetër çoroditës sa i përket ndarjeve shoqërore në Kosovë në ata që janë mbi ligjin e që arrijnë të gëzojnë mbrojtje prej tij dhe në ata që veprojnë në përputhje me ligjin, por nuk gëzojnë mbrojtje prej tij.

Pra me këtë logjik të pa precedent juridike që na ofron Qeveria e Kosovës konkretisht Ministria e Drejtësisë, përfundimisht instalohet kultura e krimit dhe mosdënimi.

Sidoqoftë dilema tjera që e shoqërojnë strukturën e këtij projektligji mbesin padyshim edhe ato që kanë të bëjnë me nene që pretendojnë të ndërlidhen me përfitimin e pasurisë së paligjshme vetëm mbi bazën e veprës penale, sepse ka raste ku mund të thuhet se është shumë e vështirë apo mos të them e pamundur që të vërtetohet lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet fitimit të një pasurie dhe një veprë të caktuar penale. Prandaj, pa këto elemente esenciale siç janë kundërligjshmëria, retroaktiviteti dhe barra e provës ku ky projektligji do të jetë pjesë e një ligji të kotë dhe vetëm sa do të krijojë dualizëm ligjor ose koluzion ligjor në mes të këtij ligji dhe Kodit Penal.

Prandaj, kalimi i këtij projektligji në këtë formë dhe përmbajtja që aktualisht e përmban jo vetëm që nuk ndihmon në luftimin e krimit të organizuar dhe konfiskimin e pasurive të fituar në mënyrë të paligjshme, por si i tillë ai shndërrohet në një paravan juridik që e legalizon krimin e organizuar dhe korrupsionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur.

Fjala është e përfaqësuesit të Qeverisë, fjalën e ka zoti zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë, zoti Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,

Unë do të filloj pak prej zonjës Alma.

Para një viti e diçka Alma kemi biseduar për ligj dhe më ke dhënë komplimente, do të thotë ja kam nisë më herët ta lexoj jo tash kur po thua dhe po më vjen keq që Makiavelin e ke lexuar vetëm një fjali e jo më shumë dhe Makiaveli. Dhe unë po e them kështu sa i

përket neneve të famshme kam menduar Alma që të kam aleat në këtë drejtim, natyrisht që besoj që do të vazhdosh të jesh aleate s'ke bërë vetëm politikë.

Ajo çka mund të them është që ju e pranuat vetë që ka pasur OJQ në këtë grup punues dhe unë s'e kam pranuar vetëm një kërkesë të OJQ-ve, që barra e provës të mbetet mbi të dyshuarin apo të pandehurin, por kam thënë që ajo duhet të ndahet për shkak të specifikave që i përmenda.

Por është një fakt këtu që besoj të gjithë duhet të pranojmë, në këtë vend ka mundësi të ngritë padi civile, kushdo që dëshiron për dikën që ka dilema ta ngritë padinë civile, prokurori vihet në lëvizje. Dhe mos ia veni barrën dikujt sikurse po përmendet emri i ligjit ose kështu me radhë.

Nëse më lejohet në mënyrë laksative, ndoshta nuk më kujtohet, por Kodin Penal po e citoj kështu- thotë: "Kushdo që fiton pasuri të paligjshme dënohet. Pasuria e tillë konfiskohet". Kjo gjithmonë ka qenë nuk ka nevojë këtë ligj ta zbulojmë ne që prej sot po fillonim t'ia konfiskojmë dikujt pasurinë dhe po ashtu dua t'ua them të gjithëve, nuk e mbron ky ligj askënd. Është ofendim t'i thuash deputetëve të Kuvendit, apo Qeverisë apo dikujt tjetër po nxirni ligje që e mbrojnë krimin e organizuar.

Dhe një institut tjetër që u përmend prej disa, në veçanti më vjen keq prej atyre që janë juristë, forma retroaktive. Mos harroni që është një institut i parashkrimit, ata që janë juristë e dinë dhe instituti i parashkrimit është për të gjitha veprat penale. Ka një afat kohor edhe në Amerikë, edhe në Kosovë edhe në BE edhe kudo tjetër që pas një afati kohor parashkruhen veprat penale. Dhe ne nëse dom, mua personalisht, fillojnë prej vitit 1970 - 1971 kur kam lindur, por ne duhet të kem parasysh nuk guxojmë një popull ta vënë në hetime, unë s'e marrë atë barrë. Urdhëroni, merrni ju deputetë, bëni ligjin cilindo që e bëni ju, unë do ta respektoj 100%. Krejt vërejtjet çka u thanë sot me 3 - 4 amendamente ndërrohen, domethënë pajtohem me ato amendamente.

Unë dua të them një, 22 ligje janë që i kam sjell në Kuvend prej se jam ministër i Drejtësisë, e këto kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Dhe merrni ligjet krahasoni me Shqipëri, zonja Alma, që nuk janë 50% dënimet, masat ndëshkuese më të rrepta se në Shqipëri, ose në cilindo vend të rajonit, ejani bisedoni me mua. Edhe unë po e them po ashtu kushdo që do të jetë në Kuvend, pas dy mandateve, ju deputetë të nderuar kushdo që do të jetë, do të kërkojë ta zvogëlojë dënimin. Dhe unë po e marrë një shembull, ne e kemi miratuar një Kod Penal, mos deklarimi i pasurisë, kemi thënë është vepër penale dhe pasuria që është deklaruar rrejshëm apo nuk është deklaruar, konfiskohet. A e dini çka do të thotë deputetë të nderuar kjo? Prokurori dhe gjyqtari do të funksionojnë dhe ne secili do ta ndiejmë barrën - individë edhe ata 74 që s'e kanë deklaruar, tash zyrtarë publikë edhe të tjerët, por ta keni të qartë edhe ai që e deklaron rrejshëm apo nuk e deklaron i konfiskohet, është masë shumë e rëndë e dënimit.

Po ashtu çka dua të them, ky ligj nuk guxon të lexohet vetë, duhet të lexohet me Kodin Penal, me Kodin e Procedurës Penale. U përmend nga zoti Isufi edhe nga disa të tjerë

Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve ekziston në këtë vend, është miratuar nga ju deputetë të nderuar dhe është në funksion.

Përgjegjësia penale e personave juridikë është miratuar ligji dhe është në funksion. Ligji për mbrojtjen e informatorëve është në funksion, domethënë të gjitha këto ligje, Ligji për deklarimin e pasurisë dhe prejardhjen e pasurisë së funksionarëve publikë, është në funksion. Dhe, ne tani duhet ta gjejmë fuqinë që tha zoti Selimi të implementimit të tyre. Dhe po e them një fakt, të gjithë ne që e mbajmë në mend dhe kemi lexuar nga pak sistem juridik dhe të tjerët që janë më në moshë, asnjëherë në këtë vend prokurorët dhe gjyqtarët s'kanë pasur instrumente më të forta ligjore se tash ta luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin, asnjëherë po e përsëris, të gjithë le të më reagojnë prokurorët dhe gjyqtarët nëse thonë që ka qenë ndonjëherë, asnjëherë gjatë historisë dhe tani duhet ta implementojmë këtë.

Çështje tjetër, çka është? U përmend çështja e vullnetit, unë mendoj që ditën që është sjellë ky ligj, nuk është kërkuar nga askush, unë e kam propozuar, nuk është kërkuar as nga Kuvendi, as nga shoqëria civile, po shoqëria civile kanë qenë e përmendi edhe Alma, deri në fund, në fund janë larguar. Po shoqëria civile është dëshpëruar me një fakt, se tre ekspertë gjermanë, që pajtohem me profesor Demollin, që ka vërejtje terminologjike, edhe me zonjushën Gashi, ka vërejtje, se është përkthyer prej gjuhëve të huaja. Tre ekspertë gjermanë e kanë punuar këtë ligj. S'e kam punuar unë. Do të thotë, e kanë punuar sipas kriterëve të BE-së dhe besoj se e keni letrën mbështetëse që ata thonë - është në përputhje të plotë me kriteret e BE-së.

Nuk është një ligj që unë dua ta tremb dikë, por as nuk jam gardian i këtij ligji. Lirisht, si t'ua merr mendja, ndërrojeni, shtone, merreni cilindo ligj në botë që ua merr mendja, mund t'i shkojmë deri në fund.

Ajo çka dua të them është se u përmendën vërejtjet te barra e provës. Unë mendoj se është bërë mirë që është ndarë barra e provës te i dyshuari dhe prokurori. Prokurorët le të jenë pak më aktivë, të dyshuarit pak më aktivë që ta mbrojtur veten dhe në këtë drejtim besoj që bëhet balancë mes lirive e të drejtave të njeriut dhe mes atyre organeve të ndjekjes që i quajmë ne.

U përmend terminologjia, që e tha zonjusha Gashi - antimafia. Në botë i thonë Ligji antimafia. S'e ka emrin antimafia, por ky është ai ligji antimafi, nëse veç po ju intereson, po ajo është terminologji që në zhargonin politik i thonë antimafi ose diçka tjetër.

Dhe u përmend çështja që ka të bëjë edhe me komisionet përkatëse. Unë mendoj se zoti Isufi dhe të tjerët që e përmendën, dhe po më vjen keq që nuk është këtu. Komisioni përkatës për çështje legjislative, le ta punojë, le ta shtojë, le ta heqë. Qeveria, gjithmonë e ka parasysh opinionin publik, interesin e vendit dhe qytetarëve në radhë të parë dhe mendimin e ekspertëve. Dhe unë, qysh po i dëgjoj disa këtu, nuk dallojnë prej asaj që kanë thënë ndonjëherë që s'janë juristë.

Unë ndikohem shumë nga opinioni publik kur kam të drejtë, por kur është interesi i vendit, nganjëherë edhe i rezistoj, kam dëshirë t' i rezistoj. Dhe atë çka përmendët ju, të gjitha nenet e shoqërisë civile, vëni në ligj dhe unë i pranoj. Merrni, zonja Alma, vëni në ligj dhe unë të gjitha do t'i pranoj, por ta kemi parasysh një- ato nene duhet të implemtohen.

Dhe një fakt, që duhet ta kemi parasysh të gjithë, nganjëherë njerëzit, edhe të shoqërisë civile, që i përmendët ju, kur flasin për ligje kanë parasysh fotografitë e nja 20 vetave në Kosovë, 10 vetave ose 50-ve. Ligji bëhet për 2 milionë, edhe për shoqërinë civile, bëhet edhe për atë qytetarin që ai është në katund dhe nuk e di tokë e babagjyshit qysh e ka marrë, por bëhet edhe për atë që e ka marrë në mënyrë të paligjshme.

U përmend 31 dhjetori. Pse është caktuar? Ne mendojmë se deri më 31 dhjetor, më 1 janar ose 15 janar 2000 është ndërtuar Këshilli i Përkohshëm Administrativ. Kështu është thënë. Nëse mendoni 12 qershor, shkojmë me 12 qershor. Nëse mendoni në vitin e 90, shkojmë në vitin 90. S'e kemi asnjë problem. Vetëm një problem e kemi, që veprat penale parashkruhen. Jo vetëm kjo, edhe rastet e tjera.

Unë dëgjova diskutimin që disa thoshin pas 30-ve e disa pas dyfishit, disa më pak. Zoti Gashi, besoj se këtu jemi të qartë. Zoti Kasolli, e tha pak, unë besoj që edhe për shkrim gazetaresk është e rëndë. Po ua përmend emrin me qëllim. Mos thuaj se po mbrohen me ligj korrupsioni dhe krimi i organizuar. Mos thuaj, se ju keni me e miratuar. Dhe pas 10 vjetëve, kur ta shkruan historinë dikush në këtë vend, nuk ka bë ky Kuvend, kurrë asi. Mund të ketë individë dhe kudo në botë, thuaj hajde ta përmirësojmë ligjin si bëhet më mirë. Vullneti i Qeverisë ekziston për me i pas të gjitha gjërat, por po e them po ashtu që vullneti i Qeverisë nuk është me bë ligje të cilat pas një viti duhet t'i ndërrojmë.

Ne kemi bërë ligje dhe po e marr një shembull. Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve, e kemi miratuar. Zoti Gashi, besoj e kujtohet, ka bërë vërejtje për buxhetin e atij ligji, se i kërkon 7 milionë buxhet. Mesatarisht 7 milionë në vit. E kemi bërë ligjin, kemi filluar ta implementojmë këtë ligj, kemi pasur problem me buxhet.

Por, për rastin konkret s'kemi asnjë telashe. Dhe nuk duhet të dalim këtu, se janë disa njerëz që po donë me e mbrojtur këtë, disa tjerë nuk po donë me e mbrojtur. Jo! Do ta mbrojmë të gjithë së bashku sepse e kemi obligim para qytetarëve të Republikës.

Unë jam shumë i bindur që drafti që propozohet është i mirë. Po e përsëris prapë, të jetë për qytetarët, jo vetëm për shoqëritë civile, se ekspertët gjermanë e kanë lexuar para shoqërisë civile, ia kanë dhënë me shkrim, ma kanë përgatitur 3 ekspertë gjermanë që i ka paguar Komisioni Evropian. I kam paguar vetëm përkthyesit si Ministri. Ligji është i gjermanëve. Nuk e kam bërë unë, e ka bërë dikush tjetër. Dhe çka i bie kjo? Kjo i bie që ju po e vini në dilemë që e ka punuar Qeveria, e kanë punuar 3 veta. Fare s'e ka punuar Qeveria, por 3 veta.

Dhe krejt çka dua të përfundoj, me këtë fakt, më lejoni të them se ne sa herë që bëjmë ligje në këtë vend, besoj edhe sa herë miratojmë, nuk i bëjmë për hatër të dikujt e as për inat të dikujt tjetër.

Ligji bëhet edhe për kohën kur je në pozitë, edhe për kohën kur je në opozitë. Ligji bëhet edhe për kohën kur je shëndosh, edhe kur nuk je bash shëndosh. Dhe unë mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm për trajtim të barabartë.

Në vendin tonë ekzistojnë parime juridike që barazohet barra e provës në mes të atij që akuzohet dhe atij që mbrohet.

Unë jam i interesuar ligji të zbatohet deri në fund, por jam i interesuar edhe me mbrojtur qytetarët e Republikës së Kosovës nga çdo lloj i mundësisë së abuzimit me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se në sallë janë 76 deputetë.

(Reagime)

Është kryer debati. Janë 81 deputetë....

(Reagime)

S'ke të drejtë në replikë. Janë 81 deputetë dhe tani e votojmë ligjin. Regjia të bëhemi gati për votim. Votojmë tash!

(Reagime)

Çka ke pasur e ke thënë, 10 minuta ke diskutuar.

Faleminderit! Konstatoj se me 41 vota për, 30 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ftoj zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,
Më lejoni që para jush të paraqes për miratim Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Pas analizimit dhe funksionimit të sistemit të provimit të jurisprudencës në Republikën e Kosovës dhe në gjitha shtetet e rajonit, pranimit të rekomandimeve dhe i sugjerimeve nga ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, Ministria e Drejtësisë, në koordinim të plotë edhe me aktorët tjerë, ka ardhur në përfundim se duhet ta amendamentojë Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Me këtë projektligj janë bërë ndryshime të cilat kanë qenë të nevojshme për t'i evituar pengesat dhe sfidat e identifikuara gjatë mbajtjes së këtij provimi dhe po ashtu për të avancuar edhe më lartë përmbajtjen e këtij provimi të jurisprudencës dhe për ta kompletuar atë që ne kërkojmë për të përgatitur kuadro më të mira për gjyqësorin, prokurorinë, avokatinë dhe sistemin e drejtësisë në tërësi.

Me këtë projektligj janë përcaktuar dispozitat që kanë të bëjnë me kushtet, kriteret, procedurën, programin, dhënien si dhe vlerësimin e provimit të jurisprudencës, organizimin e provimit, përbërjen dhe emërimin e funksionit për Komision për verifikim dhe vlerësimin e aftësive teorike dhe praktike të juristëve.

Unë besoj se ndryshimet e tilla janë në përputhje të plotë edhe me kriteret e BE-së, mundësojnë që të kemi një provim të jurisprudencës adekuat dhe ju ftoj që ta miratoni në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, fjalën e ka kryetari i Komisionit për Legjislacion, zoti Gashi. Urdhëroni!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën!

ISMET BEQIRI: Jo, unë kërkoj në emër të Grupit që seanca të kryhet dhe të vazhdohet nesër.

KRYESUESI: Ne e kemi filluar këtë pikë, e përfundojmë dhe pastaj vazhdojmë nesër.

ISMET BEQIRI: Unë e bëra kërkesën, që kam të drejtë.

KRYESUESI: Zoti Gashi e ka fjalën. Nuk e do fjalën.

Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së, Arsim Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për provimin e jurisprudence dhe ne i japim përkrahje parimore. Esenca e këtij ligji qëndron në krijimin e strukturave shumë efektive për organizimin e provimit të jurisprudence. Mendoj se kjo është jashtëzakonisht pozitive, sepse ka pasur probleme rreth emërimit të Komisionit për provim të jurisprudence dhe jemi të sigurt se me këto ndryshime do të funksionalizohet.

Ky proces është shumë i rëndësishëm për përgatitjen e kuadrove të reja për gjyqsor.

Njëkohësisht dëshiroj t'i rekomandoj ministrit që krahas këtij Projektligji të fillojë ta reformojë edhe Doracakun për dhënien e provimit të jurisprudence, sepse doracaku aktual është shkruar para pavarësisë së Kosovës dhe bazohet shumë në ligjin e zbatueshëm.

Unë kam biseduar me ministrin dhe e kam parë vullnetin e tij që ai menjëherë pas miratimit të këtij projektligji të fillojë ta reformojë Doracakun për provimin e jurisprudence, në mënyrë që ne të përgatisim gjykatës dhe prokurorë me standarde ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu është paraqitur nga Grupi "Vetëvendosje".

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Ne jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji, sidomos në kohën kur shumë kandidatë janë në pritje për paraqitjen e provimit të jurisprudence, edhe pse në dijeni të kësaj rëndësie, Projektligji i sjellë nga Ministria e Drejtësisë, lë shumë për të dëshiruar.

Ajo çka është më e rëndësishmja është se me këtë projektligj nuk do të mund të sigurojmë që në të ardhmen provimin e jurisprudence do ta kalojnë kandidatët që janë profesionistë të vërtetë.

Nëse e analizojmë projektligjin me vëmendje, vërejmë që ky proces varet drejtpërsëdrejti nga ministri i Drejtësisë. Pra, ministri organizon provimin e jurisprudence, emëron kryesuesin dhe anëtarët të Komisionit për dhënien e provimit të jurisprudence. Gjithashtu ministri nxjerr vendimin se a i plotëson kushtet një kandidat apo jo, si dhe nivelin e pagesës për provimin e jurisprudence e vendos po ashtu ministri.

E gjithë kjo mendoj se shumë lehtë mund të konsiderohet si një lloj ndërhyrjeje e ekzekutivit në tërë këtë proces, andaj në rrethana normale, do të duhej që të hartonim një ligj i cili e themelonte shkollën e veçantë për këtë çështje, e cila do të kishte këshillin e saj drejtues, në përbërje të së cilës do duhej të ishin kryetari i Gjykatës Supreme, Këshilli Gjyqsor, Këshilli Prokurorial, dekani i Fakultetit të Drejtësisë dhe drejtuesi i Odës së Avokatëve.

Një qeveri, përkatësisht ministri e Drejtësisë, e aftë dhe serioze, do të propozonte diçka të ngjashme e cila është lehtësisht e organizuar, por mbi të gjitha është e drejtë, funksionale dhe profesionale.

Pra, është logjikë e mbrapshtë, por edhe e qëllimshme që t'i lihen këto të gjitha ministrit të Drejtësisë.

Më tej do të vazhdoj me analizën e neneve të këtij projektligji.

Në nenin 4, paragrafi 2 thuhet: “Komisionit i takon shpërblim për kompensim për punën në Komision”. Mendoj që fjala “shpërblim” është e gabuar pasi që anëtarët e Komisionit duhet të jenë përgjegjës për punën që e bëjnë, andaj ata nuk duhet të shpërblehen, por duhet të kompensohen.

Sa i përket nenit 5, ka pasur mjaft diskutime si me studentë, shoqërinë civile e shumë të tjerë dhe për ne si subjekt është i papranueshëm pasi që thotë se programi katërvjeçar ka të drejtë ta paraqesë provimin menjëherë pas përvijës së punës, ndërsa ai trevjeçar pas përfundimit të masterit.

Kjo është një shkelje e të drejtave të mijëra atyre studentëve që kanë përfunduar studimet me sistemin trevjeçar kur e dimë faktin që sistemi trevjeçar ka qenë në përputhje me reformat e sistemit të Bolonjës dhe reflekton ecjen në përputhje me trendët e arsimit të lartë në Evropë.

Gjithashtu, po këta studentë kanë dhënë të njëjtat provime sikurse ata me sistem katërvjeçar.

Mendoj se duhet ta analizojmë këtë çështje pasi kjo bëhet edhe më e rëndë kur atyre që kanë studiuar jashtë u kërkohet vetëm nostrifikimi i diplomës.

Pra, jemi kundër këtyre diskriminimeve që po bëhet, andaj kjo çështje duhet të ndryshohet në atë mënyrë që nuk do të diskriminojë askënd në të ardhmen. Pra, mendojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte 3 plus 2 dhe 4 plus 1.

Tek po ky nen, pra te neni 5, ku flitet për kushtet e paraqitjes së provimit të jurisprudencës, në paragrafin 5 thuhet: “juristët e diplomuar që kanë titull shkencor, doktorë të shkencave juridike dhe 5 vjet përvijë pune në organet e administratës, u njihet provimi i jurisprudencës dhe i gëzojnë të gjitha të drejtat e parapara me ligj”.

Mendoj që duhet ta analizojmë përvijën e punës, pra ta zgjerojmë listën, më konkretisht dhe të parashihen profesione që janë relevante në mënyrë që t'u njihet provimi i jurisprudencës.

Në nenin 11 paragrafi 4, thuhet: “lartësinë e pagesës për paraqitjen e provimit të jurisprudencës, e cakton ministri me vendim”.

Mendoj se nuk duhet t'i lihet ministrit që në mënyrë arbitrare të caktojë këtë pagesë. Kjo duhet të precizohet se në çfarë baze bëhet lartësia.

Më tej, në nenin 11, paragrafi 8 thuhet: “Vendimin për suksesin e arritur e miraton Komisioni me shumicë votash”.

Pse duhet të ketë votim për derisa vendimi duhet të nxirret varësisht nga sukcesi dhe pikët e grumbulluara?

Kjo duhet të riformulohet në atë mënyrë që të mos ketë votim, por vendim në bazë të pikëve, pa votim. Kjo gjë përsëritet edhe te provimi me gojë dhe duhet të ndryshohet.

Në nenin 17, ku flitet për riprovimin, paragrafi 6, thuhet: “Kandidati i cili vlerësohet nga komisioni provues se nuk e ka dhënë provimin, mund ta përsëris dhënien e provimit brenda afatit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 6 muaj nga data kur i është komunikuar nga komisioni se nuk e ka dhënë provimin”.

Dhe, 7: “Kandidati i cili nuk e jep provimin për të dytën herë, mund ta përsërisë dhënien e provimit brenda afatit, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 12 muaj”.

Për vlerësimin tonë ky nen është skandaloz dhe nuk do të duhej që njerëzit të kufizohen në këtë formë se sa herë do t'i nënshtroheshin testit. Ndoshta, zgjidhja më e mirë do të ishte pagesa e dyfishtë apo diçka e ngjashme, por jo barrierat e tilla strukturore të cilat i pamundësojnë dikujt që të riaplikojë për dhënie të privimit.

Pas këtyre vërejtjeve që i përmenda, vërejmë se me këtë projektligj po tentohet që të pengohen gjeneratat e reja që të arrijnë ta kalojnë provimin e jurisprudencës dhe me këtë formë t'i konkurrojnë njerëzit që sot mbajnë një lloj monopoli në drejtësinë tonë.

Për fund, ne do të abstenojmë në këtë fazë, pasi që çështjet që i përmenda, konsiderojmë që janë të rëndësishme, për të cilat do të insistojmë që të ndryshohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, në emër të AAK-së.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe duke ditur rëndësinë e këtij projektligji, ne do ta përkrahim në parim dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin përkatës gjatë amendamentimit të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Amir Ahmeti, në emër të Koalicionit Kosova e Re.

AMIR AHMETI: Faleminderit, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Fillimisht e mirëpresim Projektligjin për provimin e jurisprudencës, që ka ardhur në Parlament.

Në parim, Koalicioni për Kosovë të Re do ta votojë këtë projektligj, por sikur që kemi diskutuar në Komisionin për Legjislacion, edhe këtu do t'i japim disa sugjerime tona për amendamentimin e këtij projektligji.

Tek neni 5, pika 1.2 dhe pika 1.3 kanë mundësi të ndahen dhe të vijë një pikë tjetër, sepse përsëritet pika 1.2 dhe 1.3. Fillimi i saj na përsëritet dhe ka mundësi të ndahet në 3, sepse është i njëjti kusht.

Pastaj, një gabim që është profesional, dhe nuk guxon të mbetet këtu, dhe është mirë ta përmendim.

Është te neni 11: “dhënia e provimit”. Është shumë interesant se në pikën 8 të nenit 11 thuhet: “Vendimin për suksesin e arritur në provim me shkrim e miraton Komisioni me shumicë votash”.

Mendoj se kjo është në kundërshtim me nenet 12, 13 dhe neni 14 në të cilët jepen qartë mënyrat se si fitohen pikët, sepse pika 9 e nenit 13 thotë: “Komisioni vlerëson rezultatin e kandidatit në mënyrë komulative me pikët e arritura apo të grumbulluara” që në nenin 14 caktohen, për shembull E Drejta Civile, Tregtare, 10; E Drejta e Procedurës Kontestimore dhe Familjare 10 pikë, dhe kështu me radhë.

Ndërsa pika 8 e nenit 11 thotë: “Komisioni e miraton me shumicë votash”. Me fjalë tjera, nëse pikët i arrin kandidat, por nëse Komisioni nuk dëshiron ta votojë, atëherë del problem votimi ose fitimi i provimit të jurisprudencës, mendoj se kjo mund të amendamentohet dhe të ndryshohet.

Pra, në përgjithësi projektligji është i mirë, i përpiluar me një gjuhë juridike të pranueshme dhe parimisht do ta votojmë. Shpresojmë që edhe gjatë amendamentimit të japim kontributin tonë si deputetë dhe të miratohet në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të konstatojmë se sa është prania. Faleminderit!

Në sallë janë 62 deputetë. Përfaqësuesi i Qeverisë, a e dëshiron fjalën? Faleminderit!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, e di që jeni lodhur, por kemi nevojë jo vetëm për sqarime për ju që jeni sallë, e nganjëherë edhe për opinion publik, sikur që po i marrim edhe kritikën.

Fillimisht, falënderoj profesor Bajramin për sugjerimin e tij. Ne jemi pajtuar, profesor, që ta hartojmë doracakun pas miratimit të këtij projektligji, por edhe të Kodit Penal, të Ligjit për detyrimet dhe një varg ligjesh të tjera.

Natyrisht, u përmendën edhe vërejtjet nga zonjusha Gashi dhe unë dua të them që Komisioni për Jurisprudencë...

(Ndërhyrje - reagon dikush - e përmirëson - thotë: zonjusha Haxhiu)

Atëherë, më fal, se ajo Gashi më është bërë obsesion, sepse po më merr nëpër gojë nga pak.

Pra, zonjusha Haxhiu, më duhet të ju them se unë i kam propozuar kandidatët për Komision, pa i ndryshuar fare dhe janë që disa muaj që presin në Kuvend dhe nuk janë miratuar ende, prandaj për këtë edhe s'po mbahet provimi i jurisprudencës. Dhe, mandati i atij Komisioni do të përputhet me mandatin tim si ministër, kështu që për dy vjet nuk do të jam ai unë që do t'i emërojë anëtarët e Komisionit.

Por një fakt duhet ta kemi të qartë. Provimi i jurisprudencës, është provim shtetëror dhe këtu duhet të jemi të kujdesshëm se si bëhet organizimi i tij.

E përmendët rastin me ata që janë me fakultet trevjeçar apo bachelor dhe ata pesëvjeçar. Mendoj se, traditat, edhe te ne, katërvjeçarë, kushdo që ka qenë, do të ketë të drejtë të hyjë drejtpërdrejt, por traditat që ta kryejë provimin e jurisprudencës dhe të bëhet prokurorë dhe gjyqtarë, besoj traditat në botë, tregojnë ndryshe. Dhe e dini që është një punë bukur e rëndë, nuk është bash e lehtë. Ata që kanë qenë trevjeçar, i ftoj që tani është fakulteti prapë katërvjeçar, ta kryejnë edhe një vit nëse dëshirojnë të jenë prokurorë ose gjyqtarë, apo t'i kryejnë detyrat tjera me provim të jurisprudencës.

Sa i përket riapelimit, po ashtu dua të theksoj se duhet të jenë 6 muaj, sepse aty janë në pyetje 10 lëndë që duhet t'i japë, dhe askush prej nesh nuk besoj që është në gjendje, pas tri ditësh që bie prej provimit, të hyjë prapë t' i japë 10 lëndë. Duhet të pret një afat prej 6 muajsh dhe kjo nuk i bën asgjë të keqe, përkundrazi, është një motivim që duhet të jetë më shumë edhe për palët.

Dhe, krejt në fund, unë jam plotësisht i gatshëm që të bashkëpunojë me Komisionin për amendamentim dhe plotësimin e tij në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 63 deputetë. Votojmë tash!

(Ndërhyrje: 59 i ke, nënkryetar!)

Ende ti je brenda. Tani, disa s'kanë votuar, 44 vota janë për. Ishin 63 deputetë të pranishëm, tash nuk di, ndoshta janë më pak. Sa janë tash? Atëherë, nuk është votimi i vlefshëm. Nuk mjafton që të zhvillojmë debat, kështu që vazhdojmë nesër përsëri, në orën 10:00.

* * *

(Vazhdimi i mbledhjes plenare, më 12.10.2012)
(Mbledhjen e kryeson nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,
 Ministër,
 Konstatoj se ende nuk kemi kuorum, për shkak ndoshta të vonësës që e kemi bërë ne si Kryesi, për shkak të takimit që patëm.

Atëherë, po vazhdojmë me debatin rreth pikës së nëntë, që është me radhë, e pastaj kur të ketë kuorum, votojmë.

Pika e nëntë e rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin, me rekomandime.

Ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Rashiq, që para deputetëve të Kuvendit të paraqet dhe arsyetojë projektligjin. Zoti Rashiq e keni fjalën.

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Poštovani dame i gospodo,
 Narodni poslanici,

Danas, posle, moram naglasiti jednog dužeg perioda pripremanja Zakona o penzijama, mislim da smo postigli jedan zajednički koncenzus i od strane Ministarstva i unutar Vlade i također političkih subjekata koji su deo aktivnih političkih procesa na Kosovu i mislim da pored onog povećanja koje se desilo u prethodnoj nedelji, na čemu se zahvaljujem apsolutno gospodinu premijeru, pre svega, pa i ministru Financija, a naravno i svima koji su učestvovali u tome i uz podršku Udruženja kosovskih penzionera mislim da su se stekli preduslovi za usvajanje ovog zakona.

Ono najbitnije, što hoću da naglasim, jesu kategorije koje će biti dobitnici ovog zakona i to pre svega u šest osnovnih kategorija, i to:

1. Pravo na osnovnu penziju koju realizuju svi građani koji su stanovnici Kosova, oni koji su napunili 65 godina, kao i strani državljani koji su u skladu sa međunarodnim sporazumima.
2. Pravo doprinosa za starosnu penziju, koju je realizuju svi stanovnici koji su građani Kosova i koji imaju najmanje 65 godina i imaju 15 godina radnog staža penzije pre 1.1.1999. godine.
3. Pravo na penziju ograničene sposobnosti, koje realizuju svi građani Kosova, koji su od uzrasta od 18 do 65 godina starosti, za koje je konstatovano da nisu sposobni za rad.

4. Pravo na privremenu penziju, koju je realizuju svi građani Kosova i koji su od starosti od 50 do 65 godina, koji su radili na poslovima i obavezama radnika kompleksa „Trepča“ ili drugih rudnika na Kosovu.

5. Pravo na invalidsku penziju rada, koju je realizuju svi građani mlađi od 65 godina, koji su bili prethodni korisnici ove penzije ili oni koji su povređeni na radu ili dobijaju penzionu bolest.

6. Pravo na porodičnu penziju koju je realizuju svi bivši korisnici porodičnih penzija, koji su pod 65 godina i njihovim porodicama kada njihovi osiguranici umru pre 65 godine života.

Kao što vidite, iz ovih kategorija, koje sam naveo, dve su kategorije predviđene kao nove, a to su pravo na invalidnu penziju i pravo na familijarnu, takozvanu.

Ono što je izuzetno bitno da naglasim, da jedan od osnovnih preduslova koji moramo da ispunimo osvajanjem ovog zakona je kreiranje pravne baze za ove pod-zakonske akte koji će doći posle zakona. Ja apsolutno razumem da će neki od vas nazvati zakon, zakon koji diskriminiše, pogotovo radnike koji su radili u 90-tim godinama pa su silom bili izbačeni sa poslova, ali zato i ponavljam ovo – nama treba zakon kao baza, da bi posle usvajanja zakona, imali pod-zakonske akte koje će regulisati način kako ćemo registrovati i utvrditi koji su ti korisnici.

Znate i sami da za to treba jedan tehnički proces i znate i sami da utvrđivanje broja korisnika i načina koji ispunjavaju uslove treba imati jedan proces koji će, po mojoj proceni, trajati možda od 6 meseci do godinu dana.

Znači, ponavljam, kada budemo usvojili zakon, pod-zakonskim aktom regulišemo za ljude koji su izbačeni sa posla 90-tih godina.

Takođe, pod-zakonskim aktom regulišemo kategorizaciju penzija koje takođe jeste jedan od onih amandamenata koji su dragi predstavnici penzionera bili podneli i vama, takođe i meni. Znači mi moramo da imamo zakon da bi stvorili zakonski preduslov za dalje usavršavanje tih penzija.

Pored toga, što je još jedna vrlo bitna stvar, i zbog toga vas molim da imate to na umu. Jedan od preduslova za, ta kažem tako, predstavljanje Kosova pred međunarodnim institucijama i pogotovo predstavljanje u Evropskoj Uniji, je povezivanje staža odnosno bilateralnih sporazuma koji smo mi obavezni da napravimo sa svakom državom Evropske Unije.

Prema tome, ja vas samo kratko informišem, vi ste upoznati sa nekim problemima koje smo imali, a verovatno je najveći za sada Sporazum sa Švajcarskom, koji se već, da tako kažem, razvlači već dve godine, mi smo tehnički odgovorili na njihov zahtev odmah, istog dana kada su nas obavestili, i zadnja komunikacija je bila u februaru prošle godine, kada smo mi dostavili naš predlog novog bilateralnog sporazuma koji je apsolutno sličan

kao onaj što je bio sa bivšem Jugoslavijom, s time što je samo neka osnovna titula promenjena, naravno naziv i ostale tehničke stvari. Ali još ne dobijamo odgovor iz jednog jedinog razloga, zato što mi nismo ispunili tehničke preduslove da bi mogli da uđemo u pregovore za bilateralni sporazum.

Obaveštavam vas sa kojim smo još zemljama započeli pregovore. Jedna od zemalja, takođe je Austrija. Radna grupa, na nivou eksperata, pregovarala je u vezi članova koji nemaju veze sa zakonom, dok se očekuje na pregovore za nove članove zakona koji su direktno vezani za ovaj određeni zakon.

Mi smo imali delegaciju Austrije, koje je bilo vrlo predosetljiva, vrlo tehnički korektna. Imali smo njihovu posetu i trajala je nekih 5 dana, i oni su na naš zahtev prihvatili da zakon o tom bilateralnom sporazumu bude delimično anuliran, znači da delimično ne bude na snazi dok mi opet ne budemo napravili uslove da započnemo nove pregovore.

Švajcarsku sam već pomenuo. Mislim da je to jedna od najosetljivijih stvari, zbog toga, pogotovo što znamo svi da u Švajcarskoj radi dosta naših državljana. Prema tome, verovatno će i Ministarstvo a moralo bi se da i vi, da taj izazov sa Švajcarskom smatramo najprioritarnijim.

Pored toga, pregovori smo počeli sa Makedonijom, sa Mađarskom, Italijom, sa Kraljevinom Švedske i takođe smo počeli komunikacije sa Holandijom.

Ja se stvarno nadam da ćemo zakon usvojiti što pre, zbog toga što, ukoliko ne budemo to uradili, plašim se da će ovi zahtevi koji su već došli, kao što sam rekao, bilo od Austrije, bilo od Švajcarske, bilo od Makedonije ili Mađarske, da se toliko nagomilaju gde ćemo mi imati jednu lančanu reakciju svih zemalja Evropske Unije koje će verovatno u sličnom vremenu traže da obnove te bilateralne sporazume, jer sad za sad mi nemamo aktivni sporazum koji funkcioniše između nas i tih zemalja Evropske Unije. A znajući da, samo sa Austrijom recimo, je trebalo 5 dana intenzivnih pregovora od jutra do večeri i gde smo mi samo faktički dotakli samo jedan dao ugovora, to u suštini znači, ako se lančano sve zemlje Evropske Unije obrate nama u isto vreme, kao što jeste verovatno logično i zaočekivati, mislim da ćemo biti u jednoj tehničkoj blokadi, gde mi jednostavno nećemo moći u isto vreme da sa 27 zemalja, recimo, iz Evropske Unije da vršimo pregovore zbog toga što će nam trebati jedna armija ljudi da samo to radi.

Prema tome, da bi to predupredili, da bi reagovali na vreme, stvarno je najneophodnije da ovaj zakon danas usvojimo jer svako dalje odlaganje gubimo vreme za to, gubimo vreme i gubimo potencijala i možda ulazimo u još veću tehničku problematiku. Prema tome, zakon jeste dobar. Zakon jeste usklađen sa svim normama i Međunarodnog monetarnog fonda, Svetske i čak smo dobili, da nazovem tako, zvanično priznanje da je zakon usklađen po svim tim strateškim normama.

Znam da penzioneri, uz dužno poštovanje moje prema njima, zahtevaju više od ovog zakona, više beneficije. Mi smo pokazali svoju spremnost za povećanje penzija i mislim da jedno povećanje od 40% stvarno je vidljivo, i biće osetno...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe nje minut vazhdojani!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: ...što znači da i sami penzioneri i sami trebali da imaju to na umu kao jedan bitan faktor. Znači, politička volja nikad nije nedostajala. I mi ćemo to i danas da pokažemo i da pokazaćemo i svaki drugi dan.

Ja naravno da vas opet pozivam, predstavnike penzionera, predstavnika Udruženja penzionera, da budu aktivni učesnici, kao što su bili do sad, mi uvek sa njima pregovaramo, kažemo šta su naše mogućnosti, unutar naših mogućnosti uradićemo sve što treba da bi vaše zahteve ispuniti.

Još jednom vas pozivam, zbog toga, što je ovaj zakon izuzetno važan, ne samo na jednom polju nego kao što sam i rekao na više različitih polja, da danas usvojite zbog toga što ćemo ovim još jednom dokazati da smo zrelo društvo, društvo koje može sama sebi da pravi svoje temelje. Hvala puno!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Damka. Nuk qenka këtu. Atëherë, në emër të Komisionit, fjalën e ka zonja Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2012, shqyrtoi Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe rekomandon të miratohet në parim Projektligji për skemat pensionale, të financuara nga shteti.

Arsyetim:

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2012, shqyrtoi Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe me shumicë votash vendosi që t'i rekomandojë Kuvendit që Projektligji të miratohet në parim, ndërsa vërejtjet e deputetëve të adresohen në formë të amendamenteve gjatë shqyrtimit në Komision.

Kryesues, nëse bën, në emër të Grupit të flas, për të mos e marrë fjalën dy herë?

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, edhe kësaj here e ka shqyrtuar Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, pasi që kjo është hera e dytë që projektligji po kthehet nga Kuvendi, përkundër faktit që Komisioni funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë projektligjin në leximin e parë.

Kthimi prapa konsiderojmë se ka qenë një veprim i gabuar, pasi deri më tani pensionistët do të kishin filluar t'i marrin pensionet me rritjen e përcaktuar me këtë projektligj.

Pa kthimit prapa të këtij projektligji, Komisioni Funkcional, me iniciativën e kryetarit të Kuvendit, është takuar me përfaqësuesit e pensionistëve, Ministrisë së Punës e Mirëqenies Sociale, Ministrisë së Financave, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, ku kemi biseduar rreth krijimit të një fondi të veçantë për pensionet.

Mirëpo, në këtë rast duhet pasur parasysh se për krijimin e një fondi të tillë kërkohet një kohë më e gjatë dhe konsultim e harmonizim me ligjet në fuqi. Më konkretisht, ligji aktual mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi nuk lejon krijimin e një fondi të tillë.

Projektligji për të cilin po diskutojmë sot, përfshin: skemën e pensionit bazik të moshës, skemën e pensionit kontribut-pagues të moshës, skemën e pensionit të aftësisë së kufizuar, dhe skemën e pensionit të parakohshëm.

Përmes këtij projektligji, për herë të parë në Kosovë parashihet të rregullohen edhe çështjet e pensionit familjar e invalidor të punës, në rast kur kontribut-paguesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale.

Përmes këtij projektligji, parashihet që pensionet e pensionistëve tatim-pagues të rriten 26%, ndërsa pensionet e moshës 11%, ndërsa njëra ndër kërkesat e pensionistëve ishte që kjo rritje të realizohet me një vendim të Qeverisë për vitin 2012.

Qeveria e Republikës së Kosovës e realizoi këtë kërkesë dhe mori vendimin për pagesën e pensioneve me rritjen e paraparë me këtë projektligj për 26% për pensionistët tatim-pagues dhe 11% për pensione të moshës nga 1 janar i vitit 2012, por mori vendim edhe për rritjen shtesë, gjithsej 40% për pensionet tatim-pagues dhe për 30% për pensionet e moshës prej vitit 2013. E përshëndesim këtë vendim të Qeverisë.

Është me rëndësi të ceket fakti se mosmiratimi i këtij projektligji nga ana e Parlamentit është pengesë për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet e ndryshme evropiane.

Të nderuar kolegë, duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky projektligj, ju ftojme që ta votoni në parim, e pastaj ne në kuadër të Komisionit do të angazhohemi maksimalisht për t'i bërë përmirësimet e mëtejme projektligjit gjatë procesit të amendamentimit, duke i marrë parasysh edhe vërejtjet e sugjerimet tjera të përfaqësuesve të pensionistëve. Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje ministër,

Të nderuar deputetë,

Të respektuar pensionistë të Republikës së Kosovës,
Sot këtu para nesh kemi të njëjtin projektligj që nuk ka pësuar kurrfarë ndryshimi pozitiv nga versioni i mëparshëm që ky Kuvend e ka kthyer në Qeveri për ridraftim, përveç që kemi një premtim nga Qeveria për rritjen e këtyre pensioneve.

Kërkesa jonë ka qenë që ky ligj të rishikohet dhe të merren në konsideratë kërkesat e arsyeshme të pensionistëve dhe të zgjidhet statusi i pensionistëve, të financuar nga shteti.

Kur e kemi kërkuar këtë, kemi pasur parasysh që kjo kategori e qytetarëve të Kosovës ka bërë shumë për Kosovën, ndërsa tani është kategoria për të cilën është bërë më së paku.

Versioni aktual i këtij ligji, përkundrazi, ka pësuar përkeqësim në raport me versionin e mëparshëm. Tash vërejmë që kategoria e personave të larguar me dhunë nga puna në vitet e 90-ta është lënë jashtë këtij ligji.

Fatkeqësisht, më duhet të them se neni 8 i këtij ligji, këtë ligj e bën diskriminues për një kategori të veçantë të shoqërisë sonë, për ata që me punën e tyre i dëshmuar botës se Kosova mund dhe duhet të jetë shtet i pavarur, andaj shtrohet pyetja: Mos vallë nga vitet 1990 deri në vitin 1999 qytetarët e Republikës së Kosovës kanë lëvizur me shpejtësinë e dritës dhe koha u është ndalur?

Jam i sigurt se në këtë Parlament, duke mos përjashtuar edhe Kabinetin qeveritar, ka nga ne që gjatë asaj kohe kemi marrë mësim nga mësuesit, arsimtarët, profesorët tanë, kemi marrë shërbime shëndetësore nga punëtorët shëndetësorë, të cilët sot janë të detyruar që ne deputetëve të na shkruajnë letra dhe të na lusin që t'u ndihmojmë për realizimin e të drejtave të tyre legjitime.

Në këtë projektligj nuk është bërë kategorizimi i pensionistëve sipas nivelit të arsimimit, ngritjes profesionale sipas viteve të kontribut-dhënies.

Për LDK-në, është i paqëndrueshëm neni 31 që thotë se dispozitat e nenit 11 - pagesa për pensionin invalidor të punës dhe dispozitat e nenit 12 - pagesat e pensioneve familjare, do të fillojnë së zbatuari nga 1 janar i vitit 2016 në përputhje me fondet buxhetore në dispozicion.

Rritja e pensioneve të premtuara nga Qeveria nuk mund të konsiderohet si rritje. Tani po bëhet viti i tretë kur në buxhetin e Republikës së Kosovës është paraparë kjo rritje, por që ende nuk është realizuar.

Po dëshmohet edhe një herë se kjo Qeveri rritë pagat apo pensionet vetëm atëherë kur ndodhet para presioneve apo kur ka ndonjë krizë të brendshme politike, sikur që është kjo tani dhe tenton që me këto vendime, gjegjësisht premtime, të shpërqendrojë vëmendjen e qytetarëve kah çështjet tjera.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mirëpret vendimin, gjegjësisht premtimin e Qeverisë për rritjen e pensioneve, por duhet të bëjë me dije se kjo rritje është dashur dhe ka mund të bëhet shumë më herët.

Në shkresën e sponsoruesit të këtij projektligji, kërkohet nga ne deputetët që, duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e veçantë që e ka ky projektligj për skemat pensionale të financuara nga shteti, për negociim të marrëveshjeve në fushën e sigurimeve sociale me vendet e BE-së, t'i mbyllim sytë e ta votojmë këtë ligj. Por, të nderuar qeveritarë, na e kemi kthyer disa herë këtë ligj e ju nuk i keni marrë parasysh sugjerimet e Kuvendit, për rëndësinë dhe vlerën e ligjeve ju takon juve të mendoni para se ligjet t'i sillni në Kuvend.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha këto që i thashë më lartë, Grupi Parlamentar i LDK-së, ka vendosur që mos ta votojë këtë ligj.

KRYESUESI: Faleminderit! “Vetëvendosje”! Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Sistemi pensional aktual në Kosovë është i padrejtë. Është i padrejtë sepse injoron pensionistët e sotëm dhe përkujdeset vetëm për ata të së ardhmes. Këtë të së “ardhmes” e kam vënë në thonjëza, pasi nuk po shoh të ardhme as për pensionistët e as për qytetarët në këtë politikë.

Harrohet se kjo e ndërtuara që e gëzojmë ne sot, u bë nga ata që janë pensionistë apo nga ata që nuk janë më. Arsyeja e krizës financiare, është aty vetëm për t'i shfajësuar fajtorët, pra problemi nuk qëndron te kriza financiare.

E dimë se në mes të sistemit të solidaritetit të gjeneratave dhe atij të vetëfinancimit, pas lufte u zgjodh ai i vetëfinancimit. Sistemi i vetëfinancimit së pari është i padrejtë në vetvete edhe në kushte normale, pasi nuk respekton adaptimin në rrjedhat ekonomike. Pra, inflacionet mund t'i zhvlerësojnë kursimet jetësore të individit dhe individit nuk mbrohet nga sistemi. Dhe së dyti është se ky sistem u aplikua në Kosovë në vendin ku nuk kishte kurse pensionale pasi ato ishin grabitur nga Serbia dhe kjo i binte të ishte vrasje me paramendim e pensionistëve aktualë.

T'u thuash pensionistëve se këta që po punojnë sot e bëjnë këtë për veten e tyre dhe juve nuk kemi se çka t'ju bëjmë pasi që nuk kemi para, është shumë e rëndë dhe është e rëndë pasi në përgjithësi është një mosmirënjohje. Ajo që iu dha dhe vazhdon t'ju jepet, trajtohet si diçka e dhuruar nga Qeveria dhe atë e dhuruar në një lojë morbide duke ua shtyrë muaj pas muaji rritjen e premtuar dhe duke i kushtëzuar se nëse doni rritjen, atëherë duhet të pajtoheni me ligjin që do e sjellin, e tjera.

Dhe, rritja u jepet kur pensionistët e lodhur paralajmërojnë protesta, apo Qeveria është në ndonjë siklet politik. Ky ka qenë korrupsion i hapur i Qeverisë dhe për këtë jemi vetë dëshmitarë.

Në lidhje me skemën pensionale, në Komision kemi pasur takime me pensionistët, madje nga një nismë e kryetarit të Kuvendit për trajtim të kësaj çështjeje, bash me përfaqësuesit e pensionistëve dhe me ata nga Ministria. Dhe për mua ka qenë shokante kushtëzimi i rritjes së premtuar me Ligjin për skemën pensionale. “E doni rritjen që ua kemi premtuar, pranojeni ligjin! Nuk mund të merrni rritjen pa e pranuar ligjin”. A nuk është kjo e padinjitetshme, në fund të fundit?

Dhe, ditë më parë, Koalicioni i Pensionistëve deklaroi se nëse rritja kushtëzohet nga ligji, nuk e duam rritjen. Dhe, a nuk është kjo, vërtet dinjitoze?

Të nderuar deputetë,

Mund ta shihni qartë se si një Qeveri e padinjitetshme përpiqet të luajë me pensionistët e dinjitetshëm. Ata e thanë qartë, se mund të mos kemi para, mund të jemi të varfër, por nuk mund të shkelim mbi atë që e ndërtuam me vite e me sakrifica, pra dinjitetin. Ata nuk pajtohen me këtë ligj. Ky ligj e vazhdon këtë politikë sociale ndaj pensionistëve dhe ata kanë të drejtë, dhe kanë të drejtë e nuk duan ta shesin këtë të drejtë për një lëmoshë, për të cilën pastaj krenohet kryeministri sikur ta ketë dhënë nga xhepi i tij.

Dhe, si e jep rritjen Qeveria? Në momentin politik, kur asaj i duhet, deklaroi: 40% dhe 33% rritje, e cila do të paguhet retroaktivisht 26.45 dhe 11.2% nga janari i këtij viti, e pjesa tjetër në vitin 2013.

Përse retroaktivisht nga janari i këtij viti? Pra, paratë paskan qenë aty. Përse nuk u dhanë me kohë? Përse tërë kohën premtohet dhënia e rritjes së premtuar me kushtin e pranimi të ligjit, dhe kjo rritje bëhet tani me një pompozitet. A nuk është kjo një lojë dhe me kë, me pensionistët?

Madje në media del se 40 e 33% retroaktivisht nga janari 2012, e kjo në dukje duket një shumë solide që pensionistët do të mund ta merrnin tani, por ja që bëhet fjalë për një fakt tjetër, një rritje që retroaktivisht i bie shumë pak, pasi bëhet fjalë për 11% dhe si rritje retroaktive i bie shumë pak dhe si rritje i bie një bukë në ditë.

E tash më thoni se çfarë gjuhe unë duhet ta përdori këtu në Kuvend në lidhje me këtë, pasi kam dëgjuar shpesh të kritikohet gjuha e Vetëvendosjes në Kuvend? Këtë lojë të ndyrë me pensionistët, si u dashka ta quaj, që ta përmbush unë kushtin e gjuhës korrekte? Unë po bëj përpjekje të gjej fjalë, por nuk po arrij dot.

I lus ata kritikuesit e gjuhës në Kuvend të hartojnë fjalor me fjalë të pranueshme për dukuritë e shumta të ndyra nga Qeveria që po i shohim çdo ditë, sepse do të na ndihmonin shumë.

Dhe tani vjen ky projektligj, edhe një herë i pa ndryshuar, për ta vazhduar këtë avaz të vjetër dhe po kërkohet që ta votojmë. Ne nuk do ta votojmë pasi ka rrugëzgjdhje dhe ato rrugëzgjdhje i kemi diskutuar në Kuvend, në mbledhje të thirrur nga kryetari i Kuvendit, me Komisionin, bashkë me përfaqësuesit e Ministrisë, bashkë me përfaqësuesit e

pensionistëve, me nismën e ndërmarrë nga vetë kryetari dhe nga e cila nismë kanë dalë dy konkluzione. Të paguhet rritja e premtuar së pari, dhe të bëhet projektligji me idenë e krijimit të Fondit pensional, që nënkupton përgjegjësinë e gjeneratës që sot është aktive për pensionistët.

Këto konkluzione janë injoruar, siç është injoruar dhe po injorohen kërkesat e vazhdueshme, të arsyeshme dhe të arritshme të pensionistëve. Mund të ndërtohet Fondi pensional, i bazuar në solidaritetin mes të gjeneratave, pra ka zgjidhje për pensione të dinjitetshme, duke mos e rënduar buxhetin. E për t'u arritur kjo plotësisht duhen ca vite. Dhe ky projektligj vetëm sa po e vonon zgjidhjen e vërtetë.

Ne jemi për zgjidhjen dhe kundër avazit të vjetër, prandaj nuk do ta votojmë projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

Përfaqësues të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zakonisht ligjet bëhen për ta përmirësuar jetën e qytetarëve. Dhe projektligji i sjellë këtu, në fakt nuk ka as minimumin e kriterëve të cilat nëse zbatohen do të përmbushin nevojën fillestare që të kemi një ligji të caktuar, prandaj konsiderojmë, po ashtu sikur edhe dy grupet tjera të cilat u deklaruan, që definitivisht ky projektligj nuk përmbushë as nevojat minimale të komunitetit të pensionistëve.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, nuk do ta votojë. Ne kërkojmë që ligji të rikthehet edhe një herë, sepse kjo ka qenë kërkesë e pensionistëve në takimet që i kemi pasur, t'i rikthehet Qeverisë, me shpresë që ky do të jetë kthimi i fundit dhe kërkojmë nga Qeveria që përtej premtimeve dhe deklaratave mediatike të ulet dhe të hartojë një projektligj i cili do t'u mundësojë pensionistëve, nuk po them jetë të dinjitetshme, sepse në Kosovë shumë pak njerëz sot kanë jetë të dinjitetshme, prej krizës së madhe, prandaj edhe pensionistët është shumë vështirë të kenë jetë të dinjitetshme, por të paktën minimalen e nevojave dhe kërkesave për të mbijetuar, në momentin kur kanë nevojë të shkojnë te mjeku, të udhëtojnë ose t'i përmbushin nevojat minimale për një jetë pak a shumë normale.

Kërkojmë, thashë edhe më parë si Grup Parlamentar që ky projektligj të rikthehet ashtu siç ka qenë kërkesë e pensionistëve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, zoti Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Pensionistë të nderuar të Kosovës,

Padyshim që procedimi i këtij projektligji sot në Kuvendin e Kosovës na ka sjell para një dileme shumë të madhe. Ne e dimë që ky ligj nuk është ideal dhe nuk e rregullon çështjen sociale të pensionistëve në përgjithësi. Ne gjithashtu, edhe si Komision kemi pasur shumë dilema sa i përket kalimit në shqyrtim të parë të këtij projektligji, ndërsa këtu në Kuvendin e Kosovës një herë vetëm e kemi rikthyer këtë ligj, ndërsa tash jemi prapë para një situatë të tillë.

Në anën tjetër jemi të vetëdijshëm se për gjendjen e rëndë të pensionistëve në Republikën e Kosovës dhe se ata nuk e kanë marrë dhe ende vazhdojnë të mos e marrin trajtimin e dinjitetshëm të cilin e meritojnë si qytetarë të këtij vendi, si kontribuues për edukimin e brezave të rinj dhe kontribuues që ne sot jemi këtu të gjithë ulur. Por, megjithatë, me këtë projektligj, ne veçanërisht do të mundohemi që për pensionistë të gjejmë zgjidhje sa më të përshtatshme.

Në këtë rast ne jemi para dy dilemave, ta kthejmë projektligjin apo ta miratojmë si të tillë? Në fakt, të shohim se prej këtyre dyjave a u bëjmë më shumë dobi apo dëm pensionistëve të Kosovës? Në këtë rast, nëse rikthehet prapë ligji në Qeveri, padyshim se dëmi do të jetë më i madh dhe dëmtohen edhe ato kategori të cilat janë paraparë të marrin pension përmes këtij projektligji siç është kategoria e pensionistëve invalidor të punës, pastaj pensionet familjare dhe gjithashtu nuk do të ketë rritje që është paraparë 26% për pensionet e kontribut-paguesve dhe 11% për ata të moshës.

Në këtë rast ne jemi në një situatë që të zgjedhim atë që është më pak e dëmshme. E dimë se ligji nuk është ideal, nuk i plotëson kriteret e nevojshme për një jetë të mirëfilltë të pensionistëve të Kosovës. Por, në këtë rast, nëse vetëm rikthehet ligji prapë në Qeveri, atëherë ne do t'i bëjmë dëm më shumë situatës së rëndë të pensionistëve të Kosovës, kështu që ne si koalicion parlamentar, do ta përkrahim me shpresë se ky ligj do të amendamentohet në mënyrën më të mirë në Komision. Edhe pse jemi të limituar këtu, dhe po them jemi shumë të kufizuar në Komision, për shkak të arsyeve tashmë të njohura. Ne gjithashtu u informuam edhe nga raporti i fizibilitetit ku kërkohet një dialog social sa i përket kësaj kategorie të pensionistëve të Kosovës dhe ne shpresojmë se në një të ardhme të afërt të hapet ky dialog social dhe të themelohet Fondi i pensioneve si një ndër shtyllat kryesore të këtij dialogu social.

Ne si koalicion do ta mbështesim me shpresë që sadopak do të kontribuojmë për përmirësimin e mirëfilltë të gjendjes së pensionistëve të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS-ja, e ka fjalën zoti Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala gospodine predsjedavajući!

Danas čujemo velike reči nekih po kolega - poslanika kako su protiv ovog nacrtu zakona, a da li je to tako, da li smo toliko odgovorni ili su samo to političke fraze? I pored velikih nesuglasica i nezadovoljstvo po koje je proizišlo zbog Nacrta zakona o penzijskih šemama finasiranih od strane države i vraćanje zakona ponovo na Vladu u 2012. godini, preduzeti su svi potrebni koraci kako bi se zakon poboljšao.

A vidimo izlaganje gospodina ministra Rašića da je zakon veoma važan za kosovsko društvo kako bi ono moglo da ide napred i kako bi država mogla da potpisuje bilateralne sporazume sa drugim državama i kako bi građani Kosova mogli da regulišu svoje penzije iz drugih država.

Iz Nacrta zakona vidimo da imamo i dve nove kategorije penzionera, radnici koji su se penzionisali zbog povrede na radu i kategoriju nasledne penzije ako supružnik umre.

Parlamentarna grupa SLS zna da zakon nije idealan, ali moramo biti svesni i da je zakon sada potreban i od nečega moramo nekada početi.

Parlamentarna Grupa SLS podržaće usvajanje u načelu Nacrt zakona o penzijskim šemama i u komisijama daće svoj doprinos. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! 6+, Mufera Shinik, apo zoti Damka! Urdhëro, zoti Damka!

FIKRIM DAMKA: Sayın Başkan,
Teşekkür ederim!

6+ Parlamenter grubu adına, bu Yasayı desekleyeceğimizi bildirmek istiyorum. Fakat, şunu da ifade etmek arzusundayım. Bir kaç defa emekliler Yasası bu Meclise geldi ve geri çevrildi. Lütfen ben milletvekillerinden şunu rica ediyorum, emekliler lütfen siyasi alet edilmesinler, manipüle edilmesinler, çünkü bu Yasa son derece emekliler açısından önemlidir.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj se grupet parlamentare janë deklaruar. Tani radha është e deputetëve. Zonja Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç dihet deri më tani Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që nga viti 2004, disa vite me radhë ka qenë sponsoruese e këtij projektligji për sigurimin pensional dhe invalidor, i bazuar në parimet e solidaritetit dhe në fondin e përbashkët pensional.

Duke u mbështetur në vlerësimet e ekspertëve të sigurimeve sociale, pastaj duke pasur parasysh vendimet politike të institucioneve të Republikës së Kosovës, por edhe rekomandimet e mekanizmave ndërkombëtarë financiarë, siç janë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, vitin e kaluar Ministria e Punës ka propozuar për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Për arsye të njohura, nga të gjithë ne, ky projektligj, nuk është miratuar përfundimisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Për këtë arsye Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti nga strategjia legjislative e vitit 2010, është bartur në vitin 2011,

e po ashtu në vitin 2012 për t'u diskutuar në Parlament, por siç dihet i është kthyer prapë Qeverisë për ndryshime.

Në kuadër të këtij projektligji janë ndërmarrë pra të gjitha aktivitetet e nevojshme për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji. Sipas afatit kohor të përcaktuar në strategjinë legislative dhe gjithashtu me rastin e hartimit të këtij projektligji janë përfillur të gjitha procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e akteve ligjore dhe nën-ligjore të përcaktuara me Rregulloren për punën e Qeverisë.

Për këtë më së miri tregon edhe fakti se në kohë të caktuar për këtë projektligj nga Ministria e Financave dhe Ministria për Integrime Evropiane janë siguruar deklarata financiare dhe deklarata e pajtueshmërisë së këtij projektligji me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane.

Të nderuar kolegë deputetë,

Objekt trajtimi i këtij projektligji janë skema e pensionit bazik të moshës, skema e pensionit të aftësisë së kufizuar, skema e pensionit të parakohshëm si dhe të drejtat për pension familjar dhe invalidor të punës, si pensione pra të shtyllës së parë, të cilat do të financohen nga buxheti shtetëror i Republikës së Kosovës.

Përndryshe, qëllimi kryesor i këtij projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti është konsolidimi, harmonizimi dhe unifikimi i skemave pensionale të aplikueshme, të cilat aktualisht financohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, por edhe krijimi i një kornize të re ligjore të unifikuar për sigurimin e vazhdueshëm të pensioneve për shtetasit e Republikës së Kosovës, por edhe shtetasit e huaj, sipas parimeve të reciprocitetit të cilat duhet të rregullohen me marrëveshjet bilaterale të sigurimeve sociale, për këto që na foli edhe ministri pak më parë.

Siç dihet, deri më tani, Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht Ministria e Punës ka filluar negociimin me shumë shtete vende të BE-së në lidhje me marrëveshjet bilaterale të sigurimeve sociale, gjë që ky ligj është njëri ndër ligjet bazë që varet direkt në negociim të këtyre marrëveshjeve me vendet e Bashkësisë Evropiane.

Mjetet financiare për pagesën e këtyre pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, do të sigurohen pra nga buxheti i Republikës së Kosovës, për çka Qeveria e Republikës së Kosovës ka garantuar për realizimin e të drejtave për të gjitha llojet e pensioneve.

Krejt në fund, dëshiroj të theksoj se meqenëse është fjala për një projektligj të rëndësishë së veçantë, sepse trajton shtyllën e parë të pensioneve, të nderuar kolegë deputetë, ju lus që me diskutimet tuaja të kontribuoni në ngritjen e cilësisë së këtij akti ligjor dhe më pastaj ta miratojmë Projektligjin e përmendur, ndërsa ka edhe kohë për ndryshime e propozime të reja që të bëhet një ligj sa më funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,
I nderuar ministër,
Të nderuar deputetë,

Ky projektligj dy herë është kthyer nga ky Kuvend me një qëllim të vetëm, që të ndryshohet dhe të vijë i ndryshuar, por ne sot para veti kemi një projektligj i cili nuk është ndryshuar.

Ky ligj në vete përmban nene, si nenin 8 e 30 dhe disa nene tjera, që janë diskriminuese, nene që kanë tendencë të mohimit të një pjese të historisë së popullit të Kosovës, tendencë të mohimit të punës së disa institucioneve që përkundër kushteve shumë të rënda dhe me plotë rrezikshmëri, kanë vazhduar që të punojnë, tendencë të mosnjohjes së stazhit të njerëzve që kanë punuar në një periudhë mjaft të rëndë për ne si popull.

Këtyre njerëzve u është bërë një e padrejtë e madhe para luftës, pas largimit në mënyrë të padrejtë nga vendet e tyre të punës dhe tash po u bëhet një e padrejtë për herë të dytë me ç'rast nuk po u njihet stazhi, të cilin ata e kanë realizuar në institucionet paralele në atë kohë.

Në qoftë se votohet ky ligj, me këto nene, atëherë duhet të mos njihen edhe të gjitha diplomat e certifikatat e shkollave të arritura në vitet 1990 – 1999. Duhet të mos njihet kontributi që kanë dhënë punëtorët shëndetësorë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore popullatës, që kanë dhënë një kontribut të madh në parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, në trajtimin dhe edukimin shëndetësor të popullatës. Pra ata që kanë marrë certifikata e diploma në këtë kohë, lirisht mund t'i hedhin ato në mbeturina, se sipas këtyre neneve punëtorët arsimorë në këtë kohë nuk kanë punuar aspak. Ata që kanë ndonjë dokumentacion për ndonjë shërbim shëndetësor që e kanë marrë në këtë kohë, lirisht mund t'i hedhin në mbeturina, sepse sipas këtyre neneve, punëtorët shëndetësorë nuk kanë punuar në këtë kohë.

Qeveria duhet ta marrë një vendim për rritjen e pensioneve konform komunikatës për media të ministrit të Financave, të datës 21 janar 2011 dhe konform deklarimeve të ministrit Bedri Hamza, në intervistën dhënë gazetës “Koha ditore” ku kishte deklaruar se pensionistët nëse dëshirojnë, e kanë të sigurt rritjen e pensioneve për 26%.

Kostoja e Ligjit të pensioneve është përfshirë edhe në buxhetin e vitit 2012 dhe normalisht do të shkojë duke ku indeksuar për vitet e ardhshme.

Unë i ftoj deputetët që mos ta votojnë këtë ligj dhe ky ligj t'i kthehet Qeverisë, të ndryshohet e të vijë i ndryshuar në këtë Kuvend, të vijë pa nene diskriminuese, që në vete t'i inkorporojë kërkesat e pensionistëve të cilat janë shumë reale, që në vete të inkorporojë premtimet të cilat janë dhënë nga kjo Qeveri, sepse në qoftë se votohet kështu, sikur ka ardhur sot ky projektligj, atëherë kjo ne do të na kthehet bumerang herë do kur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sot para vetes kemi në shqyrtim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti.

Ky projektligj është i ndjeshëm pasi edhe prek njërën ndër shtresat më të ndjeshme të shoqërisë.

Sa për ilustrim do të citoj një thënie të Hemingueit, e cila thotë: “Pensionimi është fjala më e shëmtuar në fjalor” dhe ku vlen kjo thënie më shumë se tek ne, ku i pensionuari, pos ngarkesave që vijnë për shkak të moshës duhet të përballet edhe me krizën e madhe financiare.

Do të shpreh këtu disa nga vërejtjet tona si Lëvizje për Bashkim në lidhje me këtë projektligj.

Te neni 8, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontribut pagues të moshës, pika 1.2. thuhet se duhet të ketë se paku 15 vjet stazh pensional para datës 1.1.1999, prej të cilave së paku 7 vjet e 7 muaj të jenë stazh pune në Kosovë.

Ky rregullim është bërë qysh nga koha e UNMIK-ut me ligjin paraprak dhe është në thelb diskriminues, sepse nuk shpjegon pse në mënyrë arbitrare është vendosur se ky pension duhet të jepet vetëm për ata që kanë stazh të punës 15 vjet para vitit 1999, pra pse 15 e jo 14, 12, 10 apo 5 vjet, për më tepër të kemi parasysh se mbi 200 mijë njerëz janë dëbuar nga puna në vitin 1991 nga Serbia.

Pra, kërkesa jonë është që kjo çështje të debatohet seriozisht gjatë fazës së amendamentimit të dëgjimeve publike për përcaktimin e një kohe të arsyeshme dhe jo diskriminuese.

Neni 9, që ka të bëjë me kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të paaftësisë së përhershme, te paragrafët 5. 1 dhe 5. 2 në vend se të thuhet: “paaftësi e përhershme” është thënë: “aftësi e përhershme”. Pastaj konsiderojmë se më korrekte është të thuhet: “paaftësia e përhershme për punë” pra të shtohet edhe fjala “për punë”.

Në pikën 5.3 thuhet: “se Komisioni mjekësor vlerëson paaftësinë në kohëzgjatje prej 1, 3 apo 5 vitesh”. Këtu konsiderojmë se është bërë gabim logjik, sepse nëse kemi të bëjmë me paaftësitë të përhershme për punë, atëherë pse duhet bërë rivlerësimi mjekësor?. Madje në një afat aq të shkurtër kohor se një vit, nëse i rikthehet aftësia për punë një personi nga kjo kategori atëherë ka qenë vlerësim i gabuar fillimisht nga Komisioni Mjekësor, sepse në këtë lëmi ekziston edhe një term tjetër e ai është paaftësi e përkohshme për punë.

Në anën tjetër, nëse është menduar të vërtetohet vërtetësia për rastin e caktuar edhe kjo është paraparë me këtë ligj në pikën 6 të këtij neni nëpërmes inspektimeve të rastësishme dhe sistematike siç janë emëruar këtu.

Në nenin 11, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës për pension invalidor të punës, paragrafi 3, që merret me lartësinë e këtij pensioni thotë se ai duhet të jetë i njëjtë me shumën e pensionit bazikë të moshës.

Ne konsiderojmë se kjo shumë është shumë e vogël duke pasur se kemi të bëjmë me individin i cili ka mbetur i paaftë për punë gjatë punës së tij, prandaj ky pension duhet të jetë të paktën në nivelin e pensionit të kategorisë së kontribut- paguesve.

Te neni 13, te lartësia e shumës pensionale, konsiderojmë se ajo duhet të përcaktohet me përqindje në raport me pagën mesatare në vend e jo sipas indeksit të kostos së jetesës, sepse kjo e para duket si metodë shumë më praktike.

Te neni 15 dhe 16, që kanë të bëjnë me reduktimin e pensioneve konsiderojmë se janë të papranueshme dhe këtë e kemi thënë disa herë, nuk është në rregull që në rast të krizave fiskale në vend, reduktimi të bëhet për kategoritë që vinë nga mirëqenia apo sponsorizohen nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Fundja nëse shteti është në krizë reduktimi i pagave duhet të bëhet për të gjithë të punësuarit në sektorin publik.

Te neni 15, paragrafi 2, flet se si çdo 6 muaj pensionist duhet të shkoj e të paraqitet në zyrat e caktuara nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale me dokument identifikimi për të dëshmuar se është gjallë. Këtu duhet të gjenden modalitete për persona të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore apo të palëvizshëm sepse nuk është në rregull që ndonjëherë detyrohen familjarët në lese t'i dërgojnë në këto zyre.

Të nderuar deputetë,

Ashtu si kontribuuan pensionistët e sotëm për vendin e tyre, për një ardhmëri më të mirë në kohën kur ishin të rinj, ashtu të matur dhe me mentalitet shtet ndërtues që duhet t'i shërbej shumë kujt vazhduan të jenë edhe në periudhën e pasluftës.

Kërkesat e tyre gjithmonë ishin modeste duke qenë të vetëdijshëm për sfidat e vendit të tyre të dalë nga lufta. Madje edhe kërkesat dhe vërejtjet e fundit që na kanë ardhur te ne për këtë projektligj janë të tilla.

Nga ana tjetër zvarritja e këtij projektligji po shkon në dëm të pensionistëve. Ligji është duke u hartuar për ta, prandaj kërkesat e tyre duhet të merren parasysh.

Do të kisha shtuar edhe një gjë se mungesa e gjithë Kabinetit qeveritar, me përjashtim të ministrit të linjës, madje edhe një numër shumë i vogël i deputetëve të pranishëm këtu, tregon se sa me seriozitet i trajtojmë ne çështjet sociale në vend. Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Petar Miletiq.)

KRYESUESI: Hvala! Reč ima poslanik Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministri i vetëm, dhe

Të nderuar kolegë deputetë, të cilët vërtetë më habit fakti se jeni në numër kaq të vogël sot këtu të pranishëm për një çështje shumë të rëndësishme sociale.

Të nderuar përfaqësues të pensionistëve të Kosovës,

Nga shkresat përcjellëse të këtij drafti dhe nga përmbajtja e tij mund të shihet se përpilimi i këtij draftligji ka filluar në vitin 2010, kurse disa nene apo pjesë të caktuara të këtij ligji do të hyjnë në fuqi në vitin 2016. Pra, e saktë është që prej fillimit të hartimit të këtij draftligji e deri në hyrjen në fuqi të tërësishme duhet të kalojnë hiç më pak se 6 vjet.

Vetë kjo periudhë 6-vjeçare tregon për interesimin apo më mirë thanë mosinteresimin e kësaj Qeverie për grup moshat më të vjetra të shoqërisë kosovare, të cilët me punën dhe djersën e tyre kanë kontribuar në ndërtimin e shumë të mirave materiale të cilat ne sot jemi duke gëzuar dhe shfrytëzuar.

Mos përkushtimi i Qeverisë për çështjen e pensionistëve, krijon një pasiguri serioze të kjo kategori e qytetarëve kosovarë, sepse është e ditur se pensionistët për shkak të moshës së tyre dhe sëmundjeve në vazhdimësi janë të rrezikuar nga vdekja. Kështu vetëm gjatë periudhës nga fillimi i hartimit të këtij ligji, vitit 2010 e deri më sot, kanë vdekur afro 13 mijë pensionistë, të cilët kanë qenë përfitues potencial nga dispozitat e këtij ligji, por që për fat të keq nuk janë më në mesin e të gjallëve që domethënë nuk ja kanë dalë që t'i gëzojnë dhe përjetojnë beneficionet që garanton ky ligj, e gjithë kjo për shkak të neglizhencës, përkatësisht mosinteresimit dhe avashllëkut të kësaj Qeverie ndaj çështjes së pensionistëve.

Por për dallim prej kësaj çështjeje e njëjta Qeveri është shumë më azhure dhe efikase kur është në pyetje komoditeti i zyrtarëve të saj.

Kështu Qeveria e Kosovës vetëm për vitin 2012 ka planifikuar dhe është duke shpenzuar afro 3 milionë euro për blerjen e veturave dhe atë më luksoze, çmimi i të cilave është madje edhe mbi 70, 80 mijë.

Derisa për nevojat e veta luksoze Qeveria është tejet agile dhe e përpiktë kur janë në pyetje pensionistët ajo i sjell Kuvendit një draftligj me të cilën bëhet një farë kategorizimi i pensionistëve më shumë sa për sy e faqe duke pretenduar se kinse e kanë trajtuar çështjen e pensionistëve se sa vërtet për t'i zgjedhur problemet jetike apo ekzistenciale të kësaj kategorie tejet të respektuar të shoqërisë kosovare.

Kur e them këtë kam parasysh dispozitat e këtij drafti me të cilat nuk trajtohet në mënyrë konkrete lartësia e pensioneve kosovare, por në mënyrë shumë të përgjysmuar në nenin 13, i njihet e drejta Qeverisë së Kosovës, që varësisht nga buxheti kostoja e jetës dhe

inflacioni të përcaktoj lartësinë e pensioneve në Kosovë. Pra, Qeveria duke dorëzuar Kuvendit draftin e këtillë nuk i përgjigjet kërkesës së arsyeshme të pensionistëve kosovarë sipas të cilës lartësia e pensioneve mesatare duhet të jetë 60% e pagës mesatare në Kosovë.

Qeveria mos përgjigjen ndaj kësaj kërkesë e arsyeton me faktin se Fondi Monetarë Ndërkombëtar dhe Banka Botërore nuk po lejojnë ngarkesa të buxhetit me shpenzime shtesë për pensione.

Por derisa për ngritjen e pensioneve institucionet financiare ndërkombëtare nuk po japin leje atëherë shtrohet pyetja - përse nuk paska kufizime të tilla për shpenzime tejet të larta për vetura, për telefona mobil, mëditje jashtë vendi, dreka dhe darka reprezentative dhe për paga të funksionarëve të lartë publik?

Për të dhënë përgjigje në pyetjen e shtuar do të merrja për shembull Draftligjin mbi pagat e zyrtarëve publik, i cili po ja u rikujtoj se ka qenë i paraparë për rend të ditës për këtë seancë e sipas të cilit ngritja e pagave për zyrtarët publik përfshirë edhe ministrat këtu ishte propozuar për afro 50%. Pas kësaj rritje një pagë e tillë do të arrinte lartësinë e diku prej 25 pensioneve kosovare.

Qasja e këtillë e Qeverisë sonë ndaj kategorisë së pensionistëve është refleks i një politike të gabuar dhe diskriminuese e cila pensionistin kosovar e vë në kategorinë e personave me pagesë më të ulët në tërë Evropën. Kështu pensioni mesatarë në Kosovë, pa këtë rritjen e fundit të premtuar nga kryeministri që ishte e karakterit kryekëput politik, ka qenë 62.5 euro, kurse në vendet tjera të regjionit pensionet janë prej afro 3 deri në 10 herë më të larta.

Por një gjë e tillë nuk mund të thuhet edhe për pagat mesatare, sepse paga mesatare prej 370 euro, sa është në Kosovë është më e lartë se sa pagat mesatare të disa vendeve të regjionit, konkretisht është më e lartë se paga mesatare në Serbi, Shqipëri dhe Maqedoni, kurse është e përafërt me ato në Bonje dhe Mal të Zi.

Andaj, për një trajtim dinjitoz dhe të respektueshëm të pensionistëve kosovarë propozoj që lartësia e pensioneve të caktohet në një përqindje prej 50 apo 60% të pagës mesatare në Kosovë.

Por ky ligj, përveç që normon një politikë të gabuar ndaj pensionistëve përmban edhe dispozita të palogjikshme dhe të papranueshme.

Kështu për shembull në nenin 11, paragrafi 3, që u theksua edhe nga kolegja Bakalli, përcaktohet që pensioni invalidor i punës është në shumë të njëjtë me pensionin bazik të moshës, që do të thotë se shoqëria jonë duhet të paguajë njëjtë sikurse personi te i cili është shfaqur paaftësia e plotë për punë si pasojë e lëndimit në punë, ashtu edhe personin i cili fare nuk ka punuar por i cili thjesht ka mbushur 65 vjet jetë, gjë që mendoj se është dispozitë e palogjikshme e cila duhet ndryshuar në drejtim të dallimit ndërmjet këtyre dy kategorive të pensionistëve.

Po ashtu dispozitat e paragrafit 6, të nenit 12, janë të paqarta, sepse nuk sqarojnë se pensioni familjarë a do të rritet për 20% për secilin fëmijë veç e veç në familje, apo për një e më shumë fëmijë i njëjti do të rritet për 20%?

Gjithsesi dispozitat më të pranueshme për një shoqëri demokratike dhe humane çfarë pretendon të jetë shoqëria kosovare, hasen në nenet 15 dhe 16, në të cilat parashihet që pagesat e pensioneve do të lejohen vetëm deri në atë masë sa ka fonde të mjaftueshme në dispozicion për pagesa të tilla.

Si dhe përcaktohet që Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim me të cilin redukton apo eliminon çfarëdo pensioni të paraparë me këtë ligj.

Dispozitat e këtilla jo vetëm që janë në kundërshtim me parimet kryesore të këtij ligji, por janë dispozita që krijon një pasiguri juridike për pensionistë e të cilat në një farë mënyre paraqesin rrezik jo vetëm për pagesën e pensioneve, por edhe për mirëqenien dhe ekzistencën fizike të tyre.

Po ashtu edhe në nenin 22, paragrafi 1.3 haset një shprehje e papranuar. Konkretisht në këtë nen bëhet fjalë për ndërprerjen e pagesës së pensioneve dhe thuhet: “se kjo ndërprerje mund të bëhet nëse vlerësohet se pensionisti ka bërë mashtrim” Vlerësimi mund të jetë i natyrës perceptivë, andaj shprehja e tillë mund edhe të keqpërdoret dhe thjesht personit të caktuar, për shkak të përceptimi mund t’i ndërpritet pagesa.

Andaj mirë është që fjala “vlerësim” të zëvendësohet me fjalën “vërtetim” që në esencë paraqet konstatimin e argumentuar se personi ka bërë mashtrim.

Dhe në fund neni 31, me të cilin parashihet që nenet 11 dhe 12 do të fillojnë të zbatuari nga janari i vitit 2016, është po ashtu i papranueshëm për pensionistët kosovarë të cilët edhe ashtu po fajin e tyre nuk janë paguar për 3-4 vjet gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë.

Andaj, duke pasur parasysh të gjitha këto të metat e këtij draftligji kërkoj nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, që mos ta aprovojnë të njëjtin. Ju faleminderit, për vëmendje!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë në fillim dëshiroj të theksoj se është mirë që të ndërpritet praktika e sjelljes së teksteve të njëjta të ligjeve të cilat ky Kuvend i kthen në Qeveri për të reflektuar mbi diskutimin që është bërë këtu dhe mbi idetë që janë dhënë këtu.

Prandaj, sot është pak e pazakonshme për të mos thënë e çuditshme që kërkohet që ne diçka që kemi thënë para dy muajve ta ndryshojmë mendimin e teksti ka ngelur i njëjtë për një projekt apo draft të ligjit.

Debati herën e kaluar ka qenë shumë i pasur, ka pasur shumë ide edhe mendoj se mbi baza të atyre ideve kanë mundur bile të bëhen hapa simbolik që të zgjidhet problemi i pensioneve.

E dimë se buxheti i Kosovës nuk i ka mundësitë që këtë çështje ta zgjedhë në mënyrën më fatlume, prandaj kërkohet edhe nga Ministria e Financave dhe nga Qeveria që të bëjnë një lloj prioriteti të zgjidhjes së çështjeve që janë më aktuale.

Ne kemi të bëjmë me pensionistët, me shtyllën e parë të sistemit aktual të pensioneve të cilën e marrin të gjithë banorët e Kosovës, që kanë qenë në marrëdhënie pune ose nuk kanë qenë në marrëdhënie pune kur i mbushin 65 vjet dhe kjo është në rregull.

Kategoria tjetër e goditur janë invalidët e punës për të cilët foli parafolësi edhe unë nuk dua të vazhdoj sepse pajtohem me atë që tha.

Dhe kategoria tjetër më e goditur janë pensionistët të cilët trashëgojnë të drejtën e pensionit nga sistemi i kaluar dhe këta janë pjesa më e rrezikuar e shoqërisë. Këtu kërkohet zgjidhja specifike, nuk po shohim asnjë përpjekje që të bëhet kjo zgjidhje. Agonia e këtyre njerëzve të cilët kanë probleme ekzistenciale po zgjat me vite. Mendoj se kjo shoqëri po sillet në një mënyrë papërgjegjshme ndaj tyre. Shumica prej tyre nuk kanë pasuri tjetër, bazohen në këto pensione, kanë probleme shëndetësore, kanë probleme me barëra dhe numri i tyre nuk është aq i madh sa të jetë i papërballueshëm për buxhetin. Ne kemi dhënë ide herën e kaluar që të shikohen edhe burimet tjera, burimet speciale.

Mendoj se ne nuk mund të adresojmë këtë problem me një komoditet të tillë sa që të fusim norma që do të zbatohen vitin 2016. Në vitin 2016, edhe 4 vjet një pjesë shumë e madhe e këtyre njerëzve do të shkojnë në botën tjetër, pa një kujdes minimal nga kjo shoqëri.

Prandaj, mendoj se ligji duhet të shkojë në Qeveri, Qeveria duhet të reflektojë debatin nga seanca e kaluar, debatin nga seanca e sotme dhe në një afat sa më të shkurt ta sjellë këtë ligj në Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Duhet ta mirëpres për të satën herë sjelljen e këtij projektligji në Kuvend, sado që i kam parasysh edhe ato që u thanë.

Kur sillet një ligj ashtu siç është kthyer, ka një defekt, megjithatë, ndoshta nuk duhet të mbetemi rob të kësaj situate. Projektligji është kështu siç është dhe mendoj Kuvendi ka mundësinë që ta marrë në shqyrtim dhe ai të bëjë ndryshimet e duhura, në marrëveshje me Qeverinë, ose në bashkëpunim dhe veçanërisht duke përfshirë përfaqësuesit e pensionistëve dhe për mendimin tim duke shfrytëzuar përvojat e vendeve të afërta në tranzicion të suksesshëm.

Unë e quaj krejt të panevojshme të flas sa është e rëndësishme kjo çështje, sa është e ndjeshme, është një çështje që nuk do koment.

Është vërtet një pozitë veçanërisht e rëndë e një kategorie që është shumë e merituar për këtë që kemi sot, të cilës i kemi borxh si shoqëri dhe mendoj që nuk meriton një trajtim të tillë çfarë ka.

Nuk është çështje sociale kjo, ose vetëm sociale, nuk është çështje mëshirimi, nuk është çështje gjynahu, është çështje e së drejtës. Është një e drejtë që u takon, që është nëpërkëmbur, një e drejtë që në fund të fundit është e garantuar edhe me akte universale që na obligojnë.

Megjithatë, mbetet një pikëpyetje, a ka mundësi shoqëria kosovare ta rregullojë më mirë dhe për mendimin tim përgjigjet duhen gjetur edhe në pyetjet që shtrohen. Në ka një fond të privatizimit që po vegjeton dhe po zhvleftësohet sipas njoftimeve që kam unë, i kujt është ai fond? Sa është pjesa e pensionistëve që na përcjellin sot në atë fond dhe të cilin ne nuk po e shfrytëzojmë as për zhvillimin e Kosovës, as për zgjidhjen e problemeve të rënda sociale?

Megjithatë, ka edhe një dilemë konceptuale që këtu u shtrua disa herë- cili është modeli i ndërtimit të sistemit të ardhshëm pensional dhe zgjidhjes së çështjes së hapur? Është skema pensionale, apo Fondi pensional, është zgjidhja mbi bazën e kursimeve, apo mbi bazën e sigurimit social? Mendoj që edhe në këtë dilemë përgjigjen mund ta gjejmë te përvoja e vendeve me të kaluar të përafërt dhe me tranzicion të suksesshëm. Nuk ka arsye që Kosova të jetë përjashtim në këtë çështje.

Një çështje tjetër që imponohet dhe kërkon zgjidhje është e vërteta për Fondin pensional të Kosovës, në të kaluarën. Kurrë nuk u sqarua çka ndodhi me atë fond? Le të jetë aq sa është, por megjithatë Kosova ka nevojë, opinionin, pensionistët kanë nevojë të dinë të vërtetën, çka ndodhi me atë, pse injorohet kjo çështje, pse kjo çështje nuk u vu asnjëherë në tryezën e dialogut midis Kosovës dhe Serbisë? Dhe është një çështje që po ashtu nuk do shumë mend për të parë se është një padrejtësi e madhe, Kosova ka pasur mëvetësinë e saj në këtë çështje, pse e injorojmë?

Po për të mos zgjatur në çështje të tilla, unë megjithatë mendoj që këto çështje duan adresuar dhe duan zgjidhur në proces, pa u bërë peng të kësaj lojë pingpongut Qeveria na e sjell si të këtillë, ne e kthejmë atje dhe në këtë mënyrë vetëm zvarritet çështja.

Mendoj që ligji duhet të kalojë kështu siç është dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme në procedurën e amendamentimit.

Në funksion të kësaj unë dua të shtroj edhe një çështje tjetër. Ligji duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe dua të shquaj këtu nevojën e përfshirjes të një kategorie që është lënë jashtë edhe kësaj gjuhe që është me skemat pensionale, çështjen e ish të burgosurve politikë. Atyre jo vetëm që u është ndërprerë puna, jo vetëm që u është mohuar puna e kaluar, por u është ndërprerë edhe shkollimi, u është ndërprerë praktikisht karriera, u është ndërprerë jeta, u është ndërprerë edhe dëmtuar familja. Prandaj, në nenet përkatëse që kanë të bëjnë me, qoftë me pensionin e parakohshëm, qoftë me pensionin për aftësi të përhershme, qoftë për pensionet invalidore, duhet të përfshihen në mënyrë adekuate edhe ish të burgosurit politikë që i përmbushin kushtet me ligj. Mos të harrojmë që ata në përgjithësi janë përfshirë në punë të detyrueshme dhe kjo duhet të merret parasysh. Në fund të fund për këtë ka edhe një obligim ndërkombëtar, na obligojnë rezolutat e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, na obligon ligji që është miratuar. Natyrisht, nuk kërkojmë që me këtë të vështirësohet çështja, por nuk mund të kuptohet logjika që një farë mënyre të merren parasysh ata që i kanë denoncuar, që i kanë arrestuar, që i kanë burgosur, i kanë torturuar, i kanë diferencuar, e u kanë shkaktuar gjithçka, kurse viktimat e tyre të përjashtohen nga kujdesi edhe në këtë fushë pensionale.

Ligjit mund t'i bëhen edhe vërejtje tjera dhe unë do t'i përmend dy.

Çështja e afateve, mendoj që nuk duhet lejohet që ajo të qohet vërtet në kalendat greke, duhet të përshpejtohet zgjidhja e çështjes dhe në dispozitat, në nenin 16 të reduktimit, mendoj që duhet rishikuar ajo, sepse nuk është një çështje që rregullohet me ligj, nevoja e si thuash që në rast të vështirësive, në raste kur Qeveria e konsideron, mund të reduktohen pensionet e të tjera. Krijohet mundësia që diçka që rregullohet me ligj, pastaj fare lehtë edhe pa ndonjë procedurë të ndryshohet, të reduktohet dhe të zhbëhet. Mendoj që dispozita të tilla nuk duan lejuar fare në legjislacionin tonë.

Unë besoj se vërejtjet këto që thashë unë dhe disa që kanë bërë deputetët tjerë, mund të përfshihen në procesin e amendamentimit dhe mendoj që zgjidhja më e mirë është Ligji të mos kthehet, le ta marrë këtë punë Komisioni përkatës, le t'i përfshijë në punën e vet edhe përfaqësuesit e pensionistëve, edhe ekspertët, le t'i marrë përvojat e vendeve tjera dhe le të gjejnë zgjidhjen që e adreson dhe e vë në rrugën e zgjidhjes problematikën e madhe të pensionistëve dhe që nuk e dëmton, nuk e bankroton shtetin e ri të Kosovës. Unë e shoh këtë të mundshme dhe besoj se edhe kështu mund të jetë zgjidhja më e mirë. Edhe një çështje në fund, kemi një obligim që të mos harrojmë edhe ish kolegët tanë deputetë, çështja e të cilëve po ashtu ka mbetur e pazgjidhur. U takon atyre që janë në Komisionin përkatës që edhe këtë çështje ta venë në rrugën e zgjidhjes. Uroj suksese! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Ju faleminderit!

Gjithashtu u bashkëngjitëm kolegëve të mi të cilët konstatuan që skemat pensionale me të vërtetë paraqesin një akt ligjor shumë të rëndësishëm, ndonëse edhe shumë të vonuar.

Sa i përket pensioneve dhe pensionistëve kjo nuk është hera e parë që po diskutohet, është fatkeqësisht është ku me ditë e sata herë që po diskutohet pikërisht edhe ky projektligj është projektligj apo skemë akt ligjor për të cilën jemi duke diskutuar për herë të dytë gjatë kësaj kohe. Por ardhja e tekstit pa ndonjë ndryshim, tregon përsëri atë jo seriozitetin me të cilën trajtohet kjo çështje aq e rëndësishme dhe aq e rëndë.

Ne të gjithë e dimë që pensionistët e sotëm në fakt janë ata të cilët e kanë pasur barrën e funksionimit të shtetit në kohërat shumë të vështira. Por në trajtimin e tyre prej 1999 e deri tash shohim që ky diskriminim vazhdon dhe ajo puna e rrënd të cilën e kanë bërë prej 1990 deri më 1999, në fakt aq që njihet e as që shihet përmes punëve, përmes veprimeve edhe përmes dokumenteve ligjore të cilat i sjellim këtu.

Çështja tjetër ka qenë që stazhi i tyre pensionistëve pas luftës nuk është llogaritur.

Gjithashtu Fondi pensional për të cilën edhe është diskutuar edhe më herët, Fondin pensional të cilën Serbia për pensionistët tanë prej 1999 e ka ndërprerë, ka qenë një çështje me të cilën Qeveria nuk është marrë edhe nuk ka diskutuar.

Unë në këtë Parlament para pak kohe e kam ngritur këtë çështje edhe kam tregua për shembullin e dy pensionistëve kosovar të cilët çështjen e pensioneve apo ndërprerjes së pensioneve të tyre e kanë qua deri në Gjykatën e Strasburgut dhe ajo gjykatë u ka dhënë të drejtë, do të thotë në qoftë se ata dy persona bashkëshortë kanë arritur që të marrin pensione prej 1999 deri tash dhe kanë pasur të drejtë përsëri po e them po e përsëris atë çështjen që e kam ngritur edhe më herët, pse Qeveria nuk ka ndërmarrë një veprim të organizuar që të kërkojë që pensionistëve tanë t'u kthehen pensionet prej 1999 deri më tash në qoftë se Gjykata e Strasburgut ka thënë që ajo është çështje e drejtë dhe mund të organizohet.

Në anën tjetër pensionistët zakonisht përmenden para fushatave edhe para veprimeve apo për blerjen e qetësisë sociale edhe kjo bashkë me dërgimin e teksteve të njëjta çdo herë tregon atë qasjen joserioze apo tregon atë zvarritjen që Qeveria e hedh topin te Parlamenti, Parlamenti i pakënaqur me tekstin e kthen te Qeveria, po në anën tjetër tregon që çështja e marrjes seriozisht me pensionistët po mungon.

Pensionistët deri më tash fatkeqësisht nuk kanë pasur jetë të dinjitetshme dhe këto zvarritje janë të dëmshme, po gjithashtu edhe miratimi i ligjeve gjysmake përsëri nuk shkon në dobi të pensionistëve, por shkon në dëm të tyre dhe vetëm që e zgjasim afatin e pakënaqësive të pensionistëve.

Edhe unë desha ta ngre çështjen e deputetëve të cilët kanë qenë këtu, deputetëve të cilët e kanë ndërtuar këtë ndërtesë edhe shumë ndërtesa, edhe shumë ndërmarrje me të cilët ka funksionuar Kosova, deputetët të cilët e kanë shpallur pavarësinë e Kosovës dhe

Kushtetutën në Kaçanik, deputetët të cilët sot janë në një gjendje shumë të padinjitetshme duke pritur prej kolegëve të tyre këtu që të merren me ata.

Çështja e fundit të cilën desha të ngre është që implementimi i rritjeve të pensioneve të premtuara parashihet që të fillojë prej 2016. Edhe një herë edhe një veprim i cili tregon që prioritetet e Qeverisë, prioritetet tona nuk parashohin kujdesin për ata të cilat e kanë ndërtuar edhe ata të cilëve u kemi borxh.

Mendoj ashtu si grupi im parlamentar që është më mirë që ligji të trajtohet edhe një herë që të plotësohet, që të ketë një qasje serioze dhe të vijë në Parlament, pa ndonjë reagim të kundërt, në mënyrë që pensionistët tanë sa më shpejtë të përfitojnë nga ky ligj dhe të kenë një jetë të dinjitetshme çfarë e meritojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht që jemi duke folur për një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme që po e përcjell Kosovën, veçanërisht prej vitit 1999, pra është çështja e pensionistëve dhe më saktësisht shkelja flagrante e të drejtave të tyre që ka ndodhur deri tash e që me propozim të Qeverisë, po synohet të ndodhë në të ardhmen përmes ligjit që e ka sjell këtu.

U ngritën këtu shumë çështje të cilat do t'i përmend edhe unë, mirëpo konsideroj që janë tri prej tyre që janë shumë të rëndësishme për çështjen e që nuk i ka ligji, natyrisht. Këto jo vetëm që janë kërkesa të pensionistëve, por janë kërkesa ose qëndrime të secilit person që e sheh këtë çështje me seriozitetin të cilin e ngërthen këtë, ku natyrisht po përjashtohet Qeveria, po vetë përjashtohet Qeveria me ligje që po i sjell në Kuvend.

Pra, duhet të nisemi nga një çështje që është jashtëzakonisht parimore, nuk mund ta diskutojmë skemën pensionale edhe politikat pensionale pa u nisur nga fakti që pensioni është e drejtë. Pra, kur të merremi vesh për këtë çështje atëherë shumë gjëra tjera do të qartësohen, mirëpo këtu nuk po merremi vesh me Qeverinë. Pra, ne po themi edhe pensionistët po thonë edhe gjithë bota demokratike e thotë që pensioni është e drejtë e patjetërsueshme e cila nuk lejon të shpërfilllet, ndërkohë që Qeveria edhe me ligj po edhe me sjelljet e saj të deritashme, ka treguar që kjo e konsideron pensionin si një favor, një lëmoshë të cilën ua jep pensionistëve sa herë që kjo konsideron se duhet t'u jepet dhe sa herë që kjo ka nevojë që kredibiliteti publik i saj të ngritët, pra duke i përdorur kështu pensionistët si një far mjeti përmes së cilit kjo synon t'ia vazhdojë vetes jetën në pushtet.

Me ligjin që e ka sjell Qeveria këtu edhe në fjalën e ministrit, i cili tha që kaq mundemi, më shumë nuk mundemi, Qeveria po thotë shumë qartë që unë si Qeveri nuk mund t' i përfillë edhe t' i respektojë të drejtat e qytetarëve të Kosovës. Pra, nëse nisemi nga parimi që pensioni është e drejtë dhe Qeveria po thotë që nuk mund ta respektojë këtë të drejtë, atëherë Qeveria po tregon që nuk është e aftë t' i respektojë të drejtat e qytetarëve.

Një Qeveri që nuk është e aftë t' i respektojë të drejtat e qytetarëve, nuk mendoj se e ka vendin këtu edhe nuk mendoj se e meriton që quhet Qeveri e Kosovës, për shkak se

Qeveria para se gjithash dhe mbi të gjitha duhet të kujdeset për të drejtat dhe interesat e qytetarëve të cilët thirret se i përfaqëson.

Kur të nisemi nga pensioni si e drejtë, atëherë shumë qartë do ta kemi që nuk është madje as në e drejtë e deputetëve e as e Qeverisë që të vendosin nëse do t'ua japim pensionin apo jo.

Deri tash kemi pasur edhe në ligje tjera edhe me këtë ligj një tendencë të Qeverisë për të futur klauzolën në to, me të cilat thotë që ne u japim pensione , por në momentin kur kemi vështirësi financiare, atëherë ua ndalim këto pensione sikur pjesëtarëve të FSK-së, sikur te skemat sociale, tash edhe me Ligjin për pension, pra po ju thuhet pensionistëve dhe të tjerëve që kanë nevojë natyrisht për parat që jepen nga buxheti apo ndahen nga buxheti në mënyrë që të mbijetojnë, po u themi që në fakt ne kemi të drejtë sa herë që donë t'ua ndalim ato pra dhe kemi të drejtë në një farë mënyre t'ua ndalim bukën e gojës, kjo është porosia që Qeveria u dërgon qytetarëve. Pra nuk e konsideron si të drejtë, po të kishte qenë e drejtë atëherë natyrisht që nuk ka të drejtë as Qeveria e askush tjetër t'ua thotë këtë gjë pensionistëve.

E drejta në pension, natyrisht që e sjell domosdoshmërinë e krijimit të një fondi pensional, për shkak se fondi pensional do t'i çlironte pensionistët jo vetëm këta aktual, por edhe në të ardhmen nga arbitrariteti i Qeverisë cila do qoftë ajo. Kur ka fond pensional atëherë Qeveria nuk e ka mundësinë që të vendosë nëse do t'u ndajë pensione apo jo qytetarëve pensionistë të Republikës së Kosovës.

Pra, Fondi pensional përfundimisht i ndan pensionistët nga arbitrariteti i Qeverisë dhe nga ky perceptim i Qeverisë që po u bën favor edhe po u jep lëmoshë atyre pensionistëve.

Po ashtu, Fondi pensional, i cili do të financohej nga kontributet që do t'i paguajnë qytetarët e Kosovës, ajo pjesa aktive e qytetarëve të Kosovës, të cilët janë të punësuar, të cilët do të punësoheshin, do të shërbente edhe si mekanizëm solidariteti , që është shumë i rëndësishëm jo vetëm në shoqërinë tonë po në secilin shoqëri që do të vazhdojë të jetojë si shoqëri. Pra, nuk ka shoqëri pa solidaritet dhe solidariteti në këtë rast mes gjeneratave me qenë se po flasim për pensionistët, është i domosdoshëm për kohezionin social dhe Qeveria edhe cili do institucion publik i Kosovës, do të duhej që çështje primare ta konsideronte kohezionin social. Ndërkohë që kjo Qeveri e jona, jo vetëm që nuk e konsideron këtë çështje primare, po e sulmon solidaritetin me secilin mjet që kjo e ka në dorë.

Pra, Fondi pensional do t'u garantonte të drejtën pensionistëve dhe është e drejtë e pensionistëve që statusi i tyre dhe kjo është çështja e tretë për të cilën dua të flas, statusi i pensionistit të jetë i garantuar me ligj. Pra, që statusi i pensionistit të jetë i mbrojtur me ligj dhe që askush të mos ketë të drejtë e as mundësi që ta ndryshojë, modifikojë madje edhe luftoj atë siç po ndodhë aktualisht.

Kjo çështja e pensionistëve e thashë edhe më herët nuk është çështje që ka lindur dje, është një çështje që po na përcjell prej vitit 1999 e tutje. E duhet ta kemi parasysh një gjë.

Në ligjin e parë për pensione që është miratuar nga Kuvendi, atëherë Institut i Përkohshëm i Vetëqeverisjes, në vitin 2001, mos gabofsha, e ka bërë ose e ka instaluar padrejtësinë fillestare në këtë çështje në Kosovën e pasluftës, për shkak se është bërë një ndarje e padrejtë ndaj atyre që atëherë ishin në pension dhe atyre të tjerëve të cilët priteshin ose do të dilnin në pension në vitet në vazhdim.

Pse është bërë kështu, për shkak se ajo që është quajtur si reformë pensionale në fakt nuk ka qenë reformë fare, por ka qenë instalim i një sistemi të ri pensional ku është përfillur tërësisht e drejta e pensionistëve dhe ky avaz që e konsideron pensionin si një farë lëmoshe që e jep Qeveria e jo si e drejtë, ka nisur që atëherë në kohën e UNMIK-ut me ligjin e parë për pensionet kur edhe është themeluar Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës. Pra, ajo që në zhargonin profesionist quhet "borxhi implicit publik", pra borxh që Qeveria, shoqëria në përgjithësi, shteti, ia ka pensionistëve për shkak të punës të tyre edhe kontributit të tyre, këtu nuk është marrë parasysh fare në Kosovë dhe që prej atëherë ende nuk merret parasysh.

Pra, nuk kemi ne një Qeveri edhe nuk kemi pasur edhe nuk e kemi këtë aktualen e cila po synon që ta përmirësojë këtë padrejtësi fillestare që është bërë në kohën e UNMIK-ut ndaj pensionistëve, ndërkohë që po kërkohet nga pensionistët që për një rritje sa do të madhe apo të vogël të jetë ajo, ta pranojnë padrejtësinë dhe ta legjitimojnë padrejtësinë e cila është bërë ndaj tyre, po që të mos keqkuptohemi është padrejtësi ndaj gjithë qytetarëve për shkak se të gjithë qytetarët e Kosovës një ditë do të bëhen pensionistë, pra do të dalin në pension. Natyrisht që përjashtohen deputetët edhe Qeveria e Kosovës për shkak se edhe me legjislaturat e kaluara e kemi parë një zell të pa shoq të deputetëve që për sa i përket vetes t'ia përmirësojnë situatën dhe të marrin masa të mbrojtjes me ligj, në mënyrë që të mos vijnë në pozitën të cilën janë pensionistët sot.

Dhe ne konsiderojmë që e kemi për detyrë si Kuvend që kësaj çështje t'ia japim përgjigjen e duhur e përgjigja e duhur është që ta bëjmë pensionin të drejtë, ta bëjmë statusin e pensionistit të mbrojtur me ligj dhe këtë mbrojtje edhe këtë të drejtë ta realizojmë përmes Fondit Pensional, i cili është i ndarë nga arbitrariteti i Qeverisë dhe i cili e garanton solidaritetin shoqëror.

Prandaj, nëse këtu na thuhet sot siç na është thënë edhe dje, që ma mirë ta kemi një ligj të keq, se sa të mos kemi ligj fare, ne u themi edhe pensionistët u kanë thënë që jo, jo kjo çështje nuk rregullohet me çfarëdo ligji.

Është vetëm një mënyrë për ta rregulluar këtë në mënyrë të drejtë dhe ajo është krijimi ose realizimi i kërkesave që i kanë edhe pensionistët dhe realizimi i të drejtave universale për sa i përket çështjes së pensioneve dhe për sa i përket kujdesit që shoqëria e ka për këtë moshë ose këtë pjesë të shoqërisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para disa muajve në këtë Kuvend ne kemi pasur një debat në lidhje me skemat pensionale. Atëherë kam shfaqur shqetësimin për qasjen ndaj politikave sociale dhe promovimit të reformave të zgjidhjeve duke u thirrur në politikat e skemave sociale të Bashkimit Evropian.

Në realitet, vetë Shtetet e Bashkimit Evropian, njëra pas tjetrës po paralajmërojnë se skemat aktuale pensionale të tyre do të dështojnë nëse nuk bëhet rishikimi thelbësor i tyre.

Kriza financiare, madje edhe Gjermaninë e ka detyruar që ta shtyjë moshën e pensionimit në 68 vjet.

Greqia si masë të menjëhershme të kursimeve është detyruar që ta zvogëlojë shumën e pensioneve për 30%. Me një fjalë të gjitha vendet e Bashkimit Evropian janë të alarmuara dhe po kërkojnë modele të reja të financimit, por edhe vetë përmbajtjes së këtyre skemave. Kurse ne pikërisht tashti ku në vendet e Bashkimit Evropian po flitet për një dështim të këtyre skemave, po hartojmë projektligje duke u thirrur në standardet e Bashkimit Evropian.

Shembulli më i freskët i këtyre ditëve është Gjermania e cila edhe pse është promotore e ekonomisë së Bashkimit Evropian, aty ka plasur një debat pro e kundër ndërhyrjes së shtetit me fonde shtesë në mbështetje të fondeve të skemave aktuale që po zvogëlohen.

Të nderuar deputetë,

Në Kosovën tonë popullsia është ende e re edhe për një kohë ajo nuk do t'i ketë shqetësimet që i ka sot Evropa Perëndimore, ku të moshuarit e dominojnë numrin e përgjithshëm të popullsisë, në raport.

Por më duhet të them se sinjali i parë në Kosovë ka ardhur në këtë vit kur Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, njoftoi opinionin se në këtë vit shkollor në klasë të parë në krahasim me vitin e kaluar i kemi të regjistruar më pak 8000 nxënës. Ky është një sinjal i parë që të kemi kujdes me politikat sociale.

Unë nuk jam i sigurt sa po u ofrojmë gjeneratave të ardhshme skema sociale e pensionale të qëndrueshme, apo po përpiqemi që ta blejmë paqen sociale e problemet reale t'ua lejmë që të zgjidhin ata që vijnë pas nesh.

Pas vitit 1999, për shkak të pamundësisë së zbatimit të ligjeve të mëhershme, rrethanat e reja kanë ndikuar që skemat pensionale të fillojnë të zbatohen vetëm nga viti 2002. Kjo ndikoi drejtpërdrejt te pensionistët kontribut-dhënës, të cilët mbetën edhe sot e asaj dite pa pensionet e tyre.

Tash kanë kaluar 12 vjet dhe nuk duhet të aprovojmë ligje sa për t'i mbyllur problemet aktuale, por duhet të kemi vizion për të ardhmen dhe ligjet t'i aprovojmë për kohët që po vijnë.

Kurse kërkesat e pensionistëve aktual kontribut-dhënës duhet t'i zgjidhim me masa të përkohshme, që edhe ata të ndihen mirë, sepse reformat në skema pensionale, rezultatit e tyre të plotë e japin vetëm pas një jete pune, pas 40 vjetëve. Pra, rrethanat kanë ndikuar që Kosova e ka një rast historik që të hartojë skema pensionale shumë të mira, të qëndrueshme për kohën që po vjen.

Mu për këtë unë mendoj që për këtë projektligj edhe nëse e aprovojmë në parim, para se të bëhet leximi i dytë është e nevojshme që të hapet debati publik në të cilin do të mund të merrnin pjesë ekspertë të shkencave sociale, ekonomistë, juristë, financierë dhe grupe tjera të interesit, për ta rregulluar këtë siç është më së miri.

Mendoj se nga ky debat nuk duhet të përjashtohet as Trusti Pensional i Kosovës, të cilin ky Kuvend veç e ka legjitimuar si trust privat, por në të cilin e ka emëruar edhe një bord mbikëqyrës të tij, e mendoj se është i gabuar, sepse në skemat private as punëdhënësit dhe as punëmarrësit nuk mund të obligohen me ligj që t'i derdhin kursimet e tyre në këto fonde.

Madje, sa për dijeni, numri i ndërmarrjeve private që nuk i derdhin paratë e tyre në fonde të trustit po rritet dhe punëtorët po dëmtohen dyfish. Funksionimi i Trustit Pensional duhet të studiohet rrënjësisht për të mësuar se e kujt është ideja e funksionalizimit të tij. Nëse kjo ide është e bankierëve, duhet të shqetësohemi, sepse ka shumë gjasa që ai të falimentojë një ditë. E, nëse kjo është një ide e ekspertëve të shkencave sociale, atëherë këtë duhet ta marrim si model bazë për skemat pensionale në Kosovë. Në të kundërtën, Trusti Pensional, kështu siç është, më shumë i ngjan një ndërmarrjeje publike.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj, për të cilin po debatojmë sot, nuk zgjidh asgjë. Ky vetëm sa i ka identifikuar skemat pensionale, që duhet të financohen nga shteti dhe asgjë më shumë, madje as shifrat e kostos financiare nga viti në vit nuk më duken se janë të sakta. Megjithatë, ka mundësi, pas miratimit të një shtese për pensionistët, që komisioni përkatës të merret me këtë problem dhe ka kohë që këtë ta shqyrtojë me një debat të gjerë, në të cilin do të thirren të gjitha palët e interesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Asllanaj?

SALI ASLLANAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Në lidhje me skemat pensionale, disa herë po diskutojmë dhe po duket sikur po sillemi në një rreth vicioz, nga i cili realisht nuk po gjejmë zgjidhje.

Nuk pretendoj ta fajësoj ministrin apo Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që i kanë fajet për këtë propozim-ligj, që vjen disa herë i njëjtë, por mendoj që është një qasje

qeveritare e gabuar komplet, e cila nuk po gjen mënyra që ta krijojë një fond më të madh, në mënyrë që t'i kompensojë njerëzit për punën e tyre në të kaluarën.

Gjithmonë duhet të mendojmë kur flasim se a ka mundësi që të punësuarit aktualë të ndajnë mjete shtesë, në mënyrë që të krijohet një fond i ri për pensione. Unë mendoj që janë të shteruara mundësitë edhe të të punësuarve, sepse të ardhurat janë minimale, por gjithsesi mendoj që ai solidariteti i gjeneratave do të duhej të kthehej dhe patjetër do të duhej të gjendeshin mjete që pensionistët tanë ta kenë një mirëqenie minimale të jetës.

Në këtë aspekt, unë mendoj që nuk do ishte dëm hiç fare nëse komplet fondi i Trustit Pensional të Kosovës kthehet në funksion të ministrisë dhe në funksion të pensionistëve, sepse llogaris që unë ua kam borxh prindërve që të kontribuoj për ta, sikur edhe bijtë tanë na e kanë borxh neve. Në këtë aspekt, mendoj që edhe nuk do të ishin ngarkuar shtesë punëtorët me kontribute shtesë, po në të njëjtën kohë kishim bërë që zgjidhja ndaj pensionistëve të jetë shumë më e dobishme, shumë më e mirë.

Vërtet është e papranueshme ajo kur tentohet të kapërcehen periudha kohore të caktuara, kur arsimtarët dhe mjekët kanë punuar në një kohë të vështirë të viteve të '90-ta, ajo tash të kapërcehet e të mos merret si bazë për pensionin e ardhshëm. Realisht, do të duhej secili t'i mbajë rrënjët e veta. Rrënjët tona janë krijuar historikisht dhe në këtë aspekt sikur nganjëherë po kemi dëshirë t'i kapërcejmë të gjitha këto.

Nuk do të duhej që as ky Kuvend të lejonte që qeveritarët, qoftë të sotëm, qoftë të nesërm, të luajnë me pensionistët dhe sipas momentit politik të bëjnë propozime, rritje, ose zvogëlime të ndryshme. Në këtë aspekt, unë mendoj që kemi përgjegjësi të gjithë që ta bëjmë një ligj konsistent dhe pa marrë parasysh ndërrimin e qeverive, pensionistët ta kenë një garanci, ta kenë një siguri pensionale, e cila ua mundëson një jetë të dinjitetshme.

Kjo që ka ndodhur deri më sot vërtet është për të të ardhur keq, vërtet është për të na ardhur turp të gjithë të pranishmëve këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë për Ligjin mbi skemat pensionale të financuara nga shteti dhe këtë debat mendoj që do të duhej vërtet ta orientonim në interes të vetë pensionistëve, të atyre që do të përfitojnë nga ky ligj, se sa të bëjmë politikë me anë të këtij ligji.

Nëpërmjet postës elektronike, të gjithë ne deputetët e kemi pranuar muaj më parë një kërkesë të Bashkimit të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës të Kosovës, të nënshkruar nga i nderuari kryetar Shaban Kajtazi. Në atë kërkesë janë paraparë disa propozime, të cilat Bashkimi i Pensionistëve dhe i Invalidëve të Punës i propozon. Janë gjithsej dhjetë propozime dhe konsideroj që në këtë ligj mund të inkorporohen gjatë amendamentimit,

sigurisht pas kalimit në lexim të parë. Mendoj, që ne pastaj do të duhej të fokusohemi bashkë me Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi që këto kërkesa të pensionistëve pastaj, pas kalimit të këtij ligji në leximin e parë, të inkorporohen në ligj dhe të adaptohen.

Ky ligj, në tërësi, e tha edhe ministri, e siguron të drejtën në pensionin bazik të moshës, të drejtën në pensionin e kontribut-paguesve të moshës, të aftësisë së kufizuar në pensionim të parakohshëm, në pensionin invalidor të punës dhe në pension familjar. Prandaj, është e padrejtë të thuhet që me anë të këtij ligji Qeveria ka tentuar ta mohojë të drejtën mbi pension. U tha se Qeveria i ka rritur pensionet ditë më parë për arsye politike. Konsideroj që nga rritja kanë përfituar pensionistët, e jo Qeveria, për arsye se Qeveria ka qenë në Qeveri dhe në detyrën e saj të punëve, ndërsa ata të cilët do të përfitojnë nga rritja janë pensionistët dhe mendoj që nuk do të duhej të manipulohet me këtë çështje.

Po sikur të mos ndodhte ajo rritje dhe kjo rritje tani të parashihej me ligj, po të njëjtit do të kritikonin se Qeveria ka tentuar që ligjin ta kalojë nëpërmjet kësaj rritjeje, e cila parashihet në ligj. Ndër të gjitha, edhe kërkesat që ligji të fillojë të zbatohet, nenet, në veçanti neni 11 dhe neni 12 i këtij ligji, prej vitit 2016, mendoj që këto çështje mund t'i diskutojmë gjatë amendamentimit dhe propozimet bashkërisht me sindikatat e pensionistëve dhe me shoqërinë civile dhe të gjithë të interesuarit tjerë. Prandaj, mendoj që të gjithë do të duhej t'i japim përkrahje këtij ligji.

Po diskutohet rreth asaj se a të vazhdohet me gjendjen aktuale siç është, në të cilën jemi pa ligj, apo të mohohet e drejta mbi pensionin bazë. Mendoj që do të duhet në këtë rast ta kalojmë ligjin në lexim të parë dhe pastaj të plotësohet në të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po diskutojmë për ligjin, s'po e kuptoj për çka replikë? Zoti Asllanaj e ka fjalën.

SALI ASLLANAJ: Jo, nuk ma ka përmendur emrin, por po më duket ka aluduar në mua. Dhe, unë mendoj që e vlen ta theksoj që u angazhova për një zgjidhje ligjore, e cila do ta bënte të qëndrueshëm dhe afatgjatë fondin pensional, ose krijimin e kushteve për një pension të qëndrueshëm. Dhe, në këtë aspekt unë mendoj që kur përmenda që rritjet e pensioneve, meqë i bie ndërmend dikujt brenda natës, objektivisht të bën mendosh që janë rritje politike, sikur edhe deklaratimet në Skenderaj, për shembull, që do të rriten rrogat e arsimtarëve për 40%, ose 50%. Dhe, në kokën e çdonjërit, që merret me politikë, i shkon që fushata elektorale filloi. Tash, këtë s'do të duhej lejuar me ligjet tona që i bëjmë, që dikush të bëjë politikë të momentit, në kurriz, qoftë të pensionistëve, qoftë të arsimtarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mustafa, e keni kërkuar fjalën përsëri.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Unë e mora edhe një herë fjalën për t'i përshëndetur pensionistët, të cilët besoj që me shumë interesim janë duke na përcjellë sot dhe ne këtu në Kuvend po përpiqemi të krijojmë përshtypje tek ata se dikush është për e dikush kundër.

Të gjithë po pajtohem se pensionistët meritojnë më shumë. Dhe, unë e thashë edhe në fjalën time, mendoj se sot duhet të votohet në parim. Ne në komision jemi shumë të përkushtuar, qysh prej momentit të parë kur ka ardhur në komision ky projektligj dhe të gjithë pa dallim kemi biseduar edhe për krijimin e një fondi dhe jemi shumë të interesuar që të punojmë edhe më tutje.

Thashë, edhe një herë po e përsëris, që nuk është fundi tash. Gjatë amendamentimit do t'i kemi parasysh edhe kërkesat e pensionistëve, që na kanë ardhur me shkrim, edhe praninë e tyre fizike. Dhe, të gjithë do të kontribuojmë që projektligji të jetë sa më funksional.

Por, të mos harrojmë edhe diçka! U tha nga ministri, por e dimë edhe ne të gjithë, sepse mosaprovimi i këtij ligji është pengesë për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet e ndryshme. Mos t'i harrojmë edhe qytetarët tanë në shtetet evropiane. Ne do të mundohemi ta bëjmë ligjin më funksional, që t'u krijojmë kushte pensionistëve, por të mos i harrojmë edhe bashkatdhetarët tanë në shtetet evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ferati!

SADRI FERATI: Faleminderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar kolegë,

U tha mjaft dhe kjo nuk është hera e parë që ne po bisedojmë për ligjin. Por, unë do të angazhohem që tani, ndërmjet dy leximeve, vërtet edhe një herë të ketë një qasje, të themi korrekte, në mënyrë që të kapet një optimum, sepse nuk ka maksimum në këto situata, në drejtimin që ajo të jetë transparente, të jetë shumë publike. Të jetë shumë publike, se cila është strategjia e kësaj fushe.

Ne flasim fjalë të mira dhe të gjithë e dimë se kemi shumë të afërm dhe njerëz që i vlerësojmë e që janë pensionistë, por konform këtij ligji, edhe ne të gjithë nesër do të bëhemi pensionistë. Pra, nuk flitet për atë se sa e duam, por se sa jemi të aftë të bëjmë zgjidhje racionale.

Këtë e them posaçërisht kur bazohemi në konventat e ndryshme, do të thotë në standardet dhe që pastaj të shihet cilat janë praktikat më të mira, sepse çështja e rregullimit të pensionit duhet të jetë një çështje strategjike për shtetin dhe unë mendoj se kjo nuk është shumë transparente dhe nuk po mund t'i bindim pensionistët dhe qytetarët se vërtet ne e kemi qasjen më të mirë.

Pse e them këtë? Sepse, i ndodh Kosovës në ndonjë fushë, në dy-tri fusha, ne i kemi pagat më të mëdha në rajon, ndërsa ndodh që në një fushë, siç janë pensionet, ne i kemi pagat më të ulëta në rajon. Tash, si do t'i bindim qytetarët dhe pensionistët se ne vërtet e kemi shfrytëzuar maksimumin.

Ne e dimë se cili shtet jemi, çfarë buxheti kemi, por duhet t'i bëjmë transparente principet. Mbi cilat principe? Ne një kategori e kemi më të paguarën, ndërsa pensionet i kemi më të ulëtat, madje edhe fyese. Prandaj, atë që e shtoi edhe kolegu, ne tash veç kemi

filluar të paralajmërojmë 50% në këtë fushë, 40% në atë fushë, ndërsa këto pensione janë lajmëruar pikërisht një javë apo dhjetë ditë para se të mbahen zgjedhjet e kaluara dhe ne dëshirojmë, që jo pagat e qytetarëve të Republikës së Kosovës gjithmonë të krijohen si motiv në prag të zgjedhjeve, por ta rregullojmë dhe ta bëjmë transparente se cila është strategjia e pagave në këtë vend. Sa do të paguhet zyrtarët e lartë, sa do të paguhet arsimi, shëndetësia, pensionet dhe të tjera? E atëherë, de fakto, do ta shohim me respektin më të mirë, me keqardhje dhe pa keqardhjen e askujt do ta shohim se pse janë pagat në arsim këto dhe ku duhet të shkojnë; pse janë pagat diferente ndërmjet një profesori dhe një mjeku dhe pse janë pensionet kaq të ulëta?

Prandaj, unë ju ftoj që ndërmjet dy leximeve të implementohet ky vizion, kjo strategji, këto parime dhe të kapet optimumi i këtij buxheti, që e kemi në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: I nderuar kryesues,
I nderuar ministër,
Kolegë deputetë,
Pensionistët janë njëra ndër shtresat më të ndjeshme të shoqërisë dhe nëse arsyeja mbizotëron te ne, nuk duhet në asnjë mënyrë dhe për asnjë çmim të manipulojmë me ta.

Nuk është mirë që mbi arsyen, logjikën dhe mundësitë reale të Buxhetit të Kosovës të mbizotërojnë hipokrizia e politikës ditore.

Pse e them këtë?

Këtu në Parlament flitet sikur pensionistët nuk qenkan pjesë e të gjithë neve, por vetëm e një pjese të politikës, që paska dhimbje dhe shqetësim të madh, e ne pjesa tjetër qenkemi të pashpirt, e që nuk interesohemi për ta. Mos të harrojmë që PDK-ja dhe koalicioni qeverisës brenda radhëve të veta i ka pensionistët, sikur edhe opozita. Edhe dëshira jonë është e madhe, sikur e tyre, por mundësitë janë ato që janë.

Ne të gjithë pajtohemi që gjendja e tyre nuk është më e mira, por mbetet e hapur mundësia, që të vazhdojmë më tutje për përmirësimin e mëtutjeshëm të tyre. Unë mendoj që sot ne duhet ta kalojmë Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe ashtu, siç e theksuan edhe kolegët deputetë, Hydajet Hyseni dhe kolegja Salihe Mustafa, që gjatë leximit të plotësohet, të amendamentohen, të inkorporohen të gjitha çështjet që konsiderojmë që janë të mundshme që ligji të jetë sa më i plotësuar, kështu që ta kemi një ligj për pensionistët, sepse koha do të tregojë se më i rëndësishëm për pensionistët, për këtë kategori të ndjeshme të shoqërisë, është ligji, se të gjitha lëvdatat, ose kinse “dhimbja” për ta, që bëhet nga shumë prej nesh sot këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Po më vjen shumë keq kur po i dëgjoj demagogjitë e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu demagogjitë e disa deputetëve të pozitës, sepse ky ligj është më mirë të... Mua po më vjen keq, plot dy ditë pensionistët i kemi në sallën e Parlamentit të Kosovës dhe janë duke pritur diçka më të mirë për ta. Është shumë më mirë të dalë ministri në foltore dhe t'u drejtohet pensionistëve e t'u thotë që ky projektligj, pjesa dërmuese e këtij ligji nuk zbatohet deri në vitin 2016. E tash jemi në vitin 2012, domethënë ministër, deri në vitin 2016, edhe katër vjet, këta pensionistë nuk kanë shpresë që do të realizohen shumica e të drejtave të tyre. Kjo është e para.

E dyta, qysh mund të themi ne që po e pranojmë në parim projektligjin, e kur të shkojmë në komision do të bëjmë ndryshime, kur kornizat kryesore të këtij projektligji janë të përcaktuara qysh tani. Kjo e tregon një joseriozitet të Qeverisë sonë. Kjo tregon që ka vetëm presion që të miratohen disa ligje dhe të kalojnë, e nuk tregon që ka interes për këtë kategori të caktuar. Ju, zoti ministër, e pranuat edhe vetë në fillim të fjalimit tuaj që keni presion nga disa organizata ndërkombëtare, nga FMN-ja, nga Banka Botërore, e shumë të tjera, që këtë projektligj ta miratoni në formën ku ta di si, por veç të mos jetë në interes të qytetarëve të Kosovës.

Mua po më vjen jashtëzakonisht keq që deputetët e pozitës janë pajtuar që ta kalojnë këtë ligj, kur një pjesë dërmuese e qytetarëve të Kosovës, të cilët në vitet kryesore kanë punuar pa asnjë pagë, janë të anashkaluar dhe të diskriminuar prej këtij projektligji.

Nuk e di si mund të krenohemi me një ligj të tillë, i cili e diskriminon një pjesë të madhe të shoqërisë kosovare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit, fjalën e ka zoti Pajaziti!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Dëshiroj vetëm të konfirmoj gatishmërinë time, që nëpërmjet deputetëve të Grupit Parlamentar të PDK-së të angazhohem në procesin e amendamentimit të këtij projektligji. Mendoj që, edhe pse i vonuar ky projektligj, më në fund e rregullon këtë fushë, e cila ka qenë dhe mbetet fusha më e ndjeshme për gjithë spektrin politik, dhe për qeveritë deri më tash.

Mendoj që nuk është momenti nga askush, pavarësisht çfarëdo përkatësie politike i takon, të manipulojë me retorikë për këtë çështje që është kaq e ndjeshme për një kategori të qytetarëve që kaq shumë kanë hequr dhe kaq shumë kanë punuar dhe aq pak janë shpërblyer nga shoqëria.

Si do që të jetë, mendoj që ky ligj përfundimisht u dedikohet ndarjeve të kategorizimit të krejt atyre përfituesve, që do të dalin nga ky ligj, që është konsideruar edhe nga vetë përfaqësuesit e tyre, sindikatat e ndryshme dhe është cilësuar si shkelje e të drejtave të

njeriut, me vetë faktin se të gjithë janë paguar njësoj, në kohën kur shumica prej tyre kanë qenë ata që kanë investuar në këtë shoqëri.

Ne e dimë që vështirësitë më të mëdha nuk vijnë nga mungesa e vullnetit politik. Ato vijnë nga e kaluara jonë e dhimbshme. Ne i dimë mungesat, jo vetëm të këtij buxheti, por edhe ato kursime, të cilat i kanë bërë qytetarët tanë me punën e tyre, të cilat janë kursime të munguara. Mendoj se ky projektligj, ky dokument vjen edhe si një balancë ndërmjet kufizimeve buxhetore, ndërmjet atyre që vijnë si sugjerime të partnerëve ndërkombëtarë, që ne e dimë se janë institucione serioze, të cilat kanë punuar dhe po punojnë në përputhshmëri me interesat e qytetarëve tanë dhe të ardhmen euroatlantike të vendit tonë dhe, po ashtu, ky projektligj është i balancuar dhe i kushtëzuar edhe nga direktivat e BE-së. Ministri e di fare mirë që gjithçka bëhet në përputhje me politikat e BE-së dhe me procesin, i cili është i monitoruar nga institucione, të cilat ne i kemi këtu për çdo ditë.

Ne mund të flasim edhe për politika, që mund t'i inkorporojmë në këtë projektligj. U përmend këtu, përveç të drejtave të njeriut, edhe solidariteti shoqëror e tjerë, që janë politika që udhëhiqen nga organizata të ndryshme politike ndërkombëtare në botë. Secila parti politike e ka profilin e vet. Mendoj që ne nuk jemi aq komodë sa të bëjmë vlerësime të tilla, gjykime të tilla. Nganjëherë edhe në këtë sallë konsideroj sikur te ne gjithçka ishte mire, vetëm ne si politikë ose si Qeveri erdhëm dhe e prishëm këtë skemë, ose atë skemë. Ne po ndërtojmë diçka, që nuk e kemi pasur. Uroj që ky draft të përmirësohet dhe të bëhet edhe më i mirë nga deputetët, nga komisionet përkatëse dhe nga grupet politike, nga i gjithë Parlamenti. Dhe, sa më shpejt që të aprovohet ky projektligj, mendoj se do të jetë një hap shumë më i mirë se që ka qenë për pensionistët dhe për të gjitha kategoritë që përfitojnë nga ai.

Fundi i fundit, ne shpresojmë të mos mungojë vetëm vullneti politik. Ju e dini, kemi pasur rast sa herë që ka pasur rritje të pensioneve, askush nuk e ka bërë telashe - pse u bë rritja, nuk ishte ligji, ose diçka e tillë. Pra, krahas një vullneti politik për rritjen e pensioneve, duhet t'i bëjmë më të mira ligjet. Ju e dini që është edhe një ligj tjetër, i cili e plotëson këtë fushë. Është ligji për fondin pensional, i cili pak a shumë duhet ta menaxhojë ose ta administrojë Trustin, ato kursimet e njerëzve që punojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri, zoti Rashiq!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Naravno, zakon nije idealan, nije perfektan. Nijedan zakon inače nije perfektan. Svaki se uvek nadograđuje. Kad bi mogli mi da dolazimo sa perfektnim zakonima, to bi značilo da imamo takav ogroman budžet, kao verovatno Norveška ili Švajcarska, pa možemo da financiramo zakon koji god hoćemo i kako god hoćemo.

To u našem slučaju nije tačno ili nije realno, znate i sami. Mi svake godine, svaki mali deo koji može dodatno da se osigura za određeni zakon i to, da nazovem i tako, uradimo na mišiće, jer svake godine imamo određeno povećanje Budžeta, koji se uvek raspoređuje na stvarno jednom ravnopravnom nivou, i koji omogućava razvoj u svim sektorima.

Ono što ću ja da naglasim još jednom, jeste možda zakon koji je vrlo malo tehnički promenjen, koji je bio. Ali verujte, mi na ovom zakonu su radili bar petoro ljudi iz profesionalaca, iz Pravnog departamenta u ministarstvu, koji su radili 3 pune godine zajedno sa ekspertima svetske banke i ekspertima međunarodnog monetarnog fonda. Znači, razumite molim vas, da je to dugogodišnji proces, koji je trajao da bi se uskladile mogućnosti i ono što je gospodin Pajaziti rekao, što mu se zahvaljujem na tome, što imamo preduslove, koje trebamo ispuniti ispred Evropske unije i Evropske komisije.

Penzioneri devedesetih godina, odnosno ljudi koji su radili devedesetih godina, zato sam i rekao na početku kada sam objašnjavao, kakav će zakon biti, pa na koji način da utvrdimo koji su ti ljudi izbačeni sa posla devedesetih godina. Mi moramo da imamo prvo zakon, pa onda podzakonski akt, koji utvrđuje pravila kako će onaj čovek koji je, nažalost, ja iskreno trudim se da i oni naravno budu u ovom našem zakonu, kako oni mogu da ispune uslove da bi postali deo ovog zakona. Moraju da obezbede određenu potvrdu ili dokumentaciju, dokaze koji će dokazati da su oni u to vreme radili. Za to nam treba vreme.

Kao što sam reako, šest meseci do godinu dana. Takođe i kategorizacija koju sam pomenuo. I za to nam treba dokazi. Mi ne možemo raditi na osnovu nečega što je na reč ili što virtualno povećanje može da bude. Mi moramo da imamo dokaze da svako od tih penzionera, koji će imati svoju kategorizaciju dokažu da su takav kao kad su radili imali bilo više obrazovanje, bilo visoko, bilo ono jednostavno srednjoškolsko obrazovanje, ali moraju da nam dokažu. Opet i za to nam treba određeni vremenski period, jer verovatno kada bi mi sada objavili, ko je bio devedestih godina izbačen sa posla, bili bi verovatno svi. Svi bi se javili da jesu. Ili kažemo ko je imao kategorizaciju visoko obrazovanje, svi bi rekli - mi smo. Ali da bi mi znali to, moramo imati dokaze.

Zbog toga i insistiram na zakonu koji se bude usvojio da ćemo podzakonskim aktima da rešimo posle sve te nedoumice, koje su očigledne. 2016. godine, tačno je da te nove penzije da je tad pomenuto bilo, ali mi za ovo što smo radili sada, morali smo da dostavimo petogodišnji finansijski okvir. Mi smo u ovom slučaju radili za 7 godina. Verujte mi da nije bilo lako, de je sve moralo da bude usklađeno. Jedini prostor, koji je bio moguć za nas je bila 2016 godina. U jednom momentu smo insistirali da bude 2015, ali naravno, u nekim sektorima, pogotovo što se finansija tiče, međunarodni monetarni fond je neumoljiv. I na kraju smo morali da se složimo zato što je to bila jedna od tačaka koju smo jednostavno morali da odobrimo.

Povećanje, koje ste više puta pomenuli. Mi smo tehnički već obavili, već smo pripremili dokumenta, i ono će biti realizovano do kraja ovog meseca. Znači, mi ćemo tehnički biti spremni da povećanje koje je naznačeno bilo od strane gospodina premijera, biti do kraja ovog meseca. S tim što naravno od početka 2012. godine penzioneri, koji su davali svoj doprinos u godinama '90-ih ili ranije, će imati 112 evra, što će značiti da posle kategorizacije koje će uslediti posle perioda, opet naglašavam da bi bilo jasno, šest do dvanaest meseci biti minimalna penzija.

Ja samo hoću da vam prikažem da je ovo dinamika...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe dy minuta, regjia!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Samo hoću da vam predočim još jednom da je dinamika koja je predviđena stvarno funkcionalna. Možda deluje vama ili penzionerima da su to mali koraci, ali verujte mi, evo ovo zadnje povećanje ne od onog planiranog za ovu godinu, pa sledeću godinu nas košta malo manje od 40 miliona. Pa zar verujete da je tako lako naći 40 miliona u Budžetu. Pa nije lako! To samo dokazuje našu spremnost da mi i dalje, uvek mislimo o penzionerima. Bez obzira što određene grupacije, ili individualci misle da nije tako. Naprotiv, nikada ne bih predložio ovaj zakon da nije u najdirektnijem, najboljem interesu penzionera. Nikad, nijedan zakon ne bih predložio da ne mislim da je profesionalno dobro urađen.

Zašto smo morali da promenimo sistem? Zato što ne može da bude više generacije za generacijom. Moramo da shvatimo jednu stvar, i zahvaljujem se gospodinu Idriziju koji je pomenuo, koji je tad bio pomenuo da sve zemlje u rajonu imaju problema sa isplatom penzija, i da znate da su sve zemlje u regionu kao što su sada najavljene reforme biti u obavezi narednih dve godina da započnu reforme, koje će značiti vraćanje, odnosno postavljanje sistema kao što je naš. Ja vam garantujem da sistem koji imamo mi danas, imaju sve razvijene evropske zemlje. A one koje ga nemaju će morati da ga imaju narednih dve-tri godine. Zato što to ne kažem ja, to samo kažem na osnovu onih analiza i onih insistiranja koja i svetska banka i međunarodni monetarni fond nametnuo svim zemljama u regionu

Petnaest godina koje se pomenulo kao minimum za ispunjavanje uslova jeste bio jedan preduslov koji smo morali da ispunimo, znači mi se toga absolutno ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, meqenëse mbrëmë nuk kishim kuorum, e votojmë pikën e tetë të rendit të ditës: *Shqyrtimi i parë i Projektligjit për provimin e jurisprudencës*

Debati është shteruar. Konstatohet që në sallë janë 85 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet që me 52 vota për, 29 vota kundër, 3 abstenime, Kuvendi e miratoi Projektligjin për provimin e jurisprudencës.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Tani e votojmë pikën, për të cilën sapo u shteruan diskutimet. Është shqyrtimi i parë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet që me 44 vota për, 38 vota kundër, dy abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për skemat...

(Ndërhyrje nga salla)

Në rregull, një është pa kartelë, 45 vota domethënë, zonja Rexhepi. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti. Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për komunikimet elektronike

Ju lus të qëndroni në sallë! Do të kemi votim. Pauzën do ta bëjmë në orën 13:30, pasi të miratohet ky projektligj, nëse jeni dakord. Ju kisha lutur ta përfundojmë pikën e dhjetë, e pastaj shkojmë në drekë dhe vazhdojmë me debatin.

Pika e dhjetë e rendit të ditës nuk ka debat, janë amendamentet. Ju kisha lutur të kemi kuorum.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për komunikimet elektronike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëroni zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka trajtuar kohë më parë këtë projektligj. Ne e kemi sjellë në seancë edhe para pushimeve. Ka qenë një kërkesë në momentin e fundit nga Komisioni për Integritet Evropian, që ka kërkuar kthimin e tij edhe një herë. Ka qenë fjala për trajtimin e disa amendamenteve, për të cilat është konsideruar që duhet të përshtaten më shumë me direktivat e BE-së. Në ndërkohë, më lejoni që të ju shpjegoj që amendamentet, çështje që kanë të bëjnë me buxhetin, i është dhënë përparësi t'i trajtojë Komisioni i përhershëm për Financa dhe Buxhet dhe në ndërkohë ka pasur disa amendamente, Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka menduar që disa prej këtyre amendamenteve duhet ose ka mundësi të mos jenë në përputhje të plotë me direktivat e BE-së.

Prandaj, dy prej këtyre amendamenteve, amendamenti 64 dhe 66, Komisioni FunkSIONAL nuk i ka mbështetur, megjithatë kemi pasur takime tjera shtesë edhe me Ministrinë e Financave, edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa. Ata i kanë dhënë justifikimet e tyre më të qëndrueshme, se janë ose nuk janë në kundërshtim me ligjet në fuqi, konkretisht me Ligjin për financat publike. Nuk dëshiroj si komision të krijoj ndonjë paqartësi ose amulli te deputetët. Thjesht, e kemi lënë edhe një shans shtesë që të vlerësohet, të jetë si alternativë, të ketë reflektim nëse është gjithçka në përputhje me kriteret, me direktivat e BE-së, ose jo. Megjithatë, dëshiroj të them që zakonisht komisioni ynë, për çështjet që kanë të bëjnë me buxhetin i ka dhënë përparësi Komisionit për Buxhet dhe Financa. Unë mendoj që në këtë rast, edhe zonja Hadërgjonaj, ose dikush nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, do ta japë arsyetimin për këto amendamente, në mënyrë që deputetët të mos kenë ndonjë hezitim për t'i votuar ato.

Si do që të jetë, mendoj që ky ligj e rregullon një fushë, e cila është jashtëzakonisht e rëndësishme. Ne kemi punuar gjatë në trajtimin e këtij projektligji. Unë dëshiroj t'i falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit dhe të grupit punues, i cili ka qenë jashtëzakonisht aktiv në punë, gjatë trajtimit të këtij projektligji dhe të gjitha institucionet tjera mbështetëse, të cilat kanë ndihmuar që ky projektligj të arrijë deri në këtë fazë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë fillojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 6.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 7.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 8.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 9.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 10.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 11.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 12.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 13.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 14.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 15.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 16.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 17.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 18.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 19.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 20.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 21.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 22.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 23.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 25.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 26.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 27.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 28.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 29.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 30.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 31.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 32.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 33.
Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 34.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 35.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 36.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 37.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 38.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 39.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 40.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 41.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.
Miratohet.

Amendamenti 42.
Kundër s'ka.
Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 43.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 44.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 45.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 46.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 47.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 48.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 49.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 50.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 51.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 52.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 53.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 54.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 55.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 56.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 57.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 58.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 59.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 60.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 61.

Kundër s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 62.
 Kundër s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Amendamenti 63.
 Kundër s'ka.
 Abstenim s'ka.
 Miratohet.

Jemi te amendamenti 64, i cili ka dy propozime. Është propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional dhe Komisionit për Integritet Evropian. Fjalën e ka kërkuar zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti nënkryetar,
 Të nderuar kolegë deputetë,
 Në mungesë të kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të nënkryetarit, atëherë unë do t'i arsyetoj amendamentet e komisionit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 16.5.2012, pasi e shqyrtoi Projektligjin për komunikime elektronike dhe raportin me amendamente të Komisionit Funksional, në të cilin takim ishin të pranishëm edhe ministri i Financave dhe zëvendësministri për Zhvillim Ekonomik, u konstatua se disa nga dispozitat e projektligjit nuk janë në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Me amendamentin 64 janë propozuar të bëhen ndryshime në nenin 79 të projektligjit, përkatësisht paragrafi 4, 5 dhe 6. Propozimi për riformulimin e paragrafit 4 është bërë për t'u saktësuar që anëtarët e Bordit të Autoritetit nuk e kanë statusin e shërbyesit civil dhe pagat dhe mëditjet e tyre do të miratohen nga Kuvendi për çdo vit, me Ligjin e buxhetit vjetor, deri në nxjerrjen e Ligjit për pagat e funksionarëve publikë, e jo siç ka qenë e propozuar në projektligj, që anëtarët e Bordit të paguheshin në bazë të skemës së pagave e mëditjeve që aplikohen për anëtarët e Kuvendit.

Ndërkaq, me paragrafin 5 është rregulluar që statusi i stafit profesional të autoritetit, pagesat dhe beneficionet tjera duhet të trajtohen në pajtim dhe brenda kornizës së Ligjit për shërbyesit civilë, përkatësisht Ligjit për paga të shërbyesve civilë, pasi me këto ligje janë përcaktuar pozitat për kategoritë e veçanta të punonjësve civilë, si dhe pagesat dhe kompensimet relevante për pozitat e përcaktuara.

Paragrafi 6 është riformuluar dhe qartësuar se struktura organizative përcaktohet nga bordi i autoritetit, në pajtim me ligjet në fuqi, e jo që bordi ta përcaktojë numrin, pagat,

orarin e punës së stafit të autoritetit, siç është përcaktuar me projektligj. Pasi edhe kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se për çështje buxhetore përparësi i kanë dhënë Komisionit për Buxhet dhe Financa, atëherë unë dua ta mbroj këtë dhe besoj që deputetët do të votojnë për rekomandimet e riformulimet, që i ka bërë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Sahatqija e ka fjalën?

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit!

Edhe unë kam qenë në grupin, i cili ka punuar në amendamentimin e këtij ligji. Çështjen e buxhetit se a është autoriteti organizëm buxhetor apo jobuxhetor, e kemi lënë ta përcaktojë Komisioni i Buxhetit.

Por, në anën tjetër, kemi pasur mjaft vërejtje. Mendoj që dikush prej Komisionit për Integritet Evropian do ta jepte më së miri një përgjigje. Por, këto amendamente, të cilat i ka sjellë buxheti, kanë qenë në kundërshtim me direktivat evropiane. Dhe, mendoj që Kuvendi duhet të diskutojë se a duhet të pranohen apo jo, duke pasur parasysh që këto tri amendamente janë kundërshtuar pikërisht për shkak se nuk janë kompatible me direktivat evropiane, të cilat kërkojnë pavarësinë e këtij autoriteti.

Kuvendi le të vendosë se cilat do t'i votojë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në sallë janë 63 deputetë. E hedh në votim! Zonja Berisha-Shala ka kërkuar fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë desha vetëm një sqarim për deputetët, që sot jemi para një dileme t'i votojmë amendamentet që i ka sjellë Komisioni për Buxhet dhe Financa, natyrisht në marrëveshje me Komisionin për Zhvillim Ekonomik.

Por, doli edhe një arsye tjetër, se këto amendamente janë edhe në kundërshtim me direktivat evropiane. Ne kemi diskutuar edhe në komision, edhe në grup, se direktiva evropiane është term jashtëzakonisht i gjerë. Përderisa nuk thuhet specifikisht se me cilën direktivë në kundërshtim, unë mendoj se ne si deputetë dhe si Parlament jemi të obliguar që së pari t'i zbatojmë ligjet, të cilat i nxjerr ky Kuvend.

Ky Kuvend e ka nxjerrë Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe amendamentet që i ka sjellë Komisioni për Buxhet dhe Financa janë në harmoni të plotë me ligjin për menaxhimin e financave publike, por është një dilemë se a janë në kundërshtim me direktivat evropiane. Përderisa direktivat - është term i gjerë, unë i thërras kolegët deputetë që t'i votojnë amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të jemi në harmoni me Ligjin për menaxhimin e financave publike.

Ky është mendimi im dhe ju ftoj që ne t'i votojmë amendamentet që ka sjellë Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas Rregullores, e hedh në votim. Së pari votohet për Komisionin Funksional, domethënë me “për”, si çdo herë. Votojmë tash!

(Zhvillohet debat në sallë)

Si?! Ju lutem, ju lutem, a e doni fjalën edhe një herë. Pra, a doni ta rikthejmë diskutimin? Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Jo, vetëm për sqarim. Ky amendament dhe një amendament tjetër janë amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa, të cilat nuk e kanë pasur përkrahjen tonë. Nuk kemi amendament të veçantë. Domethënë, vetëm duhet të hidhen në votim. Do të ishte mirë sot një fjalë, meqenëse është shtyrë për disa muaj për shkak të tërheqjes që e ka bërë Komisioni për Integritet Evropian. Do të ishte mirë ata sot ta kishin dhënë një sqarim për çështjet, por nuk janë. Unë propozoj ta hedhim në votim dhe deputetët le të vlerësojnë vetë.

Pra, vetëm propozimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, amendamentet e tyre.

KRYESUESI: Në rregull, atëherë shkojmë sipas propozimit përkatës, që të votohet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa me “për” ose “kundër”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional dhe të Komisionit për Integritet Evropian. Votojmë tash!

Konstatohet se me 36 vota për, 17 kundër dhe 1 abstenim, miratohet propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa miratohet amendamenti 64.

Amendamenti 65, zoti Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar, Megjithatë, për hir të korrektesisë, një herë u votua kundër. E hodhët edhe një herë në votim, tash i fitoi votat.

(Ndërhyrje)

Jo, u votua. 30 me 14 ishte rezultati. Ne nuk jemi... Jo, jo, zoti nënkryetar! Nëse thoni që po e përsëritim të njëjtin votim, atëherë duhet ta sqarojmë. Ne votuam një herë, zoti nënkryetar, dhe rezultati i parë ishte 33 me 14. E përsëritet dhe doli i dyti votim tash. Prandaj, votimi i parë duhet të anulohet atëherë, ose mbetet.

KRYESUESI: Jam plotësisht dakord me atë...

ISMET BEQIRI: Votimi i parë është kryer, zoti nënkryetar. Prandaj, nuk ka pasur arsye të votohet edhe një herë.

KRYETARI: Realisht, Komisioni Funksional nuk u deklarua në kohë. Pasi që votuam, Zenuni u paraqit, zonja Sahatqija u paraqit, asistencë ime u paraqit në mënyrën e vet...

Një herë është votuar kundër, tani u votua për, rezultati është e njëjta gjë. Zoti Ali Sadriu e ka kërkuar fjalën.

ALI SADRIU: Unë, jo vetëm që mendoj, por e kam bindjen se amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa duhet të merren si diçka që nuk duhen as të votohen. Çka bëjmë nëse e votojmë ndryshe nga ajo që e kanë dhënë? S'do të ketë funksionalitet ai ligj, sepse s'do të ketë kosto të pagesës, s'do të ketë bazë dhe Kuvendi njëherë e përgjithmonë duhet ta stopojë. Kur nuk ka mbështetje buxhetore, pse të miratojmë. Ne më herët e miratuam një ligj, për 2016-tën! Çka është ajo? Bile ai e dha një afat, këtu s'ka kurrëgjë. Do të thotë, s'ka para, e do të nxjerrësh ligj! Çka po bëjmë? Ku jemi? Veç kësaj desha t'ia jap peshën që vërtet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa duhet të jetë diçka për të cilën duhet të mendojmë të gjithë, pak më thellë.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë dua ta plotësoj pak. Herën e parë është votuar e njëjta gjë, që është votuar edhe herën e dytë. Domethënë, herën e parë e kam hedh amendamentin e Komisionit Funksional dhe është votuar kundër, domethënë është votuar i Komisionit për Buxhet dhe Financa. E njëjta gjë ka ndodhur edhe herën e dytë, kur është hedhur vetëm amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe është miratuar. Domethënë, vetëm ka qenë një lapsus, ndoshta më shumë imi se i të tjerëve. Po e pranoj këtë.

Atëherë, vazhdojmë me amendamentin 65.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka. Miratohet.

Amendamenti 66, propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional dhe Komisionit për Integritet. Fjalën e ka kërkuar zoti Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe te amendamenti 66 është propozuar të riformulohet neni 81 i Projektligjit dhe është përcaktuar se autoriteti është organizatë buxhetore dhe duhet të financohet nga Buxheti i Kosovës. Autoriteti duhet ta përgatisë projekt-buxhetin, të cilin e dorëzon për shqyrtim dhe miratim në Kuvend, në pajtim me procedurat e parapara me Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësitë, gjë që nënkupton se duhet përfillur nenin 20, pika 4 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në bazë të të cilit secila organizatë buxhetore, pra edhe ART-ja, është përgjegjëse që të përgatisë dhe t'i dorëzojë ministrit propozim-buxhetin dhe kërkesën për ndarjet buxhetore sipas qarkores buxhetore të ministrisë dhe të marrin pjesë në dëgjimet buxhetore, të organizuara nga Ministria e Financave, sikur që marrin pjesë të gjitha organizatat buxhetore, përfshirë edhe Kuvendin, e më pastaj institucioni i fundit që vendos për buxhetin e këtij autoriteti është Kuvendi.

Autoriteti duhet të mbajë llogari të shpenzimeve, por edhe të bëjë auditimin e pasqyrave financiare në pajtim me ligjet në fuqi, e edhe çështja e auditimit nuk është rregulluar fare në projektligj. Me këtë amendament po ashtu është rregulluar çështja e raportimit të autoritetit në Kuvend. Autoriteti për komunikim elektronik duhet t'ia dorëzojë Kuvendit

raportin e shpenzimeve buxhetore së bashku me raportin vjetor të punës brenda tre muajsh pas përfundimit të vitit kalendarik, apo edhe raportin e veçantë kurdoherë që mund të kërkohej nga Kuvendi.

Si përfundim, Komisioni për Buxhet dhe Financa vlerëson se propozimet e bëra nga ky komision në dispozitat e projektligjit për çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e buxhetit dhe të pagave të Bordit të Autoritetit Rregullativ të komunikimeve elektronike dhe postare dhe punonjësve të tij, trajtimi i të hyrave të inkasuara dhe raportimi nga autoriteti janë në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe ligjet tjera në fuqi.

Po ashtu, amendamentet e propozuara nga Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk i kufizon kompetencat dhe përgjegjësitë e autoritetit në menaxhim me buxhetin, rekrutimin dhe menaxhimin e stafit të tij. Duke i pasur për bazë këto argumente, komisioni i rekomandon Kuvendit t'i miratojë amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe dua t'ua përkujtoj disa deputetëve se në Kosovë nuk ka asnjë organizatë që është jashtë buxhetore, se ne e kemi një buxhet dhe duhet pasur një përgjegjësi. Për arsye se unë nuk e kuptoj edhe Komisionin për Integritet Evropian, sepse Ligji për menaxhimin publik të financave është miratuar në këtë Kuvend, është i harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian, e tash del që nuk është i harmonizuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, e hedh në votim amendamentin 66, propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional dhe Komisionit për Integritet Evropian. Në sallë janë 62 deputetë. Votojmë tash!

Konstatohet se me 34 vota për, 20 kundër, miratohet amendamenti 66.

Amendamenti 67, propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, me përkrahjen e Komisionit Funksional, por pa përkrahjen e Komisionit për Integritet Evropian. E hedh në votim edhe këtë. Votojmë tash!

Me 38 vota për, 20 kundër, miratohet amendamenti 67.

Amendamenti 68.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 69.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 70

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 71.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 72

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 73.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Amendamenti 74.

Kundër s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Faleminderit! Tani të nderuar zonja deputete dhe zotërinj deputetë, e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Të pranishëm janë 64 deputetë. Votojmë tash!

Faleminderit! Me 45 vota për, 15 kundër, konstatoj që Kuvendi e miratoi Ligjin për komunikimet elektronike.

Pika 11 e rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime. Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funksional, deputeti Ali Sadriu, për arsyetimin e raportit dhe për rekomandime.

ALI SADRIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

E kam shkruar edhe për Kabinetin qeveritar, por po i shoh karriget e zbrazëta,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 12 shtator 2012, e shqyrtoi Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011.

Sipas Raportit të Auditimit del se në Universitetin e Prishtinës - UP, ka opinion të pakualifikuar, me theks të çështjes. Kjo për shkak të kontrollit të pamjaftueshëm të të hyrave vetjake, që kanë rezultuar me diferenca ndërmjet të vlerave të fletëpagesave, si dhe shumëve faktike, të prezantuara në llogaritë bankare. Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar nuk është i nivelit të kënaqshëm. Nga gjithsej 8 rekomandime janë adresuar vetëm 4, kurse 4 nuk janë adresuar fare. Afro 72% e buxhetit është shpenzuar për paga dhe mëditje, ndërsa edhe në buxhetin kapital, buxheti nuk është shfrytëzuar në mënyrë racionale. Vetëm në dy muajt e fundit është shpenzuar 58%. Shtrohet pyetja: Ku është Ligji për menaxhimin e financave publike? Ku është Ligji për prokurimin? Kur dihet se ka barriera shumë specifike në tre muajt e fundit të vitit kalendarik në përdorimin e këtyre mjeteve. Ndërkohë, i ka shfrytëzuar 58%. Nga të hyrat vetjake për vitin 2011 Universiteti i Prishtinës kishte në dispozicion 9,2 milionë euro. Nga shuma e realizuar për të hyrat vetjake ka përdorur 80% për paga dhe mëditje, ndërsa vetëm 20% për nevojat tjera: për kushte pune, për bursa studentëve etj.

Ka parregullsi në procesin e barazimit të pagesave për të hyrat vetjake dhe Auditori nga 215 mostra, që ka kontrolluar, ka ardhur në përfundim se te 15% e këtyre mostrave rezultojnë që gabimet janë të qëllimshme. Parregullsitë e konstatuara nga Zyra e Auditorit të përgjithshëm janë:

1. Dobësitë në procesin e barazimit të pagesave për të hyrat vetjake. Ka dallim ndërmjet raporteve të bankave komerciale dhe shumës së mjeteve, të deklaruar nga Universiteti. Kjo gjendje ngre dyshime për mashtrime;
 2. Universiteti i Prishtinës ka mangësi në servisimin për regjistrimin e të hyrave;
 3. Mosbarazimi i tyre nga Administrata qendrore dhe niveli akademik e bën të pamundshëm pasqyrimin e plotë dhe të saktë të të hyrave dhe krijon mundësinë e moszbulimit të keqpërdoruesve në kohë;
 4. Ka zyrtarë me dy kontrata të rregullta pune. Një rast e patëm të një polici dhe të një mësuesi atje, e bënë telashe dhe mirë që e bënë, por edhe në Universitet kemi dukuri të tilla;
 5. Kontratat mbi vepra jashtë procedurës së konkursit;
 6. Kompensim i zyrtarëve për orë shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, pa dëshmi. Për këto dëshmi që vërtetojnë janë se zyrtarët nuk e kanë ofruar asnjë të dhënë kur është kryer ajo punë. Dyshohet që është kryer gjatë orarit të punës;
 7. Kompensimi i normave për personelin akademik pa e plotësuar normën e përcaktuar. Rast konkret është Universiteti i Prizrenit. E kanë të caktuar normën 6 orë, ndërkaq i mbajnë vetëm 3 orë, e paguhen për krejt normën. Mirë që është ministri këtu.
- Këto janë konstatimet e Auditorit, e jo të komisionit. Në Raportin e Auditimit janë konstatuar edhe gjetje tjera në fushën e prokurimit. Auditori ka testuar 32% të vlerës totale, të shpenzuar në kategoritë e shpenzimeve për shpenzime kapitale dhe i ka vërejtur këto dobësi: 1. eliminimin e operatorëve që e kanë pasur çmimin më të lirë, 2. lidhja e kontratave pa pasur mjete të zotuar, 3. moskryerja e punëve sipas afatit të përcaktuar me kontratë. Për sqarim, mund të them se e ka favorizuar edhe dinamikën e punës, por megjithatë nuk e ka kontrolluar deri në fund.

Pagesat në formë të avansit, kryerja e shërbimeve të organizatave punuese edhe pas skadimit të afatit dhe e fundit - blerjet janë kryer pa i përfillur procedurat e prokurimit. Pastaj shpenzimet e përcaktuara telefonike i tejkalojnë shumat e përcaktuara. Krejt kjo tregon se Universiteti i Prishtinës i ekspozohet rrezikut të vazhdueshëm të keqmenaxhimit të fondeve publike.

Po ashtu, në vitin e kaluar, Universiteti i Prishtinës, në emër të kontestit gjyqësor me operatorë ekonomikë nga Departamenti i Thesarit, Ministrisë së Financave, nga buxheti i Universitetit të Prishtinës është paguar shuma prej 677 330 euro. Në sqarimet që i kemi kërkuar, menaxhmenti aktual e jep këtë justifikim: është proces që ka ndodhur në menaxhmentin e kaluar dhe këto mjete janë hequr prej buxhetit të Universitetit me ekzekutim gjyqësor. Universiteti i ka hulumtuar shkaqet e këtij kontesti, përkatësisht këtij ekzekutimi dhe ka ardhur në përfundim se ka hapësirë për ndjekje penale. Ata thonë se e kanë përgatitur dhe e kanë dorëzuar kallëzimin penal në Prokurori për ish-menaxhmentin dhe se ai kallëzim mbetet edhe më tutje. Auditimi i brendshëm i Universitetit të Prishtinës, edhe pse ka pasur lëvizje të Auditorit nga nëntori i vitit 2010 deri në shtator të vitit 2011, është pritur të zëvendësohet me auditorë të rinj ky pozicion. Auditori konstaton që është larguar një profesionalist dhe në vend të tij është sjellë një njeri i pacertifikuar.

Bazuar në këto të gjetura dhe duke marrë për bazë faktin se Universiteti i Prishtinës ende nuk e ka një plan konkret se si do t'i adresojë këto të gjetura, komisioni ka vlerësuar se raporti duhet të shqyrtohet në Kuvend dhe Universiteti i Prishtinës duhet të obligohet që në afat prej 6 muajsh të procedojë në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave dhe ky i fundit ta sjellë në Kuvend planin konkret për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të PDK-së, fjalën e ka zoti Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Auditimit të pasqyrave të Universitetit të Prishtinës, për vitin 2011, të prodhuar nga ZAP-i.

E tha edhe kryetari i komisionit që Universiteti i Prishtinës e ka opinionin e pakualifikuar me theksim të çështjes, që domethënë është një opinion i mirë. Universiteti i Prishtinës ka laramani të financimit, si nga grandet qeveritare, nga të hyrat vetjake, si dhe një pjesë nga donacionet. Marrë në përgjithësi, nga ndarja prej 26,2 milionë euro për vitin 2011, Universiteti i Prishtinës ka shpenzuar 24 milionë e gjysmë euro, apo 94% të buxhetit që e kanë planifikuar. Nga këto shpenzime del se afro 72% e buxhetit është shpenzuar për paga dhe mëditje, ndërsa nga shuma e mjeteve të shpenzuara prej 1,6 milion euro, apo 34% e tyre janë donacione, të cilat barten nga viti në vit. Sipas raportit të ZAP-it, ka pasur parregullsi në procedurat e barazimit të pagesave për të hyrat vetjake dhe se

Auditori, në 215 mostra të marra, është vërejtur mospërputhje e vlerave të fletëpagesave të studentëve me ato të pranuar nga bankat komerciale. Vlerësohet se nga 15% të mostrave të testuara, gabimet kanë rezultuar si të qëllimshme.

Po ashtu, Universiteti i Prishtinës ka mungesë të serverit për regjistrimin e të hyrave, mosbarazim i të hyrave nga administrata qendrore dhe njësitë, tejkalimi i limitit të përcaktuar për shpenzimet e telefonisë fikse. UP-ja e ka një pasqyrë joreale të regjistrimit të pasurisë, megjithëse se ka investuar për një bazë të mirë të të dhënave, detyrimet e paguara në bazë të vendimit të gjyqit nuk ishin prezantuar dhe shpalosur në pasqyrat financiare të viteve paraprake si detyrime kontingjente, detyrimet në shumën prej 677 330 euro, siç e tha edhe kryetari, dhe 10 928 euro janë paguar drejtpërdrejt nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore. Shuma e paguar në vitin 2011, në vlerën prej 677 333 euro, kishte rrjedhë si detyrim kontingjent që nga viti 2008. Pra, pasqyrat financiare nuk kanë qenë konsistente prej vitit 2008 deri në vitin 2011, me ç'gjë menaxhmentin e UP-së e kanë sjellë në vështirësi të papritura financiare. Universiteti i Prishtinës duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për t'i shqyrtuar dhe adresuar të gjitha gjetjet e këtij raporti, duke i identifikuar me kujdes gjithë shkaktarët e parregullsive dhe duke propozuar masa konkrete.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës rekomandon që të miratohet Raporti i pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës dhe fton deputetët që ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me “Vetëvendosjen”, fjalën e ka zoti Hoti.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryesues!

Porsa ta hapësh faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës gjen disa fjali ku promovohet, realizohet dhe aspirohet në ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve intelektuale të njerëzimit, duke theksuar kështu: “Mirë se vini në Universitetin e Prishtinës, i dedikuar për mësim dhe hulumtim sipas vlerave të sistemeve perëndimore. Universiteti i Prishtinës po bën hapa të guximshëm për të shkuar kah procesi i Bolonjës”. Mirëpo, për t'u shndërruar teorizimi i kësaj fraze në praktikë, Universitetit të Prishtinës i nevojitet një qeverisje tjetër nga ajo që është aktuale, sepse menaxhimi aktual i Universitetit të Prishtinës është tërësisht politik. Prodhon kuadro politike me kapacitete të ulëta intelektuale dhe në kompatibilitet me kapacitetin e lartë të varësisë, prodhon keqmenaxhimin e parasë të taksapaguesve të qytetarëve të Kosovës, shtrin horizontalisht dhe vertikalisht korrupsionin në çdo formë në tërë strukturat e Universitetit të Prishtinës.

Si pasojë e mosinformimit të sistemit të drejtësisë prodhon rrënim të tërësishëm të hulumtimit dhe shkencës, si pasojë e mungesës së kuadrove profesionale. Pra, ky është dimension i brenda të cilit shkaktohet pasoja e rëndë për shoqërinë, ku politika avancon mbi dijen. Andaj, e lartcekura nuk është supozim, por fakt i cili përshkruhet mjaftë qartë në Raportin e Auditimit që i është bërë këtij institucioni. Për shembull, te menaxhimi financiar, që e përmendi më herët edhe kryetari i komisionit. Auditori i Përgjithshëm ka vërejtur mospërputhje ndërmjet vlerave në fletëpagesat e lëshuara nga bankat komerciale dhe shumat faktike të deponuara në llogarinë bankare të Universitetit të Prishtinës, si për

shembull në 30 raste përmbajtja e fletëpagesës ishte 250 euro, dhe në dy raste të tjera ishte nga 50 euro, ndërsa në llogaritë bankare të Universitetit shumat faktike të deponuara ishin nga 5 euro për transaksion.

Te pagat dhe mëditjet, Auditori konstaton se ka pasur zyrtarë me dy kontrata të rregullta pune, gjë që është në kundërshtim me Rregulloren Nr. 2/ 608 për të ardhurat personale në Universitetin e Prishtinës. Gjithashtu, Auditori ka konstatuar se kanë munguar dëshmitë për punën e kryer jashtë orarit për kompensimin e zyrtarëve, pastaj pagesat e ligjëruesve me paga të plota, edhe pse nuk e kanë plotësuar normën e paraparë me kontratë. Tek prokurimi, ku Auditori ka konstatuar eliminimin e operatorit me çmim më të lirë, lidhja e kontratave në mungesë të zotimit të mjeteve, sigurimit të ekzekutimit të kontratës dhe mosaplikimi e penaleve për moskryerjen e punëve në afatin e paraparë.

Auditori, përveç tjerash, ka verifikuar edhe këto mangësi dhe keqpërdorime në këtë raport: certifikimi i pagesave dhe regjistrimet në kode joadekuate, shpenzimet e regjistruara në kode të gabuara ekonomike në rekrutimin e stafit, mungesa e auditimit të brendshëm të Universitetit të Prishtinës etj. Nga e gjithë kjo, konsideroj se është nevojë imediate e organeve të drejtësisë që të hetojnë dhe ndëshkojnë të gjithë ata që kanë abuzuar në kuadër të këtij institucioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga AAK-ja, zoti Muharremaj.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Auditimit të pasqyrave financiare të Universitetit të Prishtinës për vitin 2011.

Universiteti i Prishtinës ka opinion të pakualifikuar në theksim të çështjes, kjo për shkak të kontrollit të pamjaftueshëm për të hyrat vetjake që kanë rezultuar me diferencën ndërmjet vlerave të fletëpagesave, si dhe shumave faktike të deponuara në llogarinë bankare të Universitetit të Prishtinës. Vitin e kaluar, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka dhënë 8 rekomandime për Universitetin e Prishtinës dhe lidhur me këtë e ka përgatitur një plan të veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga Raporti i Auditimit. Mirëpo, edhe këtë vit, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka vërejtur se zbatimi i panit të veprimit nga Universiteti i Prishtinës është një hap shumë i ngadalësuar. Nga 8 rekomandimet e dhëna, 4 prej tyre janë në proces të zgjedhjes, ndërsa katër tjera nuk ishin adresuar fare. Universiteti i Prishtinës ka laramani të financimit nga grandit qeveritar, nga të hyrat vetjake, si dhe një pjesë nga donacionet, marrë në përgjithësi, nga ndarja prej 26,2 milionë euro për vitin 2011.

Universiteti i Prishtinës ka shpenzuar 24,5 milionë euro nga 94% të buxhetit. Ajo që vlen të theksohet është se afro 72% e buxhetit është shpenzuar për paga dhe mëditje. Ndërsa, edhe në buxhetin kapital nuk kishte shfrytëzim racional të buxhetit. Vetëm në dymujorin e fundit është shpenzuar 58% e buxhetit, që lë të kuptohet se nuk mund të jenë shpenzime reale me programin fizik të kapitaleve, kur dihet se dy muajt e fundit të vitit janë sezon dimëror.

Më se gjysma e mjeteve që i nevojiten Universitetit të Prishtinës për operimin realizohen nga të hyrat vetjake dhe për vitin 2011 Universiteti i Prishtinës e kishte në dispozicion shumë prej 9,2 milionë euro. Nga shuma e realizuar për të hyrat vetjake 80% e tyre përdoren për paga dhe mëditje, ndërsa 20% e tyre përdoren për përmirësimin e kushteve të punës, si dhe për bursa të studentëve. Ajo që është cekur edhe në Raportin e Auditimit është se ka parregullsi në procedurat e barazimit të pagesave për të hyrat vetjake dhe se Auditori, në 215 mostra të marra, është vërejtur mospërputhje e vlerave në fletëpagesat e studentëve me ato të pranuar nga bankat komerciale. Po ashtu, Universiteti i Prishtinës ka mangësi të serverët për regjistrimin e të hyrave dhe mosbarazimin e të hyrave nga Administrata qendrore dhe njësitë akademike. Nga të gjeturat e Auditorit në kategorinë e pagave dhe mëditjeve kanë rezultuar këto të gjetura: zyrtarët me dy kontrata të rregullta të punës, kontrata mbi vepër, kompensimi i zyrtarëve për orët shtesë jashtë orarit të rregullt të punës, kompensimi i normave për personelin akademik pa e plotësuar normën e orëve.

Bazuar në këto të gjetura, Universiteti i Prishtinës obligohet në afat prej gjashtë muajve ta procedojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike planin konkret për adresimin e të gjitha rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit Kosova e Re, zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re i përkrah rekomandimet e Komisionit për kontroll financiar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Besoj që kryetari i komisionit i paraqiti në mënyrë profesionale të gjitha vërejtjet, të cilat dhe janë dhënë nga ky raport i këtij auditimi. Mendoj se sfidë kryesore në fushën e ekzekutimit të buxhetit ishte shpenzimi i donacioneve dhe po ashtu shpenzimi i buxhetit për investime kapitale, ku 58% e buxhetit është shpenzuar vetëm në dy muajt e fundit të vitit, që nënkupton planifikim jo të mirë të rrjedhjes së parasë. Pastaj, tek të hyrat vetjake është vërejtur mospërputhje ndërmjet vlerave në fletobligacionet e lëshuara nga bankat komerciale dhe shumë fakte të deponuara në llogaritë bankare të UP-së, ku janë dhënë 34 raste të transaksioneve dhe po ashtu ka pasur mosbarazim të të hyrave ndërmjet administratës qendrore dhe njësiteve akademike.

Mendoj që në raportin të cilin e ka bërë Zyra e Auditorit ka përcaktuar vërejtjet edhe njëkohësisht pikat e dobëta, por ajo çka dua të theksoj është se si për këtë organizatë buxhetore, po ashtu edhe për organizatat tjera buxhetore, për të cilat Zyra e Auditorit e përgatit raportin, jepen rekomandime të shumta, jepen vërejtje të shumta, por mendoj që prej vitit në vit kemi shumë pak përmirësime. Andaj, do të ishte mirë që edhe në këtë rast UP-ja, por edhe organizatat tjera buxhetore, të cilat e shpenzojnë paratë publike të

Kosovës, duhet që në vërejtjet të cilat jepen nga Auditori Gjeneral kryesisht të përqendrohen në përmirësimin e rekomandimeve, të cilat u jepen pikërisht nga kjo zyrë. Përndryshe, nëse vazhdohet do të thotë me rekomandime të papërmirësueshme prej vitit në vit, atëherë kjo nënkupton që kemi të bëjmë me një keqmenaxhim dhe me një buxhet jo të mirë të shpenzuar, po flas në përgjithësi.

Ne do ta votojmë këtë raport, sepse raporti me vërejtjet nga Zyra e Auditorit i ka dhënë pikat kritike dhe kërkoj që nga UP-ja në vitin 2012 t'i përmirësojë edhe njëkohësisht t'i plotësojë dhe t'i arrijë rekomandimet e kësaj zyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Ne e përcollëm me vëmendje atë që e prezantoi Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Edhe përfaqësuesit e grupeve sikur cituan pjesë nga ajo që me të vërtetë e ka shqetësuar secilin si pjesë e defekteve të punës që janë pasqyruar në pasqyrat e auditimit të përgjithshëm.

Në fakt, ajo që prezantohet nga Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike sikur përfundimisht nxjerr opinionin e pakualifikuar, ani se është opinion me theksim të çështjes, sikur tregon një mëshirë bashkë me Zyrën e Auditimit të Përgjithshëm dhe një tolerancë më shumë se korrektësi për ta ruajtur prestigjin e një institucioni, siç është Universiteti Publik. Më shumë po them tolerancë se korrektësi, ngase tërë ato që evidentohen këtu, sikur nuk e nxjerrin përfundimin që e nxjerr vetë ZAP-i, si opinion i pakualifikuar, apo ndoshta do ta ndërpresë edhe përsëritjen e opinionit të kualifikuar të vitit 2010, që ka dalë mjaft negativ, me defektet që e kanë përcjellë.

Vetë theksimi i çështjeve të problemi me kontratat e dyfishta, kontratat mbi vepër, kompensimet jashtë orarit të punës dhe atyre që nuk e plotësojnë edhe normën, pastaj shkeljet e mëdha edhe rreth Ligjit të prokurimit, diferenca ndërmjet të hyrave dhe atyre të evidentuara, janë mjaft elemente që e kontestojnë atë që unë e thashë në fillim si opinion i pakualifikuar.

Shqetësuese për ne është edhe ajo që përmendet, siç do ta shohim në pikën e 13-të, kur të bisedojmë për Statutin e Universitetit Publik. Për nevojën e mbështetjes së botimeve që do ta ketë si obligim Universiteti, e shohim se mjetet e pakta që janë ndarë në këtë drejtim, vetëm 18 194 euro për mbështetje të botimeve, edhe ato nuk përdoren drejt dhe shkojnë për pagesat e zyrtarëve apo për udhëtime zyrtare, që i bëjnë ata. Dhe, për fund, do ta përmend atë që bartet nga viti 2008 dhe shihet që është problemi që i shkakton edhe defektet e menaxhimit të parasë në vazhdimësi dhe që e përmendi kryetari i komisionit, zoti Sadriu, i cili tha se lënda që është bartur në shumën prej 677 832 euro, një lëndë për të cilën edhe menaxhmenti i tanishëm ka ngritur kallëzim penal. Do të ishte shumë e nevojshme që ky problem i bartur ta ketë edhe shtytjen e Ministrisë së Arsimit, dhe pasi e kemi ministrin e Arsimit këtu, kisha dashur t'i bashkëngjitet thirrjes së menaxhmentit të

tanishëm që menaxhmenti i kaluar t'i japë përgjegjësi për këtë borxh, ngase kjo i bart edhe defektet në menaxhimin e parasë në vazhdimësi.

Ministër, mendoj se do ta bënit një punë mjaft fisnike nëse mendoni t'i zbardhni defektet e keqpërdorimit të parasë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: I nderuari kryesues, zoti Haliti!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Kush e ka analizuar me kujdes Raportin financiar të Universitetit të Prishtinës, patjetër është gjetur përballë dilemës se a bëhet fjalë për një institucion akademik, apo për një institucion ku nuk kanë lidhje se si menaxhohet paraja, ose nuk kanë fare përgjegjësi e as frikë se si i bëjnë pagesat.

“Merr sa të duash, paguaj si të duash!”. Kështu e ka përdorur paranë e tatimpaguesve kosovarë Universiteti i Prishtinës, por edhe ato që i kanë paguar studentët. Gjetjet Auditorit Gjeneral domosdoshmërisht imponojnë që debati rreth këtij raporti zhvillohet pak më ndryshe. Nëse Universiteti nuk ka fuqi e as potencial për t'i eliminuar këto parregullsi, atëherë duhet të gjejmë zgjidhje. Sado që kemi obligim për ruajtjen e autonomisë së Universitetit, kjo nuk duhet të vlejë kur janë në pyetje keqpërdorimet materiale në përmasa kaq të mëdha. Vërtet e kam të vështirë t'i gjej format se si të vihet rregull në këtë qendër akademike, por patjetër duhet kërkuar përgjegjësi ligjore për ata që nuk kishin kujdes se si i shpenzojnë paratë. Përballë kësaj situate, menaxherët e administratorët e Universitetit dhe të njësive të tij, por edhe të punëtorëve të tjerë, duhet ta kenë guximin qytetar e intelektual që vetë të kërkojnë t'i pastrojnë të palarat që gjenden në mesin e tyre. E ato janë shumë, madje as që është kujdesur kush për mënjanimin e tyre. Kjo shihet qartë kur kihet parasysh se nuk është përmbushur asnjëri prej rekomandimeve që Auditori i ka dhënë në raportin financiar për vitin 2010. Kjo ka bërë që gabimet të përsëriten, bile disa të paraqiten në formë edhe më të keqe.

Vërejtja e parë, e cila është e natyrës së përgjithshme, ka të bëjë me faktin se 72% e të hyrave janë shpenzuar për paga e mëdijë. Në anën tjetër, investimet kapitale janë realizuar vetëm në dy muajt e fundit të vitit dhe kanë arritur në masën 58%, që do të thotë se në Universitet nuk brengosen shumë për shpenzimet e parasë me qëllim të përmirësimit të ambientit të punë. Ndërsa, kur janë në pyetje pagat, këtu nuk ka asnjë vonesë. Pos kësaj, ka devijime të vërteta serioze, pa marrë parasysh shumën për të cilën bëhet fjalë. Megjithatë, kemi të bëjmë me mosrespektimin e ligjit, apo të akteve tjera nënligjore, të cilat i ka hartuar dhe miratuar Universiteti i Prishtinës.

Nuk mund të heshtet e as të tolerohet fakti kur nga fletëpagesat prej 250 eurove janë deponuar vetëm nga 5 euro. Nuk e di ku kanë mbetur edhe 245 euro tjera! Ose nga ato me 300 euro, në konto kanë hyrë vetëm 3 euro! Këtu është e qartë se kemi të bëjmë me mashtrim, por edhe me dyshimin se kjo punë mund të jetë e koordinuar edhe me administratorët nga kjo qendër akademike. Pastaj, si është e mundur që administrata

qendrore e Universitetit të Prishtinës të mos e dijë se sa kanë të hyra njësitë akademike? Kjo e krijon mundësinë që të mos raportohen të gjitha pagesat. Anomalitë më të mëdha këtu dalin kur janë në pyetje pagat dhe mëditjet. Te kjo kategori duket se askush nuk e ka pasur dert të kujdeset për ruajtjen e një rendi dhe të asaj që e përcaktojnë ligji dhe rregulloret. Në një mes akademikësh ndodh që me të njëjtin zyrtar të lidhen dy kontrata të rregullta pune; që kontratat mbi vepër të lidhen në mënyrë të paligjshme, të paguhen 31 000 euro; që 54 zyrtarëve në emër të punës që jashtë orarit t'u paguhen 28 000 euro.

Pa dyshim se kjo punë vërtet është kryer, punë jashtë orarit, por nuk ka dëshmi për punën e kryer, që profesorët të paguhen për orët e mësimi që fare nuk i kanë mbajtur, apo që mbi pagën bazë të shtohen edhe pagesat e tjera në emër të honorarëve, apo të formave të tjera.

Çështja e prokurimit duket se është edhe më keq. Në Fakultetin e Mjekësisë eliminohet operatori më i lirë, por këtu vazhdon kontrata pas skadimit të vlefshmërisë së sigurimit dhe pajisjet sillen me vonesë prej 166 ditësh. Pa marrë parasysh vonesën, askush nuk ndëshkohet. Në Fakultetin Ekonomik bëhen kontrata nëpërmjet investimeve pa u zotuar paratë, ndërsa Rektorati e vazhdon punën me operatorin, të cilit i ka skaduar kontrata dhe ia paguan 214 000 euro. Domethënë, pas skadimit të kontratës ia paguan 214 000 euro.

Ka dhe raste kur janë bërë blerje pa procedurat e prokurimit. Janë bërë pagesa bukur të mëdha, pa dëshmi dhe me dokumentacion të duhur, apo kur pa fije përgjegjësie paratë e destinuara për botimin e librit shpenzohen për bileta të udhëtimeve zyrtare, ose ato për mirëmbajtjen e ndërtesave paguhen me materialet shpenzuese. Të gjitha këto tregojnë për një situatë shqetësuese që mbretëron në Universitetin e Prishtinës. Prandaj, ky problem nuk guxon të mbetet vetëm si dokument i Auditorit, por nga këtu të propozohen detyra dhe masa konkrete. Kjo është e domosdoshme për faktin se edhe në këtë sallë ka njerëz që mund të jenë pjesëmarrës në parregullsitë e pranishme në Universitetin e Prishtinës. Edhe me të gjitha këto vërejtje, unë i ftoj deputetët që ta përkrahin këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka tjerë të paraqitur. Konstatoj që në sallë janë 64 deputetë. E votojmë Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 52 për, 4 kundër, 2 abstenime, konstatoj se Kuvendi e miratoi Raportin e Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Universitetit të Prishtinës, për vitin e përfunduar 2011, me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Tani bëjmë pauzë deri në orën 15:00.

(Vazhdimi i seancës pas pauzës, e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,
Vazhdojmë me rendin e ditës:

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Përfaqësuesi i Qeverisë, nuk dëshiron ta merr fjalën lidhur me këtë. Nga Komisioni Funkcional, zoti Neziraj e ka fjalën në vend të kryetares..

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

Në mungesë të kryetares po lexoj unë emrat që janë aprovuar në Komision. Komisioni, në mbledhjen e mbajtur, më 19.9.2012, shqyrtoi Propozim- vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe vlerësoi se anëtarët e propozuar kanë përgatitjen profesionale dhe eksperiencën në fushë përkatëse dhe me këtë mënyrë përmbushin kushtet ligjore të parapara me Ligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore.

Komisioni i rekomandon Kuvendit të miratojë Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe mandati i anëtarëve duhet të jetë në pajtim me mandatin e bordit të përcaktuar me ligj dhe ky mandat do të zgjatë deri më 31 dhjetor 2013. Ndërsa, kandidatë janë: Faik Çollaku, Nexhat Hasani, Përparim Hoxha, Samir Lleshi, Bujar Krasniqi dhe Dejan Mitiq. Kështu që anëtarët e Komisionit njëzëri i kanë miratuar dhe i plotësojnë kushtet profesionale, sa i përket anëtarësisë partiake nëse ka, unë nuk di cilës parti janë, të partisë time s'janë kështu që propozoj që të votohen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupet parlamentare nuk janë paraqitur, nuk duan ta marrin fjalën po më duket janë dakord. E shtyjme për shkak të numrit jo të duhur të deputetëve në sallë, në qoftë se bëhet kuorumi votojmë.

13. Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës

Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje lokale dhe Media ka shqyrtuar Propozim-statutin e Universitetit të Prishtinës dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime. Përfaqësuesi i Qeverisë a e dëshiron fjalën? Zoti Buja e ka fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në bazë të nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës, miratimin e statutit të Universitetit të Prishtinës.

Statuti i Universitetit të Prishtinës është hartuar dhe duke respektuar parimet dhe rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Qeverisë dhe aktet tjera nënligjore për hartimin e legjislacionit sekondar. Këtij procesi i ka parapri një diskutim i gjerë me të gjithë faktorët në nivel të institucionit të arsimit të lartë, agjencitë dhe shoqërinë civile. Po ashtu, janë organizuar punëtori, grupe punuese, diskutime të hapura publike në të cilat të gjithë kanë dhënë komentet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Statuti i Universitetit të Prishtinës është një akt i rëndësishëm së veçantë, i cili ka 246 nene, të cilat rregullojnë: themelimin, misionin, të drejtat dhe detyrat, qeverisjen, strukturën, titujt e nderit, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë dhe administrimit, njësitë organizative, të drejtat dhe obligimet e studentëve, nivelet e studimit, titujt akademikë, njohjen dhe gjuhën e studimeve, kërkimet shkencore dhe dijen, punonjësit, pagesat e studentëve, sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e Universitetit të Prishtinës.

Prandaj, si akt shumë i nevojshëm për të funksionuar Universiteti i Prishtinës, propozoj që Kuvendi i Republikës së Kosovës ta miratojë këtë statut dhe puna të vazhdojë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Fjalën e ka raportuesi i Komisionit Funkcional zoti Vataj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Si udhëheqës i grupit punues për shqyrtimin e statutit të UP-së, shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjithë anëtarët e grupit punues, që janë anëtarë edhe përfaqësues të gjitha grupeve parlamentare këtu në Kuvend për punën e mirë dhe transparente që e kemi bërë gjatë shqyrtimit të këtij statuti.

Po ashtu, falënderoj edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, të cilët kanë marrë pjesë në takimet e grupit punues që kanë qenë shumë të rregullt. Shfrytëzoj rastin të falënderoj edhe përfaqësues të Universitetit, po ashtu pjesëmarrësit në cilësinë e ekspertëve të grupeve të ndryshme parlamentare, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në dëgjimin publik të cilin e kemi bërë gjatë shqyrtimit të këtij statuti. Duhet të sqaroj se Grupi punues ka bërë pesë ditë punë të plotë, që janë intensive, kanë qenë pjesëmarrës në çdo takim edhe përfaqësues të Ministrisë dhe të gjitha ndryshimet që janë bërë në statut janë bërë me marrëveshje të plotë, me konsensus të plotë të gjithë përfaqësuesve të partive politike, anëtarë të grupit punues. Po ashtu, janë inkurpcur edhe vërejtjet e ekspertëve të këtyre partive dhe punonjësve të Universitetit, të cilat i kemi marrë me shkrim.

Aty ku ka pasur konflikt me Ligjin për arsimin e lartë, ne i kemi bërë disa përmirësime, sepse kanë rrjedhur disa gabime gjatë përpilimit të statutit, ndërsa çdo ndryshim që është bërë, domethënë, nuk ka konflikt me Ligjin për arsimin e lartë. Ka pasur edhe disa rregullime që janë më tepër rirregullim fjalive që ta kenë një kuptim më të mirë. Dua të

sqaroj një gjë se unë kam dëgjuar zëra se janë shkelur procedurat e hartimit të statutit, këto i tha edhe ministri se të gjitha procedurat janë kryer në bazë të ligjit, ndërsa edhe unë si anëtar edhe si punëtor i Universitetit dhe anëtar i Komisionit për Arsim, nuk kam dëgjuar që janë shkel procedurat e hartimit të statutit.

Statuti është një dokument i cili do të duhej të rregullonte jetën në Universitetin e Prishtinës, domethënë, jetën qoftë akademike, qoftë studentore, ndërsa nuk është dokument që t'i plotësojë dëshirat e grupeve të ndryshme apo interesat e ndryshme të njerëzve të caktuar që kanë dalë aty-këtu disa zëra kundër statutit. Ne i kemi marrë përvojat më të mira të statuteve të ndryshme të universiteteve botërore dhe këto i kemi përshtatur gjithnjë duke i marrë parasysh kushtet dhe mundësitë që i kemi ne në Universitetin e Prishtinës. Një çështje që dua ta sqaroj dhe duhet ta shtroj para juve është emri i Universitetit të Prishtinës, i cili ka ardhur pas aprovimit të statutit në grupin punues dhe në Komisionin Parlamentar për Arsim.

Për këtë çështje unë do të jap një mendim personal e që përputhet me atë të shumë kolegëve në Universitetin e Prishtinës, ndërsa duhet ta keni parasysh ky nuk është as mendim i grupit tim parlamentar, as mendim i Komisionit për Arsim. Pra, duhet të mendojmë mirë para se ta ndërrojmë emrin e Universitetit të Prishtinës, që ka një traditë 42-vjeçare, sepse me këtë vendim për ndërrimin e emrit shkellet e gjithë veprimtaria hulumtuese dhe publikuese e Universitetit dhe me këtë do të dëmtohej puna dhe imazhi i tij në raport me universitetet tjera. Për shembull, në databazën e të dhënave të Universitetit nëse do t'i bënim një rangim të universiteteve në botë, në bazë të kriterëve vlerësues të cilësisë, e që një prej tyre dhe numri i publikimeve të Universitetit të Prishtinës pas këtij ndërrimit të emrit Universiteti i Prishtinës tash Universiteti “Hasan Prishtina” nuk do të figuronte askund. Unë po marr një shembull të freskët të arsytimit kësaj që thashë. Para rreth një muaji është publikuar rezultati i një qendre hulumtuese të Këshillit Kombëtar për Hulumtime nga Spanja, për rangimin e universiteteve botërore, ku në mesin e 20 mijë e 745 universiteteve botërore, Universiteti i Prishtinës renditet në vendin e 3 387 për nga cilësia.

Universiteti i Tiranës është i 8735-ti në radhë, Universiteti Amerikan në Kosovë i 11560-ti, AAB Riinvest i 11840-ti, e kështu me radhë. Tjetër fakt që dua të përmend është se duhet të mendojmë mirë para se t'ia ndërrojmë emrin Universitetit. Ajo është trashëgimia 42-vjeçare e punës së Universitetit të Prishtinës dhe e gjithë veprimtaria do t'i shkojë në llogari të Universitetit të Prishtinës, me seli të përkohshme në Mitrovicë, i cili nuk e ka ndërruar emrin, kuptohet.

Unë do ta mbyll fjalimin tim me rekomandimet e Komisionit për Arsim që të miratojë statutin e Universitetit të Prishtinës, këtij dokumenti shumë të rëndësishëm për mirë funksionimin e institucionit kryesor të arsimit të lartë në Kosovë. Të gjitha ndryshimet dhe miratimet e tij janë konform nenit 17, paragrafi 1 të Ligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, prandaj ju bëj thirrje të gjithë deputetëve të pranishëm që të votojnë statutin e Universitetit të Prishtinës. Ju Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati, në emër të LDK-së.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

I nderuari ministër,

Edhe ne në Grupin Parlamentar e kemi diskutuar dhe ka pasur një interesim për disa sqarime shtesë, ndërsa si anëtar i Komisionit e kemi votuar në mënyrë që Parlamenti t'ia japë mundësinë që të diskutohet më tutje.

Në punën paraprake në grupe dhe në Komision është evidente se është provuar që të nxirret maksimumi, është diskutuar edhe me përfaqësuesit e Universitetit dhe në një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë. Ajo që gjatë gjithë punës ka qenë problemi kryesor, pra pikërisht ka qenë çështja se ne nuk kemi mundur me statut të bëjmë veprime më të mëdha, sepse statuti është derivat i ligjit, pra ajo që del nga ligji. Dhe ka qenë një bindje e të gjithëve që Këshilli e ka debalancuar ndarjen e pushteteve në Menaxhment, Këshill edhe Senat. Ne këtë herë kemi qenë në situatë që t'i themi "po" kësaj pjese, që të shkohet më tutje, por e di që ministri duhet ta ketë saktësisht në mbikëqyrje ta shohë se si po funksionojnë këto kompetenca tani me ligj të fuqizimit të Këshillit në raport me Senatin, por edhe koordinimi i ngushtë i kompetencave menaxheriale edhe atyre të politikëbërjes, pra të Këshillit.

Dhe, nëse kjo formulë që është ndërtuar tash nuk funksionon, Universiteti dhe studentët nuk guxojnë që të kenë pasoja, duhet shpejtë t'i hyhet draftimit të ligjit në rast se ky tresh në bashkëpunim me Ministrinë, pra edhe me Kuvendin, shihet që pas një muaji, tre muaj, gjashtë muaji nuk funksionon mirë. Dhe unë duke e ditur që askush nuk është indiferent, as ministri që këtë do ta përcjellë dhe në një afat të shkurtë tremujor, gjashtëmujor, sigurisht që nëse askush tjetër unë do të kem pyetje parlamentare ta pyes ministrin se si po shkon ky ndërtim i këtij konselacioni me ligjin e ri që tash na derivon edhe në statut.

Sa i përket emrit, ajo është një iniciativë që ka dal pas kësaj dhe realisht unë tani po flas personalisht, gjithçka ne edhe do t'i respektojmë dhe figurat dhe patriotike, edhe të shkencës që i kemi pasur, mirëpo në takimin e fundit, domethënë, të përbërjes së kaluar, të bëhen kesi propozime, del që diçka më së pakti është që duhet të ndodhë, sepse ajo figurë ishalla s'e ka mësuar ditët e fundit ish- rektori se kush është Hasan Prishtina për të na kallëzuar, ka pasur mjaft kohë ose së paku përbërjes të re t'ia japë edhe t'ia lexoj, ta diskutojë. Sepse, është një çështje shumë interesante aty në rend të parë, të vetmit Universitet publik a i shkon më shumë ndonjë titull në kuptimin e respektimi i një figure akademike shkencore, po patriotike, por, fundit edhe të jetë kështu, t'i lëmë pak kohë të ketë diskutim publik që ta japin kontributin e vet edhe të tjerët, jo vetëm një përbërje e ngushtë. Sido që të jetë, sot nuk po diskutojmë për emrin, ndërsa për statut, personalisht unë lë vend që të shtrojnë dhe tjerët argumente dhe nëse nuk ka argumente se këtu është bërë ndonjë përkufizim që e dëmton interesin, kështu që unë mendoj se në grup punues dhe në Komision është nxjerr maksimumi dhe unë personalisht do ta votoj nëse nuk del ndonjë argument që do të ma ndryshonte bindjen time. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

I nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë,
Edhe Lëvizja Vetëvendosje ka shqyrtuar Projekt- statutin e Universitetit të Prishtinës dhe natyrisht ka marrë pjesë në Komisionin punues, por po ashtu ai ka disa vërejtje substanciale sa i përket përmbajtjes së tij, madje shumë nga këto vërejtje i kemi adresuar nëpërmjet ekspertit tonë edhe në dëgjimin publik që Komisioni Parlamentar për Arsim, ka mbajtur me përfaqësues të botës akademike.

Por, fatkeqësisht edhe ky statut që sot po e diskutojmë ashtu sikurse ai i vjetri i ruan shumë nga karakteristikat e një modeli burokratik dhe centralist në administrimin e Universitetit, prandaj me këtë statut do të ruhet edhe më tej trashëgimia jo demokratike e drejtimit të këtij institucioni akademik. Shqetësimet tona kanë të bëjnë me funksionin që ka Këshilli drejtues, organ ky thellësisht politik që po ashtu është pushtuar dhe uzurpuar nga anëtarë të partisë politike në pushtet, pastaj me mënyrën e zgjedhjes së rektorit e deri te mungesa e autonomisë themelore, me të cilën janë duke u përballur disa njësite akademike të Universitetit.

Në këtë kontekst vlen të përmenden disa nga nenet themelore të këtij statuti, të cilat e mbajnë peng mundësinë e avancimit të Universitetit të Prishtinës, e pengojnë demokratizimin e tij, i shndërrojnë pozitën menaxheriale të këtij institucioni vetëm në pozitë të kalkulimit politik, sikur që është në ndarjen e posteve publike dhe shndërrojnë kështu zgjedhjen e rektorit në çështje të koalicioneve qeveritare.

Kështu bie fjala, në nenin 23, ku përshkruhet roli i Këshillit drejtues në dispozitën 1.9, thuhet që detyrat e tij janë që të zgjedh rektorin nga lista e emrave të propozuar nga Komisioni profesion prej pesë anëtarëve, i emëruar nga Senati. Ne konsiderojmë se është joparimore që ky organ i manipuluar politikisht të ketë rol në zgjedhjen e autoritetit më të lartë menaxherial të UP-së, për më tepër, ky këshill as që duhet të ekzistojë fare, sipas pikëpamjes sonë.

Mund të marrim si shembull Universitetin e Zagrebit, ku zgjedhja e rektorit bëhet drejtpërdrejt nga Senati. Madje, në funksion të avancimit të frymës demokratike do të ishte më mirë, që të promovohet ideja, siç e kanë disa universitete, që rektori së bashku me prorektorët të zgjedhën drejtpërdrejt nga votat e të gjithë anëtarëve të stafit akademik të Universitetit.

Ndërkaq, sa i përket nenit 25, ku përshkruhen detyrat e rektorit, kërkesë jona qenësore mbetet dhe ka qenë, që të paktën nominalisht të sajohet një dispozitë e re ligjore në këtë statut, ashtu siç kemi bërë me shumë borde të institucioneve tjera publike, që çdokush që zgjidhet në pozitën e rektorit të UP-së, të paktën të mos ketë qenë në dy vjetët e fundit në pozitë të lartë drejtuese politike si ministër, zëvendësministër apo anëtar kryesie nëpër parti politike.

Në këtë mënyrë, ndoshta do të mund të pengojmë në të ardhmen situata groteske dhe absurde, ku njeriu mund të bjerë në gjumë si zëvendësministër e të zgjohet në mëngjes si

rektor, ashtu sikurse i ndodhi rasti i fundit skandaloz i zgjedhjes së Ibrahim Gashit në këtë pozitë.

Nuk mund të them se ky propozim nuk ka pasur përkrahje në Komision. Këtë nuk mund ta mohoj, ka pasur përkrahje nga të gjithë anëtarët e Komisionit, por është refuzuar me arsyetimin se amendamenti i Statutit mbi këto premisa demokratike vendos atë në antinomi me Ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Pra, sipas kësaj logjike, duhet të sakrifikohet depapartizimi i Universitetit, për hir të ligjit.

Ndërkaq, sa i përket nenit 28 të këtij Statuti, ku përkufizohen detyrat dhe përgjegjësitë e rektorit, diskutabile mbetet veçanërisht dispozita e nenit 1.6. ku thuhet se rektori kryeson Senatin. Me qëllim të çmpleksjes së pushteteve konsiderojmë se këtë organ duhet ta kryesojë vetë kryetari i Senatis, i cili duhet të zgjidhet nga anëtarët e Senatis me mandat 4-vjeçar. Shprehur në mënyrë metaforike, mënyra se si është rregulluar ky relacion ndërmjet këtyre dy instancave, i bie sikur kryeministri i vendit të jetë edhe kryetar i Parlamentit. Prandaj, kjo mënyrë e funksionimit duhet të ndryshojë rrënjësisht.

Dhe, kjo logjikë e përmbysjes së këtyre raporteve ka nevojë që të zgjerohet edhe në hallka të tjera organizative të Universitetit, kështu me qëllim të promovimit dhe avancimit të një vendimmarrjeje horizontale në nivel të këtij institucioni, detyrë qenësore mbetet edhe fuqizimi i njësive akademike, si subjekte vendimmarrëse juridike për interesat akademike, që lidhen me ato njësi. Për këtë arsye mbetet i papranueshëm edhe neni 49 dhe atë kryesisht, alineja 1.3 ashtu siç ka qenë, por edhe ashtu siç është amendamentuar tani.

Për ne problematike mbetet po ashtu edhe neni 137, i cili përfshin pjesën ku ka të bëjë me njohjen e studimeve. Thuhet se në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it mbi parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, është kompetencë e Universitetit që ta bëjë njohjen e diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare dhe të certifikatave të periudhave të caktuara të studimeve, me qëllim vazhdimin e studimeve.

Në rast se i njihen kualifikimet, studenti ka të drejtë t'i vazhdojë studimet në Universitet. E kemi konsideruar problematike këtë nen, ngase konsiderojmë se në këtë mënyrë është lënë mundësia, ashtu siç ka ndodhur që për hir të korrektësisë nuk dua t'ia përmendi emrin, një përfaqësues nga Qeveria, thuhet i cili regjistroi studimet në Harvard, studimet postdiplomike dhe erdh dhe u kthye të doktorojë në Universitetin e Prishtinës, që s'ka paradoks më të madh.

Sa i përket edhe emërimit të Universitetit të Prishtinës, që është bërë nga Senati, përpos argumenteve që u dhanë më herët, ne konsiderojmë që ky emërtim është bërë edhe në kundërshtim me ligjin, për shkak se neni 8, pika 2 thotë, emërtimi i çdo bartësi publik përcaktohet nga Ministria, në bazë të dispozitave të ligjit dhe këtë nuk e ka bërë Ministria, por e ka bërë senati dhe ish-rektori despot, Mujë Rugova.

Sidoqoftë, ka edhe shumë çështje të tjera diskutabile, të cilat ia vlen të veçohen në këtë rast, por që unë nuk do të ju marr kohë më shumë për këtë temë. Përfundimisht, me gjithë korrigjimet formale që ky statut pretendon t'i promovojë, përsëri ai nuk prodhon ndryshime substanciale juridike krahasuar me gjendjen e tanishme dhe si i tillë, ai mbetet i papranueshëm për ne. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes Statutin e Universitetit të Prishtinës dhe kemi punuar me një përkushtim maksimal në Komision. Njëkohësisht, Aleanca ka qenë shumë aktive në dëgjimin publik, që ka organizuar Komisioni dhe ka dhënë sugjerimet më të mira të mundshme, të cilat jo në përgjithësi janë implementuar në Statut.

Dhe, ne do ta votojmë Statutin jo pse është një statut që ne do të donim të jetë, jo pse është një prej statuteve më të mira, por do ta votojmë për një arsye, sepse ndryshimet që ne i kemi propozuar, ka pasur të shumtën e rasteve që nuk kanë mundur të bëhen, sepse kanë qenë në kundërshtim me Ligjin për arsimin e lartë dhe pikërisht Ligji për arsimin e lartë na e ka pamundësuar ta nxjerrim një statut shumë më të mirë për Universitetin e Prishtinës. Dhe ne do të punojmë shumë që ta sjellim në ndryshim Ligjin për arsimin e lartë, sepse ai ligj është bërë ashtu siç din me bë Qeveria, ashtu si di të ngutët shpeshherë të bëjë ligje sa për të thënë dhe me arsyetimin shpeshherë, që ka dalë nga Raporti i Progresit dhe duhet të ngutemi sa për ta bërë ligjin jo për vete, por ndoshta për të tjerët.

Pra, kjo është një arsye që ne do ta votojmë “për”. Dhe, sa i përket emrit pikërisht Aleanca ka qenë, që në dëgjimin publik e ka bërë një propozim shumë të arsyeshëm, por Senati ka qenë tamam në petkun e kryeministrit, që di shpeshherë të bëjë fushatë, të emërojë një institucion dhe kjo nuk ka guxuar të ndodhë në këtë moment. Prandaj ne, thashë, me arsyetimin që sa më par të sjellët në Parlament dhe të ndryshohet Ligji për arsyetimin e lartë, do t'i japim dritën jeshile.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, zoti Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Statutin. Ne kemi qenë pjesëmarrës në grupin punues të Statutit. Kemi dhënë kontributin tonë, propozimet tona. Na vjen keq që s'kemi pasur mundësi t'i ndryshojmë disa gjëra, të cilat kanë qenë të definuara me Ligjin për arsimin e lartë. Gjatë punimeve në Statut ka qenë një konkludim i përbashkët, që duhet të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për arsimin e lartë, në mënyrë që këto ndryshime të cilat i kemi kërkuar në Statut të vijnë në shprehje.

Ne shpresojmë, që në fazat tjera do të kemi mundësi që të bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjit dhe me atë të bëjmë pastaj edhe ndryshimet në Statutin e Universitetit të Prishtinës. Koalicioni për Kosovë të Re do ta votojë Statutin dhe ju falënderojmë për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sa i përket Statutit të UP-së kam një element që do ta evoluoj sot dhe kjo ka të bëjë me faktin se a dëshirojmë ta ngrisin nivelin e arsimimit në këtë universitet dhe si mund ta shfrytëzonim këtë statut për një universitet publik kualitativ?

Kohë më parë, siç u përmend këtu edhe më herët, është publikuar ranglista botërore e universiteteve dhe në këtë listë UP-ja zë vendin e 3387. Nuk tingëllon edhe aq mirë, por fundja është universiteti shqiptar i ranguar më së larti.

Më interesonte të dija se si është bërë ky rangim dhe kuptova se elemente kyçe për rangimin e Universitetit janë publikimet shkencore dhe hulumtimet e stafit të tij e posaçërisht publikimet në revistat prestigjioze ndërkombëtare. Rrjedhimisht, nëse dëshirojmë një universitet të ranguar mirë, duhet të kemi staf akademik që i kontribuojnë shkencës dhe të tillë besoj se do të jenë të denjë, që dijen e tyre ta bartin te studentët e tyre, të cilët paraqesin qëllimin kryesor. Po ritheksoj, studentët dhe arsimimi i mirë i tyre duhet të jenë qëllimi kryesor i çdo universiteti edhe i UP-së.

A reflekton ky statut që kemi para vetes qëllimin për një universitet të fortë, të ranguar mirë në listën botërore të universiteteve? Unë konsideroj se jo. Kur jemi te emërimet dhe avancimet e stafit akademik, më së shumti i vihet theks moshës, por mosha nuk është parametër, që do ta rangonte më mirë universitetin tonë. Po ju rikujtoj, janë publikimet shkencore të stafit akademik ato të cilat e rangojnë më mirë universitetin.

Në përzgjedhjen për profesorë- asistentë kërkohet një punim ndërkombëtar. Pse nuk është precizuar, se përzgjedhja bëhet në bazë të numrit të punimeve ndërkombëtare dhe rëndësisë së tyre, me minimum një punim ndërkombëtar, kurse të përzgjidhet ai ose ajo me më së shumti sosh?

Për të qenë më të saktë, këtu mund të instalohet edhe sistemi i poentimit, i cili mund të realizohet në bazë të rëndësisë së punimeve. Pastaj, për të njëjtin pozicion të profesorit-asistent është kërkuar përvoja 3-vjeçare, duke mos i lënë mundësi dikujt që ka kontribut meritues shkencor, por nuk ka pasur mundësinë të realizojë përvojën në mësimdhënie.

E njëjta vlen edhe për pozitën profesor i asociuar dhe profesor i rregullt. Konsideroj se është dashur të kërkohet minimumi, por të shkruhet se duhet të përzgjedhet kandidati i cili prezanton biografinë më të pasur.

Në vend se te përzgjedhja e stafit të kërkohen publikimet cilësore, te neni 185 është bërë një amendamentim te të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit, ku thuhet: Personeli

akademik, që tregon rezultate të shkëlqyeshme në punë hulumtuese dhe e dokumenton me publikime shkencore me së paku dy publikime në reviste prestigjioze ndërkombëtare me impakt-faktor në vitin paraprak, mund të lirohet prej 1/3-ës së normës në mësimdhënie në vitin vijues. Impakt-faktori apo cilësia e punimeve shkencore është dashur të ceket më lartë te përzgjedhja e stafit, ndërsa të tillët mësimdhënës, që kanë punime me impakt-faktor, konsideroj se nuk duhet t'i lirojmë nga norma, por përkundrazi të jenë afër studentëve, sepse të tillët mund ta ngrenë cilësinë në arsimin e lartë në Kosovë.

Pra, ky statut nuk reflekton për një UP cilësor, prestigjioz, por reflekton për akomodim të individëve të caktuar dhe fortifikimin e tyre. Ju Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuari kryesues,

I nderuar ministër,

Mendoj se ky projekt i Statutit krijon një avancim në krahasim me statutin e mëparmë dhe në krahasim me gjendjen që e kemi, duke reflektuar disa ndryshime në Ligjin për arsimin e lartë.

Dy çështje, që sipas mendimit tim, duhet të diskutohen më tutje, ose kisha sugjeruar ministrit dhe ministrisë t'i analizojë dhe eventualisht të propozojë zgjidhje më të mira në një të ardhme, kanë të bëjnë me organizimin e Universitetit.

Universiteti i Prishtinës ka traditë të një organizimi më të decentralizuar dhe traditën e tashme, ku funksionet që të gjitha janë të centralizuara në Rektorat, në nivelin institucional të Universitetit. Ka traditë në Evropë, shumica e universiteteve në Evropë kanë një traditë të ngjashme me këtë organizim, por Universiteti i Prishtinës është shumë specifik për nga numri i madh i studentëve dhe për nga numri i madh i fakulteteve dhe i stafit. Kështu që, kjo qeverisje shumë e centralizuar në nivel të Universitetit nganjëherë bllokoi iniciativat ose ngulfatet dhe nuk mund të jetë shumë efikase me gjithë këto njësi akademike, me gjithë këto departamente, me gjithë këto programe. Pra, është e pamundur që të sigurojë standarde të cilësisë në kushte të tilla të organizimit.

Prandaj, unë kisha sugjeruar që të bëhet një projekt, të bëhet një analizë, se si mund të lehtësohet qeverisja nga niveli universitar, duke i deleguar disa funksione, disa punë në njësitë akademike në fakultet. Për shembull financat, i tërë prokurimi është në një vend dhe njerëzit për të bërë diçka duhet të iniciojnë procedura edhe për gjëra të vogla, procedura në administratën qendrore. Gjithashtu, shumë çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen në përgjithësi dhe me qeverisjen kooperative mbeten pra, një problem që duhet të shikohet. Unë nuk jam për ta ndalë Statutin tash për këtë arsye, por kisha sugjeruar që kjo çështje të analizohet, sepse edhe nuk mund të zgjidhet shpejt, nevojitet një studim se si mund të organizohet kjo më mirë.

Çështja e dytë ka të bëjë me mënyrën e zgjedhjes së bordit.

Mendoj, në një të ardhme të afërt ndoshta duhet të analizohet me qenë se Kuvendi është themeluesi i Universitetit, a mos është më mirë që i kontribuon më shumë depolitizimit të Universitetit, që me propozim të ministrit, me propozim të Ministrisë, anëtarët e bordit që zgjidhen jashtë Ministrisë të zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës. Kuptohet domethënë ministri bën konsultimet dhe i propozon, por një propozim, një verifikim nga Kuvendi ashtu qysh bëhen edhe për disa organizata të pavarura themelues i të cilave është Kuvendi, ma merr mendja që do t'i kontribuonte qeverisjes më të suksesshme dhe më pak të politizuar të Universitetit të Prishtinës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Pika e parë problematike që shfaqet në këtë statut të Universitetit të Prishtinës, është mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimi i rektorit. Vetë mënyra se si zgjidhet dhe si shkarkohet rektori, tregon për varësinë e Universitetit nga Ministria dhe Qeveria.

Dihet që rektori zgjidhet me shumicë nga Këshilli drejtues 9 anëtarësh i UP-së, 4 prej të cilëve emërohen nga Ministria dhe 5 nga Senati.

Përderisa rektori zgjidhet me 6 vota minimalisht, kjo do të thotë që ai kurrësi si nuk mund të zgjedhet edhe përkundër vullnetit të Ministrisë dhe të Qeverisë, sepse këta i kanë 4 anëtarë në Këshill. Prandaj, po që se rektori nuk bën ndonjë pazar paraprak me Qeverinë se do të jetë lojal ndaj politikave të pushtetit, nuk mund ta ketë votën e 6-të vendimtare për t'u zgjedhur rektor.

Po ashtu, rektori mund të shkarkohet vetëm me 2/3 e votave që saktësohet në nenin 31.3, e kjo është një formulë që Qeverisë ia jep kontrollin politikë mbi rektorin. Nëse vetëm njëri nga të dërguarit e Ministrisë nuk pajtohet me shkarkim, atëherë rektori mbetet. Kjo krijon një marrëdhënie jo të shëndoshë me Këshillin drejtues, rektorit dhe Qeverisë, sepse nëpërmjet kësaj formule rektorit në fakt i thuhet se për të qenë rektor i mirë gjithnjë duhet të jetë i dëgjueshëm politikisht, sepse përndryshe nga të 4 anëtarët që i ka në Këshillin e Përgjithshëm nuk ja garanton të drejtën e saj të vetos në rastin e shkarkimit të rektorit dhe kjo është një mënyrë shumë perfide e dorës së politikës në kreun e Universitetit. Rrjedhimisht edhe ne kemi kërkuar që Këshilli të hiqet fare.

Një aspekt tjetër i varësisë së Universitetit nga Qeveria është mungesa e autonomisë së Universitetit në dy çështje esenciale.

Njëra është përcaktimi i tarifave studentore si dhe tjetra përcaktimi i numrit të studentëve. Këto të dyja vendosen nga Ministria, ndërkohë që Universiteti ka vetëm rolin e tij formal të propozimit, i cili zakonisht nuk përfillet nga Qeveria. Kjo mund të sjellë probleme të shumta, sepse ndonjëherë ka ndodhur që të kenë ndërhyrje të drejtpërdrejta në ndryshimin e strukturës së buxhetit të UP-së nga ndërhyrjet e Ministrisë.

Dihet që Universiteti zakonisht bën plane 3-vjeçare për zhvillimin e vetë në formë të projekt-programeve dhe strategjive dhe ndodhë që Qeveria të ndërhyjë sikur që ishte rasti

kur ministria hoqi tarifën e pagesave për studentët , gjë që përnjëherë e ndërroj strukturën e buxhetit të UP-së dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në strategjitë zhvillimore të cilat bëhen për tri vjet. Dhe kështu mund të destabilizohet funksionimi i Universitetit të Prishtinës.

Po kjo mundëson po ashtu që UP-ja dhe udhëheqja e saj të jenë vazhdimisht të shantazhueshëm nga Qeveria, apo rastet kur vendoset befasisht për shtrenjtimin e tarifave të semestrit, sepse Qeveria një ditë mund të ndodhë ta gjejë veten në ndonjë krizë financiare dhe kjo automatikisht e godet studentin, kurse në anën tjetër e fut atë në konflikt me strukturat udhëheqëse të Universitetit publik.

Po ashtu edhe sa i përket numrit të studentëve vendimtare mbetet Qeveria. Shpeshherë ka ndodhur që institucionet drejtuese e propozojnë numrin e përgjithshëm të studentëve që UP-ja mund të pranojë për vitin përkatës akademik, por Ministria ia shton këtij numri edhe nja 3 deri 4 mijë studentë tjerë. Prandaj, mund të kemi situata absurde sikur ajo e vitit 2010, kur ushtruesi i detyrës i UP-së patë thënë se UP-ja nuk mund të garantojë cilësi të studimeve për shkak se Ministria lejoi regjistrim shumë më të madh të studentëve në vitin akademik se sa që kishte propozuar Universiteti në përputhje me kapacitetet që i ka.

Kjo që ministri gjithnjë propozon numër më të madh të studentëve se që ka kapacitet UP-ja, shpeshherë është keqpërdorur nga politika zyrtare për qëllime elektorale.

Problemet që i ka UP-ja me politizimin dhe varësinë që i vjen nga pushteti janë të shumta, por pa u pavarësuar UP-ja në këto tri çështje, në çështjen e rektorit, në punën e financave dhe përcaktimin e numrit të studentëve, në përputhje me mundësinë dhe cilësinë, UP-ja kurrë nuk mund të ketë pavarësinë nga politika dhe ky statut pikërisht këtë pavarësi nuk e siguron. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputetja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Unë do të lexoj një letër të drejtuar deputetëve të Kuvendit nga organizatat studentore të Universitetit të Prishtinës në lidhje me statutin.

“Universiteti është studenti, studenti është thelbi dhe subjekti që e bën ekzistencë Universitetin. Pa studentin, Universiteti nuk do të kishte kuptim.

Universiteti i Prishtinës është universitet i rezistencës, është universitet në kohën e angazhimit për liri. Ai u themelua pas demonstratave të vitit 1986 dhe vazhdoi ekzistencën e tij të vërtetuar vazhdimisht si hapësira ku niste rezistenca e një populli të shtypur ndaj pushtuesit të tij.

Universiteti i Prishtinës ishte universitet dhe atë e bënë studentët.

Studenti i Universitetit të Prishtinës ishte qenie politike, e vetëdijshme për rolin dhe pozitën në shoqëri. Ata jetësuan qenien e tyre duke organizuar bashkë me profesorët për

çlirim dhe të drejta ndaj pushtuesit jugosllav. Prej përfundimit të luftës e deri në ditët e sotme, Universiteti i Prishtinës është në gjendje të mjerueshme. Fajin për këtë gjendje e kanë të gjitha qeveritë e pasluftës edhe kjo e sotmja.

Në mungesë të një plani të mirëfilltë kombëtar për arsim ku universiteti do të kishte rolin kyç pushtetet e shndërruan atë në vegël në funksion të tyre.

Qeveritë dhe partitë në pushtet filluan rekrutimin e stafit akademik për radhët e tyre. Militantët e partisë i caktuan në pozita udhëheqëse, shkak i cili bërë që brenda Universitetit të mbytej liria akademike dhe të humbasë demokracia e cila është vendimtare për zhvillimin progresiv të tij.

Duke qenë i kapur prej pushteteve nëpërmjet Këshillit drejtues, si organ me të drejta absolute si dhe rektorin e zgjedhur nga po ky këshill, Universiteti i Prishtinës ka degraduar skajshmërisht, duke u shndërruar në vendin ku prodhohen diploma në formën e shifrës.

Me një buxhet të varfër e i mbipopulluar, Universiteti i Prishtinës u bë kamp i punësimit të përkohshëm, por jo edhe vendi ku ofrohet marrëdhënia me zhvillimin e shkencës dhe ballafaqimi me dijeni.

Draft-statuti i ri i Universitetit të Prishtinës, është statuti i vjetër, po sikurse ai i vjetri draft-statuti i propozuar për miratim në Kuvendin e Republikës formalizon gjendjen ekzistuese, e cila është instaluar për vite në Universitetin e Prishtinës.

Në vend që të sillej për diskutim në këshilla të studentëve nëpër fakultete, parlamentin studentor dhe të vihej në mundësi për diskutim të gjerë për studentët dhe publikun, drejtuesit e UP-së vendosën që tinëzisht dhe pa kurrfarë diskutimi, me gjasë as me profesorët, ta dërgojnë në Kuvend për miratim. Kjo gjë është e papranueshme dhe në studentët e Universitetit të Prishtinës nuk do ta pranojnë këtë gjë. Çdo votë për këtë statut do të rëndojë edhe më tepër gjendjen e Universitetit të Prishtinës.

Në kërkojmë që deputetët të votojnë kundër këtij draft-statuti ashtu që ky draft- statut të kthehet në Komisionin Parlamentar dhe brenda UP-së të hapet debati me studentë, profesorë, qytetarë rreth përmbajtjes së statutit të ri. Nuk ka kuptim ekzistenca e statutit pa qenë pjesë e debatit dhe e vendimmarrjes me studentin.

Statuti duhet të jetë në shërbim të studentëve dhe të forcojë lidhjen në mes të Universitetit dhe studentit dhe jo status që forcon edhe më shumë lidhjen në mes universitetit dhe pushtetit.

Ju deputetët e Republikës, keni për obligim për të punuar e vepruar në emër dhe për interesat e qytetarëve të vendit tonë. Disa nga ju keni qenë pjesë aktive e lëvizjeve studentore, andaj askush më mirë se ju nuk e kupton rëndësinë e të qenit pjesë e vendimmarrjes dhe angazhimit të studentëve për vendin dhe emancipimin e gjithëmbarshtëm të shoqërisë.

Duke iu kujtuar rolin tuaj për mbrojtjen e interesave të Republikës, ne studentët e Universitetit Publik të Prishtinës, ju bëjmë thirrje të mos e votoni draft- statutin e propozuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Përveç vërejtjeve të paraqitura nga Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje, unë kam një vërejtje tjetër në lidhje me gjuhën e cila është përdorur në hartimin e statudit.

Ka pasur një kërkesë të vazhdueshme nga profesoret e Universitetit të Prishtinës, të cilat janë ankuar te Grupi i Grave Deputete, që në hartimin e statudit ato nuk janë përfshirë, mirëpo pavarësisht nga kjo ato kanë përgatitur amendamente dhe amendamentet të cilat ne jemi munduar, i kemi dorëzuar në Komision dhe një prej këtyre amendamenteve ka pasur të bëjë me gjuhën e përdorur. E kam fjalën për gjuhën e cila për momentin është maskiliste në statutin e Universitetit të Prishtinës, për shembull aty përcaktohet fjala rektor, dekan dhe jo rektore, dekane e të tjerë, natyrisht që gjuha shqipe përfshin këto do të thotë dikush, këtë e dimë shumë mirë, mirëpo në të gjithë legjislaturën evropiane në “acquis communautaire” thuhet dhe kërkohet shprehimisht që gjuha që futet nëpër ligje të jetë ‘gender sensitive’ në kuptimin që të ndikojë në largimin e paragjykimëve të cilat i kanë shoqëri të pazhvilluara në lidhje me pozitat të ndryshme udhëheqëse. Është dashur të bëhet ky përmirësim në statutin e Universitetit të Prishtinës dhe nuk është bërë dhe kjo është një arsye më shumë për të mos e votuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ramë Vataj e ka fjalën.

RAMË VATAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë ndjej obligim si kryesues i Grupit t’i jap disa sqarime.

Mua po më vjen keq për kolegun Kasolli që këtu jep mendime të Lëvizjes për Studim dhe Veprim dhe jo mendimet e ekspertit që kanë pasur në Komision aty, në dëgjim publik.

Po e marr bile një shembull disa i mori, ka qenë ideja edhe e imja rektorin edhe dekanët për t’i hequr prej Senatit, por nuk e kam pasur përkrahjen e Grupit dhe ajo mbetet derisa të bëhet rishikimi i ligjit. Gjithë kemi pasur vërejtje për ligjin se ligji na i kufizon shumë gjëra, si zgjedhën anëtarët e Këshillit drejtues, ligji është i vetmi ky statut tash i merr parasysh këta se të gjitha zgjedhjet tjera që janë bërë, janë bërë prej stafit të Universitetit e i ka emëruar Ministria. Mirëpo, kjo është një përvojë shumë e mirë përëndimore, bile ka universitete që gjithë këshilli drejtues janë jashtë Universitetit se është tregua shumë më e mirë, më e drejtë se ata nuk kanë konflikt të drejtpërdrejtë, sepse anëtarët e Këshillit drejtues përfitojnë nga pozita edhe marrin në punë Komision e lëndë e të gjitha të tjera, kështu që kjo është një praktikë shumë e mirë.

Mirëpo unë e di edhe një gjë tash që ministri e ka marrë iniciativën me ta ndërrojë ligjin se shumë gjëra kufizohen, ka anomali në ligj. Për shembull është një anomali që ne s’mund ta përmirësojmë me statut, duhet Këshilli drejtues ta ketë mandatarin sa e ka edhe

rektori, që është praktikë e shumë vendeve. Këtu Këshilli drejtues e ka 3 vjet, 4 vjet rektori, e kështu me radhë.

Mirëpo, disa mendime për shembull unë dëgjova më tepër thashë mendime të tjerëve ka qenë edhe publike eksperti i Lëvizjes Vetëvendosje kur kaluar kandidaturat, ka thënë po të isha unë kryeministër, rektorin ose po të dëgjohem unë rektorin duhet ta zgjedhë kryeministri, për arsye shumë praktike vetë eksperti tash po dalin e po nxjerrin fjalë të tjera. Se për të ecur një universitet nëse nuk e ka përkrahjen e Qeverisë dhe të kryeministrit, unë nuk po them aty po ai e ka thënë vetë publikisht, pse tash njerëzit, jo, jo mu këta qesin fjalët e ekspertit që eksperti i tyre i ka thënë i ka prononcuar. Domethënë nuk mundemi me luajt tash me fjalë ose lexojnë letra të Lëvizjes për Studim dhe Veprim.

Për gjëra konkrete ne i kemi biseduar të gjithë dhe jem pajtuar, bile edhe mendimi i ekspertit që ka qenë edhe mendimi im e kem bërë ndryshimin që dekanët t'i zgjedhë njësia akademike edhe ajo praktikë ndalet me tash me këtë statut që është shumë praktike edhe shumë demokratike. Pra, kemi bërë me të vërtetë ndryshime të mira që na i ka lejuar ligji. Unë thashë të gjitha ndryshimet janë konform ligjit edhe konform kushteve që i kemi.

Neni 137, unë e kam dhënë një sqarim, me të vërtetë Afrimi duhet ta dijë, ne i kemi thënë që primatin për njohjen e diplomave e ka Qendra Kombëtare për njohje që është në kuadër të Ministrisë, po autonomia e Universitetit është e tij që a e pranon atë diplomë a jo? Vjen një diplomë që në rregull është në mënyrë procedurale e në mënyra tjera prej Malit të Zi, nëse Universiteti mendon që nuk janë për nivelin që duhet të pranohet, nuk e pranon dhe ne nuk mund t'ia imponojmë, domethënë, kjo nuk është punë e statutit.

Tjetra, është ose për punën e punimeve që e tha zonja, po më duket jam bërë i tepërt, po e lë. Unë kam çka të sqaroj këtu, duhet të pranojmë që kemi punuar të gjithë mirë, gjithë me marrëveshje prej atyre gjërave që kanë mund të ndryshohen. Ligji do të ndryshohet se është marrë iniciativa, konform ligjit do ta ndërrojmë edhe statutin, nuk është më i miri po është më i miri që mund të jetë është ky statut tash që e aprovojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë zoti Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Pasi ma përmendi emrin, më duhet të reagoj për atë që e tha kolegu Vata, se përfaqësuesi i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka kërkuar, eksperti tha që rektori të zgjidhet nga kryeministri, dhe qysh duket zotit koleg, kujtesa pak iu paska davaritur, për shkak se atë e ka kërkuar dhe ka thënë përfaqësuesi i Ministrisë që ka qenë në Komision. Naim Hasani, a Nait Hasani, qysh e pati emrin?

(Ndërhyrje - reagim)

Jo, jo! Unë ta sjell, se tash fatkeqësisht nuk e kam me veti. Nait Hasani, por unë sot s'e kam kërkesën e tij me veti dhe ka qenë se plotësisht Senati të jetë përgjegjës për rektorin, kurse sa i përket asaj, mua më vjen çudi kur vetë përfaqësuesi ka thënë që kërkesat e Lëvizjes Vetëvendosje, në debat i ka thënë kërkesat e Lëvizjes Vetëvendosje do të

pranohen plotësisht dhe më pastaj nuk janë pranuar në Komision, me arsyetimin se bien në kundërshtim me ligjin. Pra, në debat ka thënë do të pranohen plotësisht, kurse në Komision i ka refuzuar me arsyetimin se bien në kundërshtim me ligjin.

Edhe për rektorin kam thënë, kolegë këtu nuk bëj kompromis, që të mos jetë dy vjetët e fundit anëtar i një partie politike. Jeni pajtuar të gjithë!

(Ndërhyrje)

Po, jeni pajtuar të gjithë! Dhe, e thashë edhe anëtarët tjerë të Komisionit kanë thënë mirë e ke, por nuk po mundem ta bëj këtë send, sepse duhet t' i zgjedhim njerëzit që janë të lidhur me politikën, qysh i keni zgjedhur. Dhe që jeni pajtuar edhe ju, intimisht keni thënë që rektori i zgjedhur nuk ka qenë më i miri prej atyre që kanë qenë në konkurrencë, ka pasur shumë më të mirë, por çka të bëjmë kur politika përzihet në këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena, edhe ti ke replikë. Urdhëro, Albulena!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Por më duhet ta bëj një sqarim për opinionin, pasi që këtu u thanë shumë të pavërteta. Letrën që unë e lexova, është letra nga studentët e Universitetit të Prishtinës, konkretisht nga Organizata apo Lëvizja studentore, siç është Studim, kritikë, veprim, Klubi për politikë i studentëve të Universitetit të Prishtinës dhe Paqja studentore e Universitetit të Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, konstatoj që debati ka përfunduar. Tash futemi në proces të votimit. Në sallë janë 64 deputetë.

E votojmë pikën dymbëdhjetë, të cilën e kemi kaluar më herët: *Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.*

Emrat i keni dëgjuar edhe më herët, dhe ata janë:

1. Faik Çollaku;
2. Nexhat Hasani;
3. Përparim Hoxha;
4. Samir Lleshi;
5. Bujar Krasniqi;
6. Dejan Mitiq.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash. Në sallë, thash, janë 64 vetë.

Faleminderit! Konstatoj se me 35 vota për, 10 kundër dhe 13 abstenime, Kuvendi i emëroi anëtarët e Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave me mandat deri më 31 dhjetor 2013.

Tani e votojmë pikën: *Shqyrtimi i Statutit të Universitetit të Prishtinës*

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 44 vota për, 11 kundër dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi Statutin e Universitetit të Prishtinës, me ndryshimet e propozuara nga Komisioni Funkcional. Faleminderit!

Tani kalojmë në pikën e katërmëdhjetë të rendit të ditës. Zonja Lama është paraqitur me një kërkesë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke qenë se Qeveria e Kosovës nuk është e pranishme këtu në sallë dhe ky debat lidhet në radhë të parë me Qeverinë e Kosovës, unë kërkoj që të shtyhet për ditën e hënë dhe debati të zhvillohet në mëngjes, sepse është shumë e rëndësishme që Qeveria të jetë e pranishme. Megjithatë letra dhe kërkesa për debat ka shkuar prej shumë kohësh, i është drejtuar Qeverisë që përpara pushimeve verore, ne s'kemi marrë asnjë përgjigje as me shkrim, madje as të pranishëm nuk janë, kështu që kërkoj që debati të zhvillohet kur Qeveria të jetë e pranishme në sallë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ky është një mocion për ta shtyrë debatin, dhe do ta diskutojmë e votojmë këtë kërkesë të zonjës Lama.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së, dhe e lus për mendim.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit kryesues!

Kolegë të nderuar,

Ne e kemi parasysh që i kemi tri nivele institucionale, legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, që janë institucione të pavarura nga njëra-tjetra.

Fatkeqësisht, jo rrallë herë, po ndodh që të përzihen dhe këtu është duke shkuar një tendencë që foltoren e Parlamentit të Kosovës, gjegjësisht legjislativin, të shndërrojmë në një gjykatore, të luajmë rolin edhe të vendimmarrësit, edhe të ekzekutuesit, edhe të gjyqtarit.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, për shkak të deklaramit dhe të gatishmërisë që në çdo kohë jemi të gatshëm të diskutojmë e të debatojmë dhe luftojmë të gjitha fenomenet negative që kanë ndodhur në Kosovën e pasluftës, ne kemi dhënë pëlqimin që edhe kjo aktakuzë e ngritur, fatkeqësisht ku fyhen tash jo vetëm institucionet shtetërore, por kalohet e pretendohet të luftohet edhe biznesi privat, të etiketohet edhe biznesi privat, megjithëkëtë, ne e kemi treguar gatishmërinë që këtu të debatojmë edhe për këtë çështje.

Prandaj, ne mendojmë se nuk ka nevojë të shtyhet, por debati të vazhdojë deri në përfundimin e tij. Ju Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ferati, në emër të LDK-së.

SADRI FERATI: Faleminderit, kryesues!

Në parim, sa herë që krijohen kushtet dhe respektohen procedurat dhe kërkohet debat për një fushë, ne jemi të interesuar që fusha të trajtohet ashtu siç edhe e lejoni ligji, por gjithmonë qëllimi kryesor të jetë interesi i qytetarëve dhe interesi i fuqizimit të institucioneve dhe në të duhet të marrin pjesë të gjithë aktorët.

Ne shumë mirë e dimë se cilat janë kompetencat edhe të Parlamentit, edhe të komisioneve, por dëshirojmë të bashkë komunikojmë me aktorët, pra, kompetentë, siç janë edhe ekzekutivi në këtë rast, sepse ata në masën e madhe marrin vendime, dhe jo për të gjitha vendimet, vijën dhe i pyesin parlamentet.

Ne i kemi raportet herë pas here, mirëpo del nganjëherë që nuk janë të mjaftueshme. Prandaj, Rregullorja dhe ligji ka lejuar që të ketë edhe interpelancë, të ketë edhe diskutime të ndryshme. Dhe edhe unë jam për atë që të shtyhet debati në mungesë të aktorëve kryesorë dhe të mos mbetet kjo kështu, sepse për kështu, në mungesë të debatit ka mund të shkruhet një shkresë dhe të shtrohet një pyetje parlamentare. Dhe, ku është dallimi, në një pyetje parlamentare dhe në një debat, pikërisht është mundësia që të shprehen më shumë individë dhe që të kapet esenca e kësaj çështjeje.

Pra, edhe unë, por besoj që në konsultim edhe me të tjerët, flas në emër të Grupit Parlamentar, dëshirojmë që kësaj teme t'i jepet hapësirë e mjaftueshme dhe të jenë të gjithë aktorët këtu. Pra, edhe ministrat që janë kompetent për këto fusha.

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Qartazi, këtu nuk kemi rrethana për ta debatuar këtë pikë, për shkak se kjo pikë kërkon që anëtarët e Qeverisë, po veçanërisht kryeministri, ministri i Financave dhe ministri për Zhvillim Ekonomik, të jenë të pranishëm në seancë, për shkak se çështja ka të bëjë drejtpërsëdrejti me ta.

Pra, është debat për shpenzimet buxhetore të Qeverisë së Kosovës. Dhe kjo që e thonë këta të Grupit Parlamentar të PDK-së nuk qëndron fare në gatishmërinë e tyre për t'u përballur me debat e kemi parë disa herë dhe këtë herë këta po insistojnë që një çështje e tillë të ndodhë, duke pasur parasysh që njerëzit kryesorë për këtë debat nuk janë këtu e që janë përfaqësuesit e Qeverisë, pra këta tre që i përmenda. Prandaj, në këso rrethana nuk mund të kemi debat për shkak se debati nuk do të ishte komplet pa i pasur edhe ata.

Kjo kërkesë për debat është shtruar tash e sa kohë dhe i është dërguar edhe Qeverisë, asnjëherë Qeveria nuk e ka parë të udhës që të dërgojë të paktën një letër për ta shpjeguar temën dhe qartësuar ato që kërkohen nga tema e debatit dhe tash kanë ikur madje krejt nga Kuvendi, nuk janë fare këtu.

Dhe, konsiderojmë që Qeveria duhet të obligohet e të jetë e përgjegjshme karshi kërkesave të deputetëve. Ky debat kërkon një lloj përgjegjësie dhe thirrje në përgjegjësi të Qeverisë për këto shpenzime. Prandaj, kërkojmë që kjo pikë të shtyhet dhe të debatohet të hënën, ose në seancën e ardhshme, në mënyrë që ta kemi Qeverinë këtu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! AAK-ja, zoti Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shumë shkurtimisht, grupi ynë parlamentar, mendon se definitivisht do të duhej që t'i kemi këtu ata që u adresohet edhe debati, do të thotë Qeverinë dhe për të qenë në gjendje të diskutojmë dhe të debatojmë për çështjen e shpenzimeve të fondeve publike.

Sidoqoftë, jemi të bindur se ka nevojë që të shtyhet, ndoshta për seancën e ardhshme, në mënyrë që t'i kemi të dy palët dhe të argumentohen të gjitha këto që mund t'i themi këtu.

Prandaj, besojmë se nuk ka hapësirë që të debatohet sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Koalicioni Kosova e Re, kryetarja e Grupit, Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Duke marrë parasysh kërkesën për debat parlamentar nga një grup i deputetëve dhe duke parë materialin në të cilin është vendosur debati për këtë pikë, mund të them shumë sinqerisht se në rast që ne dëshirojmë të ngremë aktpadi ndaj kujtdo këtu që është në këtë material, si deputetë kemi të drejtë në mënyrë individuale, ndërsa si parti politike, nuk kemi të drejtë të marrim vendime të prera te gjyqësori, duke marrë parasysh se në vitet e kaluara kanë shkuar raporte të auditorit dhe është dhënë llogari për të gjithë paranë publike çka është shfrytëzuar në Kosovë. Dhe në rast se domi këto materiale, të cilat janë këtu, të verifikohen, atëherë mund të shkojnë në gjyqësor dhe ata të japin verdiktin e fundit.

Mund të debatojmë, ju them me mënyrën më të sinqertë, si miq, por nuk di çka duhet të debatojmë në rast se këto kanë shkuar. Ju Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga SLS, zoti Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Poslanici Samostalne Liberalne Stranke, kao i uve, spremni su i odgovorni da učestvuju u svakoj debati, pa i u ovoj, i mi smatramo da treba da se nastavi današnja sednica. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli, për "6+"!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit! I nderuar nënkryetar,
Edhe Grupi Parlamentar 6+ është për vazhdimin e debatin parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe një herë, zonja Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk arrita të kuptoj pse janë tensionuar kaq shumë këta të Partisë Demokratike, kërkesa ime, është shumë normale. Për t'u zhvilluar ky debat, duhet që në sallë të jenë ministrat. Dhe, ky është debat, e nuk është padi, aktpadi siç po thonë dikush, dhe sinqerisht më vjen keq për injorancën e madhe që tregojnë disa deputetë, që nuk i kanë konceptet themelore të çështjeve të cilat këtu shqyrtohen. Ta hapin fjalorin e të shohin se ç'është aktpadia.

Ky është një debat parlamentar. Më lejoni t'ju kujtoj që dje, sapo ka ardhur studimi i fizibilitetit, dhe në mënyrë të qartë thotë: "Parlamenti nuk bën mbikëqyrjen e Qeverisë" ka defekt serioz dhe ky debat shërben pikërisht për këtë, që Parlamenti të bëjë mbikëqyrjen e Qeverisë. Është në mandatin e parlamentit që të bëjë mbikëqyrjen, përveç se prodhimit të ligjeve.

Prandaj, ju ftoj, të nderuar deputetë, të kuptoni mandatin tuaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Grabovci është paraqitur për replikë.

ADEM GRABOVCI: Jo, zoti nënkryetar replikë, por vetëm desha një qartësim.

Partia Demokratike nuk ka kurrfarë shqetësimi. Partia Demokratike, përkundrazi po insiston që debati të shkohet deri në fund dhe t'i lëmë lojërat e të thirret debat dhe të friksohemi prej debati. Ne duam ta çojmë debatin deri në fund. Këtu jemi dhe të shkojmë deri në fund. Dhe, pikërisht mjerimi i këtij Parlamenti është se bëhet gjithçka në brendi të vet.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, më vjen keq që unë nuk mund të përdor ndonjë vendim personal, sipas praktikës dhe rregullave, unë dua ta hedh në votim.

(Ndërhyrje)

Atëherë, e votojmë mocionin e zonjës Alma Lama dhe kërkesën që të ketë debat. Regjia dhe deputetët, lutem që të bëheni gati për votim dhe votojmë tash.

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Atëherë, nuk ka kuorum për të vendosur. Pra, mbetet që kjo çështje të vendoset në mbledhjen e Kryesisë, ose në seancën e ardhshme.

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Shiko Alma, vetëm edhe diçka. Edhe tjetra ka qenë si pikë e fundit, ju kur të bëni kërkesën, kërkon se në cilën pikë e dëshironi të jetë. Urdhëro, bën, zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Unë për t'i sqaruar qytetarët e Kosovës. Ne e kishim një debat dje, të ngritur nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që vërtet Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, në përgjithësi e ka vlerësuar si debat dashamirës, në interes të ngritjes së cilësisë së veprimit të institucioneve shtetërore, të fuqizimit të shtetit dhe ne e kemi përkrahur dhe debatuar deri në fund.

Kjo që po ndodh sot, po shihet qartë se nuk janë në pyetje mbrojtja e interesave të qytetarëve, nuk janë në pyetje luftimi i dukurive negative, por është në pyetje diskreditimi dhe përpjekja për të bllokuar jetën institucionale në vend. Këtë nuk e kemi lejuar dhe nuk do ta lejojmë asnjëherë të vetme.

Deputetët e papërgjegjshëm, vërtet do ta marrin përgjigjen e merituar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj se seanca e sotme ka përfunduar. Kjo çështje mbetet të diskutohet në mbledhjen e Kryesisë, me kryetarët e grupeve.

Mirupafshim!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë